

ENVER HOXHA

VEPRA

28

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË
SIQIPËRISË



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TE PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

28

TETOR 1964 - JANAR 1965

SHITËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1978

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 28-TË

Në këtë vëllim të Veprave të shokut Enver Hoxha përshihen materiale të periudhës tetor 1964-janar 1965. Shumica e këtyre materialeve botohen për herë të parë.

Në fjalimet, artikujt, diskutimet në Byronë Politike e në Sekretariatën e Komitetit Qendror, në bisedat me të huajt dhe në shkrimet e tjera të kësaj periudhe pasqyrohet vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë në trajtimin e problemeve të brendshme dhe ndërkom-bëtare.

Në planin e brendshëm, karakteristikë themelore e kësaj periudhe ishte fryma e lartë dhe mobilizimi revolucionar i punonjësve për nder të 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Fjalimi «20 vjet Shqipëri socialiste» dhe dokumente të tjera të këtij vëllimi tregojnë për luftën dhe për punën e madhe të masave punonjëse nën udhëheqjen e PPSH për realizimin e detyrave në të gjitha fushat, për të plotësuar me sukses planin e vitit 1964, për të zhvilluar më tej forcat prodhuese, industrializimin dhe bujqësinë socialiste nëpërmjet intensifikimit të saj, duke kapërcyer çdo pengesë e vështirësi në rrugën e ndërtimit të plotë të socializmit në vëndin tonë. Në tërë këtë luftë, parimi nga i cili udhëhiqej

Partia jonë ishte ai i mbështetjes në forcat e veta. Ky parim përshkon gjithë materialet e këtij vëllimi, sidomos ato me titujt: «Kryesorja është të mbështetemi fuqimisht në forcat tona», «Në këto situata të përpiqemi për të shtuar rezervat» etj.

Gjithashtu në dokumentet e këtij vëllimi trajtohen probleme, që kanë të bëjnë me edukimin komunist të anëtarëve të Partisë e të punonjësve, me përgatitjen politiko-ideologjike dhe ushtarake të ushtrisë dhe të gjithë popullit ushtar. Ky problem merrte një rëndësi shumë të madhe për disa arsye, nga të cilat më kryesore ishin: së pari, sepse në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, krahas përfundimit të bazës materialo-teknike të socializmit ishte e domosdoshme të bëhej edhe kalitja e gjithanshme e njeriut tonë të ri, formimi dhe forcimi i ndërgjegjes së lartë socialiste të punonjësve. Pa këtë nuk mund të ndërtohej me ritmet e parashikuara socializmi në Shqipëri. Së dyti, bllokada ekonomike, presionet politike dhe kërcënimet ushtarake të armiqve imperialisto-revizionistë shtronin para PPSH dhe gjithë popullit detyrën për të krijuar gjithnjë e më shumë bindje të thella për situatën që kalonte vendi ynë dhe për luftën që duhej bërë në mbrojtje të fitoreve të arritura, në mbrojtje të atdheut socialist. Së treti, konceptet e shfaqjet e huaja te njerëzit bëheshin edhe më të rrezikshme për shkak të agresionit ideologjik imperialisto-revizionist, që u shtua shumë pas tradhtisë së udhëheqjes sovjetike dhe përhapjes së revizionizmit modern në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Prandaj në këto rrethana organizatat e Partisë u porositën që të dendë-

sonin punën edukative ideopolitike me komunistët dhe me punonjësit, gjë që duket, përveç të tjerave, edhe në dokumentet «Partia ka nevojë për diturinë dhe zotësinë e anëtarëve të saj», «Partia kërkon që populli dhe ushtria të jenë të qartë politikisht dhe të përgatitur ushtarakisht», «Të organizojmë dhe të drejtojmë më mirë arsimin e Partisë», «Të zhvillojmë në mënyrë të organizuar informacionin politik në Parti dhe në masat».

Në dokumentet e këtij vëllimi gjen shprehje të qartë politika e jashtme marksiste-leniniste e Partisë sonë. Thelbi i kësaj politike është vazhdimi me konsekuencë i luftës së PPSH si kundër imperializmit me atë amerikan në krye, ashtu dhe kundër revizionizmit hrushovian e titist, vendosmëria për të mbrojtur deri në fund marksizëm-leninizmin, revolucionin, luftërat nacionalçlirimtare të popujve. Si rrjedhim i kësaj lufte parimore, të vendosur e heroike të PPSH, si dhe të revolucionarëve e të marksistë-leninistëve të vërtetë të botës iu gris maska pseudomarksiste revizionistëve hrushovianë, u demaskua kursi revizionist e tradhtar, gjë që çoi në disfata të reja, në dështimin e vijës së tyre revizioniste në të gjitha fushat, si në planin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar, në politikë, në ideologji dhe në ekonomi.

Veçori dalluese e shkrimeve që botohen në këtë vëllim është analiza e thellë që u bëhet shkaqeve, të cilat çuan në rrëzimin e Hrushovit dhe në demaskimin e vijës revizioniste të udhëheqësve të rinj sovjetikë. Duke kujtuar se do të mënjanonin disfatën e plotë të vijës së tyre antimarksiste, revizionistët sovjetikë u de-

tyruan të largonin kryetarin e tyre, Hrushovin, nga skena politike. Rrëzimi i Hrushovit përbënte një grusht të rëndë për gjithë revizionistët modernë dhe një fitore të madhe për marksizëm-leninizmin. Kjo ngjarje vërtetonte edhe një herë drejtësinë e vijës marksiste-leniniste të PPSH dhe të luftës së saj parimore kundër revizionizmit hrushovian.

Edhe pas rrëzimit të Hrushovit, PPSH nuk ushqente asnjë iluzion për udhëheqjen e re sovjetike. «Rrëzimi i N. Hrushovit, vinte në dukje shoku Enver Hoxha... nuk shënnon fundin e revizionizmit hrushovian dhe as të revizionizmit modern në përgjithësi... bashkë me të nuk janë likuiduar kursi, politika dhe rrënjët socialekonomike të revizionizmit, vetë revizionizmi hrushovian... Prandaj Partia e Punës, si gjithë revolucionarët e vërtetë, nuk duhet dhe nuk do të ushqejë në këtë drejtim asnjë iluzion». Krejt ndryshe veproi Partia Komuniste e Kinës, e cila mendonte se me rënien e Hrushovit u zhdruk revizionizmi sovjetik dhe se do të rivendosej uniteti në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ky ishte një qëndrim antimarksist dhe kapitullues.

PPSH ishte e bindur plotësisht se nuk mund të kishte unitet në lëvizjen komuniste përderisa udhëheqja e re sovjetike zbatonte po atë vijë si dhe Hrushovi dhe, për të luajtur rolin e «dirigjentit», u kërkonte partive komuniste e punëtoare të ndiqnin kursin e saj, që s'ishte gjë tjetër veçse një kurs tradhtar, antimarksist, kurs i bashkëpunimit me imperializmin, me socialdemokracinë dhe me klikën e Titos.

Në shkrimet e këtij vëllimi demaskohet orvatja e

udhëheqësve të rinj revizionistë sovjetikë për të zhvilluar mbledhjen ndërkombëtare përçarëse, thirrjen e së cilës Hrushovi e kishte menduar për në muajin dhjetor 1964. Por udhëheqësit e rinj revizionistë sovjetikë e shtynë këtë mbledhje për të fituar kohë dhe për shkak të vështirësive që dolën në gjirin e revizionistëve ku ishin thelluar kontradiktat, kishin shpërthyer grindje e mosmarrëveshje që çuan në përçarje. Kjo u duk qartë në «Testamentin» e Toliatit, i cili kërkonte policentrizëm, shkëputje të plotë nga hegjemonia e grupit të Hrushovit dhe njëkohësisht shprehej për një liberalizim më të thellë dhe më të shpejtë të pushtetit sovjetik.

Në veprat e këtij vëllimi demaskohet demagogjia dhe taktika e re që u përpoqën të zbatonin revizionistët sovjetikë, me Brezhnjevën në krye, pas rrëzimit të Hrushovit, për ta bërë politikën e tyre antimarksiste më mashtruese kundrejt popullit sovjetik dhe popujve të tjerë. Në të njëjtën kohë PPSH tërhoqte vëmendjen e komunistëve dhe të gjithë punonjësve që të qëndronin vigjilentë ndaj çdo veprimtarie armiqësore të revizionistëve. Ajo ndoqi me vendosmëri luftën kundër revizionizmit hrushovian për ta çuar atë deri në shpartallimin e tij të plotë. Prandaj në këtë situatë, shoku Enver Hoxha, vinte në dukje se është detyrë e të gjithë marksistë-leninistëve që të mos gënjenen nga pasardhësit e Hrushovit, por të vazhdojnë me konsekuencë luftën kundër revizionizmit modern.

Materialet që përfshihen në vëllimin e 28-të kanë një vlerë të madhe aktuale. Ato janë një armë e fu-

qishme në duart e komunistëve, të klasës punëtore, të mbarë masave tona punonjëse, për të qenë kurdoherë vigjilentë në mbrojtjen e fitoreve të arritura në ndërtimin socialist të vendit, si dhe në luftën për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit nga revizionistët e të gjitha ngjyrave.

PARTIA KA NEVOJË PËR DITURINË DHE ZOTËSINË E ANËTARËVE TË SAJ

*Fjala në Shkollën e Partisë «V.I.Lenin» me rastin
e 15-vjetorit të krijimit të saj*

20 tetor 1964

Të dashur shokë,

Është një gëzim i madh për mua që, në këtë ditë solemne e të gëzuar për të gjithë komunistët dhe popullin tonë, në ditën e 15-vjetorit të krijimit të Shkollës së Partisë «V.I.Lenin», gjendem këtu me ju, shokët e Partisë, të luftës dhe të punës për ndërtimin e socializmit. Për të gjithë ne kjo shkollë është e dashur dhe shumë e shtrenjtë, se është fidanishtja që rrit e kalit kuadrot e Partisë, ata kuadro që mbajnë mbi supet e tyre detyra shumë të rënda, të cilat duhen zgjidhur me sukses. E për t'i zgjidhur ato me sukses kërkohet jo vetëm trimëri e guxim, por edhe dituri. Tipare e veti të tilla komuniste na karakterizojnë edhe ne, komunistët e kuadrot, që kemi përgjegjësi të mëdha para Partisë dhe popullit. Kur themi se Partia jonë udhëheq popu-

llin dhe atdheun në rrugën e ndritur të socializmit, me këtë kuptojmë pikërisht përgjegjësinë e rëndë që i ësh-të ngarkuar Partisë. Por të mos kujtojmë se kjo përgjegjësi qëndron vetëm mbi ne, anëtarët e Partisë dhe se ne jemi të vetmit që bëmë luftën për çlirimin e atdheut dhe tani po bëjmë luftën tjetër për ndërtimin e socializmit. Jo. Në këtë luftë të madhe ka marrë dhe merr pjesë i gjithë populli, marrin pjesë të gjithë patriotët shqiptarë, të vjetër e të rinj, gra e burra. Përgjegjësia e Partisë sonë qëndron në faktin që ajo udhëheq, frymëzon dhe organizon masat e popullit, i edukon këto që detyrat e mëdha të kryhen të gjitha me sukses. Prandaj kjo shkollë është e dashur për Partinë dhe popullin tonë dhe ju i kuptoni mirë përfitimet e mëdha që keni prej saj.

Ne jemi në dijeni se ç'rezultate të kënaqshme ka arritur kjo shkollë, jo vetëm nga numri prej 4 000 vetash që e kanë kryer atë e që përbëjnë një ushtri të tërë, po edhe për faktin se shokët që kanë mbaruar këtë shkollë kanë dhënë një kontribut të madh për kalitjen dhe për forcimin ideologjik të Partisë, kanë përhapur dhe kanë rrënjosur në masat e popullit vijën, direktivat dhe metodën e punës e të luftës së saj.

Bashkë me kuadrot që mbarojnë çdo vit Shkollën e Partisë ka edhe mijëra të tjerë që kanë kryer shkolla 7 e 8-vjeçare, të mesme dhe të larta dhe të gjithë së toku, të frymëzuar nga doktrina jonë e pavdekshme e marksizëm-leninizmit, kanë bërë që vendi ynë të ketë rezultate kaq të mëdha në të gjitha fushat. Partia jonë, gjatë gjithë kësaj kohe, ka luftuar bashkë me popullin kundër vështirësive të panumërta e pengesave

të shumta të cilat ka mundur t'i kapërcejë me sukses. Kjo, në një pjesë të madhe, u detyrohet edhe punës e përpjekjeve të kuadrove tanë e të patriotëve, që në luftën dhe në punën e tyre janë frymëzuar kurdoherë nga vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë.

Detyra themelore për ju, studentët e Shkollës së Partisë është përgatitja me teorinë marksiste-leniniste dhe me kulturë të përgjithshme. Vetë marksizëm-leninizmi është një shkencë. Përveç marksizmit këtu në shkollë, ju, njëkohësisht zgjeroni horizontin edhe me kulturë të përgjithshme. Vitet e para pas Çlirimit në kemi pasur vështirësi se kuadrot tanë atëherë vërtet kishin një përvojë të madhe lufte, ishin të regjur në përpjekje e në vështirësi, por nivelin arsimor e kulturor e kishin akoma të ulët. Kështu shokët që kanë ardhur vitet e para në këtë shkollë ishin shokë të mirë, besnikë e të veçdosur, por nuk e kishin atë kulturë të përgjithshme që keni ju sot. Ju keni të paktën shtatëvjeçaren, bile shumë prej jush kanë edhe shkollën e mesme. Prandaj detyra juaj tani është ta përvetësoni sa më mirë teorinë marksiste-leniniste.

Në këtë çështje kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm pedagogët, që, sikurse theksohet në letërën e Komitetit Qendror drejtuar shkollës me rastin e këtij përvjetori, kanë punuar me të gjitha forcat e me ndërgjegje të lartë duke u përpjekur që t'ju shpjegojnë sa më mirë teorinë, ta lidhin atë sa më mirë me praktikën. Dhe mund të themi se në përgjithësi kuadrot, kur dalin nga kjo shkollë, nuk janë të shkëputur nga praktika, nga lufta që bën populli ynë për ndërtimin e socializmit, prandaj e marrin shpejt punën në dorë

atje ku i çon Partia. Kjo do të thotë se mësimet, teorinë, ata i lidhin mirë dhe kurdoherë me praktikën.

Le të më lejojnë pedagogët, roli i të cilëve është i madh në këtë drejtim, t'u jap ndonjë këshillë. Ata, duke dhënë mësim, duhet t'i njohin studentët me diturinë dhe me përvojën e tyre. Kur ngjiten në katedër, të mos kufizohen duke lexuar, qoftë edhe bukur, një leksion, por ta ndiejnë veten të lidhur ngushtë me studentët, të bëjnë përpjekje e përgatitje sistematike që, kur të vijnë në klasë, t'u japin këtyre të gjithë diturinë, sigurisht jo në mënyrë dogmatike, por krijuese; në qoftë se shpjegimi i pedagogëve ngjall dhe nxit te studentët interesimin, kjo tregon se ju, shokë studentë, bashkëjetoni me ta, me përvojën dhe me metodën e tyre të mirë. Pedagogët duhet të largohen nga mësimi formal, se një punë e tillë nuk jep rezultate. Mësimin ta shpjegojnë të lidhur ngushtë me jetën, me praktikën, ta ilustrojnë me shembuj të gjallë, ta bëjnë të qartë, të kuptueshëm, të këndshëm, ta lidhin me detyrat, me situatën aktuale. Pedagogu të mos mjaftohet vetëm me tregimin e thjeshtë të mëimit, me anën historike të problemit që shtrohet. Edhe ana historike duhet, po në radhë të parë kërkohet të mësohet si do të ecin, për shembull, kooperativat bujqësore, tregtia apo sektorët e tjerë të vendit tonë. Pra, kur pedagogu flet për një problem, të tregojë edhe të kaluarën, edhe të tashmen, të shpjegojë njëkohësisht edhe rrugën për zgjidhjen e problemit sot, edhe perspektivën. Kjo është e domosdoshme, se, kur studenti do të mbarojë shkollën, nuk do të mbyllet në katër muret, as do të mendojë sa të fusë në xhep diplomën e të vërë festen mbi sy. Jeta

do t'i kërkojë atij llogari, probleme të shumta e të koklavitura do t'i dalin përpara dhe do të kërkojnë zgjidhje në praktikë. Prandaj teoria marksiste-leniniste që mësohet në shkollë, rrit aftësitë dhe shton mundësitë që njeriu në jetë të kryejë mirë detyrat, të veprojë me iniciativë, me guxim dhe të arrijë rezultate. Kështu na mëson Partia të jemi ne, bijtë e saj dhe ne marrim shembull nga urtësia, guximi e pjekuria e saj.

Këto i theksoj sepse kanë rëndësi, se pedagogëve Partia u ka dhënë besim të madh, prandaj secili prej tyre, duke dhënë mësimin, teorinë, duhet t'u hapë studentëve horizonte të gjera, t'u japë një pamje të gjerë të thellësisë dhe të përpikërisë së shkencës së madhe marksiste-leniniste, t'u hapë njëkohësisht perspektivën e zhvillimit të shoqërisë. Kjo është e rëndësishme, sepse anëtarët e Partisë duhet të shohin larg dhe të jenë kurdoherë të armatosur për të ecur përpara, në krye të masave punonjëse.

Ngjarjet që po zhvillohen nuk janë të thjeshta. Shumë parti të mëdha gjatë këtyre viteve u zhytën në batakun e revizionizmit, kurse Partia jonë, me konsekuencën e rreptë marksiste-leniniste që e karakterizon, i zgjidhi problemet e kohës me urtësi dhe me pjekuri, duke hedhur hapa të matur, duke mbajtur qëndrime revolucionare, duke ecur në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Prandaj ju, shokë studentë dhe pedagogë, kini parasysh që kurdoherë të krijohen lidhje midis asaj që mësoni dhe asaj që do të bëni nesër në jetë. Secili mëson sot, që nesër, në jetë, të luftojë me sukses e pa e humbur ekuilibrin, prandaj mësimi duhet përvetësuar mirë, i lidhur me jetën. Partia i mëson anëtarët e saj

që të jenë luftëtarë të aftë për socializmin dhe, që të bëhen të tillë, detyra e tyre është që të mësojnë teorinë marksiste-leniniste të lidhur ngushtë me praktikën revolucionare. Te praktika është përqendruar e gjithë përvoja e njerëzimit, kurse teoria jonë është përgjithësimi i saj shkencor, prandaj s'duhet shkëputur njëra nga tjetra.

Ne jemi të bindur se pedagogët e Shkollës së Partisë i mësojnë në këtë drejtim studentët, të cilët janë të etshëm, të kujdesshëm për ta shfrytëzuar këtë eksperiencë të madhe të tyre; ata ju armatosin me aftësi për të zgjidhur problemet që do t'ju dalin në jetë. Dhe vendi ynë ka shumë probleme për të zgjidhur. Në këto çështje unë nuk do të hyj, se ju i mësoni çdo ditë, kurse çështjet e shkollës i trajtoi edhe drejtori dhe pedagogët bisedojnë me ju çdo ditë. Prandaj unë dëshiroj të flas pak për situatën politike aktuale, për luftën tonë kundër revizionizmit modern.

Është fakt se bota kapitaliste ka qenë dhe është në krizë, e cila vazhdon të thellohet. Kapitalizmi botëror po përpiqet të dalë nga kjo krizë, përpiqet të shpëtojë nga shkatërrimi i tij total, përpiqet të mënjanojë vdekjen e tij. Nuk është formulë ajo që thotë Partia se, për të shpëtuar nga kriza, imperialistët përgatitin luftën. Imperializmi botëror, me atë amerikan në krye, ka filluar dhe vazhdon përgatitjet për luftën e re kundër popujve. Për këtë qëllim ai armatohet, njëkohësisht forcon edhe diktaturën e vet borgjeze e, në disa vende, diktaturën e egër fashiste. Për të realizuar synimet e tij agresive, imperializmi punon jo vetëm në SHBA, por edhe në vende të tjera, duke shtypur çdo lëvizje de-

mokratike e përparimtare. Pas Luftës së Dytë Botërore imperializmi e pa që kampi socialist, me Bashkimin Sovjetik në krye, u bë një forcë kolosale, prandaj ai donte ta likuidonte. Po si? Brenda në SHBA u orvat të vendoste në vend diktaturën fashiste me Makartin në krye, i cili është një fashist. Mirëpo imperializmi amerikan nuk mundi ta bënte këtë, se forcat e revolucionit dhe të demokracisë nuk e pranonin fashizmin. Atëherë ai zgjodhi një rrugë tjetër, të shfrytëzojë revizionizmin modern në luftë kundër revolucionit, marksizëm-leninizmit dhe kampit socialist në shkallë botërore e për këtë gjeti momentet e përshtatshme.

Revizionizmi modern lindi më parë në Jugosllavi, Jugosllavia e Titos u bë vendi i parë ku revizionizmi erdhi në pushtet dhe i drejtoi goditjet kundër revolucionit dhe marksizëm-leninizmit. Kur ishte Stalini gjallë, Bashkimi Sovjetik dhe partia bolshevike ndiqnin një rrugë të drejtë marksiste-leniniste, qëndronin vigjilentë, prandaj revizionistët modernë, me klikën tradhtarë të Titos në krye, u izoluan dhe u demaskuan. Por pas vdekjes së Stalinit, ndodhi ajo që e dimë të gjithë.

Cili ishte qëllimi i imperializmit botëror, veçanërisht i atij amerikan, që nxiti dhe fuqizoi revizionizmin modern? Kryesorja ishte të goditej koka e kampit socialist, Bashkimi Sovjetik, sepse ai kishte një potencial të madh ushtarak, ekonomik dhe ideologjik, sepse ai ishte pararoja që e kërcënonte për vdekje imperializmin dhe se rreth tij qëndronin kompaktë të gjitha vendet socialiste, të gjithë marksistë-leninistët, të gjitha partitë marksiste-leniniste në fuqi ose jo. Prandaj imperializmi nuk mund të mjaftohej vetëm me revizionizmin

jugosllav, objektivi kryesor i tij ishte Bashkimi Sovjetik, ku lindi revizionizmi në format që i dimë, ku humbi vigjilenca, revolucionarët i zuri gjumi e armiqtë gjetën momentin dhe ngritën krye, duke goditur vendin e parë socialist në botë.

Hrushovi dhe grupi i tij hynë në shërbim të ideologjisë borgjeze, braktisën dhe tradhtuan marksizëm-leninizmin, i hapën këtij luftë në drejtimin e dëshiruar nga imperializmi amerikan, në ndihmë të strategjisë së tij. Këtë ju e keni të qartë, e mësoni në shkollë.

Si e zhvilloi revizionizmi modern hrushovian këtë luftë në shërbim të imperializmit amerikan për shkatërrimin e BS e të kampit socialist? Kjo ka një fillim, po lufta e hapët nisi në kongreset e 20-të dhe të 22-të. Aty u formuluan dhe u vunë në veprim tezat e revizionistëve. Cilat ishin këto teza? Ato të bashkekzistencës paqësore, të rrugës paqësore, të çarmatimit etj., të cilat u veshën me rroba «leniniste».

Për bashkekzistencën paqësore ka folur Lenini, për çarmatimin ka qenë kurdoherë Bashkimi Sovjetik, për paqen kanë luftuar gjithnjë Bashkimi Sovjetik dhe të gjithë komunistët e botës. Por këto parulla të drejta i morën revizionistët modernë, Hrushovi dhe hrushovianët, i përpunuan sipas dëshirës dhe interesit të tyre dhe i propaganduan si teza leniniste, por në fakt ato ishin revizioniste. Në praktikë, me bashkekzistencë paqësore revizionistët kuptojnë bashkëpunim klasor, politik e ideologjik me imperializmin, sidomos me atë amerikan. Kjo është brendia e teorisë së bashkekzistencës hrushoviane. Sipas revizionistëve hrushovianë, tani nuk ka më luftë, nuk ka më revolucion, se imperializmi na qenka

zbutur, pra në socializëm do të vemi me rrugë paqësore! Dhe dihet se lufta bëhet me armë, prandaj, për t'i gënjyer masat dhe komunistët e të gjithë botës, revizionistët hodhën idenë e çarmatimit, ide që nuk do të realizohet kurrë derisa ekziston imperializmi, i cili nuk i hedh armët.

Qëllimi kryesor i revizionistëve me këto teza ishte që imperializmi dhe borgjezia të krijonin besimin te hrushovianët, të bindeshin se Hrushovi dhe shokët e tij, që ishin në fuqi dhe e kishin hedhur BS në kthetrat e tyre, ishin miq të imperializmit amerikan dhe të borgjezisë liberale, se kishte kaluar koha e diktaturës së proletariatit, se në fuqi nuk ishin më as Stalini, as nxënësit e tij, po «jemi ne hrushovianët dhe populli ne na do, se me ne ju, imperialistë, mund të merreni vesh dhe ne jemi për marrëveshje, për bashkekzistencën paqësore, për çarmatimin, për botën pa luftëra, pa armë, pa ushtri» etj.

Nga ana tjetër «teoritë» e revizionistëve modernë nuk mund të ecnin si në gjalpë, prandaj atyre u duhej të luftonin me të gjitha forcat kundër marksizëm-leninizmit brenda në partitë e tyre dhe jashtë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Në vendet e tyre, ata luftuan për degjenerimin e partisë, për liberalizimin e diktaturës së proletariatit, për demoralizimin e komunistëve revolucionarë, për t'i komprometuar ata me të gjitha format. Dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare u përpoqën të krijohej një aleancë e fortë e revizionistëve kundër partive të vërteta marksiste-leniniste, siç është Partia e Punës e Shqipërisë dhe të gjitha partitë e tjera që qëndrojnë në pozita revolucionare. Ju e

dini që nga ana e tyre këto përpjekje u zhvilluan në shkallë të gjerë.

Lufta filloi, së pari, kundër Partisë sonë. Hrushovi hapi zjarr kundër saj se e pa që rreziku për të, nga Partia jonë, ishte i madh. Kjo tregon që armiku revizionist nuk u tregua sylesh, ai e kuptoi që Partia e Punës e Shqipërisë ishte pengesë për revizionistët modernë dhe hrushovianë. Partia jonë iu përgjigj zjarrit të Hrushovit dhe ky zjarr i fuqishëm i Partisë sonë nuk u shua dhe nuk do të shuhet kurrë. Ky është një she-mbull tipik heroik i zbatimit të marksizëm-leninizmit, që tregon se si një parti e vogël mund t'u rezistojë jo vetëm një partie të madhe, por edhe një koalicioni partish revizioniste, që kanë drejtuar kundër saj të gjitha mjetet, që nga propaganda e gjer te bllokada ekonomike, me qëllim që ta gjunjëzojnë atë dhe popullin tonë. Por Partia jonë jo vetëm rezistoi e nuk u përkul asnjë grimë, por u dha zemër e i frymëzoi me qëndrimin e vet dhe shumë parti të tjera. Taktikat e drejta të Partisë sonë i frymëzuan dhe i shpëtuan ato nga rreziqet që u kanoseshin. Dhe këtë ne e të tjerët që e çmojnë lart Partinë tonë, nuk e themi për t'u mburrur, por për të treguar realitetin si marksistë.

Hrushovi dhe të gjithë aleatët e tij, siç e dini, kapitulluan përpara imperializmit amerikan. Kështu u krijuan situata shumë të favorshme për imperializmin. Revizionistët arritën të bëjnë me imperialistët edhe marrëveshje sekrete, edhe marrëveshje të hapëta, sikurse janë traktati i Moskës, marrëveshjet tregtare në stil të gjerë, marrëveshjet kulturore të dyerve të hapëta dhe, më në fund, tratativa për shitjen e RD Gjermane. Nga

ana tjetër, çështja e sekreteve ushtarake të BS, të mos flasim për ato ekonomiket që po e po, të tëra kaluan në duart e imperializmit amerikan. Dihet se si Hrushovi arriti të kapitullonte përpara forcës ushtarake amerikane në Kubë.

Kurse brenda në BS revizionistët hrushovianë ndërmoren të gjitha masat që dimë për kthimin e BS në një republikë demokratike liberale borgjeze. Në këtë kuadër, në radhë të parë, ata vepruan për të shkatërruar bujqësinë kolkoziane. Kjo punë ka filluar prej kohësh në shkallë të gjerë, duke krijuar në fshat kulakërinë, mbështetjen e regjimit tradhtar revizionist.

Ju e dini konfuzionin e madh që ka krijuar Hrushovi në BS në çdo fushë, saqë tani ata që erdhën pas tij¹ në fuqi nuk dinë ku kanë kokën. Në ekonomi e në industri ka disfata të mëdha jo vetëm politike dhe ideologjike, por edhe organizative. Partia për Hrushovin duhej shpartalluar në seksione. Kështu ai krijoi partinë e industrisë, partinë e bujqësisë², u bënë re-

1 Revizionistët sovjetikë, për t'i shpëtuar disfatës së plotë të vijës së tyre antimarksiste, në plenumin e KQ të PK të BS të 14 tetorit 1964, u detyruan ta largojnë nga skena politike kryetarin e tyre, N. Hrushovin.

2 Në plenumin e nëntorit 1962 KQ i PK të BS mori vendim për rindërtimin e partisë; duke hequr dorë nga principi i ndërtimit territorial të partisë u kalua në principlin e organizimit të partisë mbi bazën e prodhimit. Kështu në çdo republikë autonome, qark apo rajon u krijuan komitete të partisë që përgjigjeshin për industrinë dhe komitete të partisë që përgjigjeshin për bujqësinë. Pra u krijuan partia e bujqësisë dhe ajo e industrisë.

forma të tjera aq të shumta, aq konfuze, aq të paqëndrueshme, që janë tipike të një pune armiqësore për krijimin me plan të anarkisë, për hutimin e njerëzve dhe të kuadrove sovjetikë.

Pra, e gjithë kjo vijë për «ndërtimin e socializmit» në BS, pësoi disfatë. Mos mendoni, shokë, se kundër revizionizmit modern luftoi vetëm Partia jonë. Do të ishte gabim të mendohej kështu. Partia jonë luftoi me heroizëm, konsekuencë dhe drejt, po kundër revizionizmit luftuan forcat marksiste-leniniste kudo, në çdo vend, në forma të ndryshme, ku fshehtazi, ku haptazi, në mënyrë të dukshme ose të padukshme; kudo marksizëm-leninizmi revolucionar veprroi kundër kësaj sëmundjeje të tmerrshme në gjirin e vet. Në këtë luftë morën pjesë edhe njerëz përparimtarë e të ndershëm. Kjo luftë e gjithanshme, revolucionare, e udhëhequr nga partitë tona marksiste-leniniste, bëri që çdo veprim i bandës së Hrushovit, i Titos dhe i aleatëve të tyre të demaskohej.

Vija e Hrushovit bëri që në BS të mos ketë as bukë as mish dhe këto ai u detyrua t'i blejë me flori nga amerikanët. Që t'i mbulonte disfatat, ai zhvilloi një plenum për problemet e kimizimit, sikur me këtë bëri një zbulim të madh, i cili s'qenkësh arritur më parë! Po ai e bëri këtë se nuk kishte bukë, prandaj, «për të qetësuar» njerëzit, trumbetoi se kimia do të bëjë mrekullira. Po edhe zhvillimin e industrisë kimike ai e parashikoi ta bënte «me ndihmën» e imperializmit amerikan dhe të Gjermanisë Perëndimore. Me një fjalë, Hrushovi erdhi në një pikë sa ia shiti Bashkimin Sovjetik kapitalit të huaj, imperializmit amerikan, anglez, gjerman. Ai jo vetëm e shiti Bashkimin Sovjetik nga

ana ekonomike, po e shiti edhe nga ana politike e ideologjike. Marksizmi na mëson se imperializmi nuk të jep kurrë asgjë «për të ndërtuar socializmin», përkundrazi, nëse ai të jep diçka, këtë e bën vetëm për ta shkatërruar socializmin dhe për të rivendosur kapitalizmin.

Në Kongresin e 20-të Toliati duartrokiti si gjithë të tjerët, se ato që tha atje Hrushovi ishin në favor të pikëpamjeve të tij revizioniste, në favor të imperializmit. Të gjithë revizionistët e duartrokitën Kongresin e 20-të, sepse ai paskësh hapur një «epokë të re», domethënë epokën e shkatërrimit të komunizmit dhe krijimin e një komunizmi të tyre, «të vërtetë», «leninist». Toliati që në fillim ishte i mendimit se stalinizmin e kishte krijuar sistemi sovjetik, prandaj, duke kritikuar Stalinin, ai kërkoi t'i shkohej thellë çështjes, të gjendeshin rrënjët, domethënë të goditej sistemi. Sistemi sovjetik, sipas Toliatit, duhej dënuar, jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra, me shpejtësi, me të gjitha format dhe metodat që «të demokratizohet», domethënë të likuidohet. Këtë e kërkonte që imperializmit amerikan, borgjezisë italiane dhe asaj botërore t'u jepeshin prova me fakte, t'u zhdukej frika nga «gogoli» sovjetik i krijuar nga Stalini, që borgjezia të mos kishte më frikë nga regjimi sovjetik dhe, atëherë, po të mos kishte më frikë, çështja e bashkekzistencës paqësore që kishin vendosur revizionistët bëhej e realizueshme, çështja e çarmatimit gjithashtu do të zgjidhej, se nuk do të ekzistonte më frika e kapitalizmit nga sistemi sovjetik. Që të bëhej kjo, mendimi i Toliatit ishte që në këtë drejtim të shkohej me guxim përpara, në radhë të parë në Bashkimin So-

vjetik, pra të shkatërrohej PK e BS, të likuidoheshin metodat, fryma marksiste-leniniste që ka udhëhequr PK të BS, të shkohej drejt «demokratizimit», të shkatërrohej sistemi sovjetik i bujqësisë, të trumbetohej se nuk ka qenë «asgjë» puna e kolkozeve, se ato «ishin ngritur me forcë» etj.

Gjithashtu në industri të krijohej një sistem ku shpërblimi material të zinte vendin e parë. Partia bolshevike të merrte mundësisht formën e një partie socialdemokrate, ku të kishte «liri të plotë fjale», ku secili të llototiste çfarë të donte e çfarë t'i vinte në kokë, domethënë të arrihej në sistemin e shumë partive, «sikurse jemi ne këtu, në vendet kapitaliste», mendonte Toliati. Këto ishin pikëpamjet e revizionistëve italianë, të cilat Toliati nuk i tha që në fillim, si çështjen e policentrizmit që e ngriti qysh atëherë, sipas së cilës të kishte shumë qendra drejtimi. Më vonë këtë ide ai e kristalizoi në «testamentin»¹ e tij.

Në lëmin ndërkombëtar revizionistët hrushovianë kapitulluan përpara shantazhit atomik, përpara presionit të imperializmit amerikan, me bashkekzistencën paqësore nuk fituan asgjë përveç dështimit. Paqja, që Hrushovi predikoi me të madhe, nuk mund të vendosej, përkundrazi u shtuan vatrat e luftës së popujve kundër imperializmit dhe kolonializmit. Pas ardhjes së Hrushovit në fuqi ne asistuaam jo vetëm në luftë «të ftohtë», po edhe në «të nxehtë». Çarmatim nga imperialistët asgjëkundi nuk ra erë, përkundrazi kudo armatim i

¹ Shih në këtë vëllim f. 114.

ethshëm. Të gjitha këto e demaskuan grupin tradhtar të Hrushovit. Pra, revizionistët patën disfata. Veçanërisht disfata të mëdha patën sidomos në luftën kundër marksizëm-leninizmit në arenën ndërkombëtare. Ata jo vetëm nuk mundën ta mposhtnin dot marksizëm-leninizmin, por përkundrazi forca e tij revolucionare që ishte vazhdimisht në rritje, i pengonte Hrushovin dhe satelitët e tij në veprimtarinë e tyre armiqësore.

Kështu erdhi një moment që Hrushovi, si agjent i vendosur i imperializmit, kësaj çështjeje duhej t'i vinte kufi, domethënë erdhi një moment që ai duhej të ndante hesapet me marksizëm-leninizmin. Deri në një kohë u përpoq me të gjitha mjetet që ne të pushonim polemikën me revizionistët, se kjo ishte vdekjeprurëse për ta. Por Partia jonë ka meritën e madhe që polemika kundër tradhtarëve revizionistë jo vetëm nuk u shua, po as u dobësua. Ky është një kyç i fitores sonë. Hrushovin duhej ta demaskonim dhe ne do ta demaskojmë gjer në fund tradhtinë e madhe të revizionizmit modern. Atëherë, kur u pa se dështuan të gjitha manovrat, lajkat e demagogjia e tij, ai hodhi parullën e «mbledhjes së komunizmit ndërkombëtar»¹. Qëllimi kryesor i Hrushovit me këtë ishte të ndante lakrat me ata që mbanin lart flamurin e marksizëm-leninizmit.

Kjo tregonte se kriza e revizionistëve ishte thelluar, prandaj Hrushovi zgjodhi vetëvrasjen. Mirëpo kishte të tjerë që ishin më të zgjuar se ai dhe i thanë ndal, se «ne nuk mund të shkojmë më tutje, se është rrezik i madh

1 Është fjala për mbledhjen e revizionistëve që ishte caktuar për t'u bërë në dhjetor 1964, por që u shty për në mars 1965.

dhe se duhet të vazhdojmë luftën me metoda më të stërholuara për të mashtruar Partinë e Punës të Shqipërisë si edhe partitë e tjera që qëndrojnë në pozita marksiste-leniniste».

Revizionizmi modern nuk mund të përfaqësojë unitetin, sepse unitet ka vetëm mbi bazat e marksizëm-leninizmit. Marksistët mund të jenë të bashkuar vetëm nën flamurin e marksizëm-leninizmit, kurse revizionistët janë tradhtarë të marksizëm-leninizmit, janë agjentë të borgjezisë. Revizionizmi është një rrymë ideologjike e borgjezisë, prandaj në radhët e tij nuk mund të ketë unitet. Përkundrazi revizionistët kanë farën e grindjes dhe të përçarjes, ashtu sikurse kanë farën e kontradiktave imperializmi dhe borgjezia. Revizionistët kanë unitet në shkallë strategjike, për të shkatërruar marksizëm-leninizmin dhe vendet socialiste, me këtë ata janë dakord, po për sa u përket taktikave për të arritur objektivin strategjik, ata nuk mund të kenë kurrë unitet. Për shembull, në Hungari partia është bërë një han me dy porta. Atje mund të hyjë kushdo, pa marrë parasysh se kush është e ç'veprimtari ka kryer. Kontradiktat midis Gomulkës e Hrushovit janë shtuar. Në vendet e tjera revizioniste ka tendenca kundër Hrushovit.

Revizionistët arritën në një situatë të tillë që të kenë njëfarë «lirie» nga Hrushovi. Ky, që luftoi për të diskredituar idealin e madh të partisë bolshevike të Bashkimit Sovjetik, predikoi edhe çështjen e «lirisë» së çdo partie. Po këtë «liri» ai e predikoi vetëm me fjalë. Atë ai e kuptonte që të tjerët të bënin ç'të donin, po ama kur të thoshte Hrushovi një gjë, të gjithë ta zbatonin! Ai, që të mund të grumbullonte të gjithë revizio-

nistët në një mbledhje dhe atje të merrte vendim kundër nesh, duhet të krijonte një unitet të tij në gjirin e revizionistëve. Pa këtë unitet ai do të mbaronte, se ishte diskredituar, kishte pësuar disfatë. Prandaj në gjirin e revizionistëve u duk hapur një krizë e rëndë, që ekzistonte qysh më parë, po kjo u acarua më shumë në lidhje me mbledhjen.

Në këtë krizë të revizionistëve, Hrushovi u ngrit dhe vendosi në mënyrë arbitrare të bëjë mbledhjen. Disa i pyeti për këtë, disa nuk i pyeti fare. Kështu do-lën edhe një herë në pah kontradiktat e tyre.

Pikërisht në një moment të tillë Partia jonë e gjykoj se ishte koha të botonte Letrën e Hapur drejtuar komunistëve të Bashkimit Sovjetik¹. Në këtë Letër sintetizohen idetë e marksizëm-leninizmit. Marksizëm-leninizmi është shkencë. Komiteti Qendror i PPSH mund ta kishte botuar edhe më parë Letrën, po këtë nuk e bëri, mendoi të mos shpejtohej, këtë do ta bënte, siç e bëri, në një moment të përshtatshëm. Dhe ky moment erdhi, ne e botuam Letrën, «bomba» u hodh.

Ka njerëz që thonë: Mos vallë ka ditur gjë Partia e Punës e Shqipërisë në lidhje me komplotin që u bë në Bashkimin Sovjetik për të rrëzuar Hrushovin? Jo, ne nuk kemi ditur gjë, po logjika marksiste-leniniste na mësoi të arrinim në këtë masë duke botuar Letrën. Dhe disa ditë pas botimit të Letrës së Hapur, Hrushovi u rrëzua.

Tani le ta gjykojmë si qëndron kjo çështje. Me sa

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 27, f. 353.

duket grupit tradhtar të Hrushovit do t'i ketë ardhur thika në grykë që arriti ta sakrifikonte atë. Kuptohet që njerëzit e grupit revizionist që sundon tani në Moskë, janë përsëri revizionistë, por nuk mund të ecnin më me metodat e tij.

Së pari, ata shihnin se me imperialistët amerikanë Hrushovi dhe tërë grupi i tij kishte shkuar shumë larg. Ata duhet të kenë parë se tratativat me amerikanët kishin hyrë në një rrugë të tillë saqë rrezikohej çështja nacionale e BS. Të mos kujtojmë se revizionistët janë agjentë të shitur tek imperializmi me kuptimin e ngushtë të fjalës. Jo, ata janë të tillë agjentë ideologjikë si Hrushovi me shokët e tij që përpiqen ta kthejnë Bashkimin Sovjetik në një vend kapitalist. Pra tratativat e Hrushovit me amerikanët mund të kenë arritur në një shkallë të tillë saqë kanë prekur interesat e BS. Kush na siguron që në këtë aleancë të fshehtë, nëpërmjet Axhubeit, Hrushovi të mos ketë rënë në marrëveshje sekrete edhe me Bonin për të sakrifikuar Republikën Demokratike Gjermane?

Së dyti, në kampin revizionist filloi të flitet se nuk janë dakord për shumë gjëra me Hrushovin. Filloi çarja, mosmarrëveshja, rezistenca. Kjo do të thotë që polemika kundër marksizëm-leninizmit, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe partive të tjera që qëndrojnë në pozita revolucionare jo vetëm që nuk u shua dot, përkundrazi, ajo u shtua edhe më shumë dhe u bë rrezik i madh kërcënues për revizionistët. Lindën si pasojë grupe revolucionare, u krijuan parti e grupe të reja, kurse Hrushovi nga ana e vet insistonte për mbledhjen. Ky ishte një shkak i rëndësishëm për revizionistët që

zunë të mendonin se me Hrushovin nuk mund të ecej më, prandaj e eliminuan. Hrushovi është ai që i hapi rrugën revizionizmit modern në BS, që qëlloi me artilleri të rëndë partinë bolshevike, Stalinin etj. Me kongreset e 20-të dhe të 22-të, të cilat janë frymëzim i vepërës tradhtarë të Hrushovit, kanë qenë dhe janë plotësisht dakord edhe udhëheqësit e rinj që janë tani në fuqi në BS. Mirëpo erdhën të tilla disfata për revizionistët saqë ata kanë nevojë të marrin ca frymë për të mbledhur pak veten. Ato që deklaruan ata se e hoqën Hrushovin për arsye gjoja pleqërie dhe sëmundjeje janë përralla. Në të vërtetë ata e hoqën atë me metoda puçiste. Ashtu sikurse erdhi në fuqi, ashtu edhe u hoq nga pushteti.

Kjo ngjarje është një fitore e marksizëm-leninizmit dhe njëkohësisht një disfatë e madhe për revizionistët, një thellim i mëtejshëm i krizës së tyre. Tani duket që kriza e revizionistëve vazhdon të thellohet, gjë që vërteton drejtësinë e vijës së Partisë sonë.

Gjithë lufta dhe qëllimet e revizionistëve dhe të imperializmit janë që të dobësohet, të degjenerohet BS, që ky të mos bëhet më një rrezik për borgjezinë kapitaliste. Hrushovi, si revizionist me damkë, kërkonte t'i mbante nën fre të tjerët dhe BS të kthehej në një vend kapitalist për të dominuar botën. Amerikanëve u intereson dhe duan që të degjenerohet BS, të cilin ta kenë nën kontrollin e tyre.

Po ç'janë këta njerëz që rrëzuan Hrushovin? Ata janë revizionistë, bashkëpunëtorë të Hrushovit. Bashkë me Hrushovin ata bënë kongreset e 20-të e të 22-të dhe janë të vendosur të ecin në këtë rrugë. Bëhet me

të drejtë pyetja: po pse atëherë e rrëzuan Hrushovin kur janë të tillë? Ata thonë se e rrëzuan edhe për kultin që zhvilloi për vete, për faktin se familja e tij dhe Axhubei u kthyen në shtëpi mbretërore etj. Fundi këto gjëra mund të korrigjoheshin, për zhdukjen e tyre kishte mundësi të veprohej ndryshe. Atëherë përse nuk e mbajtën më Hrushovin, po i nxorën vetes kaq shumë telashe? Këto telashe ata ia nxorën vetes që të mundnin të rregullonin disa telashe të tjera më të mëdha. Kështu duhet ta kuptojmë këtë çështje.

Cili është preokupacioni kryesor dhe më i madh i revizionistëve modernë? Në këto momente ata duan dhe po bëjnë përçapje që Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë marksiste-leniniste të pushojnë polemikën. Me një fjalë, ata duan që lufta e marksistëve kundër revizionistëve të pushojë. Ata shpresojnë të gënjehet Partia e Punës e Shqipërisë dhe parti të tjera marksiste-leniniste dhe këto të thonë se tani, meqë u hoq Hrushovi, «o burra mbi mjaltë»! Revizionistët mund të përdorin një mijë e një taktika, dredhi e fjalë, ata mund të thonë që ne ishim në kundërshtim me Hrushovin, i cili shkoi larg me Partinë e Punës të Shqipërisë, një tjetër mund të thotë se nuk ishte dakord që Hrushovi preu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, se shqiptarët «i kemi miq të dashur», se ata e duan Bashkimin Sovjetik, se gjoja Brezhnjevi është për miqësi etj., etj. Ata duan që ne t'i hamë të tëra këto. Po t'i hamë, atëherë pushoi polemika dhe ata këtë duan, këtë do edhe imperializmi, pjellë e të cilit është revizionizmi modern, që është në fuqi në BS, në vendet e ish-demokracive popullore të Evropës, si dhe në shumë parti të

vendeve kapitaliste. Luftën që i bën marksizëm-leninizmi revizionizmit, ata duan ta shuajnë ose të paktën ta zvogëlojnë dhe për këtë qëllim bëjnë manovra demagogjike. Pra kanë qenë të detyruar ta hiqnin Hrushovin për t'ua arritur disa qëllimeve, një nga të cilët dhe kryesori është shuarja e polemikës.

Një arsye tjetër e heqjes së Hrushovit është që revizionistët sovjetikë të afrohen edhe më shumë me miqtë e tyre revizionistë në vende të tjera, t'u thonë këtyre se «me ne që jemi tani në Kremlin mund të bisedohet më mirë se me Hrushovin, se ju e dini arrogancën e tij jo vetëm me ju, po bile edhe me ne. Rëndësi ka që të lidhim miqësi, të forcojmë unitetin dhe të shkojmë në një mbledhje ku të zgjidhim çështjet tona, sepse ashtu siç bënte Hrushovi nuk mund të bëhej mbledhja».

Ne, nga ana jonë, donim që mbledhja e revizionistëve të bëhej, që të konsumohej tradhtia e tyre. Tani duhet të vëzhgojmë me kujdes të gjitha taktikat e tyre, se jemi të fituar, kurse ata po përpëliten, po grinden, janë duke përpunuar një taktikë të re që të dalin nga qorrrokaku ku kanë hyrë.

Në kushtet e krijuara është detyrë e marksistë-leninistëve që ta thellojnë këtë krizë të revizionistëve. Në qoftë se u arritën këto situata të favorshme për marksizëm-leninizmin, ky është rezultat i luftës sonë të paprerë kundër revizionizmit modern, luftë që duhet të vazhdohet gjer në shkatërrimin e tyre, prandaj të mos u japim rast të marrin frymë. Marksistët i nuhatin situatat, nuk entuziazmohen para kohe dhe të thonë se tani u arrit çdo gjë. Rrëzimi i Hrushovit është vërtet një

sukses, po lufta nuk ka mbaruar. Edhe gëzimi duhet të jetë, si të thuash, një gëzim marksist. Kjo që ndodhi në BS është një sukses i madh për marksizëm-leninizmin, se tregon që revizionistët po dobësohen, po ata kanë akoma shumë shigjeta që i shfrytëzojnë në interesin e tyre dhe do t'i përdorin kundër nesh gjer në vdekjen e tyre. Por marksistët i mbështetin taktikat e tyre në parimet, se, po zure një rrugë që shkel parimet, atëherë more fund, mbarove, rrëshqite në antimarksizëm. Partia jonë, si kurdoherë, edhe paskëtaj do t'i ruajë me vigjilencë parimet. Ajo do të mbrojë marksizëm-leninizmin, do të mbrojë pastërtinë e tij me luftë deri në fund kundër revizionizmit modern dhe imperializmit, nën çdo maskë që ata të paraqiten. Komiteti Qendror i Partisë sonë do t'i diskutojë thellë këto probleme. Çështja është që tani ne hymë në një periudhë të re të luftës, prandaj, pa shkelur parimet, duhet të adaptojmë edhe një taktikë tjetër të re në luftën kundër revizionizmit modern, po njëkohësisht duhet të vëzhgojmë me kujdes qëllimet që ata kanë.

Në këto situata, Partia jonë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste duhet të qëndrojnë si shqiponja, të mos gënjehen se pasardhësit e Hrushovit do të kthehen në rrugën tonë. Prandaj ne do ta vazhdojmë luftën kundër tyre. Lëvizja jonë është në ngjitje dhe kudo ka filluar lëvizja revolucionare. Ne kemi besim se forcat revolucionare do të shtohen.

Sot, më tepër se kurrë ne duhet të jemi shumë vigjilentë. Situatat e krijuara na inkurajojnë për luftë e për fitore të reja. Partia jonë kurrë nuk do të lëvizë nga qëndrimi i saj parimor për mbrojtjen e marksizëm-

-leninizmit dhe nga lufta kundër revizionizmit modern. Ne kemi besim të marksistë-leninistët e vërtetë të BS dhe të vendeve të tjera dhe tek asnjëri tjetër. Këta që kanë ardhur në fuqi pas Hrushovit janë njerëz të komprometuar, të sëmurë, tradhtarë me tërë kuptimin e fjalës. Në qoftë se këta do të përdorin taktika të reja, ne do ta demaskojmë edhe më shumë tradhtinë e tyre. Ato që kanë bërë, duhet t'i paguajnë dhe me siguri do t'i paguajnë shtrenjtë.

Ne jemi optimistë, se nën flamurin e marksizëm-leninizmit kemi fituar një botë të madhe me luftë. Të armatosur me marksizëm-leninizmin do të dimë të punojmë, të mos na zërë gjumi për të siguruar fitoren përfundimtare, duke mbajtur kurdoherë parasysh eksperiencën e hidhur të BS.

Brezi ynë dhe brezat e ardhshëm, derisa të shkatërrohet imperializmi, janë të detyruar të luftojnë ditë e natë, në çdo mënyrë dhe në të gjithë sektorët. Ç'e bëri Partinë tonë që u rezistoi jo vetëm sulmeve të egra të Hrushovit, por kapërceu edhe vështirësi të mëdha ideologjike, politike, ekonomike, bllokada dhe përmirësoi jetën e popullit? Vetëm vija e drejtë, mbështetja fort e pa u lëkundur të marksizëm-leninizmi. Nivelin e jetës nuk e lamë të binte, siç ra në BS, në Çekoslovaki, në Poloni, në Bullgari etj. Këtë vit, me punën e madhe që kanë bërë populli dhe Partia, si në bujqësi ashtu dhe në industri, kemi krijuar një situatë të mirë ekonomike, që do të jetë një mbështetje e sigurt edhe për vitet e ardhshme. Forca e madhe e popullit dhe e Partisë, energjitë e tyre patjetër në të ardhmen do të mobilizohen më shumë që të krijojmë të tjera të mira materiale dhe

ta ngremë gjithnjë më lart nivelin e jetesës. Ky do të jetë një sukses i madh për Partinë dhe popullin tonë, duke marrë parasysh vështirësitë e mëdha që kemi pasur.

Situata e krijuar e ka mobilizuar dhe e ka gëzuar popullin tonë, i cili është me të vërtetë realist. Ai dhe Partia i gjykojnë drejt pasojat e disfatës së armiqve imperialistë e revizionistë si dhe fitoret tona.

Edhe një herë ju uroj punë të mbarë, të mësoni mirë se Partia ka nevojë për diturinë dhe zotësinë tuaj!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**MARRJA E PUSHTETIT ISHTE NJË NGA DETYRAT
KRYESORE TË LUFTËS SONË ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE**

*Fjala në drekën e shtruar në Berat me rastin e festimit
të 20-vjetorit të Mbledhjes së Dytë të Këshillit
Antifashist Nacionalçlirimtar*

22 tetor 1964

Të dashur shokë dhe shoqe të Beratit,

Në emër të të gjithë shokëve që kemi ardhur sot këtu, për të festuar me gëzim të madh bashkë me ju këtë datë të shënuar, ju uroj nga zemra dhe ju lutem t'u transmetoni të gjithë popullit të rrethit të Beratit dhe të gjithë shokëve të Partisë përshëndetjet dhe urimet më të zjarrta të Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të Qeverisë sonë.

Ne, shokë, gjetëm sot te populli heroik i Beratit po atë popull të dashur, trim e të zgjuar të kohëve të lashta të historisë sonë dhe veçanërisht të Luftës së madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare. U shtuan forcat tona kur kaluam përmes masave të mëdha të popullit të rre-

thit tuaj, kur pamë me ç'ndjenja të zjarrta u pritëm nga ju, me ndjenja që shprehin dashurinë dhe besimin e madh për Partinë tonë heroike, që bëri atë luftë kaq të madhe, që solli popullin në fuqi, që krijoi të mira të shumta për të, që krijoi Republikën tonë Popullore, të cilën e forcoi dhe po e forcon vazhdimisht dhe sot po ndërton me sukses socializmin.

Populli i Beratit ka qenë kurdoherë në radhët e para të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare si dhe të luftës për ndërtimin e socializmit. Ai ka dhënë me qindra dëshmorë që do të mbeten të pavdekshëm në kujtimin e brezave të ardhshëm si shembull i lartë i sakrificës më të madhe për lirinë e popullit dhe për ndërtimin e jetës së re. Populli i rrethit të Beratit ka qenë gjithashtu në pararojë për ndërtimin e kësaj jete të re, të socializmit. Ai, si gjithë populli shqiptar, e ka ndjekur dhe e ka përqaftuar fort vijën e drejtë dhe të lavdishme të Partisë sonë në të gjitha aspektet. Ne sot ndiejmë këtë forcë të madhe të populli i Beratit ashtu sikurse e kemi ndierë në të katër anët e vendit tonë jo vetëm me rastin e festave përkujtimore, por edhe në luftën e përditshme për arritjen e fitoreve të reja kundër armiqve të vendit tonë dhe të socializmit, nën çdo maskë që ata të fshihen, prandaj jemi kaq shumë të entuziazmuar e të gëzuar.

Ne erdhëm sot me rastin e 20-vjetorit të Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, që u zhvillua këtu në qytetin e Beratit. Shokët që folën e vunë mirë në dukje rëndësinë e kësaj mbledhjeje. Ndërrimi i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike ishte një etapë historike e domos-

doshme, një rrjedhim logjik i luftës që bëri populli nën udhëheqjen e Partisë. Marrja e pushtetit, e atij pushteti që e krijuam me luftë pasi rrëzuam pushtetin e vjetër, ishte një nga detyrat kryesore të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në ato kohë kur populli ishte në pragun e çlirimit, duhet të kishte qeverinë e vet demokratike, e cila do të konsolidonte fitoret e luftës dhe do t'u vinte kufi intrigave dhe veprimeve të hapëta ose nën rrogoz të imperialistëve amerikanë, anglezë dhe tradhtarëve si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Prandaj ka rëndësi kaq të madhe kjo ditë. Rëndësia e saj u duk edhe më vonë me veprimet e Partisë, të realizuara më së miri në etapa të ndryshme, në kohën e duhur, të cilat bënë që imperialistët dhe reaksioni të mos depërtonin dot në vendin tonë të porsaçliruar, të mos manovronin dot siç mendonin ata për të sjellë në kurriz të popullit tonë njerëzit e vet, domethënë armiqtë e popullit. Kjo bëri që të dështonin intrigat e shumta e të ndryshme të anglezëve e të amerikanëve jo vetëm atëherë, po edhe pasi e çliruar krejtësisht Shqipërinë.

Sa e vështirë po dhe sa heroike ishte Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit tonë! Po është fakt që edhe lufta për ndërtimin e socializmit është po aq e vështirë. Të gjithë e kemi jetuar këtë periudhë 20-vjeçare, se i madh e i vogël kemi kontribuar për fitoret e arritura. Duhet thënë se pa Partinë, as Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare nuk do të fitohej, as lufta e vështirë dhe e lavdishme e ndërtimit të socializmit nuk do të korrte këto suksese. Çdo gjë i dedikohet në radhë të parë Partisë sonë të lavdishme, vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste, e cila e udhëhoqi popullin drejt fi-

tores përfundimtare mbi fashizmin. Po të mos ishte Partia me vijën e saj të drejtë dhe luftarake, dhe kjo vijë të mos prekte e të mos bënte për vete zemrat e popullit, në atë mënyrë madhështore, saqë njeriu kur shkonte në luftë nuk i trembej vdekjes, por luftonte i vendosur e i bindur në fitore, populli shqiptar nuk do të ishte ashtu si është sot, i lirë dhe zot i vendit. Pra faktori vendimtar për fitoren e plotë është udhëheqja e drejtë e popullit nga Partia. Këtë e provon edhe realiteti i fqinjëve tanë. Edhe grekët luftuan, po mbasi partia e tyre bëri gabime të rënda, populli grek pësoi disfatë.

Partia bëri jo vetëm të arrihej fitorja e madhe e glirimit të atdheut, e lirisë dhe e pavarësisë së vendit, po njëkohësisht edhe ndryshimin kolosal në ndërgjegjen e njerëzve. Ajo mbushi zemrat e njerëzve me barut, me ndjenjat e larta të patriotizmit, u hapi horizonte të gjithëve të shihnin sa më larg, të dilnin nga jeta e ngushtë familjare e interesit të vogël shtëpiak ose të farefisit dhe të shikonin interesin e madh të të gjithë Shqipërisë. Partia i edukoi njerëzit tanë të shihnin dhe më tej Shqipërisë, të shihnin edhe interesin e popujve të tjerë. Ajo i mësoi njerëzit e thjeshtë të popullit t'i shikonin këto gjëra me një pjekuri të madhe. Populli ynë ka qenë kurdoherë i pjekur, i arsyeshëm dhe trim, po Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe urtësia e Partisë i hapën atij të tilla horizonte dhe i dhanë të tillë forcë dhe dinamizëm, që ai të ndryshonte botëkuptimin. Si një Parti marksiste ajo nuk u deh nga sukseset, por ndoqi dhe ndjek me konsekuencë vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste.

Sot ne, komunistët shqiptarë, jemi 20 vjet më të vjetër. Këtë eksperiencë që kemi fituar dhe kemi tani, natyrisht, atëherë nuk e kishim. Por merita e Partisë sonë, merita e komunistëve dhe e të gjithë popullit është se atyre nuk iu rrit mendja, ata e panë realitetin si duhet dhe punuan që këtë liri dhe pavarësi që fituan t'i forconin, t'i konsolidonin se kishte dhe ka akoma shumë rreziqe.

Gjatë luftës ne ishim në aleancë me Anglinë, Amerikën dhe shtete të tjera borgjeze, nacionaliste, të cilat ishin në luftë kundër Hitlerit. Po marksizëm-leninizmi dhe eksperiencia e partisë së lavdishme bolshevike na mësonin, si të gjithë komunistët ashtu dhe ne, komunistët shqiptarë, se imperializmi nuk i hedh armët, se ai do të luftonte edhe pas mbarimit të luftës, me qëllim që fitoret e popujve t'i kanalizonte në interesin e vet, të përfitonte nga djegiet, mjerimet dhe vuajtjet e tyre dhe me mënyra të ndryshme të arrinte që, nëpërmjet të të ashtuquajturave ndihma ekonomike e gjer te sabotazhet etj., etj., të dobësonte forcat popullore, në radhë të parë partitë marksiste-leniniste, për t'u hedhur përsëri zinxhirët popujve. Këtë çështje Partia jonë e pa qartë. Jo vetëm kaq, po ajo u bë si një bllok i çeliktë bashkë me popullin dhe ishte e sigurt se vija e saj marksiste-leniniste ishte e pagabueshme e këtë vijë duhet ta mbronte dhe do të luftonte për zbatimin e saj deri në fitoren e popullit të vet. Partia jonë, e sapodalë nga lufta, e ndiente veten të fortë si çeliku, pavarësisht se ishte e vogël në numër. Ajo kishte me vete gjithë popullin shqiptar, prandaj iu përvesh punës me besim të madh në fitore. Të gjithë shkuan në luftë

të vendosur e të bindur se do të fitonin, të preokupuar për ruajtjen e Partisë nga çdo armik. Partia e ndjeu thellë përgjegjësinë e rëndë për jetën e gjithë popullit dhe kjo e kaliti më shumë. Kur themi që Partia u kalit, ky është fakt. Hallet, vuajtjet dhe kapërcimi i tyre i kalitin njerëzit. Dhe Partia jonë u kalit në halle, në luftë e në përpjekje me të gjithë armiqtë që përpique-shin t'i bënin varrin, prandaj kapërceu me sukses shumë pengesa e vështirësi.

Tani shokë kemi krijuar një atdhe të bukur që e ndërtuam dhe e zbukuruam të gjithë së bashku popull e Parti. Të gjithë kemi vënë nga një gur në themelet e kësaj jete të bukur dhe këtë gur e kemi çimentuar mirë, prandaj, jemi të bindur se veprën, që ka bërë Partia, sado breshër e shi të bjerë, sado erëra e furtuna të fërta të fryjnë, nuk do ta tundin dot. Të tilla furtuna po i vërtiten herë pas here Partisë sonë, po ne do të fitojmë kurdoherë dhe armiqtë kurdoherë do të thyhen.

Një transformim i madh revolucionar u bë në vendin tonë, po në radhë të parë ai u krye në ndërgjegjen e njerëzve tanë, që, siç thotë Stalini, bëjnë çdo gjë. Në qoftë se Partia i frymëzon njerëzit me idealin e vet, çfarëdo plani do të arrihet, se Partia është arkitektja që llogarit si duhet të gjitha forcat dhe mundësitë ekonomike, mendore, ushtarake etj., që të realizohen planet e saj.

Ne shohim sot se të gjithë punonjësit janë në pararojë dhe ndërmarrin, zbatojnë e realizojnë me sukses të gjitha detyrat. E kam fjalën për detyrat kryesore, se kemi akoma edhe të meta, si dhe mjaft vështirësi për t'i kapërcyer, të cilat as i fshehim e as i harrojmë. Po

njerëzit tanë i rriti Partia, i edukoi, i kaliti me një frymë të tillë për të përballuar vepra të mrekullueshme e që duan përgatitje në të gjitha fushat, në bujqësi, në industri, në arsim e kulturë. Prandaj kudo te ne jeta e punonjësve është bërë më e gëzuar, më e lumtur, është ngritur niveli i tyre material e kulturor. Sot janë krijuar mundësi të tilla nga puna juaj, nga puna e të gjithë popullit tonë, që zhvillimi i ekonomisë, i kulturës dhe niveli politik dhe ideologjik i masave të mos qëndrojnë në vend. Tani çdo vit e çdo pesëvjeçar ne mund të hedhim dhe kurdoherë do të hedhim hapa më të mëdhenj përpara. Bilanci i sukseseve tona është shumë pozitiv.

Detyra jonë sot është që të realizojmë planet dhe të vëmë të gjitha energjitë për të arritur suksese të reja në të gjitha fushat. Të luftojmë që të ngremë akoma më lart ndërgjegjen e çdo shqiptari në mënyrë që kjo të jetë e pastër nga çdo mbeturinë e së kaluarës, që secili të shikojë në radhë të parë interesat e mëdha të atdheut, që janë njëkohësisht edhe interesat e çdo individi. Dhe kjo gjë bëhet shokë, vetëm duke menduar për nënën tonë Parti, për shokët tanë që ranë në fushën e nderit, të cilët, para se të dilnin në mal, morën pushkën dhe premtuan se do të luftonin me vendosmëri e, po të ishte nevoja, do të jepnin edhe jetën për Shqipërinë. Dhe, siç e dini, na u vranë me qindra e mijëra shoqe e shokë, u dogjën shumë fshatra e qytete. Vetëm këto të mendojmë kur punojmë edhe në çdo hap që hedhim. Dhe në ndodhtë që ndokush vepron keq, t'i themi: ndal, ku po shkon, shokët tanë dhanë jetën, kurse ti jetën e ke të siguruar në saje të luftës së popullit,

të jetës që ata dhanë, dhe tani, kur sheh se t'u prek pak interesi personal, nuk po vepron drejt. Duke vepruar kështu, kalitet më lart ndërgjegjja e njerëzve tanë. Nuk ka zemër patrioti shqiptar tek e cila të mos buçasin dashuria e zjarrtë për Partinë dhe patriotizmi i flaktë për atdheun. Sa ditë që kalojnë, aq më shumë kalitet një ndërgjegje e tillë. Kjo nuk përjashton mundësinë që te ne të mos ketë edhe të meta, por të mendojmë në radhë të parë detyrat e rëndësishme që kemi për të kryer. Brezit tonë dhe brezave të ardhshëm, gjersa të zhduket imperializmi dhe revizionizmi modern, gjersa të shembet sistemi kapitalist në të gjithë botën, do t'u duhet të zhvillojnë një luftë të pandërprerë kundër të metave. Lufta ne nuk na tremb, por duhet të mos harrojmë se armiqtë nuk i kanë hedhur dhe nuk do t'i hedhin armët, prandaj të jemi kurdoherë vigjilentë.

Hrushovi dhe shokët e tij revizionistë, këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit, parullën e madhe të Stalinit për vigjilencë drejtuar komunistëve dhe popujve, e përbuzën dhe e hodhën poshtë, sepse, sipas tyre, imperializmi na qenka dobësuar, nuk qenka më në gjendje të na dëmtojë, prandaj tani nuk qenka nevoja për vigjilencë! Me fjalë të tjera, tradhtari N.Hrushov e tradhtarët e tjerë revizionistë thonë: Bini në gjumë, flini, se ne kemi forcë të madhe për ta gjunjëzuar imperializmin! Qëllimi i parë i N.Hrushovit dhe i pasuesve të tij ishte të shkatërronin Bashkimin Sovjetik dhe gjithë kampin socialist dhe këto t'i shiteshin imperializmit botëror, me në krye imperializmin amerikan. Për t'ia arritur këtij qëllimi, në radhë të parë, ata duhej

të goditnin marksizëm-leninizmin, Leninin e madh, Stalinin dhe ndërtimin e socializmit në BS, të goditnin Bashkimin Sovjetik, gjithë atë forcë të madhe që ky tradhtar e rrëmbeu me shumë dredhira, me komplete e puçe.

Fryma e drejtë marksiste, mësimet e Leninit dhe të Stalinit e bënë Bashkimin Sovjetik vendin e parë socialist në botë, kurse Hrushovi donte t'u vinte kazmën BRSS dhe pas tij të gjitha vendeve të tjera socialiste. Ai donte t'i largonte ata nga marksizëm-leninizmi, nga doktrina e madhe revolucionare që ngre peshë popujt e botës në luftën për shkatërrimin definitiv të kapitalizmit. Revizionistët modernë kërkojnë ta kthejnë marksizëm-leninizmin në një ideologji për të zbutur shpirtërat e njerëzve, për t'i demoralizuar këta, për të infektuar komunistët dhe punonjësit e vendeve socialiste me të gjitha veset e këqija që përhapin kapitali dhe borgjezia për degjenerimin e tyre, për të shkatërruar potencialin e madh ekonomik e ushtarak të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve socialiste, me një fjalë, për të kthyer prapa rrotën e historisë. Ky ishte qëllimi i tradhtisë së madhe të Hrushovit.

Partia jonë, një parti e vogël po e kalitur në luftë e në vështirësi, i ka qëndruar dhe i qëndron kurdoherë besnike marksizëm-leninizmit, që e zhvillon dhe e zbaton në jetë me luftë, me djersë e me përpjekje, e kuptoi një tradhti të tillë. Gjatë 20 vjetëve ajo është ndeshur me armiq të shumtë, imperialistët dhe tradhtarët revizionistë të Beogradit, me të cilët ka zhvilluar një luftë të ashpër. Lufta me këta armiq shërbeu si eksperiencë e madhe për Partinë tonë. Nga një

anë Partisë sonë i është dashur të vigjilojë, se Lenini dhe Stalini na kanë mësuar që kurdoherë të punojmë, të vigjilojmë dhe të luftojmë në rrugë marksiste kundër imperialistëve dhe revizionistëve, kurse nga ana tjetër Partisë sonë i është dashur të ndërtojë industrinë e bujqësinë socialiste dhe të edukojë njeriun e ri me ideologjinë proletare.

Dhe Partia jonë ka vepruar kurdoherë në rrugë marksiste-leniniste. Ajo e diktoi tradhtinë e madhe të N.Hrushovit, prandaj ngriti zërin në Mbledhjen e Bukureshtit në mbrojtje të marksizëm-leninizmit. Kështu qysh atëherë filloi lufta e ashpër e bandës tradhtare të Hrushovit dhe e të gjithë miqve të tij kundër nesh. Revizionistët modernë panë te Partia jonë armikun e tyre më të madh, prandaj këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit filluan një luftë të ashpër kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. Po edhe Partia jonë i qëndroi që nga fillimi e gjer në fund çdo sulmi, çdo tradhtie, zjarr për zjarr, me demaskim dhe luftë gjer në fund derisa i dha edhe grushtin vdekjeprurës Hrushovit me Letrën e Hapur drejtuar anëtarëve të PK të BS që u botua disa ditë përpara se ky tradhtar të rrëzohej.

Tradhtarët revizionistë menduan se ne do të na shkatërronin. Për këtë ata ishin «të bindur» dhe kanë menduar: «E kush janë këta shqiptarë që po na dalin përpara? Ata janë një popull jo më shumë se një milion e gjysmë! Atyre ua mbajmë ne frymën me bukë, prandaj një fjalë të themi ne dhe Shqipëria mbaroi, udhëheqja e saj nuk është asgjë, e likuidojmë brenda dy-tri ditëve!»! Si tradhtarë të marksizëm-leninizmit ata lëshuan të gjitha bateritë kundër nesh, po nuk mun-

dën të na likuidonin, përkundrazi Partia jonë i demaskoi botërisht.

Këtë luftë e kemi jetuar të gjithë, atë e ka udhëhequr Partia dhe e kanë mbajtur lart duart e fuqishme të popullit tonë të bashkuara rreth Partisë. Revizionistët na kanë sjellë vështirësi të mëdha ekonomike, por populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë, i kapërceu të gjitha, se kishte besim në fitore, se kaloi vështirësi në kohë shumë më të rrezikshme dhe jo më tani që është koha e fitores së marksizëm-leninizmit. Prandaj kudo u punua me zjarr e vrull të paparë dhe planet tona u realizuan e po tejkalohen. Në momentet e para shumë gjëra i mungonin popullit dhe ekonomisë sonë, po secili i kuptonte këto mungesa. Kësaj i thonë kalitje e popullit nga ana e Partisë.

Rëndësi të madhe ka çështja që populli t'i kuptojë kurdoherë e më mirë vështirësitë e momentit dhe se qëllimet e Partisë janë për të mirën e tij. Në ato kushte të vështira Partia i tha popullit se mund të ketë vështirësi për bukë si edhe për veshmbathje. Dhe populli u përgjigj se pavarësisht nga çfarëdolloj vështirësie, ai është gati që, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, marksizëm-leninizmin ta mbrojë, Shqipërinë ta lulëzojë. Ja, këtu qëndron forca jonë. «Do të ngordhni për bukë», na tha Mikoiani. «Jo, iu përgjigjëm ne, populli shqiptar nuk ka vdekur dhe nuk do të vdesë kurrë, ju do të vdisni». Dhe ne ndoqëm rrugën tonë të drejtë, të prirë nga marksizëm-leninizmi, pavarësisht nga vështirësitë dhe nga pengesat e panumërta që na dolën përpara.

Partia jonë gjeti momentin për t'i dhënë kur du-

hej grushtin vdekjeprurës klikës tradhtare të Hrushovit. Letra e Hapur e Partisë sonë drejtuar anëtarëve të partisë bolshevike disa ditë përpara se të rrëzohej Hrushovi, ishte një kohcidencë, po kjo ngjarje nuk është aq e thjeshtë. Natyrisht, Partia jonë nuk parashikonte që Hrushovi menjëherë pas botimit të Letrës sonë do të rrëzohej, po ajo ishte e bindur që një ditë ai dhe shokët e tij do të shkatërroheshin, se revizionistët modernë kishin hyrë në një krizë të rëndë. Partia jonë ndiqte me vigjilencë kontradiktat e mëdha në mes revizionistëve, ajo shihte qartë dobësitë e revizionistëve të Moskës, presionet që u bënë atyre imperialistët amerikanë, të cilët kërkonin që Hrushovi të dorëzohej plotësisht, ajo shihte presionet e shokëve të Hrushovit jashtë Bashkimit Sovjetik, që i thoshin atij të shpejtohej në rrugën që kishte filluar, ta degjeneronte sa më parë Bashkimin Sovjetik për arsye se po ngrihej vala e madhe e revolucionit. Hrushovi u gjet në rrugëkryq nga lufta e pandërprerë e Partisë sonë dhe e të gjithë marksistë-leninistëve dhe forcave revolucionare në botë. Idetë e marksizëm-leninizmit veprojnë jo vetëm në radhët e partive marksiste-leniniste që janë të organizuara, po kudo në botë. Ndjenjat dhe mendja e njerëzve të ndershëm, e komunistëve që shtypen nga zgjedha e kapitalit, e atyre që janë gënjyer nga revizionistët, punojnë dhe veprojnë.

Pikërisht se u gjet në një situatë të vështirë N. Hrushovi ngriti çështjen e mbledhjes së partive komuniste. Ai donte një mbledhje ku të shkonin edhe partitë marksiste-leniniste, të shkonte edhe Partia jonë. Këtë ai donte ta bënte që të arrihej të pushohej lufta.

e marksistë-leninistëve kundër revizionistëve, se ishte pikërisht kjo luftë që ua çori maskën atyre. Të gjitha përpjekjet dhe qëllimet e revizionistëve gjatë këtij viti synonin që të pushohej polemika, domethënë që ne të heshtnim dhe atëherë ata të livadhishnin lirisht. Po marksizëm-leninizmi këtë nuk e lejon kurrë. Prandaj revizionistët u demaskuan në të gjitha frontet dhe nisën të grinden në mes tyre. Imperialistët nga ana tjetër u bënë nën presion, prandaj Hrushovi si tradhtar mbi tradhtarët vendosi ta bënte mbledhjen, pavarësisht nëse ne do të merrnim pjesë. Sigurisht ne nuk do të shkonim në një mbledhje përçarësish dhe i paralajmëruam se sido që të vepronin, ata do të demaskoheshin plotësisht si përçarës të lëvizjes komuniste.

Mirëpo Hrushovi kishte edhe shokë të tjerë, që e porositnin të mos shpejtohej, se kjo mund t'i çonte drejt greminës. Kjo tregoi qartë se revizionistët patën mosmarrëveshje midis tyre. Në këto rrethana Komiteti Qendror i Partisë sonë dha direktivën që Letra e Hapur drejtuar komunistëve sovjetikë të botohej.

Po si e bëri Partia jonë këtë Letër dhe përse nuk e bënë edhe parti të tjera një gjë të tillë? Kjo Letër është rezultat i logjikës së fortë marksiste-leniniste të Partisë sonë. Komiteti Qendror i Partisë sonë, i regjur në luftëra mendoi dhe e gjykoi drejt momentin se pikërisht në këtë kohë kjo Letër do t'i vinte zjarrin jorganit revizionist. Dhe ja, Hrushovi u rrëzua. Mirëpo të gjithë ata që kanë ardhur tani në udhëheqjen sovjetike janë shokët e tij të ngushtë, revizionistë modernë, që bashkë me Hrushovin bënë kongreset e 20-të dhe

të 22-të, janë ata që së bashku hartuan vijën e tradhtisë. Hrushovi me pasuesit e tij janë puthur e janë për-qafuar me Titon, të cilin e kanë quajtur «marksist» të kulluar dhe Jugosllavinë një vend «socialist». Të gjithë këta, me Hrushovin në krye, janë ata që kanë hapur zjarr kundër nesh, që kanë luftuar gjer në fund Partinë tonë. Megjithatë ata u detyruan t'i thonë «ndal!» Hrushovit, e qëruan se po shkonin në greminë. Kur borgjezia kapitaliste dhe revizionistët modernë e shohin se po u shket toka nën këmbë, për ta mbeten vetëm dy rrugë: ose të shpallin diktaturën fashiste dhe të shtypin popujt me zjarr, ose të luajnë një manovër tjetër për të gënjyer popujt. Në situatat aktuale të rritjes së forcave revolucionare në botë, ata e kishin të vështirë të përdornin grushtin, plumbin e mitralozin, sado që në kohën e Hrushovit edhe këto i kanë përdorur. Atëherë, ç'rrugë u mbetej atyre? E vetmja rrugë për ta ishte që ta largonin nga skena politike Hrushovin, për t'i dhënë të kuptojë popullit sovjetik se ai qenkësh fajtori, se ai i vuri thikën në grykë Bashkimit Sovjetik, boshatisi financat sovjetike, nxori jashtë floririn sovjetik për të blerë bukë tek imperialistët amerikanë, hodhi gjithë ato «bomba» se do të kaloheshin e do të tejkaloheshin SHBA dhe popullit sovjetik do t'i jepej buka pa para etj., po që të gjitha këto dolën, ashtu siç ishin, vetëm blofe. Përveç kësaj, revizionistët që erdhën në fuqi përpiqen që të mashtrojnë popullin sovjetik duke i thënë se ishte Hrushovi ai që i armiqësoi me Shqipërinë etj., kurse në të vërtetë këtë rru-gë e ndoqën edhe ata vetë.

Me një fjalë, taktika e tyre është që marksistë-leninistët të pushojnë luftën dhe se gjoja tani që ra Hrushovi do të ndreqen të gjitha punët. Jo, marksistë-leninistët nuk gënjehen, siç mund të mendojnë revizionistët.

Komiteti Qendror dhe Partia jonë na mësojnë se rënia e Hrushovit është një fitore e madhe për marksizëm-leninizmin, e cila ka ardhur si rezultat i luftës parimore që kanë bërë marksistë-leninistët. Kjo do të thotë që e gjithë politika e revizionistëve modernë pësoi një disfatë të madhe. Vija e politika e kongreseve të 20-të dhe të 22-të me luftën që shpallën kundër marksizëm-leninizmit, kundër Stalinit, Partisë së Punës të Shqipërisë, dështuan plotësisht. Për të gjithë marksistët dhe njerëzit e ndershëm në botë, kjo politikë, jo vetëm u diskreditua, po erdhi puna sa vetë revizionistët të heqin qafe kryetarin e tyre.

Tani në fakt shokët e Hrushovit ndodhen në një udhëkryq, ata janë përpara presionit të imperialistëve amerikanë, të cilët qysh tani, në ditët e para, po ndjekin qëndrimet e udhëheqësve të rinj revizionistë sovjetikë për të parë nëse edhe ata do të vazhdojnë rrugën e Hrushovit dhe do t'u bëjnë koncesione, apo do të bëjnë disa ndryshime. Për këtë arsye, imperialistët amerikanë, edhe udhëheqësve të rinj sovjetikë u bënë telegram urimi, po edhe Hrushovin e mburrën. Revizionistët përpiqen dhe do të përpiqen të shpëtojnë nga situata e vështirë, kështu që në këto momente ne duhet të jemi shumë vigjilentë dhe të ndjekim me kujdes taktikat e tyre. Ata nuk mund t'i shpëtojnë zjarrit tonë, prandaj dhe na e kanë shumë frikën. Ata ngulin këmbë

që ne të pushojmë polemikën, të mos flasim, bile mund të na thonë se janë «burra të mirë», se «të gjitha ato që u bënë kundër jush i bëri Hrushovi», po Partia jonë nuk do të gënjëhet nga të tilla manovra dhe do të dijë si t'u përgjigjet.

Parimi i Partisë sonë mbetet, si kurdoherë, i pandryshuar, mbrojtja e marksizëm-leninizmit, që do t'i sjellë botës lirinë, paqen, socializmin dhe komunizmin. Marksizëm-leninizmin do ta mbrojmë me të gjitha forcat tona. Për këtë qëllim ne bëjmë një luftë të pamëshirshme kundër imperializmit, borgjezisë, revizionizmit modern, që është një agjenturë e imperializmit dhe e borgjezisë. Nga këto parime ne nuk bëjmë asnjë lëshim. Në këto parime ka qëndruar dhe do të qëndrojë kurdoherë e patundur Partia jonë.

Mund të ngjasin shumë gjëra, mund të përdoren shumë taktika nga kundërshtarët tanë, por edhe Partia jonë do të dijë të përpunojë taktikat e saj, kurdoherë të drejta, parimore, të bazuara në marksizëm-leninizmin, që nuk të lë të gabosh kurrë. Kujtoni, shokë, ç'thanë për ne armiqtë kur filluam luftën kundër pushtuesve: «Këta njerëz s'kanë si e bëjnë luftën pa bukë, pa armë, ata janë kalamaj, janë të marrë që hidhen në luftë kundër shteteve të mëdha, si Italia e Gjermania dhe flasin kundër njerëzve të fuqishëm si Vrionasit, Vërlacët etj.». Po Partia kishte besim se populli ishte me të dhe ajo që tha Partia u vërtetua: janë ata «kalamanë» që e bënë këtë Shqipëri të lirë socialiste që gëzon populli sot. Kur filluam luftën e drejtë marksiste-leniniste kundër Hrushovit, revizionistët na quajtën «aventurierë», «trocistë», «të marrë». Po Partia i tha popullit: «përpara!».

Marksizëm-leninizmi fitoi dhe kurdoherë do të fitojë.

Ne do të ndjekim gjer në fund vijën tonë të drejtë marksiste-leniniste. Përsëri mundet të na thonë: «Këta janë të marrë, nuk e kuptojnë situatën, nuk janë politikanë»! Po të tilla «këshilla» ne i kemi dëgjuar shumë herë dhe i kemi mësuar përmendësh. Më vonë do të kuptohet kush është në rrugë të drejtë. Ne kemi rru-gën tonë, të ndriçuar nga busulla e pagabueshme e marksizëm-leninizmit, që na ka çuar dhe na çon kurdoherë në fitore.

Siç e shihni, shokë, këtë datë historike, i gjithë populli shqiptar, me Partinë e Punës në krye, po e feston i gëzuar, i lumtur dhe me besim të patundur, se puna e popullit dhe e Partisë sonë do të shkojë drejt.

Përpara, pra, se në krye na udhëheq Partia jonë e lavdishme e Punës e Shqipërisë!

Të rrojë Partia e Punës e Shqipërisë!

Le ta pimë këtë doli për lavdinë e Partisë heroike të Punës!

Botohet për herë të parë si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

POPUJT NUK DO TË NA FALIN, PO TË DOBËSOJMË VIGJILENCËN NDAJ ARMIQVE TË KLASËS

*Nga biseda me një udhëheqës të Partisë Komuniste
të Indonezisë*

24 tetor 1964

*Mysafiri u prit në mënyrë të përzemërt dhe pasi
u ftua të ulej, e mori fjalën*

SHOKU ENVER HOXHA: Gëzohemi shumë që erdhët përsëri te ne. Kanë kaluar 4 vjet që atëherë kur keni vizituar për herë të fundit vendin tonë. Gjatë kësaj kohe kanë ndryshuar shumë gjëra në favor të marksizëm-leninizmit. Këto kanë qenë kohë të rrezikshme për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, por, derisa ekzistonte sëmundja e revizionizmit, u bë mirë që ajo u zbulua, se kështu i gjendet edhe «ilaçi».

Revizionistët hrushovianë, vërtet qendrën e kanë në Evropë, por helmin e veprimtarisë së tyre kërkojnë ta shpërndajnë në të gjithë botën.

Nëpërmjet njerëzve tanë që kanë ardhur herë pas here në vendin tuaj, ne jemi vënë në dijeni mbi gjendjen dhe punën që zhvillonin ju në Indonezi, për për-

pjekjet që kanë bërë revizionistët hrushovianë për të depërtuar në partinë tuaj. Ju falënderojmë për dashurinë dhe për fjalët e ngrohta që janë shprehur nga ana e udhëheqjes suaj për Partinë e Punës të Shqipërisë. Gjithashtu kemi mësuar për luftën që ka bërë partia juaj kundër intrigave, sulmeve të fshehta dhe të hapëta të revizionistëve sovjetikë etj.

Gjeografikisht partitë e vendeve të Azisë janë afër me njëra-tjetrën, prandaj dhe kanë mundësi të shumta për takime të shpeshta. Kurse ne me ju gjeografikisht jemi shumë larg. Megjithatë, ideologjikisht, shpirtërisht ne kemi qenë e jemi pranë njëri-tjetrit, prandaj dhe jemi përpjekur që marrëdhëniet t'i kemi të shpeshta. Kjo është e nevojshme, sepse kontaktet dhe bisedimet midis nesh, shkëmbimi i mendimeve dhe koordinimi i veprimeve kanë rëndësi dhe luajnë një rol të madh në luftën kundër armiqve imperialistë dhe revizionistë.

Udhëheqësit tradhtarë revizionistë sovjetikë kanë synuar gjithnjë të godasin marksizëm-leninizmin duke diskredituar veprën e partisë bolshevike dhe të Stalinit dhe duke u sjellë në mënyrë armiqësore kundër partive marksiste-leniniste. Mirëpo kjo politikë armiqësore dhe tradhtare nuk mund t'i bënte dot ballë forcës së madhe të marksizëm-leninizmit. Aktiviteti i këtyre tradhtarëve nuk ka ndryshim nga lufta që na bëjnë neve imperializmi amerikan dhe ai botëror. Ata na luftojnë me egërsi të madhe, sepse ne, marksistë-leninistët, ishim dhe jemi armiqtë e revizionizmit, jemi ata që do t'i bëjmë atij varrin. Prandaj partitë tona dhe të gjithë marksistë-leninistët në botë duhet të forcojnë çdo ditë e më shumë unitetin në mes tyre, unitet që ne e kemi

krijuar në luftë. Ky unitet është karakteristikë e marksistë-leninistëve dhe ka një rëndësi të madhe vendimtare. Ne e kuptojmë drejt se uniteti i mendimit dhe i veprimit në mes partive tona është një unitet revolucionar, jo jashtë mendimit marksist, jo në vartësi nga madhësia e vendit ose e partisë. Vetëm një unitet i tillë është unitet i shëndoshë. Kurse revizionistët sovjetikë këtë çështje e kuptojnë jo në vijën marksiste, unitetin ata e kuptojnë si diktat të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mbi partitë e tjera.

Revizionistët modernë flasin për indipendencën e partive, bile thonë se edhe ata luftojnë për këtë. Por në fakt ata luftojnë kundër marksizëm-leninizmit. Sipas pikëpamjes së tyre, në partitë komuniste duhet të zhvillohet «komunizmi nacional» dhe partia që është më e fuqishme, në këtë rast ajo e Bashkimit Sovjetik, t'i mbajë të lidhura pas vetes partitë e tjera, t'u imponohet me anë të fuqisë ekonomike ose ushtarake të shtetit të madh, pra të jetë me to në marrëdhënie jashtë normave e parimeve të teorisë marksiste-leniniste. Kurse ne, si marksistë-leninistë, mendojmë se partitë tona janë parti të pavarura, por njëkohësisht janë të lidhura shoqërisht, vëllazërisht me njëra-tjetrën në mendime, në ideologji, në veprime si një bllok i vetëm kundër armikut, sepse i bashkon një vijë e vetme, vija e marksizëm-leninizmit.

Uniteti luftarak midis marksistë-leninistëve bazohet jo në simpatira subjektive, por në parimet e marksizëm-leninizmit, në realitetin objektiv. Është kjo që e bën të fortë aleancën tonë, prandaj revizionistët modernë, të cilët kishin mjaft forca dhe autoritet, pasi

fshiheshin prapa autoritetit të partisë bolshevike, nuk mundën të na çanin dot.

Partia jonë e ka pasur dhe e ka kurdoherë të qartë çështjen se revizionizmi modern duhet të luftohet gjer në fund, se atij nuk duhet t'i bëjmë lëshime. Revizionistët duhen goditur nga të katër anët, me të gjitha mënyrat, sipas situatave. Dhe këtë partitë tona e kanë bërë. Ato kontribuan fuqimisht në luftën për demaskimin e revizionizmit modern, dhe kjo sigurisht, do të bëhet edhe në të ardhmen.

Ne kemi respekt dhe admirim për partinë tuaj që lufton kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit modern, veçanërisht atij hrushovian. Brenda në Indonezi, hrushovianët, nëpërmjet gjoja miqësisë me Sukarnon, përpiqen të shkatërrojnë partinë tuaj, të ngrenë mbeturinat trockiste dhe t'i vënë përballë jush, të nxitin Sukarnon që t'ju skartojë ju. Por këto përpjekje kanë dështuar dhe partia juaj ka luftuar dhe ka fituar. Por si ka fituar?

Sipas mendimit tonë, deri tani ajo ka fituar sepse ka demaskuar revizionizmin modern dhe hrushovian. Revizionistët hrushovianë nuk mundën të organizonin dot në Indonezi trockistët dhe revizionistët në një parti kundër partisë suaj. Ju i shpartalluat përpjekjet e tyre dhe partia juaj u forcua jo vetëm nga ana ideologjike dhe politike, por edhe nga ana organizative, u shtri në të gjithë vendin, në qytete dhe sidomos në fshatra, gjë që përbën një fitore të madhe. Ky është një dështim serioz i politikës hrushoviane. Urojmë që në të ardhmen të arrini fitore edhe më të mëdha, sepse armiqtë që kemi përpara janë

të egër, ata edhe kur dështojnë, nuk heqin dorë nga synimet e tyre, përgjojnë momente të favorshme për të na goditur përsëri.

Duke qenë realistë, ne themi se të gjithë marksistë-leninistët në botë kanë kontribuar fuqimisht për disfatën që pësoi revizionizmi modern me rënien e Hrushovit. Kjo flet për luftën e drejtë të partive tona dhe për forcën e madhe të marksizëm-leninizmit, i cili vepron aktivisht jo vetëm në vendet ku në pushtet janë partitë marksiste-leniniste, por edhe në vendet e tjera, edhe në Indonezi. Marksizëm-leninizmi vepron kudo me forcë të madhe, në mënyra të ndryshme, ai vepron edhe në Bashkimin Sovjetik e në vendet ish-socialiste të Evropës, edhe në vendet kapitaliste e në vendet që tani janë çliruar, edhe atje ku forcat patriotike luftojnë kundër kolonializmit për lirinë e tyre.

Partitë tona, në luftën e tyre kundër kapitalizmit, kolonializmit dhe revizionizmit kanë vepruar në vijën marksiste-leniniste. Është fakt, shokë, se, po të mos kishin luftuar partitë marksiste-leniniste, Hrushovi do të ecte akoma edhe më me vrull dhe do t'i kishte konsoliduar pozitat e tij tradhtare në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Por lufta jonë e ashpër dhe e pamposhtur kundër revizionizmit bëri të arrinim këtë sukses të madh.

Partia jonë mendon se tani kemi hyrë në një fazë të re të luftës kundër revizionizmit modern, prandaj për partitë tona është shumë i dobishëm dhe i nevojshëm shkëmbimi i mendimeve. Kjo fazë e re, sipas mendimit tonë, është, si të thuash, një fazë transitore, e cila duhet të konsiderohet si një periudhë e konsolidimit të

fitoreve të partive tona mbi revizionizmin modern dhe e kalimit pastaj në një fazë tjetër, në atë të luftës për shkatërrimin definitiv ideologjik dhe politik të revizionizmit. Në këto kushte lufta kundër revizionizmit modern nuk duhet të pushojë për asnjë çast. Ne, gjatë gjithë kësaj kohe, kemi konstatuar se revizionistëve modernë u duhej qetësi, pushim i polemikës, me qëllim që të konsolidonin pozitat e tyre. Por partitë tona mbajtën një pozicion të drejtë luftarak, e vazhduan polemikën, sepse ajo ishte rruga më e drejtë në luftën kundër revizionizmit. Kjo bëri që kontradiktat midis vetë revizionistëve të thelloheshin dhe ata të dobësoheshin më tej, prandaj dhe nuk mundën të ecnin dot përpara në situatën që iu krijua atyre me Hrushovin në krye.

Partia e Punës e Shqipërisë mendon se lufta jonë shkaktoi, së pari, zbulimin e tradhtisë së grupit të Hrushovit në fushat teorike, ekonomike dhe në politikën e jashtme, si dhe demaskimin e revizionizmit modern në përgjithësi e atij sovjetik në veçanti, demaskimin e gjithë veprimtarisë së tyre si në platformën sovjetike, ashtu edhe në atë ndërkombëtare. Së dyti, lufta jonë kundër revizionizmit modern krijoi dhe thelloi më tej kontradiktat në gjirin e tij. Miqtë e revizionistëve sovjetikë u gjendën në pozita lufte me hrushovianët. Që të gjithë ata u trembën dhe filluan të kërkojnë rrugë për të zgjidhur kontradiktat midis tyre. Revizionistët sovjetikë mendonin që t'i zgjidhnin këto kontradikta në mënyrë revizioniste, por revizionistët e tjerë nuk ishin plotësisht dakord me ta. Hrushovi vendosi të bënte mbledhjen e përçarjes, por revizionistët italianë, hungarezë, polakë nuk ishin aq të bindur se duheshin

përjashtuar PK e Indonezisë, Partia e Punës e Shqipërisë etj. Ata donin të ndiqnin rrugë të tjera, jo atë të përjashtimit, por të djallëzive të mëdha, me një fjallë të «bisedimeve», të kompromiseve, për të dhënë përshtypjen se mosmarrëveshjet, kontradiktat mund të zgjidheshin.

Këto kontradikta i krijoi qëndrimi i drejtë që mbajmë në duke shpallur se nuk do të marrim pjesë në mbledhje, se kjo është një mbledhje përçarësish. Kështu, revizionistët sovjetikë u vunë në situata jashtëzakonisht të vështira, u vunë jo vetëm në grykën e pushkëve tona, por edhe në grykën e kritikave të miqve të tyre e të imperialistëve amerikanë, të cilëve u interesonte që Hrushovi të bënte lëshime akoma më të mëdha. Edhe situata e brendshme në Bashkimin Sovjetik duhet të ketë luajtur një rol të madh, saqë shokëve të Hrushovit u erdhi thika në grykë, prandaj, për ta ndrequr këtë situatë të rëndë që u krijua për ta, i thanë Hrushovit «jashtë!».

Partia jonë mendon se tani që u rrëzua Hrushovi, ne duhet të jemi edhe më vigjilentë. Ç'janë ata që erdhën në krye të Bashkimit Sovjetik? Janë revizionistë, janë shokët e luftës së Hrushovit, që bashkë me të bënë kongreset e 20-të dhe të 22-të, që luftuan kundër marksizëm-leninizmit, që konkretizuan vijën e revizionizmit modern, që luftuan me ashpërsinë më të madhe kundër partive tona, që shkaktuan çarjen *de facto* të kampit socialist, që fuqizuan revizionizmin në vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës dhe hynë në aleancë me imperializmin amerikan e borgjezinë ndërkombëtare. Pra, në krye janë njerëzit e së njëjtës vijë.

Duke e parë çështjen kështu, është e drejtë të themi se nuk duhet të kemi asnjë iluzion për pasardhësit e Hrushovit dhe të jemi shumë vigjilentë.

Por si e kupton Partia jonë këtë vigjilencë? Këtë ajo e kupton kështu: Hrushovi, si person, politikisht vdiq dhe ideologjia e tij, revizionizmi, pësoi një disfatë të madhe, por hrushovizmi nuk është zhdukur. Megjithëse Bashkimi Sovjetik gjendet në vështirësi të mëdha, tani ne duhet të veprojmë në mënyrë të tillë që jo vetëm të mos ia lehtësojmë punën revizionizmit modern në përgjithësi dhe atij sovjetik në veçanti për të marrë veten, por të ndihmojmë që ata të dobësohen edhe më shumë dhe këtë disfatë të tyre ta kthejmë në fitore të vazhdueshme të forcave marksiste-leniniste.

Kush do ta bëjë kthesën drejt fitores në Bashkimin Sovjetik? Ne kemi shpresë se forcat e brendshme të bolshevizmit në Bashkimin Sovjetik do të dinë të veprojnë. Këtë gjë ato duhet ta bëjnë, se është në interes të popullit të tyre, kurse ne duhet t'i ndihmojmë. Rrugja jonë është të mos e shuajmë asnjëherë luftën kundër revizionizmit modern dhe hrushovian.

Mund të jetë akoma shpejt për të dhënë një mendim të plotë, se pak ditë ka që u rrëzua Hrushovi, por, si e gjuajmë ne, tani për tani, udhëheqja sovjetike gjendet në pozita shumë të vështira. Nga çdo anë që ta shohësh punën, del se ne jemi në pozita të shëndosha luftarake, sulmi, kurse udhëheqja revizioniste sovjetike është në pozita shumë të rënda, pasi zhdukja e Hrushovit nga skena politike i jep forcë revolucionit, e bën atë më të fuqishëm dhe e ndihmon të ngrihet më lart. Nga ana tjetër, pasuesit e Hrushovit, revizio-

nistët e tjerë, po bëjnë presion, duke thënë se «Hrushovi ishte njeri i mirë» dhe shtojnë se «edhe në qoftë se ai nuk ka qenë i mirë, udhëheqja e re të qëndrojtë të paktën në vijën e kongreseve të 20-të dhe të 22-të».

Çfarë tendence kanë tani udhëheqësit e rinj revizionistë sovjetikë? Si revizionistë që janë, ata deklaruan se do të qëndrojnë në pozitat e kongreseve të 20-të dhe të 22-të. Natyrisht, ata do të përpiqen me taktika të ndryshme të krijojnë përshtypjen se janë në rrugë të drejtë dhe synojnë për të stabilizuar situatën-krizë në të cilën jetojnë. Kjo do të thotë që largimit të Hrushovit t'i vihet njëfarë melhemi, të kapërcehen vështirësitë, të qetësohen revizionistët e tjerë, amerikanët, Eoni dhe, mbase, gënjehen indonezianët, shqiptarët etj., për t'i mbajtur këta me shpresë se gjoja tani në Bashkimin Sovjetik diçka do të ndryshojë.

Por revizionistët sovjetikë nuk mund të na hedhin hi syve. Ata mbeten përsëri revizionistë. Gjërat nuk rregullohen sipas dëshirës së tyre. Në qoftë se pranojmë për një çast që udhëheqja e sotme sovjetike do të ndreqet, megjithëse kjo s'mund të ndodhë se ata janë si Hrushovi, atëherë duhet, për shembull, që ambasadori sovjetik në Xhakartë, Mihaillovi, ish-miku ynë, të ndryshojë qëndrimet e gjertanishme dhe të thotë përpara komunistëve indonezianë se «Hrushovi kishte bërë gabime të mëdha» dhe të tregojë konkretisht çfarë gabimesh kishte bërë. Po kështu, që të mund «ta rregullojnë» me shqiptarët, udhëheqësit sovjetikë duhet të flasin ç'ka bërë klika e Hrushovit kundër Shqipërisë dhe këtë ta thonë botërisht. Por ata nuk e bëjnë këtë, sepse një gjë e tillë u dobëson pozitat e tyre revizio-

niste. Sikur populli sovjetik, që ka katër vjet me radhë duke dëgjuar se «shqiptarët janë armiq të Bashkimit Sovjetik», se «udhëheqësit shqiptarë janë agjentë të imperializmit» etj., të dëgjojë nga udhëheqja aktuale sovjetike se «ato që janë thënë në adresë të Shqipërisë nuk kanë qenë të vërteta» atëherë kjo do t'i jepte zjarr çështjes.

Pastaj, është edhe një çështje tjetër me shumë rëndësi. Revizionistët hiqen si marksistë të shquar, por Stalinin ata e bënë leckë. Sipas tyre, ai paskësh bërë tërë ato «krime». Në qoftë se udhëheqësit e sotëm sovjetikë duan ta heqin veten më të mirë se Hrushovi, atëherë duhet të thonë se «ato që janë thënë kundër Stalinit janë shpifje». Duan s'duan, opinionin do t'i detyrojë ata ose t'i thonë poshtërsitë e Hrushovit, ose, në qoftë se nuk i thonë, të vihen në pozita false dhe njerëzit do të vërtetojnë edhe një herë se udhëheqësit sovjetikë nuk janë marksistë, por janë revizionistë, janë disa komplotistë.

Rrëzimin e Hrushovit duhet ta konsiderojmë fitore të madhe, sepse me këtë është diskredituar gjithë vija e kongreseve të 20-të dhe të 22-të. Kjo fitore duhet çimentuar duke korrur fitore të tjera. Kjo, mendojmë ne, do të arrihet nëpërmjet polemikës, të cilën ne jemi për ta vazhduar. Nuk kemi besim se udhëheqja sovjetike do të ndreqë gabimet. Tendencia e saj, si e të gjithë revizionistëve, është të shuajë luftën, të pushojë polemikën. Por marksizëm-leninizmi nuk e ka shuar kurrë luftën, polemikën, as kundër oportunistëve bernshajtjanë, kautskianë etj., as kundër revizionistëve modernë. Me gjithë fitoret e mëdha që korri Lenini kundër trockistëve, buharinistëve, zinovievistëve etj., me gjithë

fitoret që korri mbi ta Bashkimi Sovjetik, nën udhëheqjen e Stalinit, marksizëm-leninizmi nuk e pushoi asnjëherë luftën kundër oportunitizmit. Më vonë doli revizionizmi titist dhe ai hrushovian etj., që po pësojnë disfatë. Këto disfata ne duhet t'i thellojmë duke forcuar polemikën kundër revizionizmit, i cili përbën vazhdimisht një rrezik të madh në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Partia jonë mendon se revizionistët kanë krijuar në gjirin e disa partive komuniste pikëpamje që ushqehen fuqimisht nga borgjezia dhe imperializmi. Nuk mund të mendohet kurrësi se me rrëzimin e Hrushovit u shkatërrua rryma e revizionizmit modern në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në këto situata të favorshme për ne, por edhe të rrezikshme, ne duhet të qëndrojmë si deri tani në ballë të luftës për ta shkatërruar më tepër këtë frymë që kanë krijuar revizionistët.

As juve, as neve, asnjë komunisti të vërtetë nuk u shkonte në mendje tragjedia që ndodhi në Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së Stalinit. Fundja, mund të mendonim se një gjë e tillë mund të ngjiste kudo gjetkë, por jo në Bashkimin Sovjetik. Stalini e vinte theksin kurdoherë në vigjilencën revolucionare. Por është fakt se komunistët sovjetikë, pas vdekjes së tij, e humbën vigjilencën. Hrushovi përhapi tezën se «ne jemi të fortë, imperializmi s'ka ç'na bën» etj. Kjo ishte një nga tezat e tij që kishte për qëllim të nënvleftësonte rrezikun e imperializmit, të përhapte revizionizmin modern me të gjitha të këqijat e tij. Prandaj, neve marksistë-leninistëve të epokës sonë, që e jetuam këtë fatkeqësi

për Bashkimin Sovjetik dhe për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, nuk na lejohet të dobësojmë vigjilencën. Popujt tanë nuk do të na e falnin, po t'u bënim lëshime armiqve të klasës. Këtë nuk do të na e falnin as brezat e ardhshëm. Po të humbasim ne vigjilencën, brezave të ardhshëm do t'u vështirësohen jash-tëzakonisht jeta dhe lufta. Popujt do të aprovojnë vetëm qëndrimet tona të drejta. Jemi të sigurt se imperialistët, revizionistët, oportunistët e çdo lloji do të na shajnë, por neve aq na bën, sharjet e armiqve janë lëvdata për ne.

Të marrim eksperiencën e Partisë sonë. Ne kemi luftuar njëloj dhe në një radhë me partitë e vërteta marksiste-leniniste. Por dua të them se, kur filluam Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare ishim të rinj dhe të paktë në numër. Në Shqipëri u përhapën nga reaktionarët zëra, që thoshin se «komunistët janë të marrë», «janë kalamaj», «na morën në qafë», «po bëhen shkak të na digjet vendi», «a mund të luftohet me Italinë e me Gjermaninë, që janë shtete të fuqishme dhe të mëdha?» etj., etj. Mirëpo Partia jonë nuk u tërhoq nga rruga e saj, ajo shkoi përpara dhe kur e fituam luftën, shumë nga ata që i hidhnin këto parulla, pohuan se ishin gabuar, se komunistët ishin në rrugë të drejtë. Kur ne më vonë ndërnuam bazat e socializmit, përmirësuam jetën e popullit, ndërnuam industrinë moderne dhe e kthyem bujqësinë në rrugën socialiste, shumë armiq e panë edhe më qartë rrugën e tyre të gabuar. Kishte prej tyre që thanë vetë se komunistët edhe luftën ditën ta bëjnë, edhe vendin po e ndërtojnë si duhet. Edhe kur dolëm kundër revizionizmit, në mbrojtje të

marksizëm-leninizmit, ç'nuk thanë armiq të kundër nesh. Ata thanë se ne ishim «armiq», «trockistë», «aventurierë» etj. Pas fjalimit tonë në Mbledhjen e Moskës në vitin 1960, na takoi gruaja e Moris Torezit, Zhanetë Vermeshi dhe na tha: «Ku po shkoni, shoku Enver, ç'është kjo rrugë që keni nisur, ne nuk ju kuptojmë dot». Atëherë unë iu përgjigja kështu: «Në qoftë se nuk na kuptoni sot, do të na kuptoni nesër» dhe kur ra Hrushovi, ajo do t'i ketë kujtuar fjalët tona.

Tani, në situatën e krijuar, kur ne do të mbajmë qëndrimin e duhur ndaj revizionistëve, ata përsëri do të na shajnë, natyrisht tani me zë më të ulët, por prapë do të na shajnë. Por ne ndjekim një vijë të drejtë dhe e dimë që nesër edhe ata do ta mbyllin gojën, se do t'i kemi mundur, se atëherë në krye të Bashkimit Sovjetik edhe në vendet e tjera ish-socialiste do të kenë ardhur shokët tanë revolucionarë. Se kur do të ndodhë kjo, nuk e dimë, por mendojmë se do të vijë dita që shokët tanë marksistë-leninistë të vijnë në fuqi në Bashkimin Sovjetik. Se si do të arrihet kjo, varet nga lufta e tyre brenda në Bashkimin Sovjetik, nga lufta jonë e përbashkët që ndriçohet nga marksizëm-leninizmi, varet nga uniteti ynë. Prandaj sigurojeni Komitetin Qendror të partisë suaj dhe shokun Aidit se te Partia e Punës e Shqipërisë ka një mik të ngushtë marksist-leninist, që është solidar me luftën tuaj.

Vështirësi kemi pasur, por lufta është luftë. Edhe në të ardhmen armiq të nuk do të rrinë duarlidhur, por jeta ka vërtetuar dhe vërteton se marksistët janë shumë më të fortë. Le të kenë revizionistët sa të duan raketa dhe bomba atomike, rubla e dollarë, por mar-

ksizmin, të vërtetën, të drejtën ata as i shtypin, as i thyejnë dot.

Për sa u përket punëve tona brenda vendit, mund t'ju them se me gjithë vështirësitë që na kanë dalë kemi mjaft përparime. Tani jemi duke përgatitur pesëvjeçarin e ri. Rëndësi të veçantë në këtë pesëvjeçar do t'i vëmë bujqësisë në drejtim të ujitjes, mekanizimit dhe plehërimit. Duke ndërtuar dy uzinat për prodhimin e plehrave azotike dhe fosfatike, besojmë se do ta realizojmë synimin tonë për prodhimin e drithërave në vend. Sigurimi i bukës në vend ka qenë dhe është një detyrë mjaft e vështirë për ne. Në fillim patëm menduar se kjo detyrë mund të realizohej lehtë, por në praktikë pamë se nuk ishte kështu, veçanërisht në kushtet kur na mungonin plehurat. Është fakt që kolektivizimi te ne në përgjithësi ka mbaruar me sukses dhe jeta në fshatin tonë është përmirësuar jashtëzakonisht shumë. Të gjithë fshatarët pothuaj kanë bërë shtëpi të reja, jetojnë shumë më mirë se përpara, por ka rëndësi të madhe çështja që ne ta prodhojmë bukën në vend, të mos sjellim asnjë kokërr drithë nga jashtë. Këtë synojmë tani. Ne parashikojmë që në pesëvjeçarin që vjen ta përfundojmë bonifikimin e fushave, pasi kemi vite që po punojmë për këtë. Edhe industria jonë po përparon çdo ditë. Në këtë pesëvjeçar do të zgjerojmë industrinë ekzistuese e minierat tona, do të zhvillojmë më tej kulturën dhe arsimin që kanë marrë një hov të madh. Tani në vendin tonë ka shkolla kudo, në të gjitha fshatrat. Shkolla 7-8-vjeçare është bërë gati e përgjithshme. Perspektivat e zhvillimit ekonomik të vendit tonë janë të mira. Natyrisht do të na duhet akoma shumë punë, por kjo

nuk na tremb. Edhe luftë për të kapërcyer vështirësitë duhet, por edhe kjo nuk na tremb, se e dimë që pa luftë e pa përpjekje, asgjë nuk fitohet.

Na kanë thënë se edhe te ju situata është e mirë, se partia është futur thellë në fshat. Në qoftë se partia arrin të zbatojë reformën agrare, ky do të jetë një sukses i madh. Nuk di si e keni gjendjen dhe si mendoni ta bëni reformën agrare?

Duke e marrë fjalën, miku i ardhur nga Indonezia tha:

Zbatimin e reformës agrare e konsiderojmë një veprim të njëanshëm të partisë sonë. Çifligarët nuk duan që ajo të zbatohet, por ne kemi fshatra që po e zbatojnë reformën. Atje partia u ka dhënë tokë fshatarëve dhe u ka thënë që toka është juaja. Sot ka shumë presion mbi qeverinë që të ndalohen këto veprime të njëanshme, kurse ne luftojmë që këto veprime të vazhdojnë.

Jam dakord me të gjitha mendimet që shprehët ju në lidhje me situatën dhe me udhëheqjen sovjetike. Por doja t'ju pyesja për mbledhjen e Moskës, ç'qëndrim mund të mbajnë udhëheqësit sovjetikë? Kur isha tani në Moskë, pata një diskutim me sovjetikët mbi këtë çështje dhe u thashë që shtatë parti komuniste kanë shpallur se nuk do të marrin pjesë në këtë mbledhje. Kur i pyeta nëse do ta bënin mbledhjen në këto kushte, ata u përgjigjën se do ta bëjnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Partia jonë mendonte se hrushovianëve dhe revizionistëve të tjerë modernë u interesonte një mbledhje ku të merrnin pjesë partitë tona. Po përse u interesonte? Që të shuhej polemika.

Nga ana tjetër, në qoftë se partitë tona do të merrnin pjesë në të, Kjo mbledhje do të ishte e favorshme për revizionistët, pasi, megjithëse nuk do të binim dakord me pikëpamjet e tyre, ata diçka do të përfitonin. E ç'mund të përfitonin? Duke vajtur ne në këtë mbledhje do të lihej përshtypja e rreme në lëvizjen komuniste ndërkombëtare se gjoja ka mundësi të diskutohet, pavarësisht që tani për tani aty nuk u arrit ndonjë rezultat, do të krijohet iluzioni se do të bëhet përsëri mbledhje tjetër pas një viti dhe gjatë kësaj kohe revizionistët hrushovianë të zbatonin vijën e tyre, qoftë në Bashkimin Sovjetik, qoftë në arenën ndërkombëtare. Për një mbledhje të tillë ishin jo vetëm hrushovianët, por edhe revizionistët e tjerë, sepse të gjithëve u interesonte kjo. Por Partia jonë, jo vetëm që ishte e vendosur të mos shkonte vetë në atë mbledhje, por ishte e bindur se kështu do të bënin edhe partitë e tjera marksiste-leniniste. Ne kishim arritur në konkluzionin që në rast se partitë tona nuk do të venë në mbledhje, kjo nuk është në favor të revizionistëve. Një mbledhje e revizionistëve pa ne është kurdoherë revizioniste, fraksioniste, përçarëse. Por pikërisht kjo nuk u intereson revizionistëve, sepse me këtë mbledhje do të sanksionohej përçarja e plotë dhe e hapët e lëvizjes komuniste dhe do të kuptohej nga të gjithë komunistët në botë se shkaktarët e përçarjes janë revizionistët.

Ç'ngjet tani? Mbledhja është fisheku i fundit i revizionistëve. Të gjithë fishekët e tjerë në lidhje me pushimin e polemikës ata i zbrazën. Hrushovi e pa se këta fishekë i shkuan kot, domethënë demagogjia e tij

për unitetin nuk piu ujë. Grupit të Hrushovit dhe imperializmit amerikan në përgjithësi u interesonte që të arriheshin disa objektiva në politikën ndërkombëtare dhe të krijohej përshtypja se diçka po fitonin, si për shembull, në çështjen e Gjermanisë, në çështjen e çarmatimit etj. Që t'i siguronte këto, Hrushovi orientohej fuqimisht nga politika e imperializmit amerikan, presioni i të cilit ishte i tillë që e shtynte, e inkurajonte atë të bënte përçarjen. Përpara kësaj situatë Hrushovi mori vendim të bënte mbledhjen, megjithëse kjo ishte në disfavorin e revizionizmit. Por ai veprroi si një kumarxhi dhe këtë e bëri se situatën e kishte shumë të vështirë. Kjo ishte një zgjidhje e dëshpëruar për të dhe një nga shkaqet që revizionistët e tjerë, të cilët kanë hyrë në rrugën e aleancave me imperializmin amerikan, francez etj., sidomos nga ana ekonomike, por edhe nga ana politike e ideologjike, megjithëse kanë fituar njëfarë besimi më të madh në veten e tyre për të ecur me kujdes në rrugën e tradhtisë që kanë zënë, u tronditën. Ata u frikësuan nga veprimet e Hrushovit, ngaqë mendonin se, po të bëhej ndonjë çarje, kjo do të shkaktonte luftë brenda në partitë e vendeve të tyre, si në Poloni, Çekoslovakia, Rumani etj., veçanërisht në partitë komuniste të vendeve kapitaliste. Në vendet ish-socialiste të Evropës, revizionistët kanë në dorë fuqinë, armën e diktaturës, por me acarimin e gjendjes, këtë armë që kanë në dorë ata ose do ta kthejnë në diktaturë fashiste, ose nuk do ta përdorin dot. Në qoftë se do ta kthejnë në diktaturë fashiste kjo do t'i jepte hov revolucionit dhe do të ishte një dobësim për ta.

Ky ishte një shkak që i detyroi revizionistët t'i bënin presion Hrushovit për mbledhje.

Mirëpo Hrushovi u rrëzua. Tani, a do ta bëjnë mbledhjen pasardhësit e tij? Ne mendojmë se ata do të përpiqen ta bëjnë mbledhjen. Tani ata na thonë: «Ne kemi edhe një shkak tjetër për ta bërë mbledhjen, se u rrëzua Hrushovi, prandaj ejani dhe ju!». Ata mund të na thonë edhe «na falni, jemi shokë, hajdeni të përqafohemi», sepse, sipas tyre, «pas Hrushovit çdo gjë u rregullua!» Ata do të përpiqen të tatojnë pulsën tonë. Ata mund të venë, për shembull, te kinezët, mund të vijjnë gjithashtu te ju, te ne etj., por sidoqoftë ne duhet të qëndrojmë kurdoherë në pozita revolucionare.

Tani që u rrëzua Hrushovi, ata e kanë lehtë, mund ta shtojnë për ca kohë mbledhjen, pasi thonë se janë «situata të tjera». Kur thonë tani se «do ta bëjmë mbledhjen», mendojmë se vetëm bëjnë shantazhe. Për ne, marksistët, e mira është të mos vemi në këtë mbledhje për arsyet që dimë, por edhe për arsyen tjetër që, duke mos vajtur ne, ideja e Hrushovit që të bëhej mbledhja të diskreditohet gjer në fund.

Revizionistët sovjetikë që janë tani në fuqi duan të krijojnë përshtypjen se Hrushovin e skartuan «për kultin e individit», «për akroballëq», «për harxhime të kota», domethënë për disa gjëra me karakter subjektiv dhe jo për çështje të thella politike dhe ideologjike. Këtë manovër ne duhet t'ua demaskojmë. Ata duan ta bëjnë mbledhjen për të shpëtuar pozitën, vijën kryesore të politikës së Hrushovit. Me këtë politikë ka të bëjë mbledhja që kërkojnë të zhvillojnë revizionistët. Mbledhjen e ka dashur Hrushovi, por ai, siç thonë re-

vizionistët sovjetikë, ka bërë «disa gabime» subjektive, prandaj ne, thonë ata, «mund të vazhdojmë të bëjmë mbledhje për unitetin». Qëllimi është një, edhe Hrushovi këtë qëllim kishte, të bëhej mbledhja, gjoja për forcimin e unitetit.

Partia jonë mendon se edhe revizionistët që erdhën tani në krye të Bashkimit Sovjetik kanë eksperiencë në tradhti. Por Hrushovi ishte një aventurier i shkathët. Në mënyrë sekrete ai mund të ketë rënë në ujdi edhe me amerikanët, edhe me Erhardin për njëfarë mënyre zgjidhjeje tradhtare të çështjes gjermane dhe të Berlinit. Këtu duhet të ketë diçka, sepse ka katër vjet që është vendosur se si duhej zgjidhur çështja gjermane dhe kemi parë se si ka shkuar kjo çështje. Përpunimi i çështjes gjermane, ashtu si u bë nga Hrushovi, do të përfundonte medoemos në një tradhti dhe Hrushovi ka mundësi që këtë ta ketë bërë. Prandaj shokët e tij janë gjendur përpara këtij fakti dhe i kanë thënë «stop!» kursit të tij.

Lidhur me çështjen e Azisë Juglindore, Vietnamit, Laosit e Kamboxhias, lidhur me provokacionet e rrezikshme amerikane në këto vende, Hrushovi gjithashtu mund të ketë rënë në ujdi e të ketë lidhur aleanca të fshehta me amerikanët për t'i acaruar punët, për të armatosur e për të ndërsyer Indinë kundër Kinës. Me imperializmin amerikan Hrushovi mund të ketë pasur një strategji ndërkombëtare pak a shumë të njëjtë dhe që ta zbatonte këtë strategji ka mundësi që ai t'i ketë bërë lëshime të tjera atij, për shembull, në lidhje me kontrollin në fushën e çarmatimit.

Kontradiktat, gjoja ideologjike, me imperializmin

amerikan hrushovianët i kanë çuar në një aleancë të shenjtë me të. Ky është përfundimi logjik i tradhtisë së Hrushovit. Përpara një gjëje të tillë shokët e tij janë alarmuar. Po të ishte çështja për gabime subjektive, për kultin e individit të Hrushovit etj., ata mund ta thërritnin Hrushovin dhe t'i thoshin: «Ku po shkon, hiqi qafe këto gjëra!». Të mos na flasin për pleqërinë e Hrushovit, se ky nuk u bë plak në një ditë. Prandaj, çdo orvatje demagogjike e tyre synon në njëfarë qetësie, me qëllim që ata të dalin nga qorrsoakaku ku kanë hyrë, nga kjo situatë e rëndë për ta. Në këtë situatë ne nuk duhet të gabojmë, ta vazhdojmë polemikën dhe të mos e pushojmë për asnjë çast.

Ne mendojmë se lufta kundër revizionizmit hrushovian ka një rëndësi të madhe vendimtare, por po aq vendimtare është lufta brenda në vetë Bashkimin Sovjetik, sepse bolshevikët e vjetër e të rinj janë ata që mund ta thonë fjalën për sa i përket udhëheqjes sovjetike. Ne nuk mund të drejtojmë armët për të rrëzuar klikën hrushoviane sovjetike, se jemi marksistë, por dënojmë dhe demaskojmë tradhtinë e saj. Janë komunistët dhe populli sovjetik që do ta thonë fjalën për të qeruar hesapet me udhëheqjen revizioniste sovjetike. Dhe, po të arrihet një sukses i tillë në Bashkimin Sovjetik, atëherë u kemi dhënë një grusht të rëndë vdekjeprurës revizionizmit dhe imperializmit botëror.

MIKU INDONEZIAN: Edhe partia jonë qysh në fillim vendosi të mos marrë pjesë në mbledhje.

SHOKU ENVER HOXHA: Kështu duhej. Nuk përjashtohet që midis shokësh të ketë mendime të ndryshme për një problem të caktuar, por kur diskutohet

bashkërisht gjendet rruga e drejtë e përbashkët. Këtu qëndron forca e marksizmit dhe këtu tregohen ata që janë marksistë. Është e hidhur, por kur njëri gabon, i duhet thënë në sy gabimi. Kjo na forcon ne, marksistët.

MIKU INDONEZIAN: Vija e të dyja partive tona ka qenë e njëlojtë, vetëm se ju keni luftuar fare hapur, kurse ne jo.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është e kuptueshme se ne revizionistët na sulmuan të parët, ata donin të na likuidonin dhe me këtë të frikësonin edhe partitë e tjera, një pjesë e të cilave në fakt nuk u frikësuan, rezistuan dhe demaskimi i Hrushovit u bë. Nuk kemi asnjë pretendim se luftën kundër revizionizmit e bëmë vetëm ne, atë e bënë të gjithë.

MIKU INDONEZIAN: Po ju keni luajtur një rol të madh, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne kemi bërë vetëm detyrën tonë, atë që duhet të bënte një parti marksiste-leniniste. Por për demaskimin e revizionizmit dhe rrëzimin e Hrushovit është dashur lufta e të gjitha partive tona. Ishte kjo luftë që i dha një grusht të rëndë revizionizmit modern.

MIKU INDONEZIAN: Ne e admirojmë shumë parullën tuaj që është një shprehje e një morali të lartë komunist: «Më mirë të hamë bar, sesa të rrojmë të gjunjëzuar».

SHOKU ENVER HOXHA: Rreziket për ne pas Mbledhjes së Moskës ishin shumë të mëdha. Ishte në radhë të parë rreziku i sulmit me armë, i kompleteve. Ne kemi fakte që revizionistët hrushovianë, titistë, së

bashku me monarko-fashistët, grekë dhe imperialistët amerikanë kanë komplotuar kundër vendit tonë.

MIKU INDONEZIAN: Ju e kaluat me sukses këtë provë të vështirë dhe keni fituar një eksperiencë të madhe. Kjo edhe në fushën e edukimit. Ja, për shembull, ne jemi interesuar shumë për raportin që mbajti shoku Ramiz Alia në Plenumin tuaj të fundit¹ si dhe për fjalën tuaj në mbyllje të këtij Plenumi. Edhe ne e kemi shtruar këtë problem, se na preokupon në vendin tonë. Na intereson shumë shkëmbimi i eksperiencës në këtë drejtim, se te ju bëhet një luftë e madhe për edukimin ideologjik të komunistëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Te ne zhvillohet një aktivitet shumë i gjerë politik e ideologjik i lidhur ngushtë me punën, me jetën. Ne i kemi të gjitha mundësitë për këtë, sepse në fuqi është diktatura e proletariatit, kurse te ju, natyrisht, është më vështirë. Kjo nuk do të thotë se çështja e edukimit te ne është zgjidhur plotësisht. Për shembull, vjedhësin ne e dënojmë politikisht dhe ideologjikisht, por njëkohësisht te ne vepron edhe ligji. Te ne dënimi ka njëkohësisht edhe karakter edukativ. Këtë avantazh ne e kemi, sepse ligjvënës është populli. Kurse ju punoni vetëm politikisht dhe ideologjikisht që komunistët të jenë të pastër, meqenëse fuqinë e ka në dorë borgjezia, dënimin e jep ajo, sipas interesave të saj klasore. Nga ana tjetër, te ju veprojnë edhe partitë e tjera borgjeze, të cilat zhvillojnë aktivitet të gjerë për të dëmtuar partinë tuaj, përpiqen me një mijë mënyra ta korrutojnë ko-

¹ Plenumi i KQ të PPSH i Korrikut 1964.

munistin, ta godasin moralisht e ta dobësojnë. Kurse në vendin tonë nuk ka parti të tjera, elementët borgjezë luftojnë në mënyrë spontane, të shkëputur. Mbeturina të ideologjisë së huaj ekzistojnë edhe te njerëzit tanë, por ato veprojnë në mënyrë sporadike, kurse te ju ato veprojnë në mënyrë të organizuar, pasi i nxit borgjezia, që është në fuqi. Kjo nuk do të thotë se te ne nuk ka shfaqje të këqija në ndërgjegjen e njerëzve. Të tilla ka dhe do të ketë jo vetëm te njerëzit pa parti, por edhe tek anëtarët e Partisë. Por Partia jonë është kurdoherë në luftë me këto mbeturina dhe bën një punë të organizuar për t'i korrigjuar anëtarët e saj, që manifestojnë shfaqje të huaja. Në qoftë se nuk zhvillohet kjo luftë, atëherë mund të prishet ndërgjegjja e njerëzve. Prandaj njerëzit tanë mbajnë qëndrim të drejtë ndaj punës dhe jashtë saj, ndaj pronës socialiste, janë të brumosur me moralin proletar etj. Kjo natyrisht është një punë e shumanshme e Partisë, që te ne bëhet në kushte më të favorshme se te ju, pasi çdo gjë në vendin tonë, agjitacioni, propaganda, filmat, teatri, botimet etj., drejtohet nga Partia. Për Partinë edukimi i komunistëve është një nga detyrat vendimtare. Në qoftë se ata edukohen në rrugë të drejtë, atëherë çdo gjë shkon shumë mirë.

Ne nuk e njohim sa duhet popullin indonezian, por kemi përshtypjen se është një popull i mirë, i thjeshtë, i ndershëm, popull që nuk ka pretendime të mëdha, sepse ka qenë i shtypur dhe i shfrytëzuar. Kështu ka qenë edhe populli ynë, i shtypur dhe i shfrytëzuar. Sigurisht Partia Komuniste e Indonezisë duhet të jetë pasqyrë e popullit të vet, siç është pasqyrë e popullit

shqiptar Partia jonë. Virtytet e popullit janë konkretizuar te Partia jonë. Populli shqiptar është i ndershëm. Veset e këqija nuk kanë ekzistuar te njerëzit e thjeshtë të popullit, sepse ato i kanë pasë grumbulluar bejlerët. Kjo ka ndikuar që Partia jonë të jetë e pastër nga kjo anë, megjithatë nuk përjashtohet që edhe në radhët e Partisë të ketë komunistë që kanë në ndërgjegjen e tyre mbeturina.

Një urrejtje shumë të madhe ka pasur populli ynë kundër degjenerimit moral të klasës feudale dhe në shumë raste i ka imponuar feudalët të ishin të matur. Prandaj ata nuk mund të bënin dot si donin në Shqipëri dhe, për të kënaqur tekat e tyre, shkolin jashtë. Këtë ndershmëri të popullit tonë, në frymën e re të moralit proletar e ka forcuar dhe po e forcon gjithnjë e më shumë Partia. Çështja e solidaritetit, e ndershmërisë, e fjalës së dhënë janë traditë e popullit tonë. Në gjuhën tonë ekziston shprehja: «Shqiptari kur jep fjalën, ther djalin». Me këtë dua të them se për mbrojtjen e njerëzve të thjeshtë e të ndershëm populli ynë s'është kurrë. Për shembull, njërit mund t'i ndodhte që ta ndiqte feudali për ta vlarë. Ai futej te një shtëpi dhe familja që banonte aty e fshihte. Të gjithë pjesëtarët e familjes pranonin të vriteshin, por atë që ishte fshehur nuk e tregonin dhe nuk e dorëzonin te feudali. Kur na pushtoi fashizmi, populli u ngrit në këmbë dhe kudo që venin komunistët, portat e shtëpive të tij i gjenin të hapëta dhe ai i mbronte prej pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të vendit.

Ka edhe shumë karakteristika të tjera të mira po-

pulli ynë. Të gjitha këto Partia jonë i ruan, i zhvillon, i vë në dukje dhe me to edukon komunistët, kuadrot e saj dhe punonjësit. Dhe mund të themi se kemi arritur një sukses të dukshëm që popullin në përgjithësi e kemi të ngritur politikisht. Në vija të përgjithshme, ideologjikisht populli ynë i kupton drejt problemet dhe politikisht gjykon shumë drejt. Kushdo mund të bisedojë në Shqipëri me njeriun më të thjeshtë për çështje politike dhe do të konstatojë se ai nuk gabon. Në qoftë se një person flet mbi një çështje në kundërshtim me vijën e Partisë, atë e kupton menjëherë edhe punonjësi më i thjeshtë dhe i jep përgjigjen e duhur. Këtë e konstatojmë edhe tani me rrëzimin e Hrushovit. Kjo është një gjë e madhe. Populli, sa e mori vesh ngjarjen, u solidarizua plotësisht me qëndrimin e Partisë sonë dhe nisi të përshëndesë Komitetin Qendror të Partisë me letra, duke theksuar njëkohësisht parullën e Partisë: «Ta vazhdojmë luftën, se Hrushovi vdiq, por hrushovizmi është akoma i gjallë». Çështjen e kam për një kuptim të drejtë të problemeve nga ana e popullit tonë, ai nuk fluturon në hava dhe nuk entuziazohet pa baza. Pastaj popullin tonë e kemi edhe punëtor, edhe të sakrificës. Kur na bënë bllokadën ekonomike Hrushovi dhe ata që e pasojnë, na prenë të gjitha kreditë dhe furnizimet, por as më e vogla tronditje nuk u duk në popull. Përkundrazi, njerëzit thoshin: «Preferojmë të rrimë edhe pa bukë, por do të bëjmë si thotë Partia, sepse ajo e ka drejt». Kjo është një fitore e madhe për Partinë tonë, është një mbështetje kolosale. Lufta vazhdon, por ne do të fitojmë.



Ne u gëzuam që u takuam dhe dëshirojmë që të na vijnë edhe shokë të tjerë indonezianë të takohemi, bile edhe vetë shoku Aidit. Ju urojmë suksese të vazhdueshme në luftën tuaj!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**PARTIA KERKON QË POPULLI DHE USHTRIA
TË JENË TË QARTË POLITIKISHT DHE TË
PËRGATITUR USHTARAKISHT**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH*

30 tetor 1964

Mbi korpusin tuaj¹ dhe mbi ushtrinë në përgjithësi do të shfaq edhe unë disa mendime.

Ushtria jonë është një forcë e madhe, që duhet të edukohet vazhdimisht, përgatitjet e saj të bëhen me një temp të tillë që në momentet e rrezikshme të jetë e gatshme plotësisht nga ana ushtarake, ideologjike, politike, morale etj. Mjetet që ka ushtria në dispozicion duhet të përdoren në mënyrë racionale, me rendiment të plotë dhe në kohën e nevojshme.

Është e domosdoshme që ushtria të përvetësojë si duhet artin ushtarak. Në këtë drejtim nuk duhen bërë

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën politike të Partisë në Korpusin e 3-të të Korçës dhe për zbatimin e ligjit mbi shërbimin ushtarak të rezervistëve.

lëshime, përkundrazi, të zbatohen të gjitha programet dhe rregullat që janë vendosur, me qëllim që të zotërohet arti ushtarak, duke pasur kurdoherë parasysh që kjo të bëhet me ekonomizime sa më të mëdha.

Vija e përgjithshme e Partisë është që populli të ketë një ushtri të fortë, por jo shumë të kushtueshme nga ana materiale dhe e kohës. Ekonomizimi i kohës në ushtri varet shumë nga shkalla e ngritjes politike dhe kulturore të masës së ushtarëve dhe të oficerëve, në mënyrë që programi të përvetësohet brenda një afati sa më të shkurtër. Fitimi i kohës është në favor dhe në interes të ndërtimit socialist të vendit. Për këtë arsye unë drejtova edhe disa pyetje në lidhje me punën që zhvillohet për përgatitjen e paraushtarakëve, sepse kjo ka të bëjë me gjithë bazën e programit të stërvitjes. Natyrisht, përgatitja ushtarake nuk mund të bëhet në një vit, por Ministria e Mbrojtjes Popullore duhet të preokupohet më mirë dhe vazhdimisht për të studiuar çështjen e programeve, të cilat të ndërtohen në bazë të kushteve të reja që krijohen dhe të eksperiencës së fituar, sepse në rast se edukimi ushtarak dhe politik që zhvillohet sot, është po ai që zbatohet përpara 10 vjetëve, kur niveli i kuadrove dhe i masave të ushtrisë ishte më i ulët se tani, kjo nuk është e rregullt.

Në hartimin e programeve duhet të kihet parasysh që të shkurtohen gjërat e tepërta. Kjo shumicë kuadrosh që na vjen tani në ushtri, shumë çështje i ka mësuar në jetën civile. Prandaj sa më konkrete të bëhen programet, duke u bazuar në nivelin aktual të kuadrove, aq më shumë kohë fitojnë ata dhe shteti, si dhe pas-trohen kështu një shumicë gjërash që na kanë mbetur

si një rutinë, duke mos marrë parasysh shumë faktorë pozitivë që tash ka krijuar Partia. Në këtë drejtim Ministria e Mbrojtjes Popullore duhet të jetë më e gjallë.

Edukimi ideologjik dhe politik i ushtrisë është i domosdoshëm të ngrihet në një nivel më të lartë në radhë të parë për të gjithë punëtorët politikë. Natyrisht, objektivi kryesor i këtyre kuadrove është përgatitja ushtarake, sepse ky është zanati i tyre. Këtë duhet ta kemi mirë parasysh, pavarësisht se punëtorët politikë merren me punë politike dhe komandantët merren me punë ushtarake, zanatin e ushtarakut duhet ta dinë dhe ta dinë shumë mirë edhe punëtorët politikë.

Dihet se puna politike dhe ideologjike ka për qëllim që ushtarakët të bëhen të ndërgjegjshëm për mbrojtjen e socializmit, për të kuptuar shpejt dhe drejt situatat politike që zhvillohen në çdo periudhë, brenda dhe jashtë vendit, dhe këto situata t'i lidhim me përgatitjen ushtarake të Forcave të Armatosura. Ky duhet të jetë objektivi ynë, për arritjen e të cilit një detyrë të madhe kanë punëtorët politikë, prandaj këta duhet të jenë më të ngarkuar nga të gjithë oficerët e tjerë, të përballojnë një punë më të rëndë se shokët e sektorëve të tjerë të ushtrisë. Por më duket se ata nuk e kuptojnë kështu nevojën e përgatitjes së tyre ushtarake. Punëtorët politikë nuk duhet të neglizhojnë në asnjë mënyrë në këtë drejtim, përkundrazi, ushtarakisht të jenë në të njëjtin nivel me komandantët. Për këtë qëllim ata duhet të bëjnë një punë të vazhdueshme dhe shumë këmbëngulëse.

Në çështjet teorike punëtorët politikë duhet të jenë shumë më të përgatitur se komandantët dhe se çdo ofi-

cer tjetër. Format e edukimit teorik për punëtorët politikë të jenë me brendi të shëndoshë dhe të njëjlojta me ato që zhvillohen për punëtorët e sektorëve ideologjikë të terrenit, në mënyrë që çështjet e thella teorike ata t'i mësojnë me rrënjë. Punëtorët politikë duhet të kenë një horizont të gjerë teorik, sepse u kërkohet që t'u shpjegojnë të gjithë punonjësve të ushtrisë përmbajtjen ideoteorike të problemeve të ndryshme, natyrisht në një mënyrë të kuptueshme. Në qoftë se punëtori politik nuk e zotëron në nivelin e duhur bazën teorike të problemeve, atëherë edhe shpjegimin ai do ta bëjë të çalë. Edhe oficerët e sektorit ushtarak duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që çështjet t'i kuptojnë teorikisht, po programi mësimor për ta mund të jetë më i lehtë, të jetë në atë shkallë që ushtaraku, një çështje politike ta ketë të bazuar në teorinë dhe në parimet e Partisë. Komandantët, edukimin ushtarak të oficerëve dhe të ushtarëve që bëjnë në forma të ndryshme, e zhvillojnë në mënyrë shkencore, sepse janë të përgatitur për këtë qëllim, kanë mbaruar akademi, Shkollën e Bashkuar etj., prandaj çdo gjë kanë mundësi ta shpjegojnë në baza shkencore. Pikërisht kjo kërkohet edhe nga punëtorët politikë, të cilët çështjet teorike dhe politike duhet t'i shpjegojnë në mënyrë shkencore. Por për ta bërë një gjë të tillë, ata vetë duhet të përpiqen që ta mësojnë me baza të shëndosha teorinë marksist-leniniste.

Lartësimi teorik i punëtorëve politikë duhet të bëhet mbi bazën e një programi të veçantë, natyrisht të shkallëzuar, sipas nivelit të tyre. Këtë problem ne duhet ta shohim më afër. Nuk është çështja se s'është punuar

fare në drejtim të ngritjes teorike të punëtorëve politikë, po çështja është që ky edukim të jetë më efektiv, të mos veprohet në mënyrë shabllone, me programe të njëllajta, si për punëtorët politikë, ashtu edhe për ushtarakët, si për punëtorët e reparteve të mëdha, ashtu dhe për ata të reparteve të vogla. Po të vazhdohet si deri tani me programe të njëjta, nuk u jepet koha dhe mundësia e duhur punëtorëve politikë që të përgatiten mirë teorikisht dhe politikisht.

Të gjithë e kuptojnë ç'rëndësi të madhe ka çështja që të kemi oficerë dhe ushtarë të ngritur si duhet politikisht dhe ideologjikisht. Është e qartë se te ne, të gjithë, në terren dhe në ushtri, vijën dhe luftën e Partisë sonë kundër revizionizmit modern, veçanërisht kundër atij hrushovian, i kanë kuptuar drejt dhe jo vetëm i kanë kuptuar, po edhe kanë luftuar e luftojnë në ato drejtime që ka thënë Partia.

Te ne, të gjithë komunistët e kanë kuptuar drejt rrëzimin e Hrushovit, si një fitore me rëndësi të madhe të marksizëm-leninizmit, e cila ka ardhur si rezultat i luftës parimore që kanë bërë marksistë-leninistët në të gjithë botën, sipas mundësive të tyre. Disa parti marksiste-leniniste kanë qenë në ballë të kësaj lufte, disa kanë qenë më pas nga të tjerat, disa kanë ndihmuar në forma të ndryshme. Kështu duhet kuptuar kjo çështje, si një fitore e marksizëm-leninizmit.

Partia jonë, si parti marksiste-leniniste e organizuar, ka qenë në ballë të luftës kundër revizionizmit modern. Për këtë arsye ajo ka merita të mëdha në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë në majë të bajonetave, prandaj edhe

lufta e saj parimore ka ndihmuar më shumë për rrëzimin e Hrushovit.

Përse rrëzimi i Hrushovit është një fitore e madhe? Sepse kjo ngjarje tregon dështimin e vijës së kongreseve të 20-të e të 22-të të PK të BS. Udhëheqësi kryesor i këtyre kongreseve, ai që konkretizoi revizionizmin modern, u rrëzua, jo për sytë e bukur të dikujt, por pikërisht se vija politike e tij pësoi një disfatë të plotë në platformën ndërkombëtare, në atë të brendshme të BS dhe të ish-vendeve socialiste të Evropës, ku sundojnë revizionistët.

Situata u zhvillua në mënyrë të tillë që grupi revizionist sovjetik u detyrua të rrëzonte udhëheqësin e vet, «jo nga malli, por nga halli», siç thotë populli. Shokët e tij nuk i qanë hallin Hrushovit se ishte «plak» ose «i sëmurë», siç e thanë në fillim.

Po vallë do ta pohojnë ata disfatën e plotë të vijës së tyre revizioniste? Asnjë të mos ketë iluzion për një gjë të tillë. Ata nuk mund ta pohojnë këtë, po kuptohet se halli i detyron që diçka të thonë, për arsye se veprimet që kanë bërë, u kanë shkaktuar atyre shumë telashe të mëdha dhe i kanë diskredituar. Këto telashe që u dolën atyre dhe që i detyruan ta merrnin këtë masë, do t'i imponojnë diçka të pohojnë. Por ne duhet të nisemi nga parimi i patundur që udhëheqësit e sotëm sovjetikë janë shokët e Hrushovit, domethënë revizionistë, sepse së bashku me Hrushovin formuluan tezat revizioniste të kongreseve të 20-të e të 22-të dhe vazhdojnë të ecin sipas tezave të këtyre kongreseve. Prandaj ata nuk do t'i thonë disfatat e tyre. Edhe në qoftë se do të detyrohen të pohojnë diçka, këtë do ta bëjnë me të

vetmin qëllim që të gënjejnë, të krijojnë iluzione, por në të vërtetë ata do të vazhdojnë të ecin në vijën e kongreseve të 20-të e të 22-të. Pra, ata do të mendojnë se me disa gjëra që mund të pohojnë do të mund t'i gënjejnë marksistë-leninistët, se do të mund t'i zbutin ata, se do të mund të zbutin polemikën. Bile për shuarjen e luftës ideologjike ata kanë bërë të gjitha përpjekjet, por kanë dështuar.

Nuk mund të kishte dhe nuk mund të ketë pajtim në mes të revizionistëve dhe të marksistëve. Për pajtim në rrugën e tyre oportuniste ata përdorin të gjitha manovrat, duke filluar që nga lajkat, përkëdheljet e premtimet e gjer te kërcënimet, shantazhet, prerja e marrëdhënieve diplomatike etj., etj., por të gjitha këto nuk patën asnjë sukses për ta.

Më së fundi, N. Hrushovi vendosi të bënte mbledhjen pa ne, gjë që donte të thoshte vetëvrasje për revizionistët. Prandaj shokët e tij, që panë greminën ku i çonte, e rrëzuan. Me këtë veprim ata duan të mënjanojnë disfatën e plotë të vijës së tyre revizioniste. Për këtë qëllim, revizionistët sovjetikë do të nxjerrin plot justifikime, por të kemi parasysh që thelbin e çështjes, dhe sidomos çështjen e Stalinit, ata nuk do t'i prekin fare.

Çështja e J. V. Stalinit është kryesore, parimore, rreth së cilës lidhen të gjitha çështjet e tjera. Kjo nuk është çështje e një personi, apo një çështje thjesht sentimentale, por një çështje nga më të rëndësishmet për teorinë marksiste-leniniste, për atë teori, nga e cila u udhëhoq Stalini për ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik, që zhvilloi luftën e klasave dhe e vuri

këtë problem në vendin e vet, për teorinë, nën flamurin e së cilës Stalini dërrmoi fashizmin dhe ndihmoi në krijimin e vendeve socialiste, që forcoi partitë komuniste dhe punëtoare të botës si përpara, nëpërmjet Kominternit, ashtu edhe më vonë. Vepra e Stalinit është marksiste-leniniste.

Revizionistët qëlluan së pari kundër Stalinit, për të qëlluar pastaj mbi tërë marksizëm-leninizmin. Këtë goditje kundër Stalinit ata e veshën me një mijë e një epitete të poshtra, me qëllim që ta bënin komunizmin një gjë me të vërtetë të urrejtshme për popujt. Ata shpifën kundër Stalinit duke e quajtur «vrasës», «despot», «kriminel», «imoral» etj., etj. Gjithçka që ka thënë imperializmi kundër komunizmit, hrushovianët ia veshën Stalinit.

Pra, që revizionistët hrushovianë të futen në rrugë të drejtë, duhet para së gjithash të rehabilitojnë Stalinin. Por ne jemi të bindur se këtë ata nuk do ta bëjnë. Figurën e madhe të Stalinit do ta vërë në vend vetëm lufta e marksizëm-leninizmit.

Sidoqoftë, revizionistët sovjetikë janë futur në disa qorrsoqake, prandaj do të detyrohen të pohojnë diçka edhe kundër Hrushovit. Agjencitë e huaja thonë se udhëheqësit sovjetikë e akuzojnë Hrushovin se ka bërë gabime për tokat e reja, se e ndau partinë më dysh, në parti të bujqësisë dhe në parti të industrisë etj., etj. Këto gabime Hrushovi i ka bërë dhe si pasojë ekonomia sovjetike ka pësuar disfata. Lufta e marksizëm-leninizmit dhe e forcave revolucionare brenda në BS e detyruan udhëheqjen sovjetike të rishikojë format e vendosura nga Hrushovi dhe të lëshojë diçka. Por po lëshove gish-

tin, do të të kapet krahu. Ky është ligj. Disfata e mëtejshme e revizionistëve sovjetikë do të varet nga lufta e marksistë-leninistëve brenda dhe jashtë BS, jo nga dehja prej sukseseve, por nga vazhdimi gjer në fund i luftës kundër revizionizmit.

Partia jonë ka një eksperiencë të madhe në luftën me armiqtë, ajo nuk dehet nga sukseset, nuk gënjehet, as shpejtohet në qëndrimet e saj. Revizionistët mund të kenë menduar se tani që ra Hrushovi, kushedi ç'do të bëhet, se Partia e Punës e Shqipërisë do të hidhet përpjetë nga gëzimi. Po Partia jonë, pasi e futi në xhep këtë sukses, shikon, vigjilon, nuk lëkundet, nuk ushqen iluzione. Ky qëndrim tregon se Partia e Punës e Shqipërisë është një parti serioze, ajo i mat mirë fjalët dhe veprimet e saj, nuk fluturon në hava, po ecën përpara me kujdes.

Revizionistët e Moskës do të bëjnë përçapje për të na hedhur pluhur syve. Por lëvizja komuniste ndërkombëtare, partitë tona, Partia e Punës e Shqipërisë, duhet të kenë disa qëllime strategjike, një nga të cilat është që vija e kongreseve të 20-të e të 22-të të rrëzohet. Mirëpo kjo nuk mund të ndodhë në një ditë, prandaj ky objektiv nuk duhet harruar, se, po u harrua, do të jetë gabim i madh.

Në kongreset e 20-të dhe të 22-të ka disa çështje që duhen goditur, në mënyrë të veçantë si çështja e qëndrimit ndaj Stalinit që është kryesore, nga më kryesoret, është strumbullari. Hrushovi, njeriu që bëri gjithë ato poshtërsi e krime në BRSS dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, s'la gjë pa thënë edhe kundër Stalinit.

Por tani mendja e njerëzve punon, çdo njeri arsyeton dhe thotë: Hrushovit, këtij njeriu të poshtër, që ka bërë gjithë këto veprime revizioniste, që ka thënë gjithë ato gjëra kundër Stalinit, po i dalin qëllimet antimarksisiste, prandaj gjersa është kështu, atëherë edhe ato që ai ka thënë kundër Stalinit nuk mund të jenë të drejta. Pra, mendja e njerëzve punon dhe do të punojë, ky është një proces që do ca kohë.

Kur të vijë çështja, për shembull, që të publikohet se ka qenë gabim hapja e tokave të reja, të tjerët do të thonë: Atëherë, përse e rrëzuan Molotovin që ishte njeriu më i afërt i Stalinit, kur ai kundërshtoi qysh atëherë hapjen e këtyre tokave? Kjo do të thotë që ai kishte pasur të drejtë. Pra, mendimet e njerëzve do të ndjekin procesin e vet dialektik. Kjo nuk duhet harruar.

Bashkekzistenca paqësore duhet të zgjidhet vetëm në bazë të parimeve leniniste. Këtë e thonë edhe revizionistët. Por ne nuk gënjehemi nga demagogjia e tyre mbi bashkekzistencën, por kundërshtojmë armikut më të madh të komunizmit, imperializmit, mbajmë qëndrimin që na mëson marksizmi. Në marrëdhëniet me imperializmin duhet të ndreqen qëndrimet thellësisht oportuniste të Hrushovit. Ai ishte një tradhtar, një agjent i borgjezisë, që i bëri lëshime serioze imperializmit amerikan. Këto lëshime janë bërë, prandaj duhen pranuar hapur nga udhëheqësit e sotëm revizionistë sovjetikë. Partia jonë i ka mirë parasysh këto gjëra, ka parasysh gjithashtu edhe të gjitha komplotet që ka organizuar Hrushovi me imperialistët kundër socializmit dhe paqes.

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë mund ta akuzojnë Hrushovin edhe për aventurier dhe kapitullant në

çështjen e Kubës. Këtë ne e kemi thënë qysh kur ndodhi ngjarja në Karaibet. Por ne do t'u themi atyre se nuk është vetëm kjo, por është e tërë vija e Hrushovit mbi bashkekzistencën paqësore që duhet rrëzuar. Pra, ne duhet të sulmojmë dhe të hedhim poshtë të gjithë vijën e tij revizioniste.

Traktati i Moskës për ndalimin e pjesshëm të provave të armëve bërthamore ishte një tjetër kapitullim përpara imperializmit, ishte një koordinim i politikës nën maskën e bashkekzistencës për të sunduar së bashku botën me anën e shantazhit atomik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Hrushovit. Është antimarksiste të bësh aleanca me imperializmin për të frikësuar botën me bombën atomike, siç bëri Hrushovi me SHBA-në. Këtë aleancë me amerikanët Hrushovi e bëri jo vetëm kundër BS, por edhe në dëm të interesave të të gjithë njerëzimit.

Hrushovin e rrëzuan shokët e tij megjithëse ai ishte në krye të tyre. Po vallë, udhëheqësit e rinj revizionistë sovjetikë do ta rrëzojnë vijën e Hrushovit? Jo, as nesër as pasnesër. Prandaj, ne, duke e pasur të qartë këtë, me propagandën tonë duhet të ndërmarrim të gjitha veprimet që ata të demaskohen, në mënyrë që të vijë një ditë që edhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë të rrëzohen. Duhet të ndihmohet lufta revolucionare e popujve dhe vetëm këtyre t'u japim armë e jo reaksionarëve. Atëherë, ndryshon kuptimi ideologjik i bashkekzistencës paqësore, kështu vihen në praktikë pikat mbi «i». Këto gjëra Partia t'i ketë kurdoherë parasysh.

Çarmatimi, që propagandohet kaq shumë nga revizionistët, është një bluf i madh. Kjo çështje duhet vënë

drejt në vend, të kuptohet mirë se imperializmi amerikan nuk i hedh armët, se qëllimi i tij është lufta për të shkatërruar sistemin socialist. Prandaj ne duhet të armatosemi për të mbrojtur atdheun tonë, socializmin, revolucionin. Ato që thoshte Hrushovi, se do të kemi botë «pa armë» dhe «pa luftëra», kanë qenë vetëm fjale për të vënë njerëzit në gjumë, sepse në fakt imperialistët janë armatosur dhe vazhdimisht armatosen gjer në dhëmbë. Ne duhet të bëjmë që të kuptohet mirë se imperializmi nuk çarmatohet. Po u kuptua drejt kjo, atëherë popujt e tjerë që luftojnë, si në Kongo, në Vietnam, në Laos, në Amerikën Latine e kudo, do të inkurajohen për të vazhduar luftën dhe kështu imperializmi amerikan do të dobësohet dhe do ta çojmë gradualisht në varr. Çarmatimi, siç e mendonte Hrushovi, nuk është i pranueshëm për marksistë-leninistët.

Edhe në çështjen gjermane Hrushovi patjetër ka kapitulluar përpara amerikanëve, prandaj edhe kjo duhet të vihet në vend, të firmoset traktati i paqes me Gjermaninë, ashtu siç kemi vendosur.

Por të gjitha këto këlyshët e Hrushovit nuk do t'i bëjnë në bazë të marksizëm-leninizmit. Ne duhet të kemi parasysh se pozitat e tyre janë shumë më të dobëta se përpara, prandaj është e domosdoshme të luftojmë që ato të dobësohen edhe më shumë. Kësaj do t'ia arrijmë duke luftuar gjer në fund për demaskimin dhe për shkatërrimin e tyre. Prandaj nuk është e mjaftueshme të thuhet vetëm se u rrëzua Hrushovi, se ai kishte zhvilluar kultin e individit të tij, se kishte bërë Axhubein ministër të familjes etj. Këto janë bërë vërtet dhe i kanë diskredituar revizionistët, po nuk janë

vetëm këto, ka edhe shumë çështje të tjera parimore, esenciale, për të cilat Hrushovi ka vepruar si antimark-sist.

Siç thashë, rrëzimi i Hrushovit është një fitore e madhe që u arrit me luftë, por lufta duhet të vazhdohet pandërprerë në rrugën marksiste-leniniste. Pas fitoreve të arritura ne duhet të luftojmë për të arritur fitore të reja. Shokët e Hrushovit mund të na paraqiten shumë të fuqishëm, por ata nuk janë ashtu siç do të përpiqen të paraqiten, përkundrazi tani ata janë të rras-kapitur. Koha do të punojë për ne. Partia jonë do ta ndjekë këtë rrugë pa asnjë lëkundje.

Ne kemi eksperiencë në luftë kundër armiqve. Ashtu si armiqtë e tjerë, edhe revizionistët modernë në fillim na shanë dhe përsëri do të na shajnë. Po fjalën e fundit e kemi ne. Ne kurrë nuk jemi pajtuar e nuk do të pajtohemi me revizionistët. Ata do të thonë se shqiptarët janë «kokëfortë», «dogmatikë», «nuk kuptojnë nga politika» etj. Por le t'i thonë këto, kjo as na prish punë, as na tremb. Ne nuk lëkundemi. Politikë do të bëjmë, po nga çështjet kryesore, nga parimet, nuk do të lëvizim se ne e dimë që revizionistët këtu synojnë, të japësh, të lëshosh në gjërat kryesore.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha «Në ndihmë të Ushtrisë Popullore», vëll. II, f. 553.

Tiranë, 1975

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TE ORGANIZOJME DHE TE DREJTOJME ME MIRE ARSIMIN E PARTISE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

30 tetor 1964

Kam idenë se çështjen e arsimit në Parti e kemi në dorë, se këtë punë e drejton vetë Partia. Sigurisht, edukimi ideopolitik i anëtarëve të Partisë është një nga çështjet kryesore, sepse, sa më e kalitur të jetë Partia nga ana politike dhe ideologjike, aq më e fortë bëhet ajo dhe aq më fuqimisht ndërtohet socializmi, forcohen e kaliten njerëzit.

Por nga aparati i Komitetit Qendror më duket se nuk e kemi si duhet në dorë arsimin në Parti, për arsye se organizimi dhe drejtimi i tij nuk janë të mjaftueshëm. Ne mund të kritikojmë shokët, që merren me këtë sektor pune dhe që nuk bëjnë një punë të gjerë, spe-

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua relacioni mbi arsimin në Parti. Ishin thirrur në raport rrethet Fier dhe Tiranë.

cialle e të rëndësishme, për të ndihmuar në drejtim të organizimit të punës në format e edukimit, në hartimin e teksteve, të programeve etj., në mënyrë të veçantë për kategori të ndryshme komunistësh, ndryshe për rininë, që kërkon një punë jashtëzakonisht të madhe, ndryshe për gruan, për intelektualët etj. Ndryshimet në punën dhe në format e edukimit komunist për çdo kategori njerëzish duhen pasur parasysh. Në këtë drejtim them se nuk e kemi si duhet në dorë këtë çështje. Prandaj duhet menduar si ta forcojmë punën në format e arsimit të Partisë.

Në fushën e arsimit të Partisë kemi suksese, por kemi edhe të meta. Njëri i bën bisht vajtjes në formë, tjetri thotë se tekstin nuk e mëson dot pasi është i rëndë për nivelin e tij; për punëtorët, për të rejat dhe si domos për gratë nuk ka materiale të veçanta etj., etj. Çështje të tilla nuk janë mbajtur parasysh si duhet. Prandaj, a nuk ia vlen vallë që nga radhët e gjithë këtyre propagandistëve, pedagogëve, që tani i kemi me shumicë, të zgjedhim dy-tre dhe t'i bëjmë funksionarë në aparatit e Komitetit Qendror vetëm për këtë çështje të madhe? Këta do të përpunojnë një metodë pune të tillë, që çdo dy ose tre muaj të arrihet që të thërriten në qendër shefat e kabineteve të Partisë të rretheve ose sekretarët e komiteteve të Partisë, që merren me problemin e arsimit në Parti jo vetëm që ata të raportojnë si shkon çështja e edukimit në bazë, po edhe të japin mendime nga eksperiencia e tyre, të flasin për të metat në punë, në programet, në organizimin e drejtimit të formave të edukimit, për ndryshimet që ata mendojnë,

ç'gjëra duhet të mësohen në format etj. Mbledhje të tilla mund të bëhen të gjera, duke ftuar edhe specialistë për probleme të edukimit. Mua më duket se këta funksionarë do të jenë më në gjendje të flasin në rrugë të drejtë e frytdhënëse për këto probleme, të kontrollojnë më mirë punën dhe edukimin e propagandistëve, të parashikojnë tekste të posaçme, të reja e të gjithanshme dhe të mendojnë vazhdimisht për përmirësimin e punës në format e arsimit në Parti.

Këto gjëra ne i japim sot vetëm me një orientim. Po rrethet tani mund të kenë dhe kanë më shumë forca, mirëpo nuk dinë t'i shfrytëzojnë, prandaj sikur ta mendojmë më thellë këtë çështje, sepse ka rëndësi të madhe. Kemi vërtet Shkollën e Partisë që na përgatit shokët, po ajo ka një program që zhvillohet mirë vetëm me ata që e ndjekin atë. Çështja është që ne duhet të mendojmë edhe për ata që e kanë mbaruar Shkollën e Partisë dhe shkojnë të punojnë në bazë, edhe për ata që s'kanë qenë fare në këtë shkollë. Pastaj ata që kanë mbaruar Shkollën e Partisë nuk do të thotë se janë të aftë për çdo gjë. Është detyra e Partisë që të gjithë këta shokë të ushqehen vazhdimisht. Prandaj të mos kursejmë të shtojmë tre kuadro për një nga çështjet më të rëndësishme, siç është kjo e edukimit ideologjik dhe politik të Partisë.

Dihet se për arsimin shtetëror ka një ministri të tërë, ka pastaj mijëra arsimtarë, ka një metodikë të caktuar, që vazhdimisht përpunohet. Kurse me format e arsimit të Partisë merren vetëm një ose dy njerëz në qendër, gjë që nuk mund të bëhet dot si duhet. Arsimi

i Partisë përbën një çështje të madhe serioze, që ndihmon jo vetëm edukimin komunist, po edhe arsimin shtetëror. Shokët e rinisë kanë aparatën e tyre, po për këtë problem edhe ata nuk kanë asnjë njeri. Këtë çështje, pra, ta shohim me kujdes se situatat janë shumë të rëndësishme, të komplikuar dhe që do të komplikohen edhe më shumë në të ardhmen, se shikoni ç'bëjnë imperializmi dhe revizionizmi.

Të marrim çështjen e edukimit të punonjësve me anë të filmave. Jemi të detyruar të zgjedhim e të importojmë filma që s'janë dhe aq edukativë për ne. Këta janë filma borgjezë, për të cilët ne duhet të bëjmë diskutime që të interpretohen drejt. Këtë ta kemi parasysh sidomos me rininë.

Pra, na del që nuk e kemi të organizuar si duhet çështjen e edukimit. Le të shikojmë ç'veprimtari të madhe propagandistike fetare kryen Vatikani që, për punën e vet kundër nesh dhe për përhapjen e ideve të tij, ka një aparat kolosal. Për t'i bërë ballë gjithë kësaj vale armiqësore të propagandës imperialiste dhe revizioniste duhet të marrim edhe ne masa për një organizim më të përsosur, sepse edhe ne duhet të forcojmë propagandën e Partisë. Forcat tani i kemi. Propagandë bëhet, por kur vjen puna te feja, te xhamia, te ramazani, kreshmat si edhe për gjëra të tjera të rëndësishme, nuk kemi një organizim të shëndoshë. Prandaj shokët, që do të merren me çështje të tilla, do të mendojnë dhe, në këtë drejtim, të studiohet më thellë kjo çështje, sepse edukimi ideologjik sot ka një rëndësi të madhe për fitoren e kauzës sonë. Njerëzit tanë janë të mobilizuar dhe më-

sojnë, po ne duhet të bëjmë një punë shumë më të organizuar, me qëllim që përfitimet të jenë edhe më të mëdha se gjer tani.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TE ZHVILLOJME NË MËNYRË TË ORGANIZUAR INFORMACIONIN POLITIK NË PARTI DHE NË MASAT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

30 tetor 1964

Informacioni politik mund të bëhet edhe në organizatat-bazë. Kur të ketë probleme politike për të informuar dhe për të diskutuar nuk është ndonjë gjë e madhe që anëtarët e Partisë të rrinë gjysmë ose treçerek ore apo më shumë në mbledhje e të sqarohen për gjendjen politike. Kjo punë mendoj se është e frytshme dhe duhet të bëhet patjetër, bile të përpiqemi që kjo të bëhet në mënyrë të organizuar. Natyrisht, që informacioni politik të zhvillohet në mënyrë të organizuar në Parti dhe në masat, kërkon dhe kohë, edhe përgatitje. Por shokët tanë janë të mprehtë politikisht,

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën politike në rrethet Vlorë dhe Pogradec për sqarimin e problemeve ndërkombëtare.

megjithatë, ka prej tyre që, kur dalin përpara masës, janë disi të druajtur dhe ngurrojnë të flasin. Kjo vjen ose nga turpi, ose sepse kanë frikë mos ngrihet dikush dhe u drejton ndonjë pyetje. Këtë situatë ne duhet ta ndryshojmë në drejtimin që anëtari i Partisë, kur të flasë përpara masës, të jetë i përgatitur dhe me kurajë të përpiqet t'i japë shpjegimin e duhur, cilitdo që drejton pyetje.

Anëtari i Partisë, që është ngarkuar për të folur, duhet të jetë në gjendje të kuptojë karakterin dhe qëllimin e pyetjes që i drejtohet. Ne duhet t'i stërvitim shokët e ngarkuar për të folur që të jenë në gjendje të japin përgjigje menjëherë. Edhe në qoftë se dikush e bën pyetjen me qëllim të keq, përsëri përgjigjja duhet t'i jepet në formë të rregullt, në mënyrë që të demaskohet qëllimi i pyetjes së tij dhe njëkohësisht ata që janë të pranishëm të sqarohen dhe të armatosen me shpjegimet e dhëna nga konferencieri. Pastaj, ai që e ka bërë pyetjen me qëllim të keq, pasi të jetë demaskuar, edhe sikur të dojë të flasë rrëzave e qosheve, nuk ka për ta dëgjuar njeri, sepse të tërë janë sqaruar. Prandaj mendoj se një gjë të tillë ne duhet ta organizojmë dhe ta arrijmë, në mënyrë që anëtarët e Partisë të jenë të përgatitur, të zotërojnë çdo situatë që u paraqitet.

Kur shkojmë në masë për të bërë konferenca mbi një problem të caktuar, në radhë të parë duhet që secili të përgatitet mirë. Përveç konferencierit, mund të përgatiten edhe dy-tre të tjerë, të cilët, porsa të mbarojë referuesi, të ngrihen e të flasin. Mundet që këtu të bëhen edhe pyetje mbi këtë apo atë çështje, me qëllim që këto të sqarohen. Pasi jepen përgjigjet nga konfe-

rencieri, atëherë del një tjetër dhe bën pyetje të ndryshme nga ato të parat. Folësi do të gjendet në një situatë të tillë që do s'do do t'u përgjigjet të gjithëve, sepse është i detyruar, prandaj duhet të jetë i gatshëm të japë përgjigje. Një punë e tillë do të forcojë te komunistët, që ngarkohen të flasin, ndjenjën e përgjegjësisë dhe ata nuk do të shkojnë para masës sa për të bërë një punë politike formale, po do të përgatiten shumë mirë, sepse do të nisen nga mendimi se do të shkojnë në mbledhje jo vetëm për të sqaruar masën mbi problemin për të cilin janë ngarkuar, po edhe për t'u përgjigjur pyetjeve që eventualisht mund t'u drejtohen, bile edhe pyetjeve që mund të jenë si me thumb. Duhet një edukatë e tërë për këtë çështje.

Po të përgatiten kështu konferencierët tanë, atëherë nuk do të ngrihej një person në mbledhje dhe t'i thoshte një shkrimtari të ri, por të talentuar: «More djalë, pse je kaq i verdhë, duhet të të japin një rrogë më të madhe». Ky njeri nuk e ka hallin se shkrimtari është i dobët fizikisht, por me këta thumba ai synon t'i thotë atij që «Partia po ju mbyt ju të rinjtë» dhe se «Partia, i thotë ai indirekt, ka shkrimtarë të tjerë, të cilët i ka privilegjuar, u jep rrogë të madhe dhe shtëpi të mirë». Ky është qëllimi për të cilin ai iu drejtua me këto fjalë shkrimtarit të ri. Por kur një njeri i tillë nxjerr nga goja këto fjalë, përse nuk ngrihet anëtari i Partisë që është atje dhe t'i lëshojë atij disa shigjeta për ta demaskuar, në mënyrë që ai të mos dalë më me këto qëllime e të veprojë? Edhe vetë ky shkrimtar, ndaj të cilit u fol me thumb, megjithëse është një kuadër i mirë, në këtë rast nuk mori iniciativën e t'i thoshte atij se «qe-

deri yt nuk është te shëndeti im, por është një qeder politik» dhe ta demaskonte. Shkrimtari në fjalë shkruan shumë mirë, është i zgjuar dhe fare mirë mund t'i jep-te përgjigjen e merituar, po kjo nuk ndodhi, sepse shpesh mbledhjet tona marrin karakter zyrtar dhe po plasi debati drejtuesit e mbledhjes shqetësohen se mos priset qetësia. Përkundrazi debati i gjallëron mbledhjet. Prandaj, kur del rasti dhe je në rrugë të drejtë, fol, askush nuk duhet të të pengojë të flasësh dhe të mbrosh e të popullarizosh në forma të ndryshme vijën e Partisë. Më parë, shokët tanë kishin turp, e kishin vështirë të flitnin përpara masës, kurse tani ata janë më të ngritur. Në qoftë se e bën konferencën shumë bajate, ai tjetri ka të drejtë të të thotë: ç'flet kështu, të paktën më lër të të bëj një pyetje ose të diskutoj si mendoj, se ti nuk i shpjegove mirë këto çështje. Të fusim, pra, kudo një frymë të shëndoshë. Kjo nuk do të thotë «njëqind lule», por ama kur ngrihet «lulja» me gjemba, si rasti që ju tregova, atëherë demaskohet në vend, që të mos llapë më.

Duhet t'i mësojmë njerëzit që, kur shkojnë të trajtojnë një problem në masë, të jenë vigjilentë, të tregohen të mprehtë politikisht. Kjo do të çojë edhe në rritjen e pjesëmarrjes së masave në diskutimin e problemeve, do t'u hiqet druajtja njerëzve, do të ketë më shumë iniciativë për të folur, do të nxiten diskutimet. Ne duhet ta krijojmë një situatë të tillë, sepse kjo do të ndihmojë që të ketë gjallëri dhe interesim në mbledhje, njerëzit do të sqarohen më mirë.

Partia të mos synojë që këto probleme t'i bëjë shumë zyrtare dhe standard. Jeta është e tillë që shkon përpara, njerëzit duhet ta kuptojnë situatën që ndry-

shon dhe t'i përshtaten asaj. Për shembull, të rinjtë e sotëm të qytetit nuk e kanë lehtë ta mësojnë këngën labçe sikundër e ka mësuar brezi ynë, por ne duhet të përpiqemi që të rinjtë edhe këngë të tilla të mësojnë, por sidomos këngë të reja patriotike e revolucionare. Këngët labçe ne i mësuam, sepse kur ishim të vegjël nuk kishte siç ka sot këngë të tjera që të këndonim. Tani ndryshon puna; këngët popullore mund t'u mësohen grupeve kur dalin në festivale, por jo t'ia imponojmë gjithë rinisë të mësojë medoemos ato këngë që kemi mësuar ne, ashtu si nuk mund t'u themi sot grave tona të veshin çitjane. Ishte një kohë kur gratë dhe vajzat tona mbanin gërsheta, më vonë i prisnin flokët dhe i mbanin të lëshuar, tani edhe kjo ka ndryshuar, çdo gjë, pra, duhet t'i përshtatet kohës, nuk mund të mbyllim sytë përpara ndryshimeve që janë bërë e po bëhen, por nga ana tjetër nuk mund të lejojmë edhe presionin borgjezo-revizionist që na rrethon nga të katër anët dhe të biem në ekstremin tjetër. Prandaj të ruhem nga të dy rreziqet, edhe nga konservatorizmi edhe nga liberalizmi.

Për sa i përket informacionit politik në organizatat-bazë nuk është çështja që ky të bëhet vetëm tani me rrëzimin e Hrushovit. Qëllon që, kur mblidhet organizata-bazë, janë bërë, për shembull, votimet në Angli, prandaj duhet folur për ardhjen e laburistëve në qeveri. Komunistëve duhet t'u thuhet në vija të përgjithshme ç'janë e ç'përfaqësojnë laburistët dhe ç'duhet të bëjë Partia për sqarimin e masave me këtë rast. Ose bëhen zgjedhjet në SHBA. Organizata-bazë duhet të vihet në dijeni ç'janë këto zgjedhje dhe ç'përfaqësojnë kandidatët e paraqitur, çfarë politike do të ndjekin ata kur të

vijnë në fuqi, qoftë njëri, qoftë tjetri. Ose Dë Goli tani së fundi i ka dhënë ultimatum «Tregut të përbashkët», duke e kërcënuar që, po nuk u bë si ka kërkuar ai, Franca do të largohet nga ky treg. Fundi një sqarim i tillë edhe në qoftë se nuk bëhet në organizatën-bazë të Partisë, për shembull, në Mokër, s'prish dhe aq punë, ndërsa në organizatën-bazë të qytetit të Pogradecit, që çoku edhe dëgjojnë ndonjë emision të huaj në radio, duhet folur për sqarimin e çështjes. Të mos nisemi nga mendimi se të gjithë anëtarët e Partisë janë njëlloj dhe, pra, e kuptojnë njëlloj situatën politike. Ne duhet t'i bëjmë të tërë që të jenë të interesuar për ta kuptuar situatën, ashtu siç e kupton Partia, prandaj ata duhet të vihen në dijeni për ngjarjet aktuale.

Edhe nga Drejtoria e Agjitacionit dhe e Propagandës mund të jepet diçka e përgatitur. Por ju, shokë sekretarë të parë të rretheve, e merrni buletinin e ATSH, veç asaj ndiqni me kujdes edhe shtypin e Partisë, prandaj mbi këto mund të punoni vetë, pa pritur që aparati i Komitetit Qendror t'ju japë materiale të përmbledhura për situatën. Punoni, pra, me kurajë komuniste, në fillim mund të mos e bëni si duhet këtë punë, por sidoqoftë, duke u marrë me të, masat do të përfitojnë diçka.

Ka edhe çështje, të cilat duhen sqaruar ashtu si janë në të vërtetë, ashtu si i shpjegon marksizëm-leninizmi dhe Partia jonë. Të marrim, për shembull, bashkekzistencën paqësore. Në qoftë se ka marksist-leninist në botë, që e ka zbatuar drejt bashkekzistencën paqësore, ky është pikërisht Stalini. Aleancën me dinjitet të BRSS me anglezët, amerikanët etj. në luftën kundër

Hitlerit e ka bërë Stalini. Ai punoi që ta frenonte kursin antisovjetik të Çërçillit dhe ta sillte BRSS në fitore, ai bëri që Rusvelti, koka e imperializmit amerikan, ta konsideronte Stalinin, sjelljen dhe idetë e tij nga më të lartat, saqë reaksioni amerikan thoshte se Stalini e futi në kurth Rusveltin. Po ky nuk futej lehtë në kurthe, ai u detyrua ta konsideronte kështu Stalinin dhe të kishte respekt të madh për të, sepse Stalini gjithë jetën e tij bëri një politikë të drejtë, parimore, marksiste-leniniste në interes të të gjithë njerëzimit. Stalini, pra, nuk e shiti si Hrushovi Bashkimin Sovjetik, ai nuk e uli dinjitetin e BRSS as nga ana ekonomike, as nga ana politike apo ushtarake, ashtu si Hrushovi dhe as i la imperialistët t'i merrnin sekretet shtetërore, ashtu siç bëri Hrushovi.

Prandaj në rast se revizionistët e rinj sovjetikë rehabilitojnë Stalinin, rrëzohet edhe kjo kala. Po kalasë mund t'i biesh edhe drejt, edhe tërthorazi. Në qoftë se udhëheqësit e rinj revizionistë sovjetikë ndreqin një gabim të Hrushovit, ne do t'u kërkojmë të ndreqin edhe tjetrin, e kështu me radhë gjer në fund. Po ata nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë, se janë revizionistë të vendosur, ecin në rrugën e Hrushovit.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

ME RËNIEN E N. HRUSHOVIT NUK ËSHTË ZHDUKUR REVIZIONIZMI HRUSHOVIAN

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

1 nëntor 1964

N. Hrushovi, përfaqësuesi kryesor i revizionizmit modern, renegati i kauzës së madhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të themeluar nga V. I. Lenini, përçarësi i kampit socialist e i lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, ose, siç e quanin imperialistët, «njeriu më i përshtatshëm i Perëndimit në Moskë», u dëbua nga Presidiumi i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe u shkarkua nga funksionet e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Kryetarit të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Sovjetik.

Fundi i palavdishëm i N. Hrushovit është rezultat i luftës së vendosur, të guximshme e parimore të të gjithë marksistë-leninistëve revolucionarë kundër revizionizmit modern, nga pozitrat e internacionalizmit proletar, i luftës së gjithë revolucionarëve për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, është rezul-

tat i demaskimit të hapët e të pamëshirshëm që iu bë veprimtarisë së këtij renegati të komunizmit. Fundi i tij është një fitore e madhe e marksizëm-leninizmit mbi revizionizmin modern.

Në dëbimin e personit të N. Hrushovit nga postet drejtuese në partinë e në shtetin sovjetik, marksistë-leninistët dhe gjithë revolucionarët shohin dështimin e kursit politik e ideologjik të revizionizmit modern, të formuluar në kongreset e 20-të e të 22-të të PK të BS. Flakja e N. Hrushovit si limon i shtrydhur tregon kalbjen e revizionizmit hrushovian, degjenerimin e tij, diskreditimin e pandreqshëm që pësoi dhe pëson çdo ditë veprimtaria praktike e tij. Ajo flet për faktin se disfata e sigurt dhe e plotë është përfundim i natyrshëm i revizionizmit të sotëm. Ajo dëshmon se kush ngre dorën kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit, nuk e ka jetën të gjatë. Marksizëm-leninizmi, forcat revolucionare kanë triumfuar e do të triumfojnë mbi armiqtë e tyre nën çfarëdo emri e maske që ata të paraqiten.

Likuidimi nga skena politike i tradhtarit N. Hrushov provon edhe një herë atë që ka theksuar gjithnjë Partia jonë se e vërteta është në anën e marksistë-leninistëve, se kauza jonë është e drejtë dhe ajo do të triumfojë. Marksizmi është i pathyeshëm. Revizionizmin e pret disfata. Qysh në Deklaratën e 20 tetorit 1961, disa ditë pas sulmeve antisocialiste e antishqiptare të Hrushovit e të grupit të tij revizionist në Kongresin e 22-të, Komiteti Qendror i Partisë sonë shprehte bindjen se *«lufta që po u imponohet Partisë dhe popullit tonë, do të jetë e gjatë dhe e vështirë. Por vështirësitë nuk i*

kanë trembur kurrë Partinë dhe popullin tonë... Ata nuk do të përkulen e nuk do të gjunjëzohen as përpara sulmeve shpifëse, shantazheve e presioneve të N. Hrushovit dhe të atyre që e pasojnë. Parti e popull, në unitet të çeliktë, si kurdoherë, do të çajnë përpara të vendosur dhe do të fitojnë në rrugën e tyre të drejtë, në rrugën e triumfit të marksizëm-leninizmit e të çështjes së socializmit e të komunizmit»¹. Jeta, koha, faktet provuan se Partia jonë kishte të drejtë, se Partia jonë ishte në rrugë të drejtë dhe në këtë rrugë ajo korri fitore mbi revizionistët hrushovianë. Në këtë rrugë ajo do të ecë me vendosmëri e pa përkulje deri në disfatën e plotë e të fundit të revizionizmit modern.

Përjashtimi i N. Hrushovit është një shprehje e qartë e faktit se revizionizmi brehet nga kontradikta të shumta, të cilat nuk mund të zgjidhen kurrë përfundimisht nga revizionistët. Ai është një vërtetim i ri i mësimin të vjetër se kush largohet nga marksizëm-leninizmi, kush bashkohet me armiqtë e proletariatit, me armiqtë e popujve, të socializmit, do të dërrmohet pa mëshirë nga rrota e revolucionit, nga rrota e historisë. Ai është një provë e gjallë se kush ecën në rrugën e revizionizmit, qoftë ky kautskian, titist apo hrushovian, do të shpartallohet plotësisht.

N. Hrushovi është përfaqësuesi kryesor i vijës revizioniste të përpunuar në Kongresin e 20-të dhe të zhvilluar në Kongresin e 22-të të PK të BS. Duke hartuar këtë vijë antimarksiste dhe duke punuar për zbatimin

1 «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. IV, f. 154.

e saj ai u damkos si tradhtari dhe armiku më i rrezikshëm i marksizëm-leninizmit, i vetë Bashkimit Sovjetik, i kampit socialist, i revolucionit, i popujve.

Me këtë vijë, nën maskën e së ashtuquajturës luftë kundër kultit të individit të Stalinit, apo të luftës për «destalinizimin», sikurse e quanin shokët e tyre titistë e aleatët imperialistë, hrushovianët u hapën dyert oportunizmit e revizionizmit, tradhtisë e degjenerimit. Hrushovianët minuan unitetin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste duke u bërë përçarësit më të mëdhenj që njih historia e lëvizjes komuniste revolucionare, u afruan e u bashkuan me imperialistët amerikanë e me armiqtë e tjerë të popujve e të socializmit, u bashkuan ideologjikisht me titizmin, me këtë agjenturë agresive të imperializmit amerikan, i vunë kazmën kauzës së revolucionit dhe hapën të gjitha portat për restaurimin e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik.

Historia e Bashkimit Sovjetik nuk njih antisovjetik më të tërbuar se N. Hrushovi. Askush nuk e ka discredituuar e nuk e ka poshtëruar aq rëndë sa ai vendin e Sovjetëve. Askush nuk ka shpifur më shumë se ai kundër pushtetit sovjetik, kundër rendit socialist sovjetik. Ai, duke sulmuar J. V. Stalinin dhe duke thurur shpifjet më monstruoze kundër tij, i vuri kryq periudhës më të lavdishme të historisë së popujve sovjetikë, periudhës së rimëkëmbjes së vendit, të transformimit të Bashkimit Sovjetik nga një vend i prapambetur në një kolos të fuqishëm me industri e bujqësi të përparuar, periudhës së lavdishme të luftës për mbrojtjen e fitoreve të Revolucionit të Tetorit nga armiqtë imperialistë e nga renegatët e çdo ngjyre, periudhës heroike të

Luftës së Madhe Patriotike, kur populli i madh sovjetik, nën udhëheqjen e J. V. Stalinit, mposhti armikun më të egër të njerëzimit, fashizmin gjerman, duke u bërë glirimtar i popujve të skllavëruar të botës.

Duke ndjekur vijën e tij të tradhtisë, N. Hrushovi ngriti dorën kundër gjësë më të shtrenjtë të popujve sovjetikë, kundër garancisë së fitores së socializmit e të komunizmit, kundër diktaturës së proletariatit e Partisë së tij Komuniste, nën parullat revizioniste demagogjike të «partisë së gjithë popullit» e «shtetit të të gjithë popullit» goditje kjo që synonte t'i degjeneronte partinë bolshevike në një parti socialdemokrate borgjeze dhe shtetin socialist në një shtet borgjez.

Ai përçmoi dhe përbuzi punën heroike e aftësitë e njerëzve sovjetikë për ndërtimin e socializmit dhe i vuri si model Bashkimin Sovjetik Amerikën e rritur e të majmur me gjakun e proletarëve e të popujve të tjerë të shtypur të botës.

N. Hrushovi ndiqte vijën e shkallmimit të unitetit vëllazëror marksist-leninist të vendeve të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Ai e izoloi Bashkimin Sovjetik nga miqtë e vëllazërit e tij të vërtetë dhe i lidhi fatet me ato të armiqve më të vendosur të socializmit e të paqes, të lirisë e pavarësisë së popujve, me imperializmin amerikan, me klikën renegate të Titos dhe me gjithë reaksionarët e botës.

Si rrjedhim i kësaj vije tradhtare, revizionizmi hrushovian, u sul me egërsi kundër PPSH e RPSH, kundër një partie motër e një vendi vëlla socialist. Vetë N. Hrushovi bëri thirrje të hapëta për kundërrevolucion për të

përmbysur udhëheqjen e Partisë e të shtetit shqiptar; kundër RPSH u ngrit bllokada ekonomike; bashkë me klikën titiste u organizuan komplete armiqësore; me RPSH u prenë marrëdhëniet diplomatike dhe çdo lidhje tjetër ekonomike e politike.

Nga këto pozita antimarksiste e kundërrevolucionare N. Hrushovi dhe revizionistët hrushovianë u vërsulën me urrejtje prej armiku të klasës kundër PK dhe RP të Kinës. Iu vu kështu kazma miqësisë së popujve kinezë e sovjetikë dhe bashkëpunimit të tyre vëllazëror.

Ndërhyrje brutale, shkelje të sovranitetit dhe të pavarësisë, presione e shantazhe për gjunjëzimin e nënshtrimin ndaj diktatit të tij, marrje nëpër këmbë e interesave kombëtare të vendeve socialiste, mbjellje përçarjeje e organizim komplotesh, shkelje e të gjitha normave leniniste të marrëdhënieve midis shteteve socialiste e partive motra, shovinizëm i shtetit të madh, këto janë tipare karakteristike të vijës revizioniste tradhtarë që frymëzonin gjithë veprimtarinë dhe qëndrimet e N. Hrushovit ndaj vendeve socialiste, ndaj popujve vëllazër, ndaj partive marksiste-leniniste dhe gjithë revolucionarëve.

Afrimi me imperializmin amerikan dhe me gjithë reaksionarët dhe armiqtë e socializmit dhe të paqes është ana tjetër e medaljes së vijës revizioniste të ndjekur nga N. Hrushovi. Nën parullën demagogjike të sigurimit të paqes dhe të zbatimit të politikës së bashkëekzistencës paqësore të përpunuar nga revizionistët, N. Hrushovi kapitulloi përpara imperializmit amerikan, përpara shantazhit të tij bërthamor, pa ngurruar aspak që për këtë qëllim të tradhtonte jo vetëm interesat e li-

risë e të pavarësisë së popujve të tjerë, por edhe ato të Bashkimit Sovjetik. Kuba, Kongoja, nënshkrimi i traktatit të Moskës, problemi gjerman dhe ai i Berlinit etj., mbeten aktakuza të rënda të tradhtisë së revizionizmit hrushovian, janë krime kundër lirisë, sovranitetit e pavarësisë së popujve e në dobi të imperializmit amerikan. Nën parullën e «rrugës paqësore» dhe të «çarmatimit të plotë», N. Hrushovi dhe gjithë revizionistët modernë jo vetëm braktisën vetë revolucionin, por penguan me të gjitha mënyrat luftërat e lëvizjet revolucionare të popujve, të klasës punëtore e të proletarëve të vendeve të ndryshme, duke u siguruar kështu qetësinë imperialistëve, kolonizatorëve dhe shfrytëzuesve gjakpirës.

Veprimtaria armiqësore e N. Hrushovit është shumë e gjatë. Rrënjët e tradhtisë së tij janë të thella dhe të mbarsura me pasoja fatale për fatet e socializmit e të revolucionit. Prandaj marksistë-leninistët revolucionarë, duke e konsideruar fundin e turpshëm të N. Hrushovit, zhdukjen e tij nga skena politike, si një fitore shumë të rëndësishme mbi revizionizmin modern, si dëshminë e dështimit të kursit politik e ideologjik të revizionizmit të sotëm, mendojnë se lufta e tyre nuk ka marrë fund.

Likuidimi politik i personit të N. Hrushovit, edhe pse ky ka qenë shefi i revizionizmit modern, nuk do të thotë likuidim i kursit të tij politik, ideologjik, ekonomik e organizativ, që u ka sjellë kaq e kaq të këqija e dëme Bashkimit Sovjetik, marksizëm-leninizmit, kampit socialist e lëvizjes komuniste e punëtore, kauzës së revolucionit, të lirisë e të pavarësisë së popujve, kauzës

së paqes. Me përjashtimin e N. Hrushovit nga udhëheqja e partisë dhe e shtetit sovjetik, nuk vdes revizionizmi hrushovian, nuk likuidohet ideologjia dhe politika e tij, që shprehen në vijën e kongreseve të 20-të e të 22-të të PK të BS. Ato i kanë rrënjët të thella dhe për të bërë që rreziku të zhduket, që t'i priten mundësitë e përsëritjes, revizionizmi duhet të zhduket që nga rrënjët. Ky është i vetmi ilaç.

Nuk duhet të krijojmë e të ushqejmë iluzione. Nuk duhet të mashtrohemi nga demagogjia dhe nga maskat. Marksizëm-leninizmi na mëson të mos gjykojmë nga fjalët, por nga faktet, nga qëndrimet konkrete, praktike ndaj çështjeve të mëdha esenciale. Për marksistë-leninistët lufta kundër revizionizmit hrushovian mbaron kur kursi i tij të likuidohet politikisht e ideologjikisht, kur të likuidohen fryma, praktika dhe qëndrimet nga pozita revizioniste hrushoviane, kur çdo parti në politikën, ideologjinë dhe praktikën e saj të nisët e të mbështetet vetëm në parimet e marksizëm-leninizmit, të zbatojë me konsekuencë parimet revolucionare të deklaratave të Moskës, të luftojë me vendosmëri kundër armikut të përbashkët imperializmit, me atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në krye dhe agjenturës së tij të të gjitha ngjyrave, të luftojë me këmbëngulje, si për një detyrë të shenjtë, për forcimin e unitetit marksist-leninist të kampit socialist e të lëvizjes komuniste e punëtore, të mbrojë parimet e internacionalizmit proletar dhe t'i zbatojë ato në praktikë, të përkrahë pa rezerva kauzën e revolucionit, të lirisë e të pavarësisë së popujve, kauzën e paqes. Çdo hap i bërë në

këtë drejtim do të konsiderohet pozitiv dhe do të gjejë mbështetje nga PPSH.

Pa dënuar në mënyrë të vendosur, me guxim prej bolsheviku, revizionizmin hrushovian dhe gjithë ideologjinë e pasojat e tij, duke mos u tutur nga shqetësimet e kërcënimet e imperialistëve, nga lotët që derdhin për të dhe nga presionet që bëjnë miqtë e tij më të vendosur, që janë jo vetëm armiq të marksizëm-leninizmit në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë edhe armiq të tërbuar të Bashkimit Sovjetik, nuk mund të mendohet për kthim të vërtetë në pozitë të marksizëm-leninizmit, për kthim të vërtetë në normat leniniste të marrëdhënieve midis partive e shteteve socialiste, të marra nëpër këmbë aq brutalisht nga N. Hrushovi.

Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu si gjithë marksistë-leninistët dhe revolucionarët e vërtetë, do të vazhdojë me vendosmëri luftën e saj të drejtë deri në shpartallimin përfundimtar të revizionizmit modern. Pa rënë në grackat e iluzioneve, në kurthin e demagogjisë të blofeve, sado të kamufluara qofshin ato, komunistët revolucionarë, pas fitores që korrën kundër kryetarit të revizionizmit modern N. Hrushov, do t'i shtrëngojnë akoma më tepër radhët, do të forcojnë frontin e madh antirevizionist, do të ngrenë akoma më lart flamurin e marksizëm-leninizmit, do të mprehin vigjilencën revolucionare kundër armikut të popujve, imperializmit, do të intensifikojnë luftën kundër revizionizmit hrushovian, që përbën rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore në ditët tona.

Ne jemi plotësisht të bindur se në luftën e madhe

kundër imperializmit e pjellës së ideologjisë borgjeze, revizionizmit modern, marksizëm-leninizmi, socializmi do të triumfojnë plotësisht. Revizionizmi e tradhtia e kanë jetën të shkurtër dhe disfatën të afërt e përfundimtare.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 262 (5044), 1 nëntor 1964

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 46. Tiranë, 1965

ATA U BËNË TË PAVDEKSHËM DHE SOT RROJNË NË ZEMRAT TONA

*Letër dërguar nënave dhe familjeve të dëshmorëve
të rrethit të Tepelenës*

8 nëntor 1964

Të dashura nëna, shokë dhe shoqe,

Ju falënderoj nga zemra për letrën që më dërguat me rastin e takimit për të përkujtuar dëshmorët e rrethit tuaj. Fjalët tuaja prekëse dhe të ngrohta, drejtuar Partisë sonë të lavdishme, janë për të një frymëzim dhe mbështetje e madhe, sepse ato shprehin patriotizmin e zjarrtë dhe besimin tuaj të patundur e të mbarë popullit të Partia, e cila do ta çojë deri në fund amanetin e dëshmorëve, do ta udhëheqë, si kurdoherë, popullin në rrugën e drejtë deri në fitoren e plotë të socializmit e të komunizmit dhe do ta mbrojtë, sa të jetë jeta, çështjen e pavdekshme të marksizëm-leninizmit.

Sot populli ynë feston 23-vjetorin e themelimit të Partisë. Së shpejti ai do të festojë 20-vjetorin e Çlirimit të Atdheut. Në flamujt e revolucionit e të fitoreve

të popullit, të udhëhequr nga Partia, janë mishëruar, në radhë të parë, gjaku dhe vepra e dëshmorëve tanë.

Bijtë e bijat, vëllezërit e motrat, prindërit e të afërmit tuaj dëshmorë, ashtu si të gjithë dëshmorët e atdheut, bënë për lirinë e lumturinë e popullit më shumë se kushdo tjetër, dhanë për të edhe jetën. Por duke dhënë jetën për atdhe e socializëm, ata u bënë të pavdekshëm dhe sot rrojnë në zemrat tona, në zemrat e brezit të ri dhe të mbarë popullit, duke na ndriçuar me shembullin e tyre rrugën e nderit, rrugën e luftërave të reja pa kompromis kundër armiqve të betuar imperialistë e tradhtarëve revizionistë, për triumfin përfundimtar të çështjes së paqes, lirisë, demokracisë e socializmit.

Për ju, nëna, baballarë, familje të dëshmorëve, populli e Partia kanë një dashuri e respekt të madh, sepse jeni një nga shtyllat e çelikut të Shqipërisë së re, pasi ju, ashtu si nuk kursyet dje asgjë për lirinë e ndërtimin e mëmëdheut, po ashtu sot nuk kurseni djersën e jeni gati të bëni çdo sakrificë për ruajtjen e fitoreve dhe për lulëzimin e mëtejshëm të vendit tonë socialist.

Nënat dhe baballarët e dëshmorëve kanë bij e bija tërë popullin, fëmijët e dëshmorëve kanë nënë e babë Partinë. Duke jetuar e duke luftuar në gjirin e popullit e të Partisë dhe për popullin e Partinë ata kanë gjetur dhe do të gjejnë kurdoherë lumturinë dhe gëzimin e vërtetë në jetë.

Le të jeni ju edhe në të ardhmen agjitorë të zjarrtë dhe luftëtarë të palodhur për çështjen e Partisë e të socializmit!

Le t'i transmetoni brezit të ri shembullin e ndritur

të bijve e të prindërve tuaj dëshmorë dhe patriotizmin e shpirtin tuaj revolucionar!

Populli, atdheu, Partia do t'ju jenë përjetë mirënjohës!

Lavdi dëshmorëve!

Lavdi atdheut, Partisë, marksizëm-leninizmit!

Juaji

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 268 (5050), 8 nëntor 1964

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KRYESORJA ESHTË TË MBËSHTETEMI FUQIMISHT NË FORCAT TONA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

9 nëntor 1964

Ne duhet të jemi realistë dhe të gjykojmë mbi situatat, prandaj, për zhvillimin e ekonomisë edhe në pesëvjeçarin e katërt, të mbështetemi kryesisht në mundësitë tona të brendshme. Ne kështu kemi vepruar kurdoherë. Natyrisht, kur kemi dhënë direktivat e përgjithshme për hartimin e planeve të zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë, janë llogaritur edhe ndihma e miqve dhe kreditë. Kjo ishte e domosdoshme, për arsye të kërkesave që paraqiste zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë sonë socialiste me ritme pak a shumë të kënaqshme, modeste. Këtë ne përsëri nuk do ta neglizhojmë, po rëndësi kryesore ka kurdoherë çështja që të mbështetemi fort në mundësitë tona.

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës popullore gjatë pesëvjeçarit të katërt.

Cilat janë këto mundësi? Këto janë rezultatet e zhvillimit ekonomik të pesëvjeçarit të kaluar. Pesëvjeçari ynë i ardhshëm duhet të bazohet:

Në realizimin e akumulimit të mjeteve, të përdorimit të materialeve etj., që ne kemi në dispozicion. Kjo përbën pjesën më të rëndësishme, më kryesore, të planit tonë të ardhshëm. Kësaj ne duhet t'i shtojmë edhe kreditë, por për këtë çështje ne duhet të bazohemi kurdoherë në situatat politike ekzistuese. Prandaj siguria më e madhe në hartimin e planit është që të mos bazohemi në dëshirat, por në realitetin, këtej të nisemi kur të hedhim çapin për kërkesa nga jashtë. Në këtë mënyrë ritmet e zhvillimit të ekonomisë sonë në pesëvjeçarin e ardhshëm do të mbështeten në radhë të parë dhe fuqimisht në realitetin tonë.

Sasia e investimeve që do të na nevojitet për pesëvjeçarin e pestë do të varet nga mundësitë e brendshme që do të krijojmë gjatë pesëvjeçarit të katërt si edhe nga kreditë që do të na japin miqtë. Ne jemi të bindur se në pesëvjeçarin e pestë do të kemi mundësi t'i çojmë akoma më përpara ekonominë dhe kulturën e vendit tonë. Prandaj vërejtjet që bënë shoku Hysni dhe shoku Haki kanë rëndësi të madhe. Ne duhet të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë e rezervat si edhe kapacitetet ekzistuese në maksimum, me anë të vendosjes së tri turneve në të gjitha ndërmarrjet ku ka mundësi, të shfrytëzimit në shkallë të lartë të makinerisë, të rritjes së rendimentit, të përvetësimit sa më parë të çdo objekti etj., etj. Të gjitha këto ne duhet t'i llogaritim mirë dhe lidhur me to të marrim një sërë masash për të vendosur një disiplinë të ndërgjegjshme, për mbrojtjen e pa-

surisë shtetërore, të traktorëve, makinave etj., sidomos në këto situata. Prandaj t'i llogaritim mundësitë tona, forcat tona akumuluese, duke ruajtur nivelin e jetesës, të llogaritim mundësitë e investimeve tona «duke u tiganisur me dhjamin tonë», siç thotë një fjalë e urtë e popullit. I them këto, sepse në projektplanin tonë ka shumë gjëra që duhet t'i rishikojmë për të nxjerrë më tepër prodhime, akumulime dhe mjete materiale, me qëllim që këtë plan pesëvjeçar ta fuqizojmë, po duke e bërë të shtrënguar.

Kërkimi i një kredie të paktë, sipas mendimit tim, është i rrezikshëm dhe i dëmshëm, ashtu sikurse është i rrezikshëm edhe kërkimi i kredisë së shumtë në qoftë se nuk përcaktojmë disa orientime lidhur edhe me situatën. Këto eventualitete ne nuk duhet t'i harrojmë. Kredinë ta kërkojmë në atë masë që kjo të jetë e balancuar në një mënyrë të tillë që nesër, shlyerja e saj të mos na rëndojë shumë. Kredia do të na ndihmojë në disa pika kyç të zhvillimit të mëtejshëm të mjeteve të prodhimit dhe në mënyrë të shtrënguar ne të mund të plotësojmë amortizimin e shumë fabrikave ose mjeteve e veglave të punës, disa pjesë këmbimi dhe disa rezerva për materiale të nevojshme, për të përballuar çdo të papritur.

Në qoftë se kërkojmë kredi në një shkallë të madhe, duke pasur kurdoherë parasysh mundësitë tona reale në planin tonë, duhet të përpiqemi të evitojmë rëndimin e investimeve, sepse investimet e shumta në këto situata politike mund të na shkaktojnë perturbacione ekonomike dhe politike. Këtë ne duhet ta evitojmë se do të jetë në dëm të zhvillimit të forcave ekono-

mike. Kjo është e qartë. Po është dhe duhet të kemi të qartë gjithashtu se ne nga halli mund të pranojmë ngadalësimin disi të ritmeve të rritjes së forcave tona ekonomike, të paktën për një periudhë pesëvjeçare, po në asnjë mënyrë nuk mund të pranojmë që të dobësojmë pozitat politike të vendit tonë. Gjatë planit të tretë pesëvjeçar ne kemi arritur një sukses të madh, duke mbajtur një situatë të shëndoshë politike, si dhe një gjendje të qëndrueshme ekonomike. Veprimet e revizionistëve sovjetikë dhe veglave të tyre na kanë dëmtuar aq shumë, sa që ne, gjatë këtij pesëvjeçari, nuk mundëm të realizonim dot detyrat e parashikuara në plan, prandaj u detyruam që disa prej tyre t'i shtyjmë. Ky është një ngadalësim i ritmeve të ndërtimit socialist në vendin tonë. Kjo eksperiencë nuk duhet harruar nga ne për pesëvjeçarin e ardhshëm, situatat na detyrojnë ta kemi parasysh këtë, sepse në kohën që do të ndërtojmë objektet mund të ndodhë që të kemi vështirësi ekonomike, atëherë çfarë do të bëjmë, do të trokasim në dyert e miqve? Po edhe miku mund të jetë keq për vete. Prandaj mendoj që ta evitojmë rëndimin e ndërtimeve. Rëndimi i ndërtimeve përfaqësohet me shtimin e punëtorëve, me rrogat dhe materialet e nevojshme. Pra këtu nuk janë vetëm punëtorët, çështja duhet parë në gjithë gamën e saj, në shtimin e materialeve të ndërtimit, të brendshëm e të jashtëm, ushqimore e industriale.

Çështja e dytë është që të evitojmë sjelljen e makinerive të shumta, të mos notojmë në bollëk. Në fillim, kur i pashë shifrat m'u dukën të ekzagjeruara, sidomos parashikimet e përdorimit në shkallë të gjerë të meka-

nizmave, në disa sektorë 100 për qind, në të tjerë 90 për qind etj. Këto parashikime as që mund të realizohen dhe as që duhet të ecim kështu. Po që të kemi disa traktorë, pjesë këmbimi, kombajna etj. rezervë, është mirë, këto janë kërkesa të arsyeshme. Jam i mendimit që, në disa drejtime, për shembull, lidhur me mekanikën bujqësore, për të cilën më parë ishim dakord të ulej kërkesa, të qëndrojmë në shifrat që thotë Mehmeti, pra t'i kërkojmë të gjitha ato, veçse përdorimi i tyre të jetë krejt tjetër.

Prandaj, duke marrë parasysh këto situata jo vetëm për traktorët, makineritë etj., po gjer te përdorimi i veglave më të thjeshta të ndërrimit, ne duhet të forcojmë në kulm disiplinën, këtë na e kërkojnë situata dhe ndërtimi i socializmit, ndryshe nuk ka si të ecet.

Këtu do të dalë edhe çështja e ngritjes së nivelit të jetesës. Në qoftë se këtë plan e hartojmë duke u bazuar edhe në kreditë e miqve dhe në rast se ato do të na jepen sa kërkojmë, ne do të shohim sa do ta ngremë nivelin, mundet 10 për qind, po mund të ngrihet edhe vetëm 5 për qind, bile mund edhe të mos ngrihet hiç fare, sepse mund të ndodhë që të shtrëngohemi diçka dhe atëherë do t'ia shpjegojmë popullit se kjo nuk vjen për arsye se ne po shkallmojmë socializmin, sikurse bëjnë grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij, në Bashkimin Sovjetik, në Hungari, Jugosllavi etj. Në këto vende në fakt as që flasin fare për ngritjen e nivelit të jetesës të popujve të tyre, po përkundrazi, atje duken gjithnjë e më shumë vështirësitë e jetës së popullit, që nuk vijnë për arsye të rëndësishme bllokade apo mungese të ndihmave, por për shkak të vijës së tyre kapi-

taliste e revizioniste. Përkundrazi, në vendin tonë vësh-tirësitë ndodhin për arsye objektive, sepse na i kanë krijuar armiqtë imperialistë dhe revizionistë. Këto vësh-tirësi vërtet e detyrojnë popullin tonë të ketë disa mun-gesa, po në të njëjtën kohë ai qëndron në një nivel të lartë politik dhe patriotik, prandaj një situatë e tillë do të kalohet pa u ndierë.

Diku, në një vend në këtë material thuhet të ulet çmimi i ndonjë artikulli. Në këtë drejtim ne duhet të përpiqemi shumë dhe të shohim ç'mund të bëjmë. Ndër-sa me investimet për industrinë jemi në situatën që paraqita, lidhur me bujqësinë ne nuk do të jemi në një shtrëngesë të tillë të madhe. Mjetet që kemi në bujqë-si, uzinat e plehrave që po ndërtojmë, forcën e madhe të popullit, sidomos të fshatarësisë, shtimin e rrjetit ujitës etj., të gjitha këto ne duhet t'i shfrytëzojmë në maksimum. Në këtë sektor nuk kemi si të themi që na pengoi dhënia e kredisë, sepse këtu puna varet vetëm nga forcat, nga zotësia dhe nga organizimi ynë. Të tërë e kemi të qartë që çështja e bujqësisë është kryesore dhe se në këto situata nuk kemi pengesa. Punën në bujqësi e kemi përpara, prandaj duhet të mobilizohemi në mënyrë që t'i kompensojmë boshllëqet që mund të na krijohen nga vështirësitë e mundshme. Të sigurojmë mallra ushqimore në një nivel të arsyeshëm për popullin. Orientimet janë, prandaj të shihet edhe çështja e frutave dhe e vreshtave. Për sa u përket frutave, në situatën që jemi, ne duhet të bëjmë përpjekje të më-dha që të sigurojmë speciet e duhura në mënyrë që edhe populli të ketë të hajë, edhe të kemi për industrializim.

Duke pasur parasysh kredinë që do të kërkojmë,

jam dakord me heqjen e objekteve që ka bërë Kryesia e Këshillit të Ministrave dhe Komisioni i Planit të Shtetit, pra nga 41 objekte kërkesat tona të zbresin në 29. Por kam edhe unë disa vërejtje:

Për Hidrocentralin e Fierzës jam dakord që t'i kemi parasysh të dy variantet para se të vendosim. Për atë të Vaut të Dejës jemi të tërë dakord të ndërtohet, por, në qoftë se na vonohet studimi ose ndërtimi i tij, atëherë duhet parë mundësia që të shtojmë kapacitetin e TEC-it të Fierit. Ky është një variant që e bëjmë nga zori. Edhe unë isha i mendimit për ndërtimin e dy hidrocentraleve, por kjo do parë më konkretisht. Ne duhet të vëmë forcat për ndërtimin e Hidrocentralit të Vaut të Dejës, por, në qoftë se nuk do të arrijmë ta përfundojmë më 1971, atëherë duhet t'u futemi edhe teceve, po për këtë të llogaritim mirë çështjen e naftës etj.

Për zgjerimin e azotikut jam i një mendimi me shokët, kjo është një vepër shumë e mirë. Edhe për ndërtimin e uzinës tjetër azotike të tërë jemi dakord, po tani çështja shtrohet që të ndërtojmë të parën e ta shfrytëzojmë. Prandaj mendoj që ne, pasi të kemi filluar shfrytëzimin e asaj që po ndërtojmë, pasi të shohim edhe situatat si do të jenë, më vonë mund të shtrojmë çështjen e ndërtimit të uzinës së dytë azotike. Të parakohshme janë edhe të gjitha ato vepra, për të cilat kërkojmë të dyfishohet kapaciteti.

Mendoj sikur ta shohim përsëri çështjen e uzinave mekanike të Vlorës dhe të Korçës, sepse ato janë me klering, kjo çështje ka rëndësi të madhe në lidhje me ekonomizimin e kleringut.

Pajisjet për ndërtimin e pesë linjave për prodhi-

min e pijeve freskuese mund të hiqen, se këto janë gjëra të vogla dhe nuk kanë shumë rëndësi, por të kihet parasysh që të mos hiqen ato më të mëdhatë. Edhe hidrovoret mendoj të hiqen.

Këtu bëhet fjalë edhe për 15 milionë rubla devizë të lirë. Mendoj që të mos kërkojmë devizë të lirë, por të kërkojmë që në vend të dy vaporëve, të na japin tre, për të transportuar mallrat tona të import-eksportit, se nuk ecet kështu. Këta vaporë do të na sjellin të ardhura. Prandaj të kërkojmë dy vaporë të mëdhenj si «Vlora», me 12-13 mijë tonë kapacitet secili dhe një të tretë 6-7 mijë tonësh.

Jam dakord me ato që u thanë për kërkimet gjeologjike, po, në qoftë se ka mundësi, dhe më duket se Adili nuk u shfaq kundër për hekur-nikelin, nga këto 3 ose 2 për qind të ekonomizojmë. Me një fjalë të shohim në qoftë se ka mundësi të ekonomizojmë edhe këtu diçka, në disa drejtime që u thanë. Mendimi im është të mos vazhdojmë kërkimet për ato minerale, për të cilat kemi rezerva të paktën për 15 vjet, por të bëjmë përpjekje në të tjerat.

Si konkluzion mund të themi se këto çështje i kemi të qarta. Për sa i përket kërkesës për kredi, të shihen vërejtjet që u bënë dhe të dalë ajo shifër që do të jetë e pranueshme për ne, kjo të përbëjë kërkesën tonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP.*

«TESTAMENTI» I P. TOLIATIT, KRIZA E REVIZIONIZMIT MODERN DHE LUFTA E MARKSISTË-LENINISTËVE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

13 nëntor 1964

Në numrin 35 të datës 5 shtator 1964 të revistës teorike të KQ të PK të Italisë «Rinashita» u botua shkrimi i fundit i P. Toliatit, i cili u pagëzua në shtypin përrëndimor si «testamenti» i tij. Është fjala për një promemorje «Mbi çështjet e lëvizjes punëtore ndërkombëtare e të unitetit të saj», të shkruar nga P. Toliati në Jaltë (BS) në gusht 1964, e cila do t'i shërbente si bazë në bisedimet me N. Hrushovin dhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë për çështjet që kanë lindur lidhur me thirrjen e një mbledhjeje ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore nga ana e grupit të Hrushovit.

Udhëheqja e PK të Italisë, me L. Longon në krye, i cili, pas vdekjes së Toliatit, u zgjodh sekretar i përgjithshëm i saj, shpejtoi ta botojë atë dhe ta shpallë si platformën e vet. «Udhëheqja e partisë sonë, shkroi Longo në parathënien e shkurtër për «testamentin» e

Toliatit, mori dijëni me emocion të madh mbi dokumentin e përgatitur nga shoku Toliati, pranoi se në të janë paraqitur me shumë qartësi pozitat e partisë sonë për sa i përket gjendjes së tanishme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe e bëri të vetin. Prandaj po e botojmë promemorien e shokut Toliati si shprehje të saktë të pozitës së partisë mbi problemet e lëvizjes punëtore e komuniste ndërkombëtare e të unitetit të saj».

Botimi i këtij dokumenti pati një jehonë të gjerë si në qarqet revizioniste ashtu edhe në shtypin borgjez. Ndërsa grupi i Hrushovit mbajti ndaj këtij dokumenti një qëndrim të rezervuar dhe u mjaftua me botimin e thjeshtë të tij pa asnjë koment, imperialistët dhe klika titiste e përshëndetën dhe e pritën atë me gëzim. Dhe këto për faktin se në këtë dokument P. Toliati jo vetëm riafirmon pozitën antimarksiste e armiqësore të revizionistëve italianë, por edhe sepse ai zbulon divergjencat që kanë revizionistët italianë me revizionistë të tjerë, e në radhë të parë me grupin e Hrushovit.

Gjithë «testamenti» i Toliatit përshkohet fund e krye nga shtrembërimi i marksizëm-leninizmit, nga orvatjet për ta zëvendësuar atë në teori e në praktikë me revizionizmin modern. Ai pasqyron dhe përforcon vijën e «socializmit italian» dhe teorinë e «policentrizmit italian».

Si i tillë, «testamenti» i Toliatit ka rëndësi të madhe për ne, marksistë-leninistët sepse me të revizionistët demaskojnë vetveten. Nëpërmjet këtij dokumenti revolucionarët e vërtetë shohin rezultatet e deritanishme të luftës së tyre të vendosur, e cila jo vetëm ka penguar seriozisht realizimin e qëllimeve armiqësore

të revizionistëve, por edhe u ka shkaktuar atyre vështirësi të mëdha dhe ka thëlluar e ka acaruar më tej kontradiktat midis tyre. Por njëkohësisht nëpërmjet «testamentit» të Toliatit marksistë-leninistët shohin edhe më qartë planet dhe metodat e luftës që përpiqen të përdorin tani e në të ardhmen revizionistët modernë kundër partive marksiste-leniniste, kundër revolucionarëve të vërtetë, kundër komunizmit.

Këto plane djallëzore të revizionistëve duhen demaskuar me vendosmëri e pa ngurrim. Iluzionet që përpiqen të krijojnë grupet e ndryshme revizioniste mbi pozitën e tyre duhen demaskuar e duhen shpartalluar. Revolucionarët e vërtetë duhet të shohin qartë rrezikun e sotëm e të nesërm të armiqve të komunizmit. Për këtë është e nevojshme të analizohet me kujdes «testamenti» i P. Toliatit.

Qëllimi kryesor i revizionistëve është lufta kundër marksistë-leninistëve

Duke lexuar «testamentin» e P. Toliatit duket fare qartë se qëllimi kryesor i këtij dokumenti nuk është aspak arritja e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare e të kampit socialist, por është që të tregojë metodat, format e mjetet që, sipas mendimit të Toliatit e të tërë udhëheqjes revizioniste të PK të Italisë, do të bënin të mundur një luftë më të efektshme kundër partive marksiste-leniniste dhe pozitive të tyre, kundër influencës së tyre gjithnjë në rritje. Toliati nuk e fsheh aspak këtë gjë, bile në promemorien e tij ka një kapi-

tull të posaçëm që titullohet pikërisht: «Si mund të luftohen më mirë pozitat kineze». Dhe kjo për arsye se revizionistët po e shohin që pozitat e tyre po dobësohen, se demagogjisë së tyre nuk po i beson më njeri, se kudo po krijohen grupe e parti revolucionare marksiste-leniniste, rreth të cilave po bashkohen masat revolucionare të klasës punëtore dhe të popullit.

Në fakt P. Toliatin, siç shprehet në «testament», e shqetëson shumë fakti që punët në stanin revizionist, në luftën e tij kundër marksizëm-leninizmit, nuk po shkojnë mirë, dhe shkakun kryesor të kësaj gjendjeje ai e sheh në taktikën «e gabuar», «dogmatike» e brutale të Hrushovit e të grupit të tij. Ai shkruan: «Plani që propozonim ne për një luftë të fuqishme kundër pozitave të gabuara politike dhe kundër aktivitetit përçarës të komunistëve kinezë që i ndryshëm nga ai që u ndoq efektivisht... Është ndjekur një vijë e ndryshme dhe pasojat nuk i gjykoj krejt të mira».

Revizionistët toliatistë janë nga revizionistët më frikacakë, por njëkohësisht nga revizionistët më konsekuentë. Prandaj ata kërkojnë që, siç e thotë qartë kryetari i tyre i vdekur, polemika e hapët kundër «dogmatikëve» të vazhdojë pa ndërprerje.

Me këtë revizionistët italianë e tregojnë veten, ashtu siç janë, armiq të betuar të marksizëm-leninizmit. Ata shprehen vendosmërisht kundër çdo pushimi të luftës së hapur, publike kundër marksistë-leninistëve, qoftë edhe vetëm të përkohshëm e sa për formë, sepse ndryshe nuk kanë si të realizojnë misionin e tyre tradhtar. Me këtë ata njëkohësisht i thonë Hrushovit se manovrat e tij demagogjike që «të pushohet polemika» janë

krejt të kota e nuk mashtrojnë dot njeri, se polemika nuk është e mundur të pushohet as nga revizionistët e as nga «dogmatikët».

Por, nga ana tjetër, P. Toliati kërkon që të spostohet boshti i polemikës. Duke vënë përballë eksperiencën e hidhur të rezultateve të mjerueshme të propagandës së grupit të Hrushovit në mbrojtje gjoja të parimeve të marksizëm-leninizmit krijues, ai kërkon që të hiqet dorë nga polemika teorike me partitë marksiste-leniniste, e cila prek çështjet parimore e jetike të doktrinės revolucionare marksiste-leniniste e të veprimtarisë së lëvizjes komuniste, dhe diskutimi të orientohet kryekëput te lufta e përditshme e vogël, konfuze, joparimore, e pakontrollueshme për çështjet e brendshme korente të vendit, ku sipas Toliatit, propaganda e «dogmatikëve» «është krejt e çarmatosur dhe e pafuqishme» dhe nuk ka «asnjë efekt».

Me këtë propozim P. Toliati hedh një ide shumë të rrezikshme. Në polemikën me marksistë-leninistët për çështjet e mëdha parimore, siç është i detyruar ta pranojë edhe vetë P. Toliati, revizionistët modernë kanë pësuar disfatë të plotë, demagogjia e tyre ka dështuar dhe ata nuk janë në gjendje të errësojnë parimet bazë të marksizëm-leninizmit. Polemika mbi baza parimore është vdekje e sigurt për revizionistët, sepse ajo po tregon sheshit para masës së komunistëve e të punonjësve largimin flagrant të revizionistëve nga parimet themelore të marksizëm-leninizmit, po nxjerr në pah fytyrën e tyre të vërtetë si renegatë.

Si rrjedhim, marksistë-leninistët revolucionarë kudo po organizohen, po krijojnë grupe e parti të reja, të

cilat luftojnë me vendosmëri kundër revizionizmit, në mbrojtje të doktrinës marksiste-leniniste. Kësaj situatë dhe perspektive, ia ka frikën P. Toliati. Dhe për të evituar demaskimin e plotë të revizionizmit, ai kërkon që polemika të largohet nga çështjet parimore dhe të përqendrohet në diskutime mbi çështje të dorës së dytë, mbi çështje të përditshme. Me këtë Toliati do të thotë: secili të ruajë pikëpamjet e veta ideologjike dhe për këto çështje parimore të mos ketë polemikë; komunistët të mos preokupohen për parimet bazë të marksizëm-leninizmit; të pengohet me çdo mënyrë procesi i krijimit të grupeve dhe të partive të reja revolucionare; renegatët revizionistë të lihen të qetë në veprimtarinë e tyre, në mënyrë që të vënë në jetë me më pak telashe e kokëçarje vijën e tyre oportuniste, vijën e heqjes dorë nga lufta revolucionare, vijën e likuidimit të marksistë-leninistëve revolucionarë, vijën e aleancave me borgjezinë dhe me imperializmin.

Por polemika e madhe që zhvillohet sot midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit, me gjithë orvatjet e Toliatit e të shokëve të tij për ta devijuar e për ta shuar atë, nuk mund të ndalohej kurrë. Kjo polemikë do të pushojë vetëm atëherë kur të jetë shpartalluar plotësisht revizionizmi modern. Çuarjen deri në fund të kësaj lufte ideologjike, që ka rëndësi jetike për fatet e lëvizjes komuniste e revolucionare, marksistë-leninistët e konsiderojnë si detyrën e tyre të lartë internacionaliste.

P. Toliati është i pakënaqur jo vetëm nga mënyra e polemikës së grupit të Hrushovit kundër partive marksiste-leniniste, por edhe nga hapat praktikë që ai

ka ndërmarrë për vënien në jetë të politikës së tij tradhtarë revizioniste. Si hapa «pozitivë», por «të pamjaftueshëm», në këtë drejtim Toliati përmend nënshkrimin e traktatit famëkeq të Moskës për ndalimin e pjeshëm të provave bërthamore dhe vizitën e N. Hrushovit në Egjipt. Dhe kërkon që hapa të tillë «praktikë» të ndërmerren më shpesh si nga revizionistët hrushovianë ashtu edhe nga ata të vendeve të tjera.

Pra, Toliati dhe shokët e tij revizionistë italianë, të cilët kanë kapitulluar kokë e këmbë para shantazhit atomik të imperializmit, i bëjnë thirrje grupit të Hrushovit të hedhë poshtë çdo «ngurrim të kotë» dhe të ecë më shpejt në rrugën e afrimit e të lëshimeve kapitulluese kundrejt imperialistëve, siç bëri në rastin e nënshkrimit të traktatit tripalësh për provat bërthamore. Por politika e kapitullimit para shantazhit imperialist, e lëshimeve të paparim ndaj imperialistëve dhe e pazarllëqeve me ta jo vetëm nuk ka çuar në uljen e tensionit ndërkombëtar dhe nuk ka mënjanuar rrezikun e luftës, siç mendojnë revizionistët, të cilëve u ka hyrë frika në palcë, por, përkundrazi, ka shtuar oreksin e imperialistëve dhe ka rritur agresivitetin e tyre, gjë për të cilën dëshmojnë veprimet agresive të imperialistëve amerikanë në Azinë Juglindore, provokacionet e pareshtura në Berlinin Perëndimor, shtimi i akteve pirateske kundër Kubës etj., në këta muajt e fundit. Bile edhe vetë Toliati detyrohet ta pranojë në promemorjen e tij se gjendja ndërkombëtare tani është më e keqe nga ç'ishte dy-tre vjet më parë.

Toliati në «testamentin» e tij nxit revizionistët, nga janë e nga s'janë, që të shtojnë përpjekjet e tyre ku-

ndër partive marksiste-leniniste, autoritetit dhe ndikimit të tyre në botë. Atë e preokupon në mënyrë të veçantë ndikimi gjithnjë më i madh i marksistë-leninistëve, në vendet e Azisë, Afrikës e Amerikës Latine, ose në «botën e tretë», siç i quan këto zona P. Toliati. Prandaj ai rekomandon të ndërmerret një ndërhyrje më aktive e grupeve revizioniste në këto zona, me qëllim që të luftohen atje pozitave të partive marksiste-leniniste dhe të likuidohet influenca e tyre. Ai propozon «...një takim ndërkombëtar, i thirrur nga disa parti komuniste perëndimore, me një rreth të gjerë përfaqësuesish të vendeve demokratike të «botës së tretë» dhe të lëvizjeve të tyre përparimtare, për të përpunuar një vijë konkrete bashkëpunimi e ndihme për këto lëvizje».

Përse P. Toliati dhe toliatistët janë kaq të shqetësuar për gjendjen në të ashtuquajturën botë e tretë? Mos vallë në këto vende nuk po zhvillohet një lëvizje e fuqishme antiimperialiste nacionalçlirimtare? Apo mos vallë është pikërisht kjo që i shqetëson? Tani dihet nga tërë bota se partitë marksiste-leniniste janë për-krahëset e vërteta e më të vendosura të luftës nacionalçlirimtare të popujve të Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine, luftëtare të paepura kundër imperializmit, për lirinë dhe për pavarësinë e popujve. Prandaj të ngrihesh kundër vijës së ndjekur prej tyre, të përpiqesh të eliminosh influencën e tyre në popujt që janë ngritur në luftë kundër imperializmit, siç kërkon P. Toliati, do të thotë në fakt të ngrihesh kundër luftës antiimperialiste çlirimtare të popujve. Dhe faktet provojnë se tërë vija e revizionistëve modernë, që nga Titoja deri te Hrushovi e Toliati, ka synuar kurdoherë

që, me pretekste e manovra të ndryshme, të frenojë e të paralizojë luftën çlirimtare të popujve të robëruar kundër imperializmit. Është pikërisht P. Toliati ai që ka deklaruar më se një herë se «regjimi kolonial është shembur gati plotësisht» dhe se «nuk ekzistojnë më në botë sfera influence të imperializmit». Janë pikërisht revizionistët italianë, me P. Toliatin në krye, ata që kanë predikuar bashkëpunimin midis vendeve socialiste dhe «klasave drejtuese të vendeve kapitaliste» për krijimin e një rendi «në të cilin të mund të kënaqen të gjitha aspiratat e njerëzve e të popujve për liri, mirëqenie, pavarësi». Janë pikërisht ata që kanë kërkuar «iniciativa unike» midis shteteve me sisteme të ndryshme, sidomos në Evropë, «për të realizuar ndërhyrjen e përbashkët, në mënyrë që të ndihmohet përparimi i rajoneve pak të zhvilluara». Ja se si e kupton P. Toliati «ndihmën» për popujt që luftojnë kundër imperializmit!

Duke vazhduar idenë e tij se si të luftohet më me sukses kundër partive marksiste-leniniste, Toliati, në «testamentin» e vet, shpreh rezerva lidhur me dobinë dhe oportunitetin e një mbledhjeje të partive komuniste që do të kishte si qëllim skomunikimin e dënimin e PK të Kinës, të PPSH e të partive të tjera dhe përçarjen definitive të lëvizjes komuniste. Një taktikë të tillë të grupit renegat të Hrushovit toliatistët e quajnë të gabuar dhe shumë të dëmshme për çështjen e revizionistëve.

P. Toliati e quan shumë të rrezikshme thirrjen e një mbledhjeje për të çuar deri në fund e për të konstatuar përçarjen në lëvizjen komuniste, sepse një gjë

e tillë do të forconte luftën e marksistë-leninistëve në gjithë botën kundër revizionistëve, do të shpejtonte procesin e diferencimit në radhët e lëvizjes komuniste botërore e të bashkimit të forcave marksiste-leniniste dhe do të afronte kështu fundin e pashmangshëm të revizionistëve. «Rreziku do të bëhej veçanërisht i rëndë, shkruan P. Toliati, po të arrihej në një përçarje të lëvizjes, me formimin e një qendre ndërkombëtare kineze, që do të krijonte «seksione» të saj në të gjitha vendet. Të gjitha partitë, dhe sidomos ato më të dobëtat, do të prireshin t'u kushtonin pjesën më të madhe të veprimtarisë së tyre polemikës dhe luftës kundër këtyre të ashtuquajturave «seksione» të një «Internacionaleje» të re... Është e vërtetë që edhe sot orvatjet fraksioniste të kinezëve po zhvillohen gjerësisht dhe pothuaj në të gjitha vendet. Duhet të evitohet që sasia e këtyre orvatjeve të shndërrohet në cilësi, domethënë në një përçarje të vërtetë, të përgjithshme dhe të sanksionuar».

Palmiro Toliati, si kominternist i vjetër, e njej mirë forcën e organizimit të marksistë-leninistëve të botës dhe ia ka shumë frikën kësaj. Ai, megjithëse përpigjet të nënçmojë grupet dhe partitë e reja marksiste-leniniste që po lindin, formohen e forcohen kudo në botë, ua ka shumë frikën, duke parashikuar rrezikun e madh që po i vërsulet revizionizmit modern. Me këtë ai do t'u thotë hrushovianëve që mbështeten në arrogancën, që janë të dehur e të verbuar nga «forca ekonomiko-ushtarake» që kanë në dorë, që mbështeten verbërisht në prestigjin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të mos harrojnë mësimet e historisë, mësimet

e eksperiencës së lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të mos harrojnë disfatën e turpshme që u shkaktoi Internacionalja e Tretë oportunistëve e revizionistëve të Internacionales së Dytë. Pra, Toliati u thotë N. Hrushovit e përkrahësve të tij: hiqni dorë nga «mbledhja», hiqni dorë nga përçarja definitive, sepse shpejtojmë katastrofën tonë, dhe këtë katastrofë mund ta evitojmë duke vepruar ndryshe!

Këto dy taktika të ndryshme të revizionistëve diktohen nga kushtet e ndryshme në të cilat ata veprojnë. Hrushovi dhe grupi i tij, të cilët kanë rrëmbyer pushtetin në Bashkimin Sovjetik, mendojnë se ata mund ta përballojnë krizën që do të shkaktonte një përçarje të plotë në lëvizjen komuniste, duke përdorur ndaj marksistë-leninistëve revolucionarë, që ngrihen e do të ngrihen kundër vijës tradhtare të revizionistëve, masa të ashpra policore, persekutimi e shtypjeje. Kurse toliatistët, që veprojnë në një vend kapitalist dhe nuk kanë fuqi shtetërore në dorë, që për pasojë nuk mund të ndalojnë me masa të tilla veprimtarinë e marksistë-leninistëve, kundërshtojnë veprimet ekstremiste të N. Hrushovit për përçarjen e plotë në lëvizjen komuniste, duke shpresuar kështu të evitojnë katastrofën dhe, me manovra e metoda të tjera, më elastike e më «demokratike», të paralizojnë organizimin dhe luftën e komunistëve revolucionarë.

Por as metodat brutale të përdorura nga Hrushovi e grupi i tij dhe as taktikat «e holla» që propozon P. Toliati nuk mund të ndalojnë procesin e pashmangshëm të grumbullimit dhe të organizimit të forcave re-

volucionare marksiste-leniniste, nuk mund të evitojnë disfatën e plotë e përfundimtare të revizionizmit modern.

Toliatistët shprehen kundër qëllimeve të Hrushovit e të grupit të tij për t'i prishur përfundimisht e për t'i prerë të gjitha marrëdhëniet me RP të Kinës dhe me vendet e tjera socialiste vëllezër edhe për një arsye tjetër. Ata kanë frikë nga tendencat ultrareaksionare që po bëhen çdo ditë e më të theksuara si në SHBA (Gollduoteri) ashtu dhe në Evropën Perëndimore. «Këtë situatë, shkruan P. Toliati në «testamentin» e tij, mendojmë se duhet ta kemi parasysh në tërë qëndrimin tonë. Uniteti i të gjitha forcave socialiste në një veprim të përbashkët, edhe përmbi divergjencat ideologjike, kundër grupeve më reaksionare të imperializmit, është një nevojë e domosdoshme. Nga ky unitet nuk mund të mendohet se mund të përjashtohen Kina dhe komunistët kinezë».

Nga thëniet e P. Toliatit del se ajo që e preokupon atë nuk është aspak fakti që lëvizja komuniste dhe kampi socialist janë përcarë dhe as gjetja e rrugëve për kapërcimin e divergjencave të thella e parimore që kanë lindur në gjirin e tyre. Jo, ai kërkon që polemika kundër partive marksiste-leniniste të vazhdohet pa ndërprerje, bile, siç e kemi treguar më sipër, rekomandon edhe rrugët e mjetet më të efektshme për të luftuar kundër tyre. Por ai ka frikë prej «të tërbuarve», propozon të ndiqet një rrugë më elastike, më e matur, të mos priten të gjitha urat me Kinën Popullore 700-milionëshe duke menduar për ditët e vështira që mund të vij-

në në të ardhmen. Ky është një qëndrim oportunist tipik, ala borgjezi italiane, e cila e ka pasur për traditë t'i ndërrojë në momentet vendimtare aleancat e «këmi-shat» si mbreti gratë.

Pohimet e Toliatit se atë gjoja e preokupon çështja e luftës kundër armikut të përbashkët, imperializmit, si dhe propozimi i tij për të koordinuar veprimet e përbashkëta me RP të Kinës në këtë luftë, janë fund e krye demagogjike, të llogaritura për të mashtruar njerëzit. Çfarë uniteti e bashkëpunimi mbi bazën e luftës kundër imperializmit mund të ketë me revizionistët modernë, qofshin këta toliatistë, hrushovianë apo titistë, të cilët jo vetëm vetë kanë hequr dorë nga lufta kundër imperializmit, sidomos kundër kështjellës kryesore të reaksionit botëror, imperializmit amerikan, por edhe janë përpjekur e përpiqen me çdo mjet të zbukurojnë imperializmin dhe krerët e tij, të përhapin iluzione pacifiste për të, të largojnë popujt nga lufta e vendosur kundër tij, bile kanë arritur deri atje sa të bien në marrëveshje skandaloze me imperialistët dhe me reaksionarët e ndryshëm kundër interesave jetike të vendeve socialiste dhe të paqes? Unitet dhe bashkëpunim në luftën kundër imperializmit mund të ketë vetëm me marksistë-leninistët dhe me të gjitha forcat që qëndrojnë me të vërtetë në pozita antiimperialiste, duke e treguar këtë me vepra e jo vetëm me fjalë, por kurrë me revizionistët, që janë pjellë e imperializmit dhe i shërbejnë atij.

P. Toliati kërkon degjenerimin e mëtejshëm të vendeve socialiste dhe të partive komuniste

Shkrimi i fundit i P. Toliatit është një shprehje e qartë e divergjencave që ekzistojnë midis grupimeve të ndryshme revizioniste lidhur me rrugët dhe me ritmet e zhvillimit të revizionizmit modern në teori e në praktikë.

Toliati u bën një barrë kritikash grupit të Hrushovit dhe pasuesve të tij se po ecet me ritme shumë të ngadalta në rrugën e «transformimit demokratik e liberal» të jetës në vendet socialiste. Ai kërkon që të ecet më shpejt, më hapur, më me vendosmëri në rrugën e degjenerimit të rendit socialist.

P. Toliati ngre përsëri çështjen e vjetër, të cilën ai, bashkë me renegatin Tito, e pat ngritur qysh më 1956, në kohën e kundërrevolucionit në Hungari, mbi «origjinën e kultit të individit të J. Stalinit». Ai shkruan se «... konsiderohet në përgjithësi i pazgjidhur problemi i origjinës së kultit të Stalinit dhe se si ai u bë i mundur. Njerëzit në Perëndim, thotë Toliati, midis tyre edhe shumë simpatizantë të komunistëve, nuk pranojnë t'i shpjegojnë të gjitha «vetëm me veset e rënda personale të Stalinit». Bëhen orvatje për të hetuar cilat mund të kenë qenë gabimet politike që kontribuan në lindjen e kultit».

Duket sheshit se P. Toliati, duke ngritur në këtë mënyrë çështjen e burimeve të «kultit të individit» të Stalinit, kërkon të bëhen ndryshime themelore në vetë bazat e rendit socialist, në parimet kryesore të organi-

zimit të tij e të politikës së ndërtimit socialist që është ndjekur në Bashkimin Sovjetik në kohën e udhëheqjes së J. Stalinit.

Por ç'kërkon konkretisht Toliati?

Kjo duket fare qartë në një intervistë që ai i pat dhënë korrespondentit të revistës amerikane «Tajm» të nesërmen e zgjedhjeve të 28 prillit 1963 në Itali, e cila u botua për herë të parë pas vdekjes së Toliatit¹ si një dokument që përmban mjaft teza të zhvilluara më pas në promemorjen e Jaltës të P. Toliatit. Në këtë intervistë Toliati kritikon në mënyrë krejt të hapur politikën e shtetëzimeve të industrisë kapitaliste, të kolektivizimit të bujqësisë dhe udhëheqjen e një partie të vetme etj., me fjalë të tjera, vijën themelore të organizimit e të ndërtimit socialist që është ndjekur në periudhën e udhëheqjes së J. V. Stalinit në Bashkimin Sovjetik. Ai kërkon të hiqet dorë nga një vijë e tillë dhe «të mos përsëriten gabimet e Stalinit».

Nuk është aspak e rastit kërkesa e Toliatit në promemorjen e tij që në vendet socialiste të organizohen herë pas here «diskutime publike», në të cilat «drejtues që kanë pikëpamje të ndryshme» për çështjet e ndërtimit socialist të marrin pjesë dhe të shprehin mendimet e veta «origjinale» lidhur me rrugët e me metodat e zhvillimit të ekonomisë socialiste. Kuptohet lehtë se ku e ka hallin P. Toliati. Dihet se të tilla «diskutime» po zhvillohen tani në Bashkimin Sovjetik lidhur me rrugët e futjes së parimit të «fitimit» në ndërmarrjet sovjetike, gjë që përbën një hap drejt zbatimit në ekono-

¹ Shih: Gazeta «Unita» 18 shtator 1964.

minë sovjetike, të eksperiencës së klikës titiste mbi të ashtuquajturin vetadministrim punëtor. Kjo është rruga e degjenerimit kapitalist të ekonomisë socialiste. Dhe pikërisht në këtë rrugë tradhtare P. Toliati bën thirrje që të ecet më shpejt e më me guxim.

Por në radhë të parë e mbi të gjitha për P. Toliatin, për gjithë revizionistët italianë dhe ata që, hapur ose fshehtazi, shkojnë pas tyre, «procesi i destalinizimit» në vendet ku sundojnë revizionistët nuk është i kënaqshëm dhe nuk po zhvillohet me ritmet e duhura. «Problemi të cilit i kushtohet vëmendja më e madhe për sa u përket si Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe vendeve të tjera socialiste, thotë ai në «testament», është sot në mënyrë të posaçme ai i kapërcimit të regjimit të kufizimit e të shtypjes së lirive demokratike e personale që ishte vendosur nga Stalini... Përshtypja e përgjithshme është se ekziston një ngadalësi dhe rezistencë për t'u kthyer në normat leniniste që siguronin, në parti dhe jashtë saj, liri të gjerë shprehjeje e diskutimi në fushën e kulturës, të artit, si dhe në fushën politike».

Pra, me proces të «destalinizimit» Toliati kupton transformimin rrënjësor e me ritme të shpejtuara, në teori e në praktikë, të regjimit, të sistemit, të politikës së brendshme e të jashtme në BS dhe në vendet e tjera socialiste të Evropës, me qëllim që këto vende të kthehen nga rruga e drejtë e ndërtimit të socializmit mbi baza shkencore marksiste-leniniste, në vende me një rend kapitalist — shtetëror, liberal, socialdemokrat. Me fjalë të tjera, Toliati kërkon që rruga që hapën N. Hrushovi dhe Kongresi i 20-të i PK të BS drejt degjenerimit të Bashkimit Sovjetik nga një vend socialist në një

vend borgjez liberal, të mos ndërpritet, procesi të mos ngadalësohet, por përkundrazi, të shpejtohet.

Që të ecë përpara ky proces, sipas revizionistëve italianë, duhet të diskreditohet plotësisht, si politikisht ashtu dhe ideologjikisht, sistemi sovjetik që polli gjoja «kultin e individit të Stalinit», duhet të diskreditohet Stalini, që gjoja deformoi marksizëm-leninizmin, «krijoi diktaturën më të egër që ka parë njerëzimi», që shkaktoi «dëme të mëdha» me luftën e klasave «të panevojshme» e «barbare», që «e bëri Bashkimin Sovjetik gogol të frikshëm për borgjezinë botërore, për social-demokracinë» etj.

Në të vërtetë, grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij janë në parim plotësisht dakord me P. Toliatin dhe po ecin pikërisht në rrugën antisovjetike që predikon ai. Është fakt se në Bashkimin Sovjetik, në kuadrin e «liberalizimit» dhe të «demokratizimit» të rendit shoqëror, po likuidohen diktatura e proletariatit dhe partia proletare. Dihet gjithashtu se në Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende të ish-demokracisë popullore janë hapur gjerësisht dyert për përhapjen e gjithfarë tendencave antisocialiste e dekadente borgjeze në fushën e kulturës e të artit. Këto nuk janë më sekret për asnjëri. Por ecja në këtë rrugë me hapa të shpejtë është diçka shumë delikate dhe e shoqëruar me disa pasoja negative për vetë revizionistët, gjë që i detyron Hrushovin dhe grupin e tij të tregohen më të matur e më të përmbajtur nga ç'dëshiron P. Toliati.

Ata detyrohen të tregohen më të matur e më të përmbajtur sepse ecja me revan në rrugën e degjenerimit liberalo-borgjez të rendit socialist do të demasko-

nte shpejt para masave fytyrën e tyre të vërtetë prej renegatësh të socializmit dhe restauruesish të kapitalizmit. Veç asaj, me sa duket, grupi i Hrushovit ka frikë t'ua lëshojë shumë perin elementëve revizionistë ekstremistë, duke u dhënë atyre liri të plotë fjale e veprimi, sepse ata do t'i nxirrnin telashe atij vetë, siç ndodhi në fakt me disa shkrimtarë në Bashkimin Sovjetik, të cilët filluan t'i kërkonin llogari edhe vetë Hrushovit për të ashtuquajturat «krime» të kohës së Stalinit. Më së fundi, grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij revizionistë në vende të tjera nuk mund të jenë për një «liberalizim» pa kufi, sepse një gjë e tillë do të shtronte para tyre problemin e lirisë së fjalës e të veprimit edhe për elementët e shëndoshë revolucionarë e marksistë-leninistë, që kundërshtojnë vijën e tyre revizioniste. Por dihet se kundër marksistë-leninistëve grupi i Hrushovit dhe përkrahësit e tij kanë vendosur censurën dhe regjimin policor më të ashpër.

Natyrisht, Toliati dhe toliatistët i përshëndetin si «shumë pozitivë» hapat e ndërmarrë në BS dhe në disa vende të tjera socialiste për degjenerimin e rendit socialist dhe për futjen e gjerë të influencave të ideologjisë borgjeze. Por, sipas tyre, ky proces po zhvillohet shumë ngadalë, me zigzage e frenime, dhe po has në rezistencën e «së vjetrës», kurse atyre ua kërkon puna që të ecet më shpejt në rrugën e likuidimit të plotë të «pasojave të dëmshme të diktaturës së proletariatit», në rrugën e degjenerimit kapitalist në ekonominë socialiste, në fushën e kulturës e të artit dhe në të gjitha fushat e tjera. Ata duan që të ecë më shpejt procesi i degjenerimit në PK të BS, që është bërë tanimë «partii

e gjithë popullit», kërkojnë që ajo të bëhet krejtësisht një parti e tipit të PK të Italisë, pa rregulla, pa disiplinë, «e lirë», «demokratike», me fraksione e tendenca të çfarëdolloji brenda saj. Me një fjalë, Toliati u rekomandon revizionistëve hrushovianë që reformat e ndërmarra për liberalizimin e partisë të thellohen më tej, që PK e BS dhe partitë e republikave, që e formojnë atë, të kenë liri të mëdha (të hiqet dorë edhe nga format e tanishme «dogmatike» që përdorin revizionistët hrushovianë), dhe e mira e të mirave do të ishte që, mundësisht, të kalohej nga sistemi i vjetër «dogmatik» i një partie në sistemin me shumë parti. Ky do të ishte, sipas toliatistëve, kulmi i «demokracisë socialiste» (gati sa nuk thonë që «për këtë kishte ëndërruar me kohë Lenini», por këtë «ëndërr të Leninit» e pengoi për dhjetëra vjet Stalini! Por edhe këtë mund ta thonë ndonjë ditë).

Toliati dhe gjithë revizionistët italianë, të cilët veprojnë në një vend kapitalist, nuk duan t'i marrin parasysh kushtet e posaçme dhe vështirësitë që hasin hrushovianët dhe revizionistët e tjerë për të ecur pa frena në rrugën e degjenerimit. Toliatistët kërkojnë të shpejtohet procesi i degjenerimit në Bashkimin Sovjetik, për pasojë edhe në vendet e tjera socialiste të Evropës, sepse vetëm kështu bota kapitaliste nuk do të ketë më frikë nga BS, nga socializmi, nga komunizmi, sepse kështu do t'u mbushet mendja borgjezisë e intelektualëve borgjezë se «djalli nuk është aq i shëmtuar se ç'e tregojnë», se socializmi nuk është aq i papranueshëm për ta (edhe në qoftë se deri tani ka pasur në vendet socialiste gjëra të papranueshme për borgjezinë, ato kanë qenë «shtrembërime» të Stalinit!). Kështu, pra, do të mund

të bisedohet për ndërtimin e një «sistemi të ri të socializmit botëror» me «marksistë», me «socialistë», me socialdemokratë, me demokristianë e me kapitalistë, në rrugë «paqësore», pa luftë klasash, pa diktaturë të proletariatit, pa shkatërruar pushtetin e vjetër të borgjezisë, por me anë «reformash të strukturës», në rrugë parlamentare, duke vepruar sipas ligjeve të kushtetutave borgjeze etj., etj.

Përderisa në Kongresin e 20-të u pranuan parimet e shkuarjes në «socializëm» me anë të një rruge të tillë «demokratike» e «paqësore», arsyetojnë revizionistët italianë, atëherë ato duhen zbatuar me konsekuencë jo vetëm me fjalë, por me vepra dhe revizionistëve hrushovianë e të tjerëve u bie të japin shembullin përpara tërë botës, t'u heqin frikën «demokratëve», duke provuar se me vepra e zhdukën «gogolin stalinian» dhe i shndërruan Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste në parajsë socialdemokrate, në vende të «socializmit popullor», të pranueshëm nga tërë demokratët e botës!

Pretendime e pakënaqësi shpreh P. Toliati edhe lidhur me çështjet e zhvillimit të revizionizmit në vendet perëndimore. «Ne kemi qenë kurdoherë të mendimit, shkruan ai, se nuk është e drejtë ta paraqesim në mënyrë kryesisht optimiste lëvizjen punëtore e komuniste të vendeve perëndimore. Në këtë anë të botës, edhe në qoftë se aty-këtu janë bërë përparime, zhvillimi ynë dhe forcat tona janë edhe sot e kësaj dite të papërshtatshme për detyrat që na paraqiten».

Ky është një pohim me të vërtetë shumë interesant. Dihet se në shumicën dërrmuese të këtyre vende-

ve udhëheqja e partive komuniste ndodhet në duart e elementëve revizionistë, që ecin në të njëjtën rrugë oportuniste e antimarksiste të predikuar nga Toliati, Titoja e Hrushovi me shokë. Pohimi i Toliatit tregon se në ç'pasoja të rënda e ka çuar lëvizjen komuniste rryma e revizionizmit modern.

Dhe ç'kërkon P. Toliati? Ç'rekomandon ai për ta nxjerrë lëvizjen komuniste të botës perëndimore nga kjo situatë e papëlqyeshme? Logjika më elementare kërkon që hapi i parë e vendimtar në këtë drejtim duhet të jetë heqja dorë nga vija revizioniste e antirevolucionare, që ka ulur përtokë autoritetin dhe prestigjin e partive komuniste e punëtore në Perëndim dhe ka çuar në shkëputjen dhe në izolimin e komunistëve nga masat. Kurse P. Toliati rekomandon pikërisht të kundërtën: kërkon që të ecet akoma më tej në rrugën revizioniste të Kongresit të 20-të të PK të BS. «Në përgjithësi, shkruan ai, ne nisemi, dhe jemi të bindur se duhet të nisemi, në përpilimin e politikës sonë, nga pozitat e Kongresit të 20-të. Por edhe këto pozita kanë nevojë sot të thellohen dhe të zhvillohen».

Konkretisht ai kërkon që të gjitha forcat dhe përpjekjet e partive komuniste e punëtore në vendet perëndimore të drejtohen nga format «paqësore» e «legale» të luftës, në shembullin e së ashtuquajturës «rrugë italiane» drejt socializmit (kërkesa për përpunimin dhe vënien në jetë të një «plani të përgjithshëm zhvillimi ekonomik» në interes të punonjësve «për t'ia kundërvënë programit kapitalist», që është në interesin e monopoleve të mëdha, për «demokratizimin» e drejtimit të jetës ekonomike në vendet kapitaliste etj., etj.). «Për

shembull, shkruan P. Toliati, një gjykim më i thellë mbi temën e mundësisë së një rruge paqësore të shkuarjes në socializëm na shtyn të saktësojmë se ç'kuptojmë ne për demokraci në një shtet borgjez, si mund të zgjerohen kufijtë e lirisë dhe të institucioneve demokratike dhe cilat do të jenë format më të efektshme të pjesëmarrjes së masave punëtore e punonjëse në jetën ekonomike dhe politike. Lind kështu çështja e mundësisë së fitimit të pozitive të pushtetit nga ana e klasave punonjëse, në kuadrin e një shteti që nuk ka ndryshuar natyrën e tij si shtet borgjez dhe, për pasojë, nëse do të ishte e mundur lufta nga brenda për një transformim progresiv të kësaj natyre. Në vende ku lëvizja komuniste është bërë e fortë si te ne (dhe në Francë), kjo është çështja themelore që del sot në jetën politike».

Ne edhe më parë, sidomos në artikullin «Mbi tezat për Kongresin e 10-të të PK të Italisë», botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 17-18 nëntor 1962, kemi pasur rast të ndalemi me hollësi në analizën e së ashtuquajturës rrugë italiane drejt socializmit dhe të provojmë se ajo karakterizohet nga largimi flagrant prej mësimëve themelore të marksizëm-leninizmit mbi luftën e klasave, revolucionin socialist dhe diktaturën e proletariatit, se ajo është një «rrugë» krejt oportuniste e revizioniste, e ngjashme si dy pika uji me predikimet e Bernshtajnit, Kautskit e të oportunistëve të tjerë në të kaluarën, të socialistëve të djathtë, të klikës tististe e të renegatëve të tjerë të kohës së sotme. Dhe pikërisht thellimin e mëtejshëm në këtë vijë tradhtarë të mohimit të revolucionit, të largimit të partive

komuniste e të masave punonjëse nga lufta revolucionare, P. Toliati e rekomandon si rrugëdalje nga kriza ku e ka futur lëvizjen komuniste në Perëndim revizionizmi modern!

Toliati kërkon gjithashtu që të hiqet dorë nga çdo gjë që mund të pengojë aleancat e revizionistëve me borgjezinë liberale, intelektualët borgjezë, demokristianët, socialdemokratët dhe gjithë «aleatët» e tjerë të tyre në «rrugën italiane, demokratike drejt socializmit». Ai përmend si shembull nevojën e domosdoshme që të hiqet dorë «nga formula e motshme ateiste», domethënë nga lufta parimore kundër fesë e politikës reaksionare të Vatikanit, si dhe nga lufta për parimet e marksizmit në fushën e kulturës, artit, shkencës e filozofisë.

Kjo është në fakt vija e degjenerimit politik e ideologjik të partive komuniste e punëtore në vendet perëndimore, e shndërrimit të tyre në parti të tipit socialdemokrat. Për të plotësuar kuadrin, do të shtojmë këtu se udhëheqja e PK të Italisë, me P. Toliatin në krye, prej kohësh ka ndjekur njëkohësisht politikën e degjenerimit organizativ të partisë proletare, duke shndërruar atë gradualisht nga pararojë revolucionare luftarake, e organizuar dhe e disiplinuar e klasës punëtore, në një organizatë amorfe, pa kufij të qartë, pa një disiplinë të shëndoshë partie, ku secili mund të hyjë e të dalë sipas qejfit dhe ku detyra supreme e anëtarit të partisë konsiderohet të japë votën për partinë komuniste në zgjedhjet parlamentare, apo në zgjedhjet e tjera që bëhen në vendet kapitaliste.

Pra, revizionistët italianë, dashur padashur, pra-

nojnë me hidhërim se rruga e tyre tradhtare nuk u ka sjellë ndonjë përfitim. Përkundrazi, partitë revizioniste në vendet kapitaliste jo vetëm janë larg që të marrin pushtetin me rrugë «parlamentare», por po humbasin edhe vendet që kishin në të kaluarën në parlamentet borgjeze; ato jo vetëm që s'mundën të konsolidonin dot aleancat e vjetra dhe të krijonin të reja me socialistët, me demokristianët, me socialdemokratët etj., por edhe ato që kishin, u shkatërruan; jo vetëm me anën e reformave «strukture» dhe nën hijen e kushtetutave borgjeze «nuk u martuan dot me çupën e priftit, por nuk i qasin as në fshat». Dhe, mbi të gjitha, ata shohin se po shtohet nga dita në ditë rezistenca kundërshtare brenda në partitë e tyre, se po krijohen jashtë partisë grupe marksiste-leniniste, të cilat po rriten e forcohen dhe do të shndërrohen në parti të reja marksiste-leniniste. Kjo është një perspektivë vdekjeje për ta, sepse ata shohin në një të ardhme jo të largët shkatërrimin e tyre.

Duke pasur parasysh këtë gjendje, kuptohet fare lehtë klithma e alarmit që u drejton Toliati revizionistëve të tjerë, dhe veçanërisht atyre sovjetikë, me Hrushovin në krye. Ai kërkon të ndryshohet taktika e luftës kundër «dogmatikëve» dhe, në të njëjtën kohë, kërkon shpejtimin e ritmeve për degjenerimin e vendeve socialiste dhe për afrimin e mëtejshëm me borgjezinë e imperializmin; Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste, sipas Toliatit, duhet të japin «shembullin e mirë» të likuidimit të plotë të «anomalisë staliniane» dhe të krijimit të një socializmi «demokratik» e «liberal» të tipit që predikojnë krerët e djathtë socialde-

mokratë, të cilin ata thonë bile se e kanë realizuar në disa vende kapitaliste evropiane!

Kështu, për hir të triumfit të «rrugës italiane drejt socializmit», për hir të aleancave të tyre me borgjezinë, socialdemokratët, demokristianët etj., Toliati dhe gjithë revizionistët italianë kërkojnë të sakrifikohen Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste, të likuidohen fitoret e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit dhe të revolucioneve popullore në vendet e tjera, të arritura me luftën dhe me gjakun e popujve. Ky është një komplot i madh antisovjetik e antisocialist, që tregon fytyrën e vërtetë tradhtare të revizionistëve toliatistë.

Por këto kërkesa të Toliatit kanë hasur e nuk mund të mos hasin në kundërshtimin e grupit të Hrushovit, i cili ndodhet tani në një situatë të vështirë. Ai është futur thellë në rrugën e tradhtisë dhe nuk do e nuk mund të kthehet më prapa, sepse një gjë e tillë do të ishte dështim e likuidim i plotë i tij. Por ai as nuk mund të ecë përpara me ritmet e shpejtuara që kërkon P. Toliati, sepse kjo do të shpejtonte gjithashtu demaskimin e plotë dhe shpartallimin e tij. Përballë kësaj gjendjeje të vështirë, grupi i Hrushovit kundërshton vijën e Toliatit dhe përpiket t'u imponojë toliatistëve vijën e tij, duke u mbështetur në forcën e «rublës», në fuqinë ushtarake dhe në autoritetin e BRSS e të PK të BS.

Të gjitha këto tregojnë se, me gjithë që ecin në të njëjtën rrugë të tradhtisë, midis revizionistëve nuk ka dhe nuk mund të ketë unitet, se divergjencat midis tyre nuk mund të zgjidhen, por do të shkojnë duke u thelluar gjithnjë më shumë, duke përçarë e duke copëtuar frontin revizionist.

Policentrizmi dhe monocentrizmi, dy tendenca antimarksiste në gjirin e revizionizmit modern

Çështja tjetër me rëndësi që ngre Toliati në «testamentin» e tij është e ashtuquajtura teori e policentrizmit, e cila i kundërvihet vijës monocentriste të Hrushovit e të grupit të tij.

Vija e grupit të Hrushovit është vija e grushtit rabi bankë jo vetëm ndaj partive marksiste-leniniste, por edhe ndaj revizionistëve të tjerë, vija e diktatit të ashpër për t'i detyruar të gjithë t'i binden pa kushte grupit të tij dhe të aprovojnë në gjunjë politikën e tij të shovinizmit të shtetit të madh dhe të «partisë mëmë». Kurse vija policentriste e Toliatit është shprehja tipike e një politike liberale, oportuniste, socialdemokrate, që do të heqë qafe çdo imponim nga grupi i Hrushovit, dhe jo vetëm për PK të Italisë, por edhe për të gjithë revizionistët e tjerë, si në botën kapitaliste ashtu edhe në vendet socialiste.

Për Toliatin «Moska» nuk është dhe nuk mund të jetë më në gjendje të drejtojë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Autoriteti i PK të BS, sipas Toliatit, duhet eliminuar, sepse kjo është një «anakronizëm», një «mbeturinë e rrezikshme e kultit stalinian». Grupi i Hrushovit duhet të heqë dorë nga drejtimi dhe dominimi i lëvizjes komuniste ndërkombëtare, duhet të heqë dorë nga monopoli për të mbajtur të lidhur pas PK të BS të gjitha partitë e tjera, të heqë dorë nga privilegji që vetëm ai të jetë i autorizuar të mbajë lidhje me partitë komuniste e punëtore të vogla, të bëjë me to

takime e mbledhje e t'u japë direktiva e këshilla. Bile nuk do t'u lërë PK të BS dhe qeverisë sovjetike as privilegjin që vetëm këto të kenë lidhje e të bëjnë politikë me elementët jokomunistë, nacionalistë, qeveritarë përparimtarë të vendeve të prapambetura. Toliati kërkon ekzistencën e disa qendrave drejtimi politik, ideologjik e veprimi, sidomos në botën kapitaliste. Dhe, konkretisht, sipas tij, këto qendra duhet të jenë PK e Italisë, PK e Francës dhe PK e Spanjës.

Këto dy vija u shprehën qartë sidomos në qëndrimet e ndryshme ndaj mbledhjes së partive komuniste e punëtoresh, të propozuar nga grupi i Hrushovit. Ky ka vendosur të thërresë sa më parë mbledhjen ndërkombëtare të partive jo vetëm që të dënojë e të përjashtojë PK të Kinës, PPSH dhe partitë e tjera marksiste-leniniste dhe të sanksionojë kështu përçarjen e plotë e të hapur në lëvizjen komuniste, por edhe që të vendosë hegjemoninë e tij, të diktojë ligjin dhe vijën e tij mbi partitë revizioniste, t'i nënshtrojë gjithë revizionistët ndaj diktatit të tij, t'u imponojë atyre «kartën» e vet. Kurse revizionistët italianë e kundërshtojnë mbledhjen e propozuar nga Hrushovi për qëllimet e mësipërme dhe bëjnë çmos që të pranohet teza e tyre policentriste, sepse ata nuk duan t'i nënshtrohen asnjë diktati, nuk duan t'i lidhin duart vetes me kurrfarë vendimesh të përbashkëta, por kanë tendencën të ecin pa asnjë «kartë të përbashkët», qoftë kjo edhe fund e krye revizioniste.

Në «testamentin» e tij Toliati i shpreh qartë këto ngurrime e tendenca. Ai thotë se «dyshime e rezerva rreth oportunitetit të konferencës ndërkombëtare qën-

drojnë... te ne», se «bile edhe mund të kemi frikë se mos pranimi i formulave të ngurta të përgjithshme është një pengesë», se «ne do të ishim, pra, kundër çdo propozimi për të krijuar përsëri një organizatë ndërkombëtare të centralizuar». Prandaj P. Toliati propozon që në vend të mbledhjes ndërkombëtare «të procedohej në një sërë takimesh me grupe partish... në sektorët e ndryshëm të lëvizjes sonë (Perëndimi evropian, vende të Amerikës Latine, vende të «botës së tretë» dhe kontaktet e tyre me lëvizjen komuniste të vendeve kapitaliste, vende të demokracisë popullore etj.)». Kjo, sipas Toliatit, do të ishte edhe një rrugë më e mirë për të luftuar kundër partive marksiste-leniniste. «Fundja, vazhdon Toliati, si të përcaktoheshin një herë e mirë detyrat dhe vija jonë politike sektor për sektor, do të mund edhe të hiqej dorë nga konferenca ndërkombëtare, nëse kjo do të shihej e domosdoshme për të evituar një përçarje formale», nga e cila toliatistët, siç e kemi treguar më lart, kanë frikë si djalli nga thimjami.

Por duke u shprehur kundër mbledhjes së përgjithshme, Toliati në «testament» thekson: «Mbetet e pa diskutueshme se ne do të marrim pjesë dhe pjesë aktive, në mbledhjen përgatitore». Ky qëndrim, në dukje kontradiktor, i revizionistëve toliatistë përputhet plotësisht me vijën dhe me qëllimet e tyre. Mbledhja përgatitore, paraprake nuk e lidh udhëheqjen e PK të Italisë me kurrfarë zotimesh e detyrimesh, ndërsa, nga ana tjetër, i jep asaj mundësinë të shtrojë atje platformën e vet të ndryshme nga ajo e grupit të Hrushovit, me shpresë se do të mundë të gjejë përkrahës, bile

edhe ta bindë grupin e Hrushovit për një sërë çështjesh.

Por një pozitë e tillë e P. Toliatit dhe e udhëheqjes së PK të Italisë për të marrë pjesë në mbledhjen përgatitore është gjithashtu në interesin e grupit të Hrushovit dhe u përgjigjet qëllimeve të tij. Siç komentonte edhe shtypi perëndimor, një pozitë e tillë «origjinale» krijon një precedent për ato parti komuniste e punëtore të cilat deri tani lëkunden të marrin ose të mos marrin pjesë në mbledhjen e 15 dhjetorit, «duke argumentuar» se mund të marrësh pjesë fare mirë edhe në një mbledhje me vetë misionin e së cilës nuk je dakord!

Duke u shprehur kundër mbledhjes përçarëse që kërkon të organizojë N. Hrushovi, revizionistët italianë nuk i preokupon aspak çështja e unitetit të lëvizjes komuniste e të kampit socialist. Përkundrazi, ashtu si grupi i Hrushovit, edhe ata janë për përçarjen, bile për copëtimin e plotë të lëvizjes komuniste. Me pikëpamjet e tyre fund e krye oportuniste e socialdemokrate, revizionistët italianë, kanë futur prej kohësh farën e përçarjes dhe po e thellojnë atë gjithnjë më shumë. Ata kanë bërë e vazhdojnë të bëjnë një luftë të ashpër kundër partive marksiste-leniniste dhe ngulin këmbë që kjo luftë të mos pushojë për asnjë moment. E ashtuquajtura «autonomi» që predikojnë toliatistët për vendet socialiste e partitë komuniste do të thotë, siç del nga shkrimet e P. Toliatit dhe dokumentet e ndryshme të udhëheqjes së PK të Italisë, që vendet socialiste dhe partitë komuniste të jenë «të pavarura» nga çdo parim marksist-leninist, nga çdo ligj i përgjithshëm, që ato të jenë «të lira» të kenë secila rrugën e

vet të veçantë, «specifike», të ndjekin «politika të ndryshme», të hyjnë në aleanca, të bashkëpunojnë me kë të duan e si të duan. Në kundërshtim të hapur me idenë e unitetit është edhe vija policentriste e revizionistëve italianë, vija e krijimit të qendrave të ndryshme drejtuese në lëvizjen komuniste, aq sa është edhe vija hrushoviane e «komandës unike».

Gjithë vija e revizionistëve italianë, të cilët kërkojnë të heqin qafe çdo zgjedhë nga grupi i Hrushovit jo vetëm për PK të Italisë, por edhe për gjithë revizionistët e tjerë, që kërkojnë ta copëtojnë lëvizjen komuniste në «zona influence» të veçuara, nga njëra anë, tregon mosbesimin e tyre ndaj grupit renegat të Hrushovit dhe frikën para rrezikut të shkatërrimit të plotë, ku po i çon ai, ndërsa, nga ana tjetër, ajo është një orvatje për ta evituar këtë katastrofë të përgjithshme, duke krijuar grupime partish revizioniste, të cilat, nëpërmjet aleancash të ndryshme e me maska të ndryshme, t'i shpëtojnë fytyrën e t'i zgjatin jetën revizionizmit modern. Taktikës «së trashë» të N. Hrushovit, e cila vë në rrezik ekzistencën e tërë revizionizmit modern, të lidhur pas qerres hrushoviane, toliatistët i kundërvënë taktikën «e hollë» të shumë qendrave revizioniste, në mënyrë që në qoftë se dështon njëra, të shpëtojnë të tjerat.

Pozita policentriste e revizionistëve italianë i intereson fort edhe imperializmit, i cili, megjithëse përkrah kursin revizionist të N. Hrushovit kundër marksizëm-leninizmit revolucionar, kërkon ta dobësojë akoma më

tepër këtë grup, duke ndihmuar me «kavalerinë e Shëngjergjit¹ e të dollarit» grupimet revizioniste që të shkojnë në më tej në garën për të fituar pavarësinë nga «rubla» dhe për të hyrë në vartësinë e «dollarit», për ta detyruar kështu udhëheqjen hrushoviane t'u bëjë imperialistëve lëshime e koncesione të reja në rrugën e degjenerimit të socializmit e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Është e natyrshme që grupi revizionist i Hrushovit, i cili qëndron kokë e këmbë në pozitat e shovinizmit të shtetit të madh dhe të paternalizmit në marrëdhëniet me partnerët e tij revizionistë, i cili e kupton fare mirë se toliatistët po përpiqen t'i vënë minat «sundimit absolut» të tij dhe të forcojnë pozitat e veta në kurriz të interesave të grupit hrushovian, e kundërshton me ashpërsi dhe e hedh poshtë vijën policentriste të P. Toliatit e të pasuesve të tij. Bile disa herë polemika midis tyre, me aluzione kur më të hapura e kur më të maskuara, e ka nxjerrë kokën edhe publikisht. Duke folur lidhur me çështjen e thirrjes së mbledhjes ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore, B. Ponomarjovi², në fjalën e mbajtur më 28 shtator në mbledhjen kushtuar 100-vjetorit të Internacionales së Parë, thumbon pozitën e toliatistëve e të përkrahësve të tyre dhe thekson se pavarësia e partive komuniste nuk do të thotë aspak se ato duhet të veprojnë sipas proverbit «çdo bretkosë këndon në pell-

1 Sterlina angleze.

2 Në atë kohë sekretar i KQ të PK të BS.

gun e vet». «Prirja për ta interpretuar pavarësinë e partive si largim nga zgjidhja e detyrave të përbashkëta internacionaliste, vazhdon B. Ponomarjovi, si njëfarë-lloj «asnjanësie» kur është puna për zgjidhjen e çështjeve të përbashkëta, nuk mund të konsiderohet kurrësi as shenjë pavarësie dhe as shenjë pjekurie»¹.

Faktet provojnë se sa më tepër afrohet koha e mbledhjes së propozuar nga grupi i Hrushovit, aq më tepër midis revizionistëve po shtohet nervozizmi e acarohen divergjencat, aq më tepër po dalin në pah dy vijat e kundërta në frontin revizionist. Por që të dyja ato janë vdekjeprurëse për vetë revizionizmin. Vija dogmatike revizioniste dhe diktatoriale e grupit të Hrushovit përmban në vetvete farën e përçarjes së frontit revizionist, sepse ngjall protestën e grupimeve të tjera revizioniste dhe rrit orvatjet e tyre për të shpëtuar nga diktati brutal i Hrushovit dhe i grupit të tij. Kjo vijë ka çuar e çon në izolimin e këtij grupi edhe nga vetë partnerët e tij revizionistë. Vija policentriste-revizioniste dhe liberale e Toliatit, që predikon shpartallimin e «komandës unike» të grupit të Hrushovit në luftën kundër marksizëm-leninizmit revolucionar, gjithashtu përmban farën e përçarjes së grupimeve revizioniste, pra edhe të disfatës e të shpartallimit të tyre të pashmangshëm.

1 Gazeta «Pravda», 29 shtator 1964.

Lufta e vendosur e parimore kundër të gjitha rrymave revizioniste, detyrë e shenjtë e komunistëve revolucionarë

«Testamenti» i P. Toliatit dhe shumë fakte të tjera dëshmojnë qartë se fronti i revizionistëve është çarë dhe kjo e çarë po thellohet e do të thellohet gjithnjë e më shumë në të ardhmen. Kontradiktat në gjirin e revizionistëve nuk janë diçka e jashtëzakonshme, por fenomene krejt të ligjshme, sepse revizionistët janë njerëz pa parime, sepse ata, qofshin hrushovianë, toliatistë, titistë apo të çdo marke tjetër, janë shërbëtorë të borgjezisë dhe teoritë e tyre janë variante të ideologjisë borgjeze, pra kanë brenda farën e kontradiktave, të nacionalizmit, separatizmit dhe të përçarjes. Unitet të vërtetë mendimi dhe veprimi mund të ketë vetëm mbi bazën e ideologjisë marksiste-leniniste dhe të internacionalizmit proletar, që revizionistët i kanë tradhtuar dhe i kanë braktisur. Si rrjedhim, midis revizionistëve modernë, në luftën e tyre të përgjithshme kundër marksizëm-leninizmit, të cilën gjithnjë do ta vazhdojnë me këmbëngulje, do të ketë forma, nuanca, aleanca të shtyra e të frymëzuara nga çfarëdo faktorësh të përgjithshëm, të përkohshëm e të rastit, të koordinuara e të shthurura, do të ketë kontradikta dhe taktika të ndryshme.

«Testamenti» i P. Toliatit nxjerr në pah se tani në kampin revizionist janë duke u kristalizuar të paktën dy vija të ndryshme taktike për luftën kundër mar-

ksizëm-leninizmit: vija monocentrisme e grupit të N. Hrushovit dhe vija policentrisme e P. Toliatit.

Këto divergjenca në mes hrushovianëve e shokëve të tyre dhe toliatistëve e shokëve të tyre janë të vjetra dhe dolën hapur menjëherë pas Kongresit të 20-të të PK të BS. Kongresin e 20-të e aprovuan njëzëri të gjithë revizionistët. Por ndërsa një pjesë e tyre e quajtën atë «të plotë» e «të mjaftueshëm» për atë kohë, toliatistët u treguan revizionistë «më radikalë» dhe donin e kërkuan që «analiza» të shkonte «më thellë». Revizionistët hrushovianë, për efekte propagande e demagogjike dhe nga frika e një përçarjeje të thellë e imediate në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, vepruan në mënyrë më të matur, u përpoqën t'i qetësonin, por pa arritur t'i bindnin, toliatistët, të cilët, pa e bërë këtë çështje një «konflikt», zhvilluan pikëpamjet e veta të djathta, natyrisht duke mbështetur e duke aprovuar njëkohësisht Kongresin e 20-të dhe më vonë edhe Kongresin e 22-të të PK të BŞ. Kjo «heshtje» relative e revizionistëve italianë, ose, si të thuash, ky inkuadrim i tyre në «euforinë» e përgjithshme të revizionistëve u shkaktua edhe nga qëllimi i tyre që të konsolidohehin më parë këto pozita revizioniste në radhët e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të gëlltitej një herë «pilula e helmit» dhe pastaj të bëheshin hapat e mëtejshëm, në teori e në praktikë, në rrugën e revizionizmit e të degjenerimit.

Mund të thuhet se metoda e fillimit të punës së tyre të tradhtisë nga ana e renegatëve hrushovianë ishte më e rezervuar, më e matur, më dinake, më demagogjike. Kurse ajo e toliatistëve, po për punën e

tyre të tradhtisë, ishte më pak e matur dhe më shumë aventureske. Grupi i Hrushovit, «për të qetësuar» To-liatin dhe shokët e tij, vuri «komunistët» francezë që t'u bënë, dhe në fakt u bënë, presion, bile disa herë «zjarri» i polemikës nxori veshët edhe publikisht.

Megjithëse grupi tradhtar i Hrushovit, që kishte milituar në klandestinitet në gjirin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ishte i ndërgjegjshëm se tradhtia e revizionistëve nuk do të mbetej për shumë kohë pa u diktuar, demaskuar e luftuar, prapëseprapë ai u tregua mjaft naiv. Revizionistët hrushovianë besonin, sidomos në fillim, se çdo gjë do t'u kalonte «si në gjalpë», pa hasur kundërshtime të mëdha, ata kishin besim të madh në demagogjinë e tyre, ata mendonin se prestigji i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik do t'ua maskonte tradhtinë e tyre, ata mbështeteshin në potencialin e madh ekonomik të Bashkimit Sovjetik, në vartësinë e të tjerëve nga kreditë ekonomike sovjetike dhe nga aleancat ushtarake. Udhëheqësit sovjetikë, me N. Hrushovin në krye, besonin gjithashtu se «partnerët» e tyre, imperialistët e ndryshëm, e në radhë të parë ata amerikanë, do t'u dilnin lehtë përpara «propozimeve paqësore» të tyre «për të rregulluar botën».

Por të gjitha këto synime e të tjera si këto, revizionistët modernë nuk mundën dot t'i realizonin ashtu siç dëshironin. Lufta parimore e PPSH, si dhe e gjithë marksistë-leninistëve të botës, e gjithë njerëzve përparimtarë, i pengoi ata seriozisht. Dhe pengesat po shtohen e çdo ditë do të shtohen gjithnjë më shumë.

Revizionistët modernë, me ata hrushovianë në krye,

janë futur thellë në rrugën e tradhtisë, ata do të vazhdojnë më tej. Por tanimë ata janë demaskuar në sy të të gjithë botës, në sy të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Lufta e partive tona marksiste-leniniste u bë një rrezik shumë i madh vdekjeprurës për ta. Prandaj tani ata duhet t'i bëjnë seriozisht llogaritë me luftën tonë që po rritet e po bëhet shumë kërcënuese për revizionistët. Lufta e madhe, e drejtë e parimore e partive marksiste-leniniste jo vetëm ua çori maskën e u prishi planet revizionistëve, por edhe u krijoi atyre vështirësi të pakapërcyeshme, ajo solli gjithashtu në acarimin e kontradiktave latente e në lindjen e kontradiktave të reja midis tyre.

Revizionistët hrushovianë dhe përkrahësit e tyre, duke parë se u dështuan të gjitha taktikat djallëzore, që nga gënjeshttrat, demagogjia, lajkat, kërcënimet e deri te bllokatat ekonomike, prerja e marrëdhënieve diplomatike e akuzat shpifarake si «nacionalistë», «përçarës», «renegatë», «agjentë të imperializmit» etj., nuk shohin më rrugë tjetër veçse të lidhen më ngushtë me imperializmin dhe të çojnë deri në fund përçarjen e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Në këto kushte grupi i Hrushovit kërkon të thërrisë në Moskë mbledhjen e të gjitha grupimeve revizioniste dhe atje t'u diktojë vullnetin e tij prej renegati përçarës e t'i inkuadrojë ato rishtas në vazhdimin e një lufte «më të organizuar» e me të gjitha mjetet kundër marksistë-leninistëve revolucionarë (deri te përdorimi i «armës së re shfarosëse», që N. Hrushovi përmendi në këto kohët e fundit kundër RP të Kinës dhe ven-

deve socialiste vëllezër). Kjo është lufta e dëshpëruar dhe e pashpresë e një klike tradhtare.

Akolitët e Hrushovit janë në dilemë të madhe. Ata nuk duan të eliminohen e të largohen shpejt nga skena, nuk duan të luajnë si në një lodër kumari, por duan ta zgjatin jetën e tyre dhe t'i shërbejnë më gjatë borgjezisë ndërkombëtare. Prandaj nxorën kokën divergjencat midis revizionistëve dhe, në këto momente të një krize të madhe e të pashmangshme për ta, këto kontradikta po acarohen në mënyrë të theksuar.

Kontradiktat e hrushovianëve me revizionistët policentristë italianë po paraqiten më të acaruarat. Këto dy tendenca po ballafaqohen dhe po hahen përpara projektit hrushovian për thirrjen e mbledhjes ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore. Rreth këtyre dy vijave kryesore taktike po grupohen revizionistët e vendeve të ndryshme. Në fakt, vija e Toliatit ka prishur qetësinë në pellgun revizionist, ku lëvrijnë bretkosat. Disa po e mbështetin hapur këtë vijë të Toliatit, disa e aprovojnë me zë të ulët se e kanë gurmazin të zënë me rubla, disa të tjerë i bëjnë kritika të pjesshme duke e përkrahur në drejtime të tjera. Nga ana e tyre, revizionistët italianë kanë lëshuar delegacione në shumë vende për të shpjeguar pozitën e vet, për të bërë sa më shumë aleatë të taktikës së tyre.

Është më se e qartë se, pavarësisht nga taktika që përdorin revizionistët e të gjitha ngjyrave, që nga N. Hrushovi te Toliati, Titoja e shokët e tyre, kanë një preokupacion e qëllim të përbashkët, të forcojnë luftën kundër marksizëm-leninizmit, kundër revolucionit dhe socializmit, të konsolidojnë pozitat e revizionizmit,

t'i zgjatin atij jetën. Ata përpiqen të shuajnë zjarrin e luftës së marksistë-leninistëve kundër tyre, të arrijnë ndalimin e polemikës së madhe parimore që zhvillohet sot, të pengojnë krijimin e grupeve dhe të partive të vërteta revolucionare. Në këtë luftë dhe për këto qëllime ata janë të bashkuar, veprojnë në një front. Divergjencat midis tyre nuk janë për çështje strategjike, po për çështje taktike, si ta bëjnë më efektive luftën kundër marksizëm-leninizmit dhe si të arrijnë më lehtë qëllimet e tyre.

Marksistë-leninistët dhe gjithë revolucionarët, duke mos pasur asnjë iluzion rreth manovrave taktike të revizionistëve, e konsiderojnë si detyrën e tyre të shenjtë luftën e vendosur dhe konsekuente kundër të gjitha rrymave të revizionizmit modern, luftën për demaskimin e qëllimeve dhe të planeve të tyre kundër-revolucionare. Në këtë luftë udhëheqin mësimet e marksizëm-leninizmit, që përbëjnë busullën dhe armën e sprovuar për çdo revolucionar të vërtetë.

Duke mbjellë gjithfarëlloj iluzionesh mbi mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duke marrë bile edhe pozën e armiqve të imperializmit e të kundërshtarëve të N. Hrushovit, pozën e luftëtarëve për unitet, revizionistët modernë kanë për qëllim të mashtrjnë komunistët, të fshehin fytyrën dhe qëllimet e tyre të vërteta. Por këto manovra mashtruese nuk do të kenë sukses.

Luftëtarë të vërtetë kundër revizionizmit hrushovian, për unitetin e vërtetë marksist-leninist, mund të jenë dhe janë vetëm partitë komuniste dhe gjithë revolucionarët që qëndrojnë me vendosmëri në pozitën e

ideologjisë së klasës punëtore. Revizionizmi nuk mund të luftohet nga pozita revizioniste, ashtu si dhe uniteti i vërtetë nuk mund të vendoset mbi baza revizioniste.

Në këtë luftë marksistë-leninistët dhe revolucionarët kanë edhe aleatë, me të cilët i bashkojnë disa çështje. Por, duke bashkëpunuar me ta në luftë, marksistë-leninistët nuk lëshojnë në parimet, nuk e fshehin vijën e tyre revolucionare, ata e kanë për detyrë dhe ua bëjnë të qarta këtë vijë e këto parime të gjithëve.

Ndryshe qëndron puna me ata, si toliatistët dhe shokët e tyre, që, megjithëse kanë kontradikta me Hrushovin e shokët e tij, prapë mbeten revizionistë konsekuentë dhe qëllimi kryesor i tyre është lufta kundër marksizëm-leninizmit. Të gjithë këta revizionistë, pavarësisht nga kontradiktat që kanë midis tyre, janë armiq të revolucionit e të komunizmit. Kontradiktat midis revizionistëve, pa dyshim, janë në favorin tonë dhe duhen shfrytëzuar, sepse dobësojnë frontin revizionist. Lufta parimore, konsekuente dhe e vazhdueshme kundër revizionizmit modern do t'i thellojë e do t'i acarojë gjithnjë e më shumë këto kontradikta, por marksistë-leninistët nuk kanë asnjë iluzion për revizionistët, nuk gënjehen nga demagogjia e tyre dhe nuk bien në grackat që përpiqen të ngrenë ata.

Revizionizmi modern është armiku kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Grupi i Hrushovit është koka e revizionizmit modern, është reparti më i fuqishëm i tij. Prej këtij grupi, që ka shtënë në dorë udhëheqjen e partisë së themeluar nga Lenini dhe të shtetit të parë socialist në botë, Bashkimit Sovjetik, vjen sot rreziku më i madh e më serioz. Prandaj

lufta kundër këtij grupi, për demaskimin dhe për shpartallimin e tij, është detyra themelore e të gjitha partive marksiste-leniniste dhe e komunistëve revolucionarë të botës.

Krahas grupit të Hrushovit, një rrezik të madh përbejnë edhe grupet e tjera revizioniste dhe sidomos toliatistët e titistët. Titizmi është një pjesë e rëndësishme e revizionizmit modern në pushtet, që ka prapa një fuqi të madhe imperialiste, që e drejton dhe ndihmon, imperializmin amerikan. Zëri i titistëve është zëri i imperializmit amerikan, që këndon me gojën e titizmit në gjirin e komunizmit ndërkombëtar. Nëpërmjet veprimeve të drejtpërdrejta të agjunkturës së tij të blerë me dollarë, titizmit, imperializmi amerikan përpiqet të sabotojë e të minojë kampin e socializmit, të degjenerojë gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. N. Hrushovi rehabilitoi klikën e Titos, e fuqizoi dhe, padashur plotësisht, e bëri një partner ideologjik e politik të fuqishëm që po i shkakton kokëçarje, sepse tani jo vetëm hrushovianët, por edhe titistët diktojnë ligjet në gjirin e revizionistëve. Klika e Titos përpiqet t'i nxitë e t'i thellojë kontradiktat që kanë lindur në gjirin e revizionistëve dhe të dobësojë sundimin e grupit hrushovian mbi partnerët e tij, me qëllim që të çojë ujë në mullirin e vijës së vet egocentriste. Klika titiste përpiqet gjithashtu që kontradiktat midis grupit të Hrushovit, nga njëra anë, dhe grupeve të tjera revizioniste, nga ana tjetër, të mos i shtyjnë këta të fundit të rikthehen në pozitë e marksizëm-leninizmit, por të pakënaqurit të qajnë në gjirin e titizmit. Titoja i nxit revizionistët në gjirin e KNER-it

që të fitojnë sa më tepër pavarësi ekonomike nga grupi i Hrushovit. Dhe duke qenë se vetë nuk është në gjendje t'u japë «ndihma» e kredi, i nxit të drejtohen për «ndihma» në Perëndim, të afrohen e të lidhen me imperializmin dhe, në shembullin e Jugosllavisë, «të ndërtojnë socializmin» me ndihmën e dollarëve amerikanë!

Për marksistë-leninistët nuk mund të ketë asnjë dyshim së «lufta» e titistëve, ashtu si dhe «lufta» e toliatistëve kundër Hrushovit, është luftë midis tradhtarëve për dominim, për drejtim, është luftë e grupeve të ndryshme revizioniste kundër popujve të Bashkimit Sovjetik, kundër marksistë-leninistëve dhe gjithë revolucionarëve, të cilëve ata ua kanë frikën.

Revizionistët e grupeve të ndryshme janë pjesë përbërëse dhe përfaqësuese të një rryme të vetme regresive, të revizionizmit modern. Ata, qofshin të mëdhenj apo të vegjël, të fuqishëm apo të dobët, të maskuar apo të demaskuar, që veprojnë në pararojë apo në praparojë, të gjithë luftojnë kundër marksizëm-leninizmit, kush hapur e me të gjitha bateritë, kush duke hedhur gurin e duke fshehur dorën, në përshtatje me situatat e rrethanat. Këta herë veprojnë të veçuar, herë paraqiten si të bashkuar me tutkall, herë çahen për t'u rigrupuar në fraksione, që i lidhin interesat e luftës kundër socializmit ose kontradiktat midis tyre.

«Testamenti» i P. Toliatit tregon qartë se revizionistët modernë janë të vendosur ta vazhdojnë deri në fund luftën kundër marksizëm-leninizmit dhe gjithë forcave revolucionare të botës. Ata nuk kanë rrugëdalje tjetër. Lufta konsekuente e parimore e marksistë-

-leninistëve ua ka zbuluar fytyrën revizionistëve, ata tani nuk mund të veprojnë më nën rrogë, ata janë të detyruar të dalin hapur në mbrojtje të pozitive të tyre revizioniste dhe të luftojnë aktivisht kundër marksistë-leninistëve. Kjo është një fitore e madhe e arritur, fitore që duhet thelluar më tej me anën e forcimit të vazhdueshëm të luftës sonë kundër revizionizmit modern, nën çfarëdo forme e maske që të paraqitet ai.

Si rezultat i luftës së partive marksiste-leniniste e të komunistëve revolucionarë në vendet e ndryshme dhe si pasojë e orvatjeve të udhëheqësve revizionistë për të ruajtur me çdo kusht pozitën e tyre, duke përjashtuar nga radhët e partive komuniste e shëndoshë, u zhvillua procesi i diferencimit në lëvizjen komuniste, u krijuan parti të reja e grupe revolucionare marksiste-leniniste. Ky proces vazhdon e do të vazhdojë në mënyrë të pandalshme. Kjo është një fitore tjetër e madhe që është arritur, e cila duhet thelluar më tej, duke mbrojtur, ndihmuar, mbështetur e përkrahur pa rezerva këto forca të reja revolucionare në luftën e tyre kundër revizionizmit, kundër të gjitha manovrave e taktikave djallëzore të revizionistëve për të mbytur e për të paralizuar rrymën revolucionare në lëvizjen komuniste.

Lufta e vendosur e marksistë-leninistëve, demaskimi i revizionistëve modernë, disfatat që ata kanë pësuar e pësojnë çdo ditë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre kombëtare e ndërkombëtare, kanë bërë që në gjirin e revizionizmit modern të shpërthejnë e të thellohen kontradikta të ashpra. Edhe kjo është një fitore tjetër

e madhe e marksizëm-leninizmit revolucionar në veprim, e cila duhet çuar përpara, duke i thelluar më tej kontradiktat në kampin revizionist. Për këtë është e domosdoshme gjithashtu të forcohet gjithnjë më shumë lufta e vendosur e gjithë marksistë-leninistëve kundër të gjitha rrymave të revizionizmit modern.

Këto fitore historike të marksizëm-leninizmit do të shkojnë duke u shtuar e duke u thelluar dita-ditës. Kusht vendimtar dhe garanci për këtë është lufta parimore e pa kompromis e të gjitha partive e forcave marksiste-leniniste kundër qëllimeve e veprimeve tradhtarë të revizionistëve modernë, për shpartallimin e plotë e përfundimtar të tyre. Fitorja e pashmangshme në këtë luftë i përket marksizëm-leninizmit.

Botuar për herë të parë si artikull redaksional në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 272 (5054), 13 nëntor 1964

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 53. Tiranë, 1965

NË KËTO SITUATA TË PËRPIQEMI PËR TË SHTUAR REZERVAT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

13 nëntor 1964

Ne i dimë vështirësitë që kemi për realizimin e planit pesëvjeçar, por të jemi realistë se përveç shkaqeve objektive, pengesat e jashtme, koha e keqe etj., ka edhe vështirësi të brendshme, që vijnë nga dobësitë tona. Ne po shohim se ka raste që ministritë i pranojnë me zor këto dobësi, bëjnë edhe kërkesa të tepërta importi. Në këto situata të përpigemi që të shtojmë rezervat dhe të mos kemi deficite.

I vetmi vend ku ne mund të krehim është importimi i mallrave që kanë të bëjnë me industrinë, si makineria, lënda e parë, pjesët e këmbimit, duke shfrytëzuar sa më mirë këto mjete që kemi. Duhet të shi-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi projektplanin dhe projektbuxhetin e vitit 1965 për zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit.

kojmë thellë pse ndodh që ndonjëherë nuk eksportojmë aq bitum sa parashikohet, ose shpesh në fillim caktojmë se sa krom do të prodhojmë, por kur vjen fundi i vitit na thuhet se «sasia e parashikuar nuk u realizua», se «ky apo ai sektor nuk e realizuan planin, prandaj edhe deficitin në eksport nga viti në vit është i madh». Kështu nuk ecet.

Me eksperiencën që ka fituar Komisioni i Planit të Shtetit mund të thotë se si do të dalim nga kjo situatë. Ritmet e zhvillimit të ekonomisë sonë, veçanërisht për eksportin kanë një limit dhe nuk mund të shkojnë më tutje. Prandaj në qoftë se kërkesat e importit, sidomos në disa drejtime, vijnë duke u shtuar, në qoftë se ato i kapërcejnë mundësitë tona në devizë, si do t'ia dalim? Ku po shkojmë kështu? Duhet të kemi parasysh pastaj se çdo vit na shtohen edhe ratat që duhet të paguajmë sipas rregullit.

Nuk do të flas për kreditë, se këto janë të caktuara, po e kam fjalën për kleringun tonë ku po dalim deficit. Atëherë çfarë duhet të bëjmë për të dalë nga kjo gjendje? Industria dhe bujqësia jonë vazhdimisht duhet të prodhojnë, bile edhe mbi planin, po për të arritur këtë, domethënë që brenda një kohe të shkurtër të përmirësojmë bilancin tonë valutor, është e nevojshme të marrim edhe disa masa. Po të bëjmë shtrëngime, për shembull, në planin e vitit 1965, ne mund të shkurtojmë një shumë prej rreth një milion rublash, më shumë nuk mund të shkurtojmë dot, prandaj çështja është për të ardhmen.

Në fakt, tani punët tona shkojnë mirë, po sikur të na vështirësohen, si do të bëjmë? Ne duhet të men-

dojmë seriozisht për këtë problem. Për shembull, për të shtuar eksportimin e llullave mund të sjellim edhe një sasi mekanizmash, me qëllim që ta katërfishojmë prodhimin e tyre. Punëtorët e llullave mund të përqendrohen në ato drejtime, ku kërkohet për të shtuar fuqinë punëtore, si për shembull, në ndërtim ose në punët e tjera sezonale. Atyre që shkurtohen mund t'u bëhet thirrje që të shkojnë për të punuar atje ku ka nevojë, në këtë mënyrë nuk tërhiqen punëtorë nga fshati. Në gjithë këtë kompleks problemesh ka të tilla që duhen studiuar.

Jam i mendimit që shokët e Komisionit të Planit të Shtetit ta studiojnë thellë çështjen se si do të vejë puna që kleringu ynë, domethënë import-eksporti, të mos dalë deficit, çfarë duhet të bëjmë që të kemi në dorë një rezervë në klering, dua të them një rezervë rublash për përbalimin e situatave të vështira? Me sa di unë, po të marrim masë që të prodhojmë më shumë bukë, po të mos importojmë kaq shumë sheqer, yndyrna etj. si tani, do të na mbetet një sasi kleringu rezervë. Po kjo do studiuar.

Lidhur me këtë doja të shtoja diçka për dikasteret. Ne duhet të tregohemi më të shtrënguar në çështjen e kleringut. Njerëzit tanë të tregtisë duhet të mësojnë si të bëjnë tregti. Duke vepruar kështu ne do të kemi përfitime. Tani naftën apo bitumin nuk mund ta eksportojmë ku të duam, se nuk na i merr tjetri me çmimet që ofrojmë, po edhe ne nuk duhet të pranojmë që mallrat tona t'i blejnë të tjerët me çmimet që duan ata. Por, kur ne ta kemi të mirë bitumin, ikim nga një vend dhe vemi e shesim gjetkë. Pra, çështja e ekzi-

gjencave në tregti duhet të jetë reciproke. Kjo ka të bëjë edhe me zhvillimin e aftësive profesionale në fuqshën e tregtisë së jashtme, ku duhet të përmirësojmë shumë punën tonë, ndryshe nuk mund të ecet përpara.

Dëshiroj të them diçka edhe për specialistët. Është e vërtetë që tani kemi ekonomistë dhe specialistë të ndryshëm. Mirë u tha këtu që Partia duhet të bëjë një punë të madhe në këtë drejtim. Puna e Partisë nuk është thjesht t'u thotë: o burra të punojmë dhe të prodhojmë! Çështjen ta kuptojmë që si t'i drejtojmë specialistët tanë për një punë sa më të frytshme. Këtu Komisioni i Planit të Shtetit luan një rol shumë të rëndësishëm, por një rol të tillë luajnë gjithashtu edhe nëpunësit e planifikimit në çdo ministri. Ata mund të jenë specialistë për planifikimin, ata janë ekonomistë, po do parë se mos te këta shokë është krijuar një pikëpamje rutine e burokratike dhe, hartimin e planit e bazojnë vetëm në realizimin e vitit të kaluar, duke dalë kështu me një plan pak a shumë shabllon, të cilin ua paraqesin ministrit dhe Komisionit të Planit të Shtetit. Këta njerëz, edhe pse janë specialistë në ekonomi, më duket se nuk i kanë të qarta si duhet nocionet e mëdha që diskutojmë mbi importin dhe eksportin. Agromi ynë për pambukun ose duhanin duhet të mendojë në radhë të parë që të prodhojë pambuk ose duhan të cilësisë së parë dhe të bëjë përpjekje jo vetëm të realizojë sasinë e parashikuar brenda vendit, po kjo sasi, po të jetë e mundur, të jetë e tëra e cilësisë së lartë si për brenda vendit ashtu dhe për eksport. Prandaj Partia dhe Qeveria duhet të rritin te këta specialistë kujdesin që të mendojnë për eksportin. Ne t'u

themi specialistëve që prodhimin e duam të cilësisë së parë, pastaj si do ta përdorim, për eksport ose për brenda vendit, kjo është çështje tjetër.

Kështu duhet vepruar edhe në industri. Ky kujdes te ekonomistët dhe te specialistët e tjerë më duket se nuk është në atë lartësi që kërkon koha. Ne duhet t'i edukojmë ata me këtë kujdes dhe kjo është një punë partie me rëndësi.

Po nuk është kjo e tëra. Qeveria dhe Komisioni i Planit të Shtetit kanë tani një eksperiencë 20-vjeçare. Kështu, për shembull, Komisioni i Planit të Shtetit mund të arrijë në konkluzion që, këtë vit, me këtë kualifikim të kuadrit, me këtë shfrytëzim racional të makinerive tona, sa duhet të prodhojmë e sa të importojmë dhe asgjë më shumë. Për këtë të reflektohet nga të gjithë dhe jo të thuhet më duhet kaq ose më duhet aq. Secili të mendojë thellë që mua Qeveria më jep këtë kuotë importi, prandaj zotësia ime si drejtues është që të rregullohem me kaq dhe jo t'i bëhen Qeverisë kërkesa për shtesa pas shtesash. Kjo nuk është e drejtë, prandaj specialistët tanë të ekonomisë t'i edukojmë me këto ndjenja mbi problemet që na preokupojnë.

Vërejtjet e Qeverisë dhe të Komisionit të Planit të Shtetit, ministrat dhe shokët e Partisë e të pushtetit në rrethe të mos i konsiderojnë si të dhëna të dërguara kot, pa përgjegjësi dhe në erë. Ka një arsye që Qeveria jep një kuotë të caktuar, prandaj shokët kanë për detyrë ta ulin atë dhe jo ta ngrenë. Ngritja e kuotave është një shfaqje, të cilën ne duhet ta luftojmë dhe njerëzit e bazës t'i edukojmë me një frymë të shëndoshë

partie, që ata t'i kuptojnë drejt kuotat që dërgon Qeveria, bile të luftojnë që ato t'i ulin, në mënyrë që Qeverisë t'i krijohen mundësi për rezerva. Po të vijnë ministritë dhe rrethet me kuota më të larta, atëherë edhe Qeveria do të detyrohet të përgatitë një plan me deficite. Në këtë drejtim ne duhet të jemi kurdoherë të shtrënguar, bile edhe sikur të notojmë në bollëk.

Atëherë, të gjithë jemi dakord që të pranojmë planin që na është paraqitur me vërejtjet që u bënë, si dhe me detyrat që u shtruan, të cilat të na sillen të studiuara brenda tremujorit të parë të vitit të ardhshëm, natyrisht pasi të bashkëpunohet ngushtësisht me organet e bazës.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

FORCA E POPUJVE TË VEGJËL QËNDRON NË UNITETIN E TYRE LUFTARAK PËR LIRI, PAVARËSI DHE PËRPARIM SHOQËROR

*Nga biseda në takim in me zonjën Shirlei Graham
Dy Bua, drejtore e televizionit të Republikës
së Ganës*

27 nëntor 1964

Pasi shkëmbyen përshëndetjet e rastit, zonja Shirlei Graham Dy Bua i drejtohet shokut Enver Hoxha duke i thënë, midis të tjerash, se kishte ardhur në Shqipëri për të marrë pjesë në festën e 20-vjetorit të Çlirimit si dhe «për të parë sukseset që ka arritur Shqipëria, me qëllim që të çoj në Ganë eksperiencën e ndërtimit të Shqipërisë së re, eksperiencë që përbën një shembull për ne». Pastaj e merr fjalën shoku Enver Hoxha:

Jam i gëzuar që më jepet rasti të flas drejtpërsëdrejti me ju, bashkëshorten e të nderuarit shokut Dy Bua¹. Ai ishte një shok i vyer për ne, për komunistët,

¹ Poet zezak amerikan, luftëtar i njohur për mbrojtjen e të drejtave të zezakëve; vitet e fundit të jetës i kaloi në Ganë, ku mori edhe nënshtetësinë.

për popujt e shtypur. Njerëzit si shoku Dy Bua do të rrojnë kurdoherë në zemrat e popujve. Popujt nuk mund ta harrojnë atë që ka luftuar për lirinë e tyre, nuk mund të harrojnë veprimtarinë e madhe të shokut Dy Bua, deklaratat e tij, me të cilat i dha një mbështetje të fuqishme lëvizjes përparimtare në botë, nuk mund të harrohet mbrojtja e vazhdueshme që ai i ka bërë çështjes së zezakëve për të drejtat e tyre, për punë dhe për bukë. Prandaj ne jemi shumë të gëzuar sot që kemi rastin të takohemi me bashkëshorten e nderuar dhe bashkëpunëtoren e Dy Buasë, njëkohësisht edhe mikeshë e popullit shqiptar.

Ne, zonja Dy Bua, na prekën shumë fjalët tuaja të ngrohta në adresë të popullit shqiptar.

Ne, shqiptarët jemi një popull i vogël. Gjithë jetën populli ynë është përpjekur të ketë kurdoherë miq në botë. Megjithëse i vogël, ai nuk është përlulur kurrë përpara armiqve, asnjëherë nuk e ka duruar robërinë, por gjatë të gjitha kohërave ka luftuar kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm që donin ta robëronin. Nga gjithë këto luftëra e përpjekje shekullore kurrsesi nuk mund të përjashtohet kontributi i madh i gruas.

Gruaja, siç e dini edhe ju, ka luajtur, luan dhe do të luajë një rol të madh në jetën e njerëzimit, për ndërtimin e jetës së lumtur e për përparimin e tij. Përpara, për fat të keq, gjendja për gruan nuk ishte si sot. Atëherë në vendin tonë gruaja rronte në errësi, në injorancë dhe vuante nga një shtypje e dyfishtë, megjithëse ishte dhe është po aq e zgjuar, sa dhe burrat. Dhe kush vuante në këtë mënyrë? Ajo që lind jetën, ajo që mban gjallë frymën e patriotizmit në familje,

ajo që punon me aq ndërgjegje e, do të thosha, ndoshta, më shumë se burrat. Ne, shqiptarët, jemi kryelartë për gratë e vendit tonë, se ato jo vetëm gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, por, kurdoherë, gjatë gjithë luftërave shekullore të popullit shqiptar, kanë qenë luftëtare të papërkulura. Sot, në ndërtimin e socializmit, gruaja te ne është gjithashtu një faktor vendimtar. Prandaj jemi gjithashtu të lumtur që gratë, nënat dhe motrat tona sot, në socializëm, kanë fituar të gjitha të drejtat, kanë fituar lirinë e plotë.

Tani që vendi ynë ka dalë në dritë, në socializëm, populli shqiptar e ndien më shumë se kushdo tjetër vlerën e miqësisë, të një miqësie të sinqertë me të gjithë popujt. Ne kemi simpati, për të gjithë popujt, veçanërisht për popujt e Afrikës, që kanë pasur të njëjtin fat si dhe populli ynë.

Prandaj gëzohemi shumë për sukseset që ka arritur dhe po arrin populli i Ganës. Ambasadori ynë në Ganë na vë vazhdimisht në dijeni mbi përparimet e vendit tuaj, për miqësinë e ngrohtësinë që ka gjetur dhe gjen atje.

Pasi mysafirja ganeze foli për përshtypjet e saj entuziaste nga vizitat në vendin tonë dhe i njohu të pranishmit me përpjekjet dhe me synimet e popullit ganez për konsolidimin e pavarësisë së vendit dhe për përparim shoqëror, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ju kuptoj shumë mirë, zonja Dy Bua dhe i përshëndes pikëpamjet tuaja të drejta.

E para, ka rëndësi të madhe çështja që ju thoni se rruga më e mirë për lumturinë e popullit është ajo e socializmit.

E dyta, ka rëndësi gjithashtu që, kur flisni për socializmin, keni parasysh ato ide të pavdekshme që i udhëheqin popujt në rrugën për në socializëm, domethënë marksizëm-leninizmin.

Populli ganez përpiket që të çlirohet plotësisht nga zgjedha e imperializmit, të forcojë lirinë dhe pavarësinë e vendit, gjë që ka një rëndësi të madhe. Ai ka parë dhe sheh në jetë se si ndaj aspiratave të tij për liri, pavarësi e përparim shoqëror po bëhen njëri pas tjetrit atentate e komplete nga ana e imperialistëve dhe agjentëve të tyre dhe kjo për arsye se ai shkon në kundërshtim të hapët me dëshirat e imperialistëve dhe të kolonialistëve.

Është shumë e drejtë ajo që thoni ju se kushtet e përgjithshme të Evropës ndryshojnë shumë nga ato të Afrikës. Por, natyrisht, dihet që ndryshimet cilësore kërkojnë një punë relativisht të gjatë, kërkojnë zotërim të thellë të marksizëm-leninizmit dhe zbatim krijues të tij në bazë të kushteve konkrete.

Unë dëshiroj t'ju them se kushtet shoqërore të vendit tonë, kur filluam Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ishin pak a shumë të ngjashme me ato që thatë ju për Ganën. Qëllimet e drejta të Partisë sonë prekën ndjenjat e vërteta të popullit shqiptar, prandaj ai e ndoqi Partinë tonë gjatë gjithë luftës për çlirim, e ndjek edhe tani për ndërtimin e socializmit. Në ato kushte, kur edhe ne, ashtu sikurse tani ju, nuk kishim një klasë punëtore të zhvilluar, por kryesisht një fshatarësi të shtypur, por heroike, kur edhe ne ishim një gjysmëkoloni, kur borgjezia porsa kishte filluar të merrte konturet e saj, Partia jonë, me programin e saj të

gartë, e çoi punën përpara, çliroi Shqipërinë dhe e futi atë në rrugën e socializmit. Edhe te ju janë mundësitë dhe kushtet që t'i arrihet qëllimit, sepse idetë e mëdha të socializmit po shtrihen në të gjitha kontinentet, në të gjithë popujt. Forca e marksizëm-leninizmit është e pakufishme, kolonializmi po shembet nga themelet, imperializmi sot është në një krizë të madhe, prandaj kushtet janë të favorshme që socializmi të fitojë. Socializmi kudo do të arrijë suksese, se atë e duan popujt, të cilët ëndërrojnë për të, sepse ai është i lidhur me ndjenjat e tyre. Mbretërit, feudalët, kapitalistët, vijnë dhe shkojnë, por popujt qëndrojnë, jetojnë në shekuj dhe fitojnë, ndërsa armiqtë e tyre do të zhduken një ditë. Natyrisht kjo do të arrihet me përpjekje të gjithanshme, me luftë, se imperialistët nuk i lëshojnë kurrrë armët me dëshirë.

Uniteti i popujve në luftën e tyre për liri, pavarësi e përparim shoqëror është i domosdoshëm dhe, po ta shikojmë këtë çështje nga ana marksiste, ky unitet është një nga armët kryesore të internacionalizmit proletar. Vendet që ndërtojnë socializmin duhet t'i ndihmojnë me të gjitha forcat popujt e robëruar që luftojnë për pavarësinë kombëtare, si edhe popujt e tjerë që aspirojnë të ecin në rrugën e socializmit. Kjo ndihmë duhet kuptuar drejt, në bazë të marksizëm-leninizmit.

Ju jeni në dijeni të luftës së Partisë së Punës të Shqipërisë kundër revizionizmit hrushovian. Partia jonë e ka luftuar vazhdimisht dhe gjer në fund Hrushovin bashkë me idetë e tij, sepse ai ishte njeri i blofeve, një antimarksist i regjur, i pandreqshëm. Ndihma që jepte Hrushovi nuk ka qenë ashtu siç e kupton marksiz-

mi, një ndihmë pa asnjë interes jo vetëm material, por edhe politik. Përkundrazi, ndihma e Hrushovit dhe e shokëve të tij, ka pasur karakterin e një politike nënshtrimi dhe imponimi, të një politike shoviniste të shtetit të madh ndaj popujve të vegjël. Pikëpamjet që kanë revizionistët mbi popujt e vegjël nuk kanë ndonjë ndryshim nga ato të kapitalistëve dhe të imperialistëve. Këtë e themi me bindje, sepse e kemi pësuar në kurrrizin tonë.

Ne luftojmë dhe do të luftojmë që popujve të Afrikës e atyre të kontinenteve të tjera t'u jepet një ndihmë e sigurtë, marksiste-leniniste, pa interes, pa intriga. Kështu kuptohet miqësia e vërtetë. Partia jonë është e vogël, ajo lufton dhe do të luftojë me guxim në këtë drejtim dhe në këtë rrugë ajo nuk është e vetme. Bashkë me të luftojnë shumë parti të tjera, luftojnë popujt e botës e, ndër ta, edhe popujt e Afrikës.

Çështja e shtetit të madh dhe e shtetit të vogël, e popujve të mëdhenj dhe e popujve të vegjël, në kuptimin e nënshtrimit të të vegjëlve prej të mëdhenjve, është një sëmundje shumë e keqe, një mbeturinë e kohërave të kaluara, një trashëgim i botëkuptimit kapitalist, imperialist. Marksistë-leninistët bëjnë dhe duhet të bëjnë një luftë të pamëshirshme kundër kësaj pikëpamjeje. Njerëzit si Hrushovi dhe shokët e tij në sy të buzëqeshin, po në vetvete, në brendi, në ndërjegjen e tyre, ata e kanë shumë të zhvilluar këtë pikëpamje. Mirëpo në kohën e tanishme edhe popujt e vegjël janë zgjuar. Ne e kuptojmë mirë rëndësinë e popujve të mëdhenj, kuptojmë gjithashtu edhe rolin e shteteve

të mëdha. Por ai që është marksist duhet të kuptojë mirë dhe drejt edhe vlerat e rëndësishme të popujve të tjerë, sado të vegjël që të jenë ata. Kush nuk e kupton këtë çështje në rrugën marksiste, kush nuk e kupton drejt çështjen e popullit të madh apo të popullit të vogël, ai nuk është dhe nuk mund të jetë marksist, por një njeri që ka mbeturina të vjetra të botëkuptimit kapitalist në ndërgjegjen e tij.

Hrushovi dhe shokët e tij mburren dhe e heqin veten marksistë-leninistë. Por ishte Hrushovi ai që aprovoi ndërhyrjen e OKB-së në Kongo më 1960, gjë që u dha mundësi agjentëve të imperialistëve amerikanë dhe reaksionarëve të tjerë kongolezë të vrisnin Lumumbën¹. Edhe tani revizionistët hrushovianë përsëri vazhdojnë të bëjnë lëshime të tjera ndaj imperializmit dhe reaksionit. Pra jeta, praktika dhe lufta i sqarojnë çështjet, i dallojnë njerëzit se kush prej tyre është me popujt dhe kush është kundër popujve. Hrushovi me shokë, sado që hiqen si marksistë, janë kundër popujve. Të tilla janë faktet.

Ne, shqiptarët, na sulmojnë se themi të vërtetën. Është e vërtetë që jemi të vegjël, po frikë nuk kemi nga sulmet e armiqve, se e dimë që sot fjalët e drejta të një populli, sado i vogël të jetë, dëgjohen me simpati dhe dashuri kudo nga njerëzit e ndershëm dhe nga gjithë popujt e botës. Forca e popujve të vegjël qëndron në unitetin shpirtëror luftarak me të gjithë popujt që luftojnë për të drejtën dhe jo për intriga,

¹ Hero i Lëvizjes Nacionalçlirimtare Kongoleze, kryetar i qeverisë së parë të Kongos së pavarur, u vra më 1961.

qëndron në vendosmërinë për ta çuar gjer në fund luftën për realizimin e aspiratave të tyre kundër synimeve të imperialistëve dhe të revizionistëve.

Në fund shoku Enver Hoxha ngriti një doli duke thënë:

Le ta ngremë këtë gotë për miqësinë në mes të dy popujve tanë, të Ganës dhe të Shqipërisë, për shëndetin tuaj, zonja Dy Bua, që ne ju konsiderojmë mikeshë të nderuar të popullit tonë; për shëndetin e të nderuarit president Nkvame Nkruma¹, mik i popullit shqiptar! Unë ju lutem t'i transmetoni atij përshëndetjet e mia të përzemërta si dhe keqardhjen time që nuk u takova dot kur ai vizitoi Shqipërinë, mbasi nuk ndodhesha këtu.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

¹ Grushti i shtetit i kryer në vitin 1966 në Ganë përmbysl qeverinë e N. Nkrumës.

20 VJET SHQIPËRI SOCIALISTE

*Fjala në mbledhjen solemne kushtuar
20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut*

28 Nëntor 1964

Të dashur shokë dhe shoqe, motra e vëllezër,

Të nderuar miq,

Sot mbarë populli ynë në të katër anët e vendit dhe të gjithë bashkatdhetarët tanë patriotë, kudo që ndodhen në botë, janë në festë e gëzim të papërshekruar: ata kremtojnë jubileun më të shënuar në historinë e lavdishme shumëshekullore të Shqipërisë, 20-vjetorin e Çlirimit të Atdheut dhe të vendosjes së pushtetit popullor.

Më lejoni që, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Këshillit të Ministrave dhe të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, t'u shpreh të gjithëve përshëndetjet dhe urimet më të zjarrta: Gëzuar festat e mëdha të nëntorit! Gëzuar përjetë e mot Shqipërinë e re, socialiste, sot 20-vjeçare!

Në këtë gëzim të madh të popullit tonë marrin pjesë me gjithë zemër shokë e miq të panumërt nga të katër anët e botës, bashkëluftëtarë për çështjen e madhe të paqes, lirisë, demokracisë e socializmit. Më lejoni që, në emrin tuaj, në emër të popullit e të Partisë sonë, t'u shpreh të gjithë miqve të vërtetë të Shqipërisë së re mirënjohjen e thellë e të pakufishme për dashurinë e sinqertë, përkrahjen vëllazërore dhe solidaritetin ndaj popullit e Partisë sonë të Punës. Miqësia dhe solidariteti i tyre kanë qenë, janë e do të jenë kurdoherë të shtrenjtë për ne, mbasi janë faktorë të rëndësishëm dhe pjesë përbërëse e të gjitha fitoreve të popullit tonë; ata përbëjnë një inkurajim të madh për të vazhduar me vendosmëri gjithnjë më të madhe luftën tonë të drejtë për lulëzimin e mëtejshëm të Shqipërisë së re, për ndërtimin e plotë të socializmit, për triumfin e kauzës fisnike të marksizëm-leninizmit.

Në këto çaste solemne, ne që jetojmë të lumtur në atdheun socialist, të lirë e të pavarur, le të kujtojmë me respektin dhe me ndjenjën më të thellë të mirënjohjes së përjetshme të gjithë ata që bënë sakrificën supreme, duke derdhur gjakun dhe duke shkrirë tërë jetën e tyre që t'i siguronin Shqipërisë së dashur 28 Nëntorin e 1912-s, 29 Nëntorin e 1944-ës dhe begatinë e këtyre 20 vjetëve: le të kujtojmë, duke u ngritur në këmbë, patriotët e vjetër dhe luftëtarët trima të Rilindjes, demokratët revolucionarë, dëshmorët e lavdishëm të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, heronjtë e rënë të ndërtimit socialist. Lavdi e përjetshme kujtimit të tyre!

29 Nëntori 1944 e ngriti popullin tonë në piedestalin e zotit të plotfuqishëm të fateve të tij

Të dashur shokë,

29 Nëntori i vitit 1944 ka hyrë në fondin e artë të historisë së atdheut tonë si një ngjarje me rëndësi politike të pakrahasueshme, e cila i dha popullit tonë lirinë dhe pushtetin popullor, Republikën Popullore të Shqipërisë, si shtet të diktaturës së proletariatit dhe hapi rrugën e përparimit drejt socializmit e komunizmit. Ky ishte kurorëzimi i të gjitha përpjekjeve dhe luftërave mbinjerëzore e të pareshtura të popullit shqiptar, që nisin nga thellësitë e shekujve, luftëra e përpjekje me armë e me pendë, me gjak, djersë e sakrifica të panumërta, kundër armiqve të ndryshëm që donin ta zhduknin nga faqja e dheut, luftëra për ekzistencë, për liri, për bukë, dritë e begati.

52 vjet më parë, më 28 Nëntor 1912, populli ynë korri një fitore historike, ai hodhi tej zgjedhën otomane dhe shpalli pavarësinë. Ky akt pati një rëndësi shumë të madhe, pasi për herë të parë Shqipëria doli në botë si një vend sovran e i pavarur. Mirëpo kjo fitore e madhe e popullit tonë u shfrytëzua në dobi të armiqve të brendshëm e të satrapit Zog dhe, më në fund, më 1939 u grabit nga pushtuesit fashistë. Më 29 Nëntor 1944 populli ynë fitoi lirinë, sovranitetin dhe pavarësinë e tij të vërtetë.

29 Nëntori shënon në historinë tonë kufirin midis

dy botëve, të asaj ku populli ishte marrë tërë jetën nëpër këmbë nga «të fuqishmit» e ku s'kishte asnjë të drejtë dhe të asaj ku ai u ngrit në pedestalin e zotit të plotfuqishëm të fateve të tij. Këtë fakt të madh historik masat tona punonjëse, të udhëhequra nga Partia, e sanksionuan më 11 Janar 1946, duke u mbyllur derën pergjithmonë regjimeve antipopullore dhe duke shpallur me solemnitet e para tërë botës regjimin e ri republikan popullor, ku tërë pushteti buron nga populli dhe i përket popullit.

Në të njëjtën kohë, masat tona punonjëse, që kishin si hegjemon klasën më revolucionare e të organizuar, klasën tonë heroike punëtore, dhe që u udhëhoqën nga një parti marksiste-leniniste, Partia Komuniste e Shqipërisë (sot Partia e Punës e Shqipërisë), nuk u ndalën në gjysmë të rrugës, por i çuan fitoret e 29 Nëntorit 1944 e të 11 Janarit 1946 më tej, duke e zhvilluar pandërprerë revolucionin në rrugën e socializmit. Kështu, 29 Nëntori hapi për popullin tonë epokën e luftës për një shoqëri ku të mos ekzistojë shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, epokën e luftës për socializëm e komunizëm.

Më 29 Nëntor 1944 bota mbarë mësoi se rilindi shteti sovran shqiptar, por rilindi mbi një bazë të re, si një shtet i tipit të ri, i pavarur ekonomikisht, politikisht e ushtarakisht nga imperializmi dhe i paprekshëm nga synimet e tij grabitqare e shtypëse, i cili u bë pjesëtar i denjë i kampit të demokracisë e të socializmit.

E tillë është rëndësia historike e fitores së 29 Nëntorit 1944. Për të arritur në këtë fitore popullit tonë iu desh të bëjë Luftën heroike Antifashiste Nacionalçli-

rimtare, të kryejë një epike legjendare, e cila do të mbetet e paharruar në shekuj.

Frymëzuesja, organizatorja dhe udhëheqësja e sprovuar e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare u bë Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila u themelua në kushtet e vështira të terrorit fashist, në një nga momentet më kritike në historinë e popullit shqiptar, u ngrit mbi bazën e parimeve prej graniti të marksizëm-leninizmit dhe trashëgoi traditat e virtytet më të mira të popullit tonë.

Partia Komuniste e Shqipërisë, mbi bazën e një analize të thellë e krijuese marksiste-leniniste të gjendjes së vendit pas pushtimit fashist, si dhe të gjendjes ndërkombëtare, përcaktoi një program të qartë lufte e veprimi, i cili përfshinte luftën e armatosur e pa kompromis kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve të vendit për çlirimin e plotë të atdheut, përmbysjen e shkatërrimin nga themeli të pushtetit reaksionar e anti-popullor të pushtuesve e të klasave shfrytëzuese, vendosjen në Shqipëri të një pushteti të vërtetë demokratik popullor dhe realizimin e reformave të mëdha ekonomike e shoqërore. Qysh në ditën e parë të themelimit të saj Partia i bëri thirrje popullit të hidhej në luftë për zbatimin e këtij programi revolucionar.

Partia nuk ia fshehu asnjëherë popullit vështirësitë e mëdha të luftës dhe sakrificat e panumërta që kërkonte ajo. Populli dhe Partia kishin përballë forcat e pushtuesve fashistë italianë e gjermanë të armatosur gjer në dhëmbë, që ishin bërë zotër të Evropës, si dhe forcat e tradhtarëve të vendit, të organizuara në «Ballin Kombëtar» e «Legalitetin», të cilët, me gjak e me dema-

gogji, përpiqeshin të mbytnin lëvizjen çlirimtare. Një rrezik të madh real qysh gjatë luftës përfaqësuan për popullin tonë aleatët e atëhershëm anglo-amerikanë, si dhe klika titiste, të cilët u përpoqën gjer në fund t'i rrëmbenin fitoret nga duart dhe ta vinin vendin tonë nën një pushtim të ri.

Kundër të gjithë këtyre u ngrit në luftë populli ynë, për të vënë në jetë programin e Partisë. Dhe u ngrit siç ishte, i raskapitur nga shtypja e shfrytëzimi, i uritur e i zbathur, me ca pushkë e ca fishekë që ua rrëmbeu armiqve. Por dalngadalë malet tona filluan të gjëmojnë, Shqipëria u ndez flakë anembanë. Armiaqë përdorën terrorin, torturat, internimet, burgjet, pushkatimet, litarin. Ata ndërmorën si të tërbuar një varg operacionesh ushtarake, dogjën e shkretuan vendin. 28 mijë dëshmorë i dha populli ynë kauzës së çlirimit e të luftës kundër fashizmit. Vendi ynë, relativisht me territorin dhe popullsinë, zë një nga vendet e para në botë për sa u përket humbjeve në njerëz dhe dëmeve materiale në Luftën e Dytë Botërore. Por asgjë s'e ndali popullin në rrugën e tij të lavdishme.

Në këtë luftë vigane, nën udhëheqjen e Partisë, u realizua aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë heroike dhe me të gjitha shtresat patriotike e përparimtare, të cilat u bashkuan në Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar. Në luftë e sipër, nën udhëheqjen e Partisë, u krijua, u rrit e u kalit si një forcë goditëse e pathyeshme ushtria e re revolucionare partizane, e dalë nga gjiri i popullit dhe besnike ndaj interesave jetike të tij. Në zjarrin e luftës, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, u shkatërrua nga themeli pushteti anti-

popullor i pushtesve dhe i tradhtarëve dhe mbi gërmadhat e tij u ngritën në tërë vendin këshillat nacionalçlirimtarë, si organe të luftës çlirimtare dhe si emision i pushtetit të ri të vetë popullit.

Krahas luftës kundër pushtesve e tradhtarëve për çlirimin e vendit, Partia Komuniste e Shqipërisë nuk harroi për asnjë moment çështjen e pushtetit, si problemin themelor të revolucionit, nuk i lejoi klasat shfrytëzuese, bashkëpunëtore të pushtesve, që, pa hedhur asnjë pushkë, të dilnin në krye dhe t'i rrëmbenin popullit fitoren. Partia diti të bëjë mirë dallimin midis aleatëve të vërtetë dhe armiqtve të luftës revolucionare. Me vendosmëri marksiste-leniniste Partia likuidoi kompromisin tradhtar të Mukjes, intrigat e misioneve anglo-amerikane me pushtesit e tradhtarët e vendit dhe komplotin e forcave «aleate» të Mesdheut për të pushtuar Shqipërinë nën maskën e «ndihmës». Ajo e lidhi në mënyrë të pandarë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit tonë me luftën çlirimtare vigane të Ushtrisë Sovjetike, të mbarë popujve sovjetikë, kundër hordhive fashiste, e cila qe faktori i jashtëm vendimtar edhe për çlirimin e vendit tonë.

Vija e qartë dhe e vendosur marksiste-leniniste e Partisë Komuniste të Shqipërisë qe shpëtimtare për fatet e popullit punonjës dhe për të ardhmen e atdheut tonë. Si rezultat i kësaj vije jo vetëm u çlirua vendi nga pushtesit e tradhtarët, por tërë pushteti kaloi plotësisht e përfundimisht në duart e popullit punonjës, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, gjë që bëri të mundur përparimin e vendit në rrugën e ndritur të socializmit.

Në zjarrin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare,

Partia dhe populli jo vetëm arritën fitore të mëdha, por edhe u kalitën e u pajisën me një eksperiencë të pasur historike. Edhe në shembullin e revolucionit tonë u vërtetua drejtësia e mësimëve të marksizëm-leninizmit, të cilat hedhin poshtë predikimet e revizionistëve modernë, që orvaten të shuajnë luftën çlirimtare e revolucionare, duke përhapur iluzione mbi imperializmin e borgjezinë dhe duke rekomanduar gjithfarë recetash false mbi rrugët e çlirimit të popujve.

Eksperiencia jonë tregon, para së gjithash, se liria nuk dhurohet, se ajo nuk duhet pritur të jepet nga ana e imperialistëve, e këtyre armiqve të tërbuar të lirisë e të pavarësisë së popujve, se kurrfarë iluzioni nuk duhet ushqyer ndaj imperializmit dhe nuk u duhet besuar asnjëherë demagogjisë e premtimeve të tij të bukura. Çlirimi kombëtar e shoqëror është vepër e vetë popullit të çdo vendi, e masave të gjera punonjëse dhe arrihet me luftën dhe me përpjekjet e tyre të vendosura.

Kjo eksperiencë tregon se për kryerjen e Revolucionit Popullor dhe për konsolidimin e fitoreve të tij është e domosdoshme të krijohet ushtria politike, bashkimi i të gjitha forcave patriotike, demokratike e revolucionare të popullit, që ka si bërthamë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë. Ky bashkim u realizua te ne në Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste.

Eksperiencia e Luftës sonë Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe e zhvillimit të mëtejshëm të vendit pas Çlirimit tregon gjithashtu, me qartësinë më të madhe, domosdoshmërinë e krijimit të një ushtrie të fortë revolucionare, popullore, besnike pa kufi ndaj interesave

jetike të popullit e të atdheut, të aftë për ta çliruar vendin dhe për ta mbrojtur atë nga çdo atentat i imperialistëve dhe i forcave reaksionare.

Eksperiencia e Revolucionit tonë Popullor tregon më tej se kusht i domosdoshëm për fitoren e popullit dhe hyrjen në rrugën e socializmit është shkatërrimi i plotë i tërë sistemit shtetëror shfrytëzues dhe krijimi që nga baza deri në qendër i një pushteti krejt të ri, të dalë nga vetë populli, të lidhur ngushtë me të dhe të kontrolluar krejtësisht prej tij, një formë e të cilit ishin edhe këshillat nacionalçlirimtarë të ne. Predikimet e revizionistëve modernë se gjoja mund të kalohet në socializëm pa shkatërruar aparatën shtetëror borgjez dhe me ndihmën e tij, s'janë tjetër veçse një mistifikim i madh e një tradhti.

Kjo eksperiencë tregon, së fundi, se lufta për fitoren e revolucionit, për krijimin e pushtetit popullor dhe për ndërtimin e socializmit mund të kurorëzohet me sukses në qoftë se populli udhëhiqet nga një parti revolucionare, që mbështetet dhe zbaton me besnikëri mësimet fitimtare të marksizëm-leninizmit.

Lufta për ndërtimin e socializmit — një epope tjetër heroike e popullit tonë

Të dashur shokë,

20-vjetori i Çlirimit e gjen atdheun tonë, Shqipërinë, një vend të lirë e të pavarur socialist, me një bazë industriale të zhvilluar, me një bujqësi të madhe socia-

liste, me një kulturë të përparuar dhe me nivel jetese të ngritur, me një rend shoqëror të shëndoshë, të përbërë nga klasa punonjëse mike, të bashkuara në një unitet moralo-politik të pathyeshëm, me një pozitë ndërkombëtare më të fortë se kurrë ndonjëherë.

Vetëm dy dekada kanë kaluar qysh nga 29 Nëntori i 1944-ës, por pamja e sotme e Shqipërisë së re, që ndryshon si dita plot diell nga nata e zymtë dhe e hidhur e së kaluarës, zbulon me qartësinë më të madhe rëndësinë kolosale të kthesës që u shënua në atë ditë historike, dëshmon për vitalitetin e rendit socialist dhe për madhështinë e veprës e të forcës së paepur të popullit e të Partisë sonë.

Po, shumë ka vuajtur populli ynë në të kaluarën! Hordhi barbare, që nga ato të Romës e të Bizantit, të sllavëve e të osmanllinjve, të fqinjëve shovinistë e të fuqive të ndryshme imperialiste, deri tek ato të fashistëve italo-gjermanë, kanë ardhur në vendin tonë me urë në dorë, e kanë shkretuar atë, kanë vrarë e kanë masakruar popullin tonë. Këtyre vuajtjeve e fatkeqësive u është shtuar shtypja e shfrytëzimi i pamëshirshëm i feudalëve e i çifligarëve vendas, i borgjezisë dhe i tradhtarëve të shitur të të huajt, të cilët u kanë rrjepur lëkurën dhe u kanë thithur gjakun masave të gjera punonjëse.

Në vendin tonë, jo më të tjerat, por edhe buka thatë e gojës, misri ishte kthyer në «legjendë», siç thoshte Migjeni. Shqiptarit i qante syri për një ditë të mirë: punëtori thyente kurrizin në punë 10, 14 e 18 orë në ditë, pa siguruar dot as minimumin e jetesës; fshatari, ndonëse rropatej natë e ditë në baltë, shihte tek i

treteshin e i vdisnin fëmija nga malarja e nga uria; malësori mezi mbahej në këmbë në shkrepat, ku «pula hante strall»; inteligjencia e paktë punonjëse bridhte poshtë e lart me ëndrra të shembura. Në Shqipëri mbi-zotëronin marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore feudo-borgjeze. Zhvillimi i forcave prodhuese e i marrëdhënieve në prodhim pengohej me çdo mjet, si nga klasat sunduese, ashtu edhe nga monopolet e huaja, që e përdornin atdheun tonë si treg e burim lëndësh të para. Në vendin tonë kishte shumë herë më tepër qendra obskurantizmi, si kisha, xhami, teqe, tyrbe e të tjera, sesa shkolla e spitale. Nën regjimin zogist e fashist jeta e njeriut që luftonte për të drejtat e tij, s'kushtonte më shumë se një fishek, ose një pash litar. Hakmarrja e ushqyer nga klikat sunduese bënte kërdrinë e shuante qindra vatra në vit. Njeriu rronte mesatarisht jo më shumë se 38 vjet.

Në të tillë gjendje të mjeruar e kishin katandisur popullin dhe atdheun tonë të dashur regjimet e urryera të së kaluarës dhe armiqtë e jashtëm. Nga një gjendje e tillë filluam ne marshimin tonë fitimtar drejt socializmit.

Rruga e ndjekur nga populli e nga Partia për ndërtimin e socializmit nuk ka qenë aspak një shesh me lule. Ajo ka qenë një rrugë e vështirë, por e lavdishme, që ka kërkuar tërë talentin, tërë guximin e heroizmin, të gjitha forcat dhe këmbënguljen e popullit dhe të Partisë sonë të Punës.

Prapambetjes së thellë të trashëguar nga e kaluara iu shtuan pengesa e vështirësi të tjera kolosale, të shkaktuara nga rrënimet e luftës. Shqipëria ishte gër-

madhë, vendi kërcënohej nga uria e nga sëmundjet, si dhe nga armiq të egër imperialistë e shovinistë.

Të gjithë ata që i kanë jetuar vitet e para të pasçlirimit e kujtojnë, por rinia e sotme kurrë nuk duhet të harrojë, se si në ato kushte të vështira populli ynë heroik, i madh e i vogël, si një trup i vetëm, iu përgjigj thirrjes së Partisë së tij Komuniste, bëri të tijën parrullën e zjarrtë revolucionare «Të ndërtojmë socializmin, duke mbajtur në njërën dorë kazmën e në tjetrën pushkën» dhe u hodh në sulm me entuziazëm e me vetëmohim të papërshkruar. Ju kujtohet, shokë, se si, duke shtrënguar rripin, masat tona punonjëse dhe rinia heroike mbushnin brigadat e punës vullnetare, ngrinin ura e fabrika, ndërtonin rrugë e hekurudha, shkolla e spitale, thanin kënetat e moçale, ndiqnin kurset kundër analfabetizmit e shkollat, përvetësonin shkencën e teknikën, administrimin e prodhimit dhe artin e drejtimit të shtetit, vinin në jetë transformimet revolucionare të pushtetit popullor. U zhvillua një luftë e madhe dhe e ndërlikuar kundër valës së rrezikshme të spontaneitetit mikroborgjez, kundër mbeturinave të vjetra që rëndonin mbi ndërgjegjen e punonjësve, sidomos mbi masat e fshatarësisë, për t'i tërhequr ato në mënyrë aktive në rrugën e socializmit. Si edhe Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, kjo ka qenë një epike tjetër heroike, që do të mbetet e paharruar në historinë e popullit tonë.

Gjithë kjo rrugë u përshkua në kushtet e një lufte të ashpër klasash, nën sulmet e tërbuara dhe komplotet e armiqve të brendshëm e të jashtëm. Partia e pushteti ynë, me përkrahjen e mbarë popullit, shpartalluan

e likuiduan njërin pas tjetrit planet agresive dhe provokacionet e imperialistëve anglo-amerikanë, grupe spiunësh e sabotatorësh, oportunistët e ndryshëm, që përpiqeshin ta çonin vendin në rrugën e zhvillimit borgjez dhe në vartësinë e kapitalit të huaj, komplotet e titistëve e të Koçi Xoxes me shokë për të nënshtruar Partinë e për ta bërë Shqipërinë republikë të 7-të të Jugosllavisë, provokacionet e monarko-fashistëve grekë të gushtit 1949, diversantët e panumërt që hidheshin në vendin tonë nga deti, toka e ajri.

Pasi u kryen transformimet e thella ekonomiko-shoqërore dhe pasi u rindërtua vendi, populli ynë iu përvesh në shkallë të gjerë punës për ndërtimin e socializmit sipas programit të përpunuar nga Partia.

Kur kujtojmë të kaluarën dhe e krahasojmë atë me të tashmen, kuptohet më mirë se sa ndryshime kolosale janë bërë në vendin tonë brenda këtyre 20 vjetëve, se ç'luftë, ç'përpjekje e ç'sakrifica i janë dashur popullit tonë për realizimin e tyre.

Sot çdo gjë ka ndryshuar nga rrënjët. Në vend të marrëdhënieve të vjetra shfrytëzuese feudalo-borgjeze, tani në të gjithë sektorët e ekonomisë, në qytet dhe në fshat, kanë triumfuar marrëdhëniet socialiste, është ngritur baza ekonomike e socializmit. Tani sektori socialist përfshin 99,5 për qind të prodhimit të përgjithshëm industrial, 100 për qind të tregtisë së jashtme, 92,9 për qind të tregtisë me pakicë, 82 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, 90,5 për qind të të ardhurave kombëtare.

Kjo është një fitore e madhe historike, e arritur nga populli ynë nën udhëheqjen e Partisë së Punës të

Shqipërisë. Tani në vendin tonë klasat shfrytëzuese dhe shfrytëzimi i njeriut nga njeriu kanë mbetur vetëm si një kujtim i hidhur i së kaluarës. Shqipëria jonë socialiste, dikur e përçarë në klasa antagoniste, përbëhet sot nga dy klasa mike e të çliruara përgjithmonë nga zgjedha e rëndë ekonomike, politike e shpirtërore e bejlerëve dhe e kapitalistëve, nga klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste, të cilat, në aleancë të ngushtë e në unitet monolit me njëra-tjetrën dhe me shtresën e inteligjencies popullore, përbëjnë bazën e patundur shoqërore të pushtetit popullor dhe krah për krah, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, marshojnë drejt një qëllimi të përbashkët, ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Tani punëtorët së bashku me familjet e tyre përbëjnë 32,2 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë, kurse fshatarësia kooperativiste përbën rreth 75 për qind të numrit të të gjithë fshatarësisë sonë.

Bashkë me ndryshimin rrënjësor të marrëdhënieve në prodhim, një kërcim gjigant përpara kanë bërë edhe forcat prodhuese të vendit tonë. Vetëm brenda 2 planeve pesëvjeçare Shqipëria u shndërrua, nga vendi më i prapambetur bujqësor i Evropës, në një vend bujqësoro-industrial, ndërsa tani po përparon me hapa të shpejtë në rrugën e shndërrimit në një vend industrialo-bujqësor. Industrializimi socialist ia ndryshoi krejt fytyrën atdheut. Oxhaqet e fabrikave e të uzinave ngrihen tani të larta drejt qiellit po me aq krenari sa dhe pishat shekullore atje lart në bjeshkët legjendare. Digat e fuqishme të hidrocentraleve në Mat e në Bistricë u prenë yryshin lumenjve të rrëmbyer dhe agregatët e turbinat e tyre po i japin pareshtur dritë e energji elektrike

atdheut. Thesaret e nëntokës, të cilat kanë ngjallur kurdoherë lakmitë grabitqare të imperialistëve e të shovinistëve, po zbulohen çdo ditë e më shumë nga gjeologët, nga minatorët e nga naftëtarët tanë të talentuar e të palodhur, që i japin popullit çdo vit qindra mijë tonelata naftë, krom, hekur, bakër, qymyr e produkte të tjera të çmuara. Gjatë kësaj periudhe janë ndërtuar mbi 1 000 vepra të rëndësishme industriale, bujqësore, transporti, socialkulturore etj. Prodhimi i përgjithshëm i industrisë është rritur rreth 33 herë. Kjo tani në më pak se 12 ditë jep aq sa jepte gjithë industria e vendit më 1938. Mjafton të përmendim për krahasim se vetëm prodhimi i Kombinatit të Drurit në Elbasan dhe i Fabrikës së Cigareve në Durrës është më i madh se prodhimi industrial i tërë vendit në vitin 1938; ose vetëm fuqia që po instalohet në Centralin Elektrik të Gjogjanit në Kukës është më e madhe nga sa ishte fuqia e instaluar e gjithë centraleve elektrike të vendit në vitin 1938. Duke i marrë veç e veç disa sektorë, do të shohim se sot industria minerale i jep atdheut 26 herë më shumë prodhime se më 1938, industria elektrike — mbi 34 herë, industria mekanike — 39 herë, industria e materialeve të ndërtimit — 37 herë etj. Industria jonë është bërë sot një mbështetje e shëndoshë për zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë kombëtare dhe për ecjen tonë të mëtejshme në rrugën e ndërtimit të socializmit,

Ka ndryshuar rrënjësisht pamjen edhe fshati i kolektivizuar. Bujqësia socialiste, ku po përhapet gjithnjë më tepër agroteknika moderne, prodhon sot 2,4 herë më shumë se në vitin 1938. Në vitin 1964, kundrejt vitit 1938, sipërfaqja e mbjellë me bimët e arave po-

thujse është dyfishuar, sipërfaqja e vreshtave është afro trefishuar, numri i rrënjëve të ullinjve është rritur 81 për qind, ndërsa numri i pemëve frutore, kundrejt vitit 1947, është rritur rreth 4 herë. Një zhvillim të madh kanë marrë sidomos kulturat industriale, që më parë pothuajse nuk mbilleshin fare.

Për arritjen e të gjitha sukseseve në fushën e bujqësisë një rol të madh ka luajtur pajisja e saj me mjete moderne. Në vend të 30 traktorëve që numëroheshin në vendin tonë më 1938, tani punojnë 7 700 traktorë të llogaritur në 15 kuaj-fuqi.

Një faktor tjetër i rëndësishëm për përparimin e bujqësisë ka qenë kryerja e veprave të mëdha të bonifikimit e të ujitjes. Rreth 28 për qind e sipërfaqes së tokës nën kulturë që kemi sot, është përfituar e është përmirësuar në saje të veprave të bonifikimit që janë kryer gjatë këtyre 20 vjetëve. Gjithashtu, si rezultat i ndërtimit të veprave të shumta të ujitjes, në vitin 1964 sipërfaqja e ujitshme zë rreth 43 për qind të tokës arë, nga 10,5 për qind që zinte në vitin 1938.

Por zhvillimi i bujqësisë dhe përparimi i fshatit tonë janë të lidhur ngushtë e nuk mund të kuptohen pa atë transformim të madh shoqëror dhe ekonomik që u bë në jetën e fshatarësisë me kolektivizimin e bujqësisë. Jeta vërtetoi edhe në eksperiencën e vendit tonë drejtësinë e ideve leniniste mbi kolektivizimin e bujqësisë, si e vetmja rrugë e drejtë, e pranueshme nga fshatarësia për t'i nxjerrë bujqësinë dhe fshatin nga prapambetja shekullore.

Një revolucion i thellë kulturor është kryer dhe vazhdon të zhvillohet me ritme të shpejta në vendin to-

në. Këtu, ku 20 vjet më parë mbi 80 për qind e popullsisë ishte analfabete, kjo plagë shekullore jo vetëm është zhdukur në përgjithësi, por rreth një e katërta e gjithë popullsisë është ulur në bankat e shkollave dhe mëson. Arsimi dhe kultura janë bërë pasuri e masave popullore dhe janë përhapur deri në skajet më të largëta të atdheut. Për herë të parë në historinë shumëshekullore të Shqipërisë, shqiptarët kanë shkollat e veta të larta, kanë opera e teatro profesionistë kombëtarë dhe të gjitha ato të mira shpirtërore që ka krijuar qytetërimi njerëzor. Bijtë e punëtorëve e të bujqve, dikur të shtypur nga pesha e rëndë e shfrytëzimit e të rrethuar nga errësira e padijes, kanë marrë në duart e veta laboratorët modernë, merren me shkencë e me teknikë, janë bërë inxhinierë, mjekë, pedagogë, agronomë, shkrimtarë, artistë etj. Tani, kundrejt vitit 1938, në degët e ndryshme të ekonomisë e të kulturës punojnë mbi 21 herë më shumë kuadro të lartë dhe mbi 11 herë më shumë kuadro të mesëm.

Partia vazhdimisht është kujdesur e kujdeset jo vetëm për zhvillimin dhe përhapjen e gjerë të arsimit e të kulturës në të gjitha masat e popullit, por në mënyrë të veçantë që tërë arsimi, kultura dhe arti ynë i ri të kenë një brendi të shëndoshë, socialiste e revolucionare, që t'i pritët rruga depërtimit të çfarëdo influence të huaj të ideologjisë e të kulturës dekadente borgjeze, që arsimi, arti e kultura jonë të bëhen një armë e fuqishme në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, për triumfin e idealeve të komunizmit.

Likuidimi i çdo shfrytëzimi dhe sukseset e mëdha në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës socialiste kanë

bërë të mundur që mirëqenia materiale e kulturore e masave të gjera punonjëse të atdheut tonë të rritet në mënyrë të pakrahasueshme me të kaluarën. Të ardhurat kombëtare janë rritur 5,3 herë kundrejt vitit 1938. Mbi bazën e rritjes së prodhimit, të të ardhurave kombëtare dhe të shpërndarjes së drejtë të tyre, është rritur mjaft fuqia blerëse e popullsisë dhe qarkullimi i mallrave të shitjes me pakicë në vitin 1964, kundrejt vitit 1938, është shtuar 7,4 herë. Gjatë 20 vjetëve nga ana e shtetit janë investuar për banesa mbi 10 miliard e 600 milionë lekë dhe i janë dhënë popullsisë rreth 34 mijë apartamente banimi. Veç kësaj, nga vetë popullsia e qytetit dhe e fshatit, duke u ndihmuar edhe nga shteti me kredi, janë ndërtuar afro 100 000 shtëpi komode banimi. Sot populli ynë, në masën e tij dërrmuese, e jo ndonjë shtresë e vogël e privilegjuar, ushqehet më mirë, vishet dhe jeton më mirë, gëzon shërbimin shëndetësor falas etj. Brenda këtyre 20 vjetëve popullsia e vendit tonë është rritur rreth 64 për qind dhe mesatarja e jetës së njeriut në vitin 1960 ishte afro 65 vjeç.

Gjatë këtyre 20 vjetëve pas Çlirimit, mbi bazën e transformimeve të thella shoqërorë-ekonomike, në luftën praktike për ndërtimin e socializmit dhe në saje të punës së gjithanshme edukative të Partisë, shtetit dhe organizatave të masave, rezultate të mëdha janë arritur edhe në fushën e edukimit komunist të punonjësve. Bashkë me jetën e re, ka lindur, po formohet e po kalitet edhe një njeri i ri, me ide e mendime të reja, me botëkuptim e virtyte të larta morale. Kjo është një nga fitoret më të shkëlqyera të Partisë sonë. Pa këtë do të kishin qenë të pamundura sukseset e mëdha të

arritura në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës socialiste. Më lejoni, shokë, që në emër të Partisë e të Qeverisë, të përshëndes e të falënderoj me rastin e festës së madhe të 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut gjithë popullin shqiptar, klasën punëtore dhe fshatarësinë e lavdishme, rininë dhe gratë heroike të Shqipërisë, inteligjencien popullore, heronjtë e punës socialiste, punonjësit e përparuar të punës fizike e mendore, të qytetit e të fshatit, të cilët, me punën e tyre të palodhur krijuese, që nuk njeh të pamundurën dhe nuk ndalet para asnjë pengese e vështirësie, qëndrojnë në radhët e para të luftës për ndërtimin socialist dhe janë bërë një shembull i shkëlqyer vetëmohimi e ndërgjegjeje të lartë socialiste për të gjitha masat punonjëse të vendit tonë. Më lejoni të përshëndes gjithashtu forcat tona të lavdishme të armatosura, Ushtrinë tonë Popullore, Armën tonë të Sigurimit, kufitarët trima dhe Policinë Popullore, që kanë qëndruar e qëndrojnë kurdoherë roje të patrembura e vigjilente të fitoreve socialiste, të punës paqësore dhe të lirisë e të pavarësisë së atdheut tonë të dashur.

Fitoret e mëdha historike të arritura nga populli ynë nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës, gjatë këtyre 20 vjetëve të pushtetit popullor, janë një dëshmi e gjallë që tregon se, në epokën e triumfit të ideve të ndritura të marksizëm-leninizmit, të rënies së kapitalizmit e të triumfit të socializmit e të komunizmit, që filloi me Revolucionin e Madh Socialist të Tetorit, rruga e socializmit është e hapur edhe për vende të tilla të vogla e të prapambetura, siç ishte Shqipëria. Shembulli i atdheut tonë tregon qartë se vetëm në rrugën e so-

cializmit këto vende mund të fitojnë pavarësinë e vërtetë jo vetëm politike, por edhe ekonomike nga imperializmi, të arrijnë suksese efektive në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës kombëtare dhe të sigurojnë kushte më të mira jetese për popullin. Shqipëria e re është një dëshmi e pakundërshtueshme e epërsisë së pakrahueshme të rendit socialist mbi çdo rend shtypës e shfrytëzues.

Nuk mposhten kurrë populli ynë heroik dhe Partia jonë e lavdishme

Shokë,

Këto fitore të mëdha të arritura me luftën vetëmohuese të popullit tonë, nën udhëheqjen e urtë dhe të vendosur marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë, bënë të mundur që vendi ynë, pas ndërtimit me sukses të bazës ekonomike të socializmit, të hyjë në një etapë të re, në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Vendimet historike të Kongresit të 4-t të Partisë hapën një perspektivë të qartë e të ndritur në këtë drejtim dhe janë një program i madh pune e lufte për Partinë dhe për mbarë popullin tonë në të ardhmen. Të ndriçuar nga këto vendime, Partia dhe populli ynë, që prej afro 4 vjetësh po luftojnë me të gjitha forcat e aftësitë e tyre krijuese për ndërtimin e plotë të bazës materialo-teknike të socializmit, si hallka kryesore për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, duke arritur ato rezultate të shkëlqyera që na

mbushin sot me gëzim. Por, ashtu si gjatë gjithë punës sonë për ndërtimin e Shqipërisë së re, edhe në këtë etapë të tanishme të ndërtimit socialist, Partisë dhe popullit u është dashur e u duhet të zhvillojnë një luftë të ashpër kundër vështirësive e armiqve. Siç dihet, në këto vitet e fundit, kur vendi ynë përgatitej për t'iu përveshur punës për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar, veprimtarisë së zakonshme armiqësore të imperialistëve, të titistëve e të shovinistëve të tjerë reaksionarë kundër atdheut tonë socialist, iu shtua dhe veprimtaria e egër armiqësore e N. Hrushovit dhe e revizionistëve hrushovianë, si rrjedhim i së cilës është sabotuar rëndë realizimi i planit të tretë pesëvjeçar në shumë sektorë.

Nuk është nevoja të ndalemi në të gjitha hollësitë e kësaj veprimtarie banditeske antishqiptare të tyre. Por mjafton të kujtojmë se ç'presione bënë ata për ta thyer Partinë tonë, se si u përpoqën të kenë një agjunkturë të tyre në Partinë tonë, se si bënë thirrje për kundërrevolucion në Shqipëri nga Kongresi i 22-të i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik; le të kujtojmë se si prishën të gjitha marrëveshjet tregtare, kulturore etj., me vendin tonë, se si na prenë kreditë dhe u përpoqën të vendosin bllokadën ekonomike; le të kujtojmë se si arritën derisa të presin marrëdhëniet diplomatike me vendin tonë socialist, se si u përlyen në komplotin e madh të imperialistëve amerikanë, titistëve, monarko-fashistëve grekë e një grupi tradhtarësh kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, duke marrë në mbrojtje tradhtarët e popullit tonë, se si lidhën mi-

qësi me të gjithë armiqtë e vendit tonë, se ç'shpifje monstruoze kanë bërë kundër Partisë e popullit tonë.

Vendi ynë u ndodh përpara rreziqesh nga më të mëdhatë: ishin në rrezik liria, pavarësia e sovraniteti i atdheut, fitoret socialiste, ishte në rrezik të pengohet ndërtimi i mëtejshëm socialist, ishte në rrezik të pllakoste uria. Por ç'doli më në fund? Të gjitha planet e revizionistëve hrushovianë dështuan.

Ëndrrat mizore të imperialistëve, titistëve, hrushovianëve dhe veglave të tyre për të ndalur hovin revolucionar të popullit tonë, për t'i vënë minat ndërtimit socialist, për ta bërë atë t'i shtrijë dorën imperializmit e për ta hedhur në prehrin e tij, për të marrë nëpër këmbë dinjitetin e nderin e popullit e të Partisë sonë, u bënë pluhur e hi. Popull e Parti, si një trup i vetëm, u rezistuan të gjitha rreziqeve, pengesave, vështirësive, u treguan armiqtë kurdoherë grushtin dhe u dhanë goditje të njëpasnjëshme dërrmuese.

Shumë kanë mbajtur shpatullat e popullit tonë të vogël; shumë kanë mbajtur shpatullat e Partisë sonë 23-vjeçare. Sa gurë u janë hedhur nga armiqtë, ç'poshtërsi të panumërta e të paimagjinueshme kanë kurdisur ata kundër tyre! Por populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës janë në gjendje e do të mbajnë mbi shpatullat e tyre edhe shumë më tepër, po ta lypë nevoja, për kauzën e socializmit, të lirisë e të paqes, për triumfin e marksizëm-leninizmit, sepse nuk mposhtet kurrë populli ynë, stërnip i pellazgëve dhe i ilirëve, popull i Skënderbeut dhe i Naim Frashërit, i Ismail Qemalit dhe i Bajram Currit, i Selam Musait e i Avni Rustemit, i Halim Xhelos e i Ali Kelmendit, i Mujo Ulqinakut e i

Qemal Stafës, popull heroik që u ka rezistuar furtunave e rrebesheve të shekujve dhe ka triumfuar kurdoherë mbi to. Nuk mposhtet kurrë gjithashtu Partia e lavdishme e Punës, që lindi në gjirin e këtij populli të pavdekshëm, që u kalit në zjarrin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që u ka rezistuar të tëra breshërive e kompleteve të imperialistëve e revizionistëve, që ka në gjakun e saj mësimet jetëdhënëse e kurdoherë fitimtare të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Përkundrazi, nga betejat me armiqtë, nga përleshjet me vështirësitë e me pengesat, nga zjarri i luftës revolucionare në të gjitha frontet, ata kanë dalë dhe do të dalin kurdoherë më të fortë, më të çelikosur, më optimistë për fitoren përfundimtare.

Të dashur shokë,

Duke u hedhur këtë vështrim të shkurtër rrugës së kaluar, luftërave dhe fitoreve të deritanishme, duke parë me krenari e gëzim lartësitë në të cilat është ngritur atdheu ynë i dashur, respekti e admirimi i të gjithëve drejtohet në radhë të parë ndaj faktorit numër një, që i bëri ato të mundshme, ndaj popullit tonë të lavdishëm. E kush tjetër përveç masave të gjera të popullit mund t'u rezistonte furtunave të shekujve e të triumfante mbi to? Popullin tonë, edhe në rrethanat më të vështira, e ka karakterizuar kurdoherë një optimizëm i madh revolucionar dhe një besim i patundur në forcat e tij. Ai kurrë nuk e ka lënë fatin e tij në shpërsën dhe në duart e të tjerëve, cilëtdo qofshin ata. Mo-

toja e tij ka qenë: «Liria nuk dhurohet, por fitohet». Një moto tjetër e plotësoi më vonë këtë: «E ardhmja e lumtur, socializmi e komunizmi, gjithashtu nuk dhurohet, por fitohet». Prandaj populli ynë i ka dalë kurdoherë zot vetes dhe e ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë, me pushkë e kazmë, me pendë e dituri.

Kurrë popullit tonë s'i është trembur syri nga armiqtë, vështirësitë e pengesat. Ai s'e ka ulur kokën dhe s'ka rënë në gjunjë as përpara pushtuesve fashistë, as përpara tradhtarëve, vrasësve, diversantëve e sabotatorëve, as përpara imperialistëve, me ata amerikanë në krye, as përpara revizionistëve titistë e hrushovianë, as përpara terrorit, urisë, shantazheve e bllokadave, por ka çarë kurdoherë përpara, ashtu si do të çajë edhe në të ardhmen kurdoherë vetëm përpara! I tillë është populli ynë!

Fitoret madhështore dhe të mirat që gëzojmë ne sot i detyrohen gjithashtu udhëheqjes së urtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, besnikërisë së saj të patundur ndaj marksizëm-leninizmit, aftësisë së saj për ta zbatuar atë në çdo moment në mënyrë krijuese në kushtet historike konkrete të vendit tonë, zotësisë së saj për të frymëzuar, për të organizuar e për të mobilizuar masat më të gjera të popullit për vepra të mëdha.

Ishte Partia ajo që i hapi sytë popullit dhe që ndezi në zemrat e masave zjarrin e revolucionit; ishte Partia ajo që i bashkoi, i organizoi dhe i udhëhoqi ato me trimëri e mjeshtëri të pashoqe nëpërmes një mijë e një kurtheve të armiçve në revolucionin fitimtar, ishte Partia ajo që i bëri ato të vetëdijshme mbi gjithëfuqishmërinë e të drejtat e tyre të paprekshme në push-

tetin popullor që transformoi, formoi e po kalit ndër-gjegjen e tyre socialiste dhe që i udhëhoqi nëpërmjet një mijë e një kurthesh të tjera të armiqve në ditët e lumtura që gëzojmë sot.

Sa qesharakë duken armiqtë revizionistë kur përpiqen t'i ngjitin Partisë sonë etiketat bajate «dogmatike», «aventuriere», «sektare» etj. Por të gjitha këto janë përralla që, ndonëse i thonë edhe vetë, zor t'u besojnë, pasi jeta ka vërtetuar e vërteton të kundërtën.

A mundet një parti «dogmatike», «aventuriere» e «sektare», siç thonë ata, të vërë në jetë në mënyrë krijuese e me besnikëri mësimet e marksizëm-leninizmit mbi revolucionin dhe ndërtimin socialist në rrethanat e koniunkturave ndërkombëtare të ndërlikuara dhe në kushtet e vendit tonë që dihen, siç e bëri këtë Partia jonë? A mundet një parti e atillë, siç thonë ata, të shpartallojë të gjitha manovrat e armiqve të hapët e të maskuar, të brendshëm e të jashtëm, të fashistëve, imperialistëve, trockistëve, kapitullantëve, titistëve e të gjithë revizionistëve modernë, siç e bëri këtë Partia jonë? A mundet, pra, një parti e atillë, siç thonë për Partinë tonë revizionistët, të sjellë në fuqi popullin dhe ta bëjë atë ndërtues fitimtar të socializmit, të ngrejë kaq lart lavdinë e atdheut dhe prestigjin ndërkombëtar të Republikës sonë siç e ka bërë këtë Partia jonë?

Jo! Këto mund t'i bënte vetëm një parti që mbështetet kryekëput te marksizëm-leninizmi, vetëm një parti që e zbaton doktrinën tonë të madhe me besnikëri e në mënyrë krijuese, vetëm një parti që shfrytëzon, në përshtatje me kushtet e vendit të saj, eksperiencën e partive motra e të vendeve vëllezër, vetëm

një parti e lidhur si mishi me kockën me popullin e saj dhe që ka besim të patundur në forcat e tij krijuese e në të ardhmen e tij të ndritur, në komunizmin. E tillë është Partia jonë. Parti e dashur si drita e syve për popullin, pjesëtare e denjë e familjes së madhe të lëvizjes komuniste e punëtore marksiste-leniniste botërore.

Pra, popull e Parti, janë faktori i brendshëm, vendimtar, pa të cilin nuk do të mund të kishte Shqipëri të lirë, socialiste.

Në të njëjtën kohë, lufta e fitoret e popullit e të Partisë sonë janë të pandara edhe nga lufta, fitoret e solidariteti ndërkombëtar i popujve vëllezër të vendeve socialiste, i partive motra marksiste-leniniste dhe i të gjitha forcave revolucionare në botë.

Partia jonë e ka theksuar më se një herë dhe e rithekson edhe sot se ekzistenca e Bashkimit Sovjetik, Lufta e Madhe Patriotike dhe fitorja e popujve vëllezër sovjetikë kundër agresorëve fashistë ishte faktori i jashtëm kryesor i çlirimit të atdheut tonë. Dhe jo vetëm kaq, por pas Çlirimit të vendit tonë Bashkimi Sovjetik dhe partia e tij bolshevike, me Stalinin në krye, pa marrë parasysh vështirësitë e tyre të shkaktuara nga lufta, u dhanë popullit e Partisë sonë një ndihmë vëllazërore internacionaliste të gjithanshme për konsolidimin e pushtetit popullor, për rimëkëmbjen e zhvillimin e ekonomisë mbi baza socialiste, për zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të jetës sonë; ata u dhanë popullit e Partisë sonë një përkrahje të fuqishme në luftën kundër imperializmit e revizionizmit jugosllav, përkrahje e cila ka qenë shpëtimtare. Për të gjitha këto populli e Partia jonë u janë dhe do t'u jenë mirënjohës përjetë popujve

dhe bolshevikëve të vendit të Sovjetëve. Tradhtia e N. Hrushovit dhe e pasuesve, të tij revizionistë, të cilët u përpoqën t'u vinin kazmën Partisë dhe atdheut tonë socialist, miqësisë sovjeto-shqiptare, nuk i ka pakësuar ndjenjat e mirënjohjes, të dashurisë e të miqësisë së popullit e të Partisë sonë ndaj popullit sovjetik dhe atdheut të Leninit e të Stalinit. Aq më tepër këto ndjenja ne do t'i forcojmë akoma më shumë sot, kur ata po kalojnë vështirësi e rreziqe të mëdha për shkak të tradhtisë së revizionistëve modernë, dhe e konsiderojmë e do ta konsiderojmë veten deri në fund bashkëluftëtarë me ta në betejat e reja për triumfin e kauzës së komunizmit.

Një frymëzim i madh dhe një mbështetje e fuqishme në luftën e popullit e të Partisë sonë, për të kryer, si kurdoherë, me nder detyrat e tyre kombëtare dhe internacionaliste, ka qenë dhe mbetet lufta e tërë marksistë-leninistëve dhe e popujve të botës për çështjen e paqes, lirisë, demokracisë e socializmit.

Populli ynë, pra, e feston këtë datë i rrethuar nga miq e shokë besnikë, të fortë e të panumërt. Me këtë rast unë, në emër të popullit e të Partisë, dua të siguroj edhe një herë të gjithë miqtë e shokët tanë kudo në botë, se punonjësit e komunistët shqiptarë, ashtu si deri më sot, edhe në të ardhmen do të dinë t'i përgjigjen me dinjitet solidaritetit të tyre revolucionar, duke kryer kurdoherë detyrën e tyre internacionaliste.

Idetë e socializmit, të revolucionit, të paqes, të lirisë e të demokracisë marshojnë përpara në mënyrë të pandalshme

Shokë e shoqe,

Populli shqiptar e feston përvjetorin e 20-të të Çlirimit të Atdheut i gëzuar e plot optimizëm revolucionar, jo vetëm për fitoret e mëdha që ka arritur në fushën e ndërtimit socialist, por edhe për fitoret e rëndësishme që kanë korrur në këta 20 vjet popujt vëllezër të kampit të socializmit në ndërtimin e shoqërisë së re, për fitoret historike që kanë arritur në luftën për çlirimin kombëtar popujt e kombet e shtypura të botës, për fitoret e proletariatit dhe të njerëzve të punës kundër kapitalit, kundër shfrytëzimit e shtypjes.

Republika Popullore e Shqipërisë në këta 20 vjet të Çlirimit ka luftuar pa rezerva krah për krah me gjithë popujt paqedashës për mbrojtjen e kauzës së lirisë e të pavarësisë së popujve, për demokracinë e socializmin, për mbrojtjen e çështjes së madhe të paqes e të sigurimit ndërkombëtar. Në luftën e pandërprerë që zhvillohet sot midis imperializmit, nga njëra anë dhe popujve, kombeve të shtypura dhe proletariatit ndërkombëtar nga ana tjetër, Shqipëria socialiste ka qenë, është dhe do të jetë me vendosmëri në anën e popujve, në anën e proletariatit, në anën e lëvizjes revolucionare, kundër imperializmit, me qendrën e tij më agresive e më të rrezikshme, imperializmin amerikan në krye, dhe kundër armiqve të tjerë të lirisë e të paqes.

Në ditën e shënuar të festës sonë kombëtare ne vëmë re me kënaqësi marshimin triumfal të ideve të socializmit e të revolucionit. Bota e re, socializmi, po rritet, fuqizohet dhe po arrin fitore të rëndësishme përditë e më të mëdha. Idetë e socializmit po futen gjithnjë e më thellë në zemrat e njerëzve, në zemrat e popujve, duke i frymëzuar ata në luftën për liri e përparim. Nga viti në vit rriten forcat e lëvizjes së madhe antiimperialiste të kohës sonë, të lëvizjes revolucionare të klasës punëtore, të lëvizjes nacionalçlirimtare, të lëvizjes masive luftarake për mbrojtjen e paqes në botë. Gjendja ndërkombëtare në tërësi po zhvillohet në favor të socializmit, në favor të luftës së popujve, kundër imperializmit e reaksionit.

Një pamje krejt tjetër ka sot bota e kapitalizmit. Pas goditjeve të «Aurorës» së bolshevikëve të Leninit e të Stalinit më 1917, ajo mori të tatëpjetën. Marshimi luftarak revolucionar i popujve drejt socializmit e lirisë ngushtoi zonën që gjer dje shtypej e shfrytëzohej nga imperialistët e nga kolonialistët, i dha goditje vdekjeprurëse sundimit hegjemonist të imperializmit. Bota e dollarit dhe e stërlinës po përpëlitet sot nën kthetrat e pamëshirshme të kontradiktave. Politika e saj e agresionit dhe e luftës ka pësuar e po pëson çdo ditë disfata pas disfatash. As bomba atomike, as dhëlpëritë e diplomacisë së dollarit nuk kanë mundur të thyejnë yllnetin e paepur të popujve për liri, për demokraci, për socializëm, nuk kanë ndalur dot stuhitë e furishme të lëvizjeve revolucionare që kanë shpërthyer në Azi, Afrikë e në Amerikën Latine. Kuba dhe Algjeria i treguan botës edhe një herë se kur popujt vendosin dhe

ngrihen në luftën e drejtë të çlirimit, fitorja është e tyre. Me hekur e me zjarr nuk mposhtet çështja e drejtë e popujve që janë ngritur në revolucion. Populli heroik i Vietnamit të Jugut po jep në ditët e sotme një shembull tjetër të lartë heroizmi e vetëmohimi në luftën patriotike kundër zgjedhës së imperializmit të huaj e tradhtarëve të vendit. Ne jemi të bindur dhe të sigurt në fitoren e çështjes së popullit vëlla vietnamez. Në zemër të Afrikës populli kongolez po lufton me lavdi kundër imperialistëve të bashkuar, duke treguar se kauza e lirisë nuk mund të shtyhet nga asnjë forcë.

Por kjo gjendje dhe kjo tendencë që vihen re në zhvillimin e përgjithshëm, rritja e lëvizjes revolucionare antiimperialiste të popujve, fitoret e tyre të mëdha, nuk duan të thonë në asnjë mënyrë se imperializmi ka hequr dorë nga politika e tij reaksionare, se rreziku i madh që përbën imperializmi amerikan për vendet socialiste, për popujt dhe vendet e tjera liridashëse, është pakësuar. Përkundrazi, sikurse e theksojnë deklaratat e Moskës të viteve 1957 dhe 1960, imperializmi, me atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në krye, ka qenë dhe mbetet armiku më i madh i socializmit, i lirisë e i pavarësisë së popujve, xhandari dhe shfrytëzuesi më i egër ndërkombëtar, rreziku kryesor për prishjen e paqes botërore. Me armë e me dollarë, me gjak e me dinakëri, ai ka synuar e synon të shkatërrojë kampin socialist, të mbytë lëvizjen revolucionare çlirimtare të popujve, të shtjerë nën thonjtë e sundimit të tij vendet paqedashëse e përparimtare. Vatrën e shumta të «luftës së nxehtë», mbajtja gjallë e «luftës së ftohtë», gara e ethshme e armatimeve, planet për kri-

jimin e forcës së shumanshme bërthamore të NATO-s, nëpërmjet së cilës në fakt u jepen arinët bërthamore revanshistëve të Bonit, forcimi i bazave dhe i aleancave agresive ushtarake, të gjitha këto tregojnë se imperia- lizmi është i pabesë, i egër e luftëdashës.

Pa hequr dorë nga agresionet e provokacionet, nga përdorimi i armëve dhe i dhunës, në kohën e sotme imperializmi u ka dhënë një rëndësi të veçantë dema- gogjisë e mashtrimit, diversionit ideologjik. Në këtë drejtim ai ka përdorur me mjeshtëri shërbimet e revi- zionistëve modernë, titistë e hrushovianë, të cilët, nga njëra anë, mbështetin politikën imperialiste dhe, nga ana tjetër, punojnë aktivisht për dobësimin e për shka- tërrimin e kampit socialist, të kështjellës kryesore anti- imperialiste. Propaganda e shfrenuar e revizionistëve për të zbukuruar imperializmin, ngjallja e iluzioneve për qëllimet e tij, sakrifikimi i interesave dhe i sovra- nitetit të popujve, siç u vërtetua në kohën e krizës së Karaibeve apo në Kongo, zvarritja e nënshkrimit të traktatit të paqes me Gjermaninë dhe pazarllëqet me qeverinë e Bonit në kurriz të popullit gjerman, nën- shkrimi i traktatit tripalësh të Moskës, justifikimi i agresioneve imperialiste etj., të gjitha këto kanë pro- vuar sheshit se revizionistët dhe shërbëtorët e tjerë të borgjezisë imperialiste veprojnë me zell të madh për t'i shërbyer politikës së agresionit e të luftës të imperia- lizmit amerikan. Qëndrimet kapitullante të revizionis- tëve hrushovianë ndaj imperializmit, kompromiset dhe pazarllëqet e paprincipita të tyre nën parullën demago- gjike të «mbrojtjes së paqes», kanë treguar haptazi se

këta janë tradhtarë fort të rrezikshëm të kauzës së socializmit, të revolucionit e të çlirimit të popujve.

Rreziku kërcënues i kryqëzatës së imperialistëve e të revizionistëve kundër socializmit e lirisë së popujve nuk pakësohet as me vdekjen e Kenedit e zgjedhjen e Xhonsonit, as me ardhjen e laburistëve në fuqi në Angli dhe as me dëbimin e Hrushovit nga udhëheqja sovjetike. Rrënjët e kësaj kryqëzate janë të thella, ato janë të lidhura me vetë karakterin reaksionar të sistemit kapitalist dhe të ideologjisë së tij.

Prandaj sot përpara popujve, përpara gjithë revolucionarëve, dalin me tërë forcën detyrat imperative historike: të forcohet lufta kundër imperializmit botëror, me imperializmin amerikan në krye, lufta e vendosur, e paprerë, dhëmb për dhëmb, deri në shkatërrimin e tij përfundimtar, të demaskohen planet e tij luftënxitëse dhe të rritet vigjilenca revolucionare e popujve. Janë gjithnjë aktuale fjalët e J. V. Stalinit se

«Paqja do të ruhet dhe do të forcohet në qoftë se popujt do ta marrin në duart e veta çështjen e ruajtjes së paqes dhe do ta mbrojnë atë deri në fund»¹.

Për këtë qëllim duhet të bashkohen të gjitha forcat revolucionare dhe luftëtarët e vërtetë të paqes në frontin e madh antiimperialist. Dhe ky front do të forcohet dhe do të korrë fitore në betejat kundër imperia-

¹ J. V. Stalin. Bisedë me korrespondentin e gazetës «Pravda». «Pravda», Nr. 48 (11885), 17 shkurt 1951.

lizmit botëror, duke zhvilluar në të njëjtën kohë një luftë të pandërprerë kundër revizionizmit modern dhe gjithë veglave të tjera që janë vënë në shërbim të politikës së agresionit e të luftës së imperializmit, në shërbim të strategjisë së tij globale. Pa luftën kundër revizionizmit nuk mund të luftohet me sukses imperializmi. Ky mësim leninist është më aktual se kurrë në ditët tona.

Në luftën e madhe kundër imperializmit dhe kolonializmit popujt e vendeve socialiste dhe gjithë revolucionarët duhet të ndihmojnë pa rezerva, ndershmërisht dhe me të gjitha mjetet popujt që sapo kanë fituar lirinë, si dhe lëvizjen revolucionare nacionalçlirimtare në botë.

Por kjo ndihmë duhet dhënë në mënyrë që t'i shërbejë kauzës së revolucionit, të demokracisë, të lirisë, të socializmit e të paqes dhe të godasë e të dëmtojë pozitën e imperializmit e të reaksionit. Është e drejtë, për shembull, dhe gjen aprovim nga marksistë-leninistët dhe revolucionarët, nga masat punonjëse, ndihma që i jepet Republikës Arabe të Bashkuar për ndërtimin e pendës së Asuanit, apo Republikës Demokratike Popullore të Algjerisë, Guinesë ose Malit, sepse ato luftojnë kundër imperializmit e kolonializmit. Por nuk është aspak e drejtë ndihma që hrushovianët i japin borgjezisë reaksionare indiane, për ta armatosur e për ta ndërhyer atë për agresion kundër Republikës Popullore të Kinës. Kjo është një ndihmë që shkon në dobi të imperializmit e të kundërrevolucionit, një ndihmë që forcon pozitën e borgjezisë e të reaksionit. Gjithashtu, s'ka asgjë të përbashkët me përkrahjen e luftës së popujve

të robëruar, por përkundrazi, është një tradhti e ulët ndaj tyre të bësh kauzë të përbashkët me imperialistët amerikanë për të dërguar forcat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të shtypur lëvizjen çlirimtare në Kongo.

Lufta nacionalçlirimtare e popujve të shtypur, lufta për të thyer vargonjtë e kolonializmit, janë forca të mëdha revolucionare në luftën antiimperialiste, në luftën për paqe. T'i ndihmohet e t'i përkrahësh ato do të thotë të luftosh imperializmin, të mbrosh paqen.

Partia dhe Qeveria jonë edhe në të ardhmen do të ndjekin me konsekuencë politikën e paqes, politikën e miqësisë e të bashkëpunimit të ngushtë vëllazëror, në rrugën marksiste-leniniste e të parimeve të internacionalizmit proletar, me popujt e vendeve socialiste, politikën e miqësisë dhe të solidaritetit me popujt që luftojnë për liri e për pavarësi, në mënyrë të veçantë me popujt vëllazër arabë, me popujt e Afrikës së Zezë, të Azisë, të Amerikës Latine dhe me të gjitha forcat antiimperialiste. Populli ynë mbron me vendosmëri e rreptësi sovranitetin, lirinë dhe pavarësinë e tij. Ai sillet me respektin më të madh ndaj sovranitetit, lirisë dhe pavarësisë së popujve të tjerë. Mbi këtë bazë Partia dhe Qeveria jonë kanë qenë dhe janë kurdoherë të gatshme të forcojnë miqësinë e bashkëpunimin me të gjitha vendet, duke përfshirë edhe vendet fqinje.

Edhe në të ardhmen Partia dhe populli ynë do të luftojnë me vendosmëri kundër imperializmit, e veçanërisht kundër imperializmit amerikan, rrezikut kryesor të paqes dhe të lirisë së popujve, si dhe kundër gjithë shërbëtorëve dhe përkrahësve të tij.

Partia jonë ka luftuar dhe do të luftojë kundër revizionizmit hrushovian e titist deri në shpartallimin e tyre të plotë

Shokë dhe shoqe,

Gjatë këtyre 20 vjetëve Partia dhe populli ynë janë ndeshur ballë për ballë jo vetëm me imperializmin, por edhe me revizionizmin, me tradhtinë, në fillim me klikën titiste e më pas edhe me revizionistët hrushovianë.

Revizionizmi, si armë e luftës ideologjike të borgjezisë kundër komunizmit, nuk është një fenomen i ri. Ai është shfaqur qysh në hapat e parë të zhvillimit të marksizmit. Kundër revizionizmit dhe varianteve të ndryshme të tij kanë bërë një luftë të vendosur, të hapur e pa doreza, Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Nga këto luftëra marksizmi ka dalë gjithnjë më i fortë dhe kurdoherë fitimtar.

Revizionizmi i sotëm hrushovian është pasardhës i revizionizmit të vjetër. Grupi revizionist i Hrushovit dhe pasuesit e tij ndoqën me konsekuencë një vijë tradhtare ndaj çështjes së socializmit, një vijë që u përshatet kërkesave dhe interesave të borgjezisë ndërkombëtare. Revizionistët hrushovianë tradhtuan mësimet marksizëm-leninizmit, hoqën dorë nga tezat themelore të tij, nga lufta e klasave, nga revolucioni dhe nga diktatura e proletariatit. Ata ndoqën vijën e minimimit të unitetit marksist-leninist të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, vijën e shkatërrimit të

sistemit sovjetik socialist, të ndërtuar nën udhëheqjen e Leninit e të Stalinit, vijën e degjenerimit të shteteve socialiste në shtete borgjeze e të partive komuniste në parti socialdemokrate. Ata zbatuan kursin tradhtar të afrimit, të kapitullimit dhe të nënshtrimit të turpshëm ndaj imperializmit botëror, ndoqën vijën e sabotimit të revolucionit dhe të largimit të popujve nga rruga e luftës për çlirimin kombëtar e shoqëror dhe dëmtuan rëndë çështjen e paqes e të sigurimit të popujve.

Kjo vijë revizioniste, që u formulua në kongreset e 20-të, të 21-të dhe të 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i solli dëme të mëdha lëvizjes komuniste dhe luftës antiimperialiste të popujve. Megjithëkëtë, revizionistët nuk i ndalën dhe nuk mund t'i ndalnin marksizëm-leninizmin dhe revolucionin në rrugën e tyre fitimtare. Revizionizmi ndeshi në një rezistencë të madhe, të pakapërcyeshme, në luftën parimore, të vendosur dhe heroike të Partisë së Punës të Shqipërisë e të partive motra që qëndrojnë në pozita marksiste-leniniste, ndeshi në luftën e gjithë revolucionarëve e të komunistëve të vërtetë të botës. Si rrjedhim i kësaj lufte parimore, iu gris maska pseudomarksiste gjithë kursit revizionist të hrushovianëve dhe u demaskuan qëllimet e tyre tradhtarë.

Në të gjitha fushat, si në plan kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, në politikë dhe në ekonomi, njëra pas tjetrës, filluan të shfaqen disfatat e vijës revizioniste. Grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij, nëpërmjet aparatit të tyre të fuqishëm propagandistik, u përpoqën shumë që këto disfata t'i mbulonin me zhurmë demagogjike, u përpoqën t'i paraqitnin me zor si fitore, por

pa sukses. Veç kësaj, në gjirin e revizionistëve gjendja u ndërlikua dhe u rëndua: grindjet, përçarjet, mosmarrëveshjet, të zakonshme për ata që nuk kanë parime, dolën sheshit. Kjo u duk qartë, qoftë në të ashtuquajturin testament të Toliatit, qoftë edhe në qëndrimin e rezervuar që mbajtën shumë parti komuniste ndaj projektit hrushovian për mbledhjen fraksioniste ndërkombëtare të partive. Kriza e revizionizmit hrushovian u acarua në kulm, duke vënë përpara rrezikut të disfatës së plotë të kursin antimarksist, vetë ekzistencën e revizionizmit modern.

Në këto kushte, revizionistët u detyruan të eliminojnë kryetarin e tyre nga skena politike. Dëbimi i N. Hrushovit, i këtij tradhtari e renegati të rrezikshëm të komunizmit, nga postet drejtuese që mbante në Partinë Komuniste dhe në qeverinë sovjetike, përbën një disfatë të madhe, një grusht të rëndë për gjithë revizionizmin modern, për ideologjinë e për politikën e tij antimarksiste dhe një fitore të rëndësishme për marksistë-leninistët.

Populli dhe komunistët shqiptarë u gëzuan me të drejtë për këtë fitore të madhe mbi revizionizmin, sepse në rrëzimin e N. Hrushovit ata panë edhe një herë drejtësinë e vijës marksiste-leniniste të Partisë, rëndësinë e luftës së saj të pareshtur e parimore për mbrojtjen e çështjes së madhe të komunizmit.

Rrëzimi i N. Hrushovit është një fitore e madhe, po kjo nuk shënon fundin e revizionizmit hrushovian dhe as të revizionizmit modern në përgjithësi. Pavarësisht nga roli i madh që ka luajtur N. Hrushovi si udhëheqës i revizionistëve, bashkë me të nuk janë li-

kuiduar kursi, politika dhe rrënjët socialekonomike të revizionizmit, vetë revizionizmi hrushovian, që u ka sjellë gjithë ato të këqija lëvizjes komuniste, Bashkimit Sovjetik, kampit socialist dhe luftës çlirimtare të popujve. Prandaj Partia e Punës, si gjithë revolucionarët e vërtetë, nuk duhet dhe nuk do të ushqejë në këtë drejtim asnjë iluzion.

Rrëzimi i N. Hrushovit shënon, pa dyshim, fillimin e një etape të re në luftën midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit, që do të çojë në shpartallimin e plotë të revizionizmit të sotëm dhe në triumfin e pashmangshëm të marksizëm-leninizmit.

Në këtë etapë komunistët dhe populli ynë duhet të kenë më tepër se kurrë të qartë qëndrimin e vijën e luftës së ardhshme, që janë përcaktuar drejt nga Partia duke u mbështetur në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe në interesat e forcimit të gjithë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Partia jonë ka luftuar dhe do të vazhdojë të luftojë me konsekuencë kundër revizionizmit modern, hrushovian apo titist, gjer në shpartallimin e tij të plotë si vijë regresive, si kurs antimarksist, si ideologji e politikë, që ka gjetur shprehjen e tij konkrete në vendimet revizioniste të kongreseve të 20-të, të 21-të dhe të 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Kjo pozitë e Partisë sonë është thellësisht e drejtë dhe parimore, sepse as që mund të mendohet për shkatërrimin e revizionizmit, për fitoren e marksizmit, pa hedhur poshtë e pa shqelmuar bazën ideologjike e politike, platformën e revizionizmit.

Udhëheqësit e sotëm të partisë e të qeverisë sovje-

tike, pas rrëzimit të Hrushovit, kanë deklaruar më se një herë se ata do të ndjekin me besnikëri vijën e kongreseve të 20-të, të 21-të e të 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, si dhe programin e saj të aprovuar në Kongresin e 22-të. Ata kanë shpallur, gjithashtu, se largimi i N. Hrushovit nuk do ta prekë aspak esencën e vijës së ndjekur deri tani nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Është e qartë se ndjekja edhe në të ardhmen e këtij kursi antimarksist, pavarësisht nga nuancat taktike që mund të përdoren, e pa dyshim do të përdoren, në zbatimin e tij dhe që llogariten për të mashtruar revolucionarët e popujt, nuk mund të mos shkaktojë kundërshtimin e vendosur dhe luftën e hapët e parimore të marksistë-leninistëve të vërtetë.

Partia jonë mendon se likuidimi i vërtetë i platformës revizioniste, pra edhe i vetë revizionizmit hrushovian, duhet dhe do të arrihet nëpërmjet luftës parimore të marksistë-leninistëve, për vënien në vend dhe korrigjimin hap pas hapi të të gjitha të këqijave që revizionistët i kanë sjellë deri tani komunizmit ndërkombëtar me vijën e tyre tradhtarë.

Në radhë të parë, vënia në vend e çështjes së Stalinit, e rehabilitimit të tij, si një marksist-leninist i madh, pavarësisht nga ndonjë gabim i vogël që mund të ketë bërë, është një çështje e madhe parimore me rëndësi ndërkombëtare. Partia jonë dhe gjithë marksistë-leninistët çështjen e Stalinit nuk e shohin si një çështje sentimentale, por ashtu siç është në të vërtetë, një çështje vije, një çështje parimore.

Profkave revizioniste se «Stalini ishte diktator i

egër», marksistët dhe njerëzit e ndershëm nuk u besojnë, sepse në këta pak vjet të gjithë revolucionarët e njerëzit e ndershëm po e shohin se kush janë revizionistët, cila është figura e tyre morale dhe çfarë janë në gjendje të bëjnë ata. Dihet se Stalini kurrë nuk u soll si diktator, as edhe me kundërshtarët e leninizmit, por brenda normave leniniste bëri kundër trockistëve, buharinistëve, zinovievistëve etj., me durim, për vite me radhë, në parti e jashtë saj, një luftë të hapët. Kurse krejt ndryshe, me metoda policore e aspak sipas normave leniniste, luftojnë sot revizionistët me kundërshtarët e tyre. Jo në kohën e Stalinit dhe as nga Stalini, por nga revizionistët po përdoret në sistem metoda antileniniste e puçeve, si rrjedhim i së cilës rrëzohen njëri pas tjetrit udhëheqës jo vetëm në Bashkimin Sovjetik, por edhe në vende të tjera socialiste.

Revizionistët thonë se Stalini paska qenë «vrasës e terrorist». Pse? Sepse në kohën e Stalinit u zhdukën armiqtë e revolucionit, tradhtarët e spiunët. Dhe këta nuk i vrau Stalini, por revolucionit dhe mbrojtja e fitoreve të socializmit, ata i gjykuan gjyqet revolucionare mbas debatesh e vendimesh publike. Kurse revizionistët veprojnë si kusarë, si komplotistë, fshehtazi. Ata të vrasin natën e të qajnë ditën. Ata veprojnë si një «mafia» ndërkombëtare. Ata u hapën dyert e Bashkimit Sovjetik agjenturave imperialiste, ata po përpiqen t'u japin satisfaksion imperialistëve, bjellogardistëve, trockistëve, kundërrevolucionarëve, revizionistëve e tradhtarëve, duke rehabilituar nëpër zyra të

errëta, në fshehtësi, njërin pas tjetrit, njerëzit e tyre dhe duke vendosur që tradhtarëve t'u ngrenë monumente etj. Kësaj kuzhine revizioniste nuk mund t'i besohet. Prandaj rehabilitimi i Stalinit duhet bërë sa më parë dhe nga pozita marksiste.

Stalini nuk ishte as tradhtar i marksizëm-leninizmit dhe as palaço panairesh. Ai ishte një leninist i madh, ai fliste pak dhe bënte shumë për Bashkimin Sovjetik dhe për revolucionin. Kur fliste Stalini, borgjezia dhe imperializmi nuk duartrokitnin e nuk shkulleshin në gaz, po dridheshin si purteka.

Stalini nuk iu përul kurrë imperialistëve, nuk tradhtoi dhe nuk e futi kurrë revolucionin në qorrrokak. Stalini nuk ishte një luftënxitës, ai nuk i deklaroi luftë asnjë shteti, por të tjerë i deklaruan luftë dhe sulmuan Bashkimin Sovjetik. Stalini e mbrojti atdheun sovjetik me zotësi e me heroizëm.

Stalini nuk u bashkua kurrë me kundërrevolucionarët dhe nuk dekretoi likuidimin e partisë komuniste, siç bënë disa që sot paradojnë si marksistë me diplomën që u dhanë Hrushovi e Titoja. Stalini i dërrmoi kundërrevolucionarët dhe e kaliti më tej partinë e madhe të bolshevikëve.

Duke vënë në vend çështjen e Stalinit, vihet në vend leninizmi, i mbrojtur me konsekuencë gjatë më se 30 vjetësh nga Stalini e partia bolshevike, vihen në vend vija dhe orientimet e drejta, sipas të cilave u kryen me sukses revolucionin, lufta kundër intervencionit, lufta për ndërtimin e socializmit në BRSS, mbrohet sistemi sovjetik, vihet në vend vija sipas së cilës u zhvillua lufta e klasave, Lufta Patriotike, u sigurua fitorja

mbi fashizmin në Luftën e Dytë Botërore dhe u hap rruga për ndërtimin e komunizmit në BRSS. Çështja e Stalinit është e lidhur ngushtë me krijimin dhe me konsolidimin e kampit socialist dhe me çelikosjen e unitetit marksist-leninist të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, me ndihmën e përkrahjen e gjithanshme internacionaliste ndaj vendeve socialiste e partive motra. Me qëndrimin ndaj çështjes së Stalinit janë të lidhura vija dhe qëndrimet e drejta ndaj bashkekzistencës paqësore, vigjilenca kundrejt armikut të jashtëm e të brendshëm, ndihma për luftën nacionalçlirimtare të popujve, lufta kundër imperializmit dhe lufta për paqe.

Hrushovianët dhe gjithë revizionistët modernë veprimtarinë e tyre tradhtarë jo rastësisht e filluan me mohimin e J. V. Stalinit, me shpifjet e sulmet më tendencioze e të shëmtuara kundër jetës e veprës së tij të lavdishme. Mohimi i J. V. Stalinit ishte çështje themelore për revizionistët, sepse kështu i hapej rruga mohimit të leninizmit, revizionimit të marksizmit, tradhtisë. Tani është e qartë për të gjithë revolucionarët e njerëzit e ndershëm të botës se imperialistët amerikanë dhe revizionistët modernë organizuan dhe vunë në jetë një komplot të madh për të shkatërruar Bashkimin Sovjetik, për të goditur marksizëm-leninizmin, vetë socializmin. Për këtë komplot ne i akuzojmë botërisht këta tradhtarë. Prandaj, për të vënë në vend këtë çështje parimore e kyç, për ngritjen e prestigjit e të autoritetit të Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë së tij Komuniste, për forcimin e dashurisë së popujve dhe të partive marksiste-leniniste ndaj tyre, duhet dhe do të

luftojnë me konsekuencë Partia jonë dhe gjithë revolucionarët e vërtetë.

Për t'u kthyer në pozitë e marksizëm-leninizmit është e domosdoshme të demaskohet plotësisht kursi revizionist hrushovian i aleancave e i marrëveshjeve të hapëta e të fshehta me imperializmin amerikan, të rishikohet në thelb e nga rrënjët dhe të dënohet gjithë politika e tij tradhtare e jashtme dhe të vihen këto në rrugë të drejtë.

Grupi hrushovian në themel të gjithë politikës së tij kishte bashkekzistencën paqësore hrushoviane. Jeta tregoi se kjo përdorej nga N. Hrushovi për t'u lidhur e për t'u afruar me imperializmin amerikan, duke tradhtuar interesat e socializmit. Fakt është se bashkekzistenca hrushoviane nuk dha asnjë rezultat pozitiv për paqen botërore: tensioni ndërkombëtar nuk u ul, përkundrazi, rreziku i luftës dhe agresiviteti i imperializmit janë shtuar. Çarmatimi nuk u arrit, përkundrazi, me politikën hrushoviane imperialistëve iu krijuan kushte të favorshme për t'u armatosur, ndërsa vendeve socialiste iu mohua një gjë e tillë. Politika e bashkekzistencës paqësore hrushoviane dështoi, ashtu siç pësoi fiasko të plotë edhe vija revizioniste e marrjes së pushtetit me rrugë paqësore e parlamentare.

Politika e bashkekzistencës hrushoviane u përdor për të degjeneruar sistemin socialist sovjetik, me qëllim që ky «të liberalizohej», «të demokratizohej», të bëhej «oksidental», pra të bëhej i pranueshëm për borgjezinë dhe të zhdukej frika e «gogolit» të komunizmit. Kjo politikë tradhtare hrushoviane u mbështet plotësisht nga gjithë revizionizmi modern, dhe gjeti për-

krahjen e borgjezisë ndërkombëtare, e cila jo rastësisht deklaronte se «Hrushovi ishte njeriu i besuar i Perëndimit në Moskë». Këto tradhti të N. Hrushovit, lëshimet e tij ndaj imperializmit amerikan në dëm të socializmit, u pagëzuan si «ulje të tensionit».

Partia jonë, parti të tjera motra dhe gjithë marksistë-leninistët, kanë luftuar me guxim kundër kësaj politike tradhtare të revizionistëve. Hrushovianët na quajtën «luftënxitës» por jeta provoi se ne jemi marksistë revolucionarë, luftëtarë kundër imperializmit, mbrojtës të vendosur të Bashkimit Sovjetik, të revolucionit dhe të paqes. Marksistët janë partizanë të bashkekzistencës paqësore leniniste, por jo për të tradhtuar socializmin, jo për t'i bërë lëshime imperializmit, jo për ta kufizuar këtë vetëm në marrëdhëniet me fuqitë e mëdha imperialiste, por për të mbrojtur socializmin e revolucionin, për të forcuar mbi bazën e saj miqësinë dhe bashkëpunimin me të gjithë popujt e botës. Marksistë-leninistët dhe gjithë popujt janë dhe do të luftojnë për çarmatimin e përgjithshëm, por duke shqelmuar krejtësisht lëshimet tradhtare të N. Hrushovit ndaj imperialistëve, duke ia imponuar çarmatimin imperializmit, duke forcuar fuqinë mbrojtëse të vendeve socialiste dhe vendeve të porsaçliruara në qoftë se imperialistët vazhdojnë garën e armatimeve.

Për t'u vënë në rrugën e drejtë leniniste duhen vepra e jo fjalë: duhet denoncuar politika tradhtare e N. Hrushovit dhe afrimi i tij me imperializmin, duhet dënuar politika e tij aventureske e kapitulluese në ngjarjet e Kubës dhe të mbështetet pa rezerva populli vëlla kuban në luftën e tij kundër agresionit imperialist

amerikan; duhet denoncuar traktati tripalësh i Moskës si një akt tradhtie ndaj interesave të Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste; duhet përfunduar traktati i paqes me Gjermaninë dhe të zgjidhet problemi i Berlinit ashtu siç është vendosur prej kohësh bashkërisht; duhet të dënohet politika luftënxitëse e agresive e imperialistëve amerikanë kundër Republikës Popullore të Kinës, ajo e pushtimit të tokës kineze, Tajvanit, agresioni kundër Republikës Demokratike të Vietnamit etj. Lufta e drejtë e konsekuente e marksistë-leninistëve nuk duhet dhe nuk do të pushojë pa u arritur këto qëllime.

Rivendosja e unitetit të kampit socialist dhe e lëvizjes komuniste e punëtore mund dhe duhet të bëhet vetëm mbi bazën e marksizëm-leninizmit

Veprimet tradhtarë të revizionistëve hrushovianë i kanë shkaktuar dëme shumë të mëdha çështjes së unitetit të kampit socialist. Hrushovianët e titistët kanë punuar intensivisht për shpartallimin dhe shthurjen e kampit socialist, këtij realiteti të kohës sonë, kësaj fitoreje të madhe të të gjithë klasës punëtore të botës. Ky veprim tradhtar ishte i dëshiruar dhe u përkrah aktivisht nga imperializmi amerikan.

Tashmë dihet edhe nga armiqtë se në gjirin e kampit socialist ka kontradikta të mëdha, jo vetëm midis marksistëve e revizionistëve, por edhe midis vetë revizionistëve. Këto kontradikta janë shfaqur në të gj-

tha fushat: në atë ideologjike, politike, ushtarake e në fushën e marrëdhënieve ekonomike. Si rrjedhim i politikës tradhtare të revizionistëve, në marrëdhëniet midis vendeve socialiste kanë gjetur terren të përshtatshëm tendenca të shëmtuara e antimarksiste, si politika shoviniste e shtetit të madh dhe e «partisë mëmë», politika e diktatit, e spekulimit dhe e shfrytëzimit, ndjenjat nacionaliste dhe të zhatjes nga njëri-tjetri etj.

Nuk do të ndalem në shembuj të tjerë për të përkthuar situatën e rëndë në të cilën gjenden marrëdhëniet në kampin socialist. Është fakt i padiskutueshëm që rivendosja e unitetit mbi bazat aktuale, pa spastruar me guxim dhe nga rrënjët padrejtësitë dhe politikën revizioniste, as që mund të mendohet.

Uniteti i kampit socialist është një gjë e shtrenjtë për të gjithë punonjësit e revolucionarët e botës, sepse ai përfaqëson shtyllën kurrizore të unitetit të të gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare për sot, nesër e përgjithmonë. Pa u rivendosur uniteti në kampin socialist nuk është e mundur të rivendoset ai në gjirin e gjithë komunizmit ndërkombëtar. Prandaj partitë e vendeve socialiste kanë një përgjegjësi të madhe jo vetëm para popujve të tyre, por edhe përpara gjithë komunistëve të botës.

Rivendosja e unitetit të kampit socialist duhet të bëhet me vepra konkrete, duke flakur me guxim çdo gjë të huaj e antimarksiste, pra burimin e të këqijave, dhe duke përcaktuar sipas mësimëve leniniste detyrat dhe rrugën tonë të ardhshme. Sipas mendimit tonë, duhet shqelmuar gjithë platforma revizioniste mbi të cilën mbështeten sot marrëdhëniet midis vendeve socia-

liste; duhet rishikuar dhe të vihet në rrugë marksiste-leniniste bashkëpunimi ekonomik, politik e ushtarak, si dhe të gjitha marrëveshjet themelore që rregullojnë marrëdhëniet në gjirin e tërë vendeve të kampit socialist; duhen përcaktuar bashkërisht dhe me unanimitet të plotë të drejtat dhe detyrat e çdo shteti socialist, përkrahja reciproke, duke mbajtur parasysh si interesat e sovranitetin e secilit, ashtu edhe interesat e përgjithshme të kampit socialist; duhet të respektohen parimet e ndihmës për njëri-tjetrin, duke flakur tej si qëllimet shoviniste, ashtu edhe ato nacionaliste: ndihma nuk duhet të përdoret as si mjet për t'i mbajtur të tjerët nën presionin e ndokujt, as si mjet për të zhvatur dhe për ta dobësuar atë që e jep. Vetëm një unitet i vënë mbi binarë të tillë zhduk komandimin e shtetit të madh dhe krijon fuqinë e vërtetë të kampit socialist, zhduk tendencat nacionaliste dhe forcon internacionalizmin, zhduk revizionizmin dhe forcon marksizëm-leninizmin, zhduk tendencat e shfrytëzimit e të spekulimit ekonomik e politik dhe nuk lejon më të bëhen presione e shantazhe të çdo lloji. Një kamp socialist i tillë është tmerr për imperializmin, është siguria për paqen botërore, është ndihma më e madhe për çlirimin dhe për begatinë e popujve në botë, është garanci për triumfin e revolucionit, socializmit dhe komunizmit.

Partia jonë mendon se në këtë drejtim duhet parë edhe ndihma për vendet që luftojnë kundër kolonializmit, që është një detyrë e rëndësishme për kampin socialist. Kjo ndihmë duhet të jepet në mënyrë vëllazërore e pa interesa të ndyra politike. Popujt e vegjël e të pazhvilluar të Afrikës e të kontinenteve të

tjera duan miqësi të sinqertë e jo fjalë. Nuk ka asgjë të përbashkët me marksizmin e internacionalizmin ajo ndihmë që u jepet popujve si lëmoshë nga revizionistët modernë dhe që përdoret për t'u grabitur pasuritë natyrore e aq më pak kur ajo ndihmë u pritet për t'u bërë presion, për të organizuar edhe komplete për rrëzimin e udhëheqësve të këtyre popujve, sepse këta nuk i pëlqekan dikujt. Këto metoda u përkasin kapitalistëve kolonialistë. Shekuj me radhë kanë vuajtur prej tyre popujt vëllezër heroikë të Afrikës e të kontinenteve të tjera. Pikëpamjet e shovinizmit të shtetit të madh, se me para e me kërcënime mund të dominohen popujt e vegjël e të pazhvilluar, nuk mund të realizohen në shekullin e leninizmit. Marksizëm-leninizmi, drejtësia, forca e madhe e popujve, nuk do të të lënë të veprosh për shumë kohë si ta do qejfi yt kapitalist, borgjez, revizionist. Historia e popujve ka dhënë dhe po jep çdo ditë prova të mëdha në këtë drejtim.

Uniteti i kampit socialist mund të arrihet në qoftë se më parë, nëpërmjet mbledhjesh dypalëshe e shumëpalëshe do të zgjidhen mosmarrëveshjet që ekzistojnë sot midis vendeve të ndryshme socialiste. Partia jonë ka qenë dhe është kurdoherë e gatshme për një gjë të tillë, sepse këtë e diktojnë interesat e përgjithshme të kampit socialist. Por ne kemi deklaruar dhe përsëri e theksojmë se, për t'iu hapur rruga bisedimeve dypalëshe, ku Republika Popullore e Shqipërisë të gjendet në pozita me të vërtetë të barabarta e jo si e akuzuar, duhet që qeveria sovjetike të pranojë botërisht gabimet e veta dhe dëmet materiale që u ka shkaktuar Republikës

Popullore të Shqipërisë e popullit shqiptar me veprimet e veta të njëanshme e antimarksiste. Ajo duhet të pranojë botërisht se, me iniciativën e saj, preu marrëdhëniet diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë; se ndërpreu të gjitha kreditë dhe organizoi bllokadën ekonomike kundër vendit tonë, duke i shkaktuar dëm të madh ndërtimit socialist në Shqipëri; se ka ndërhyrë në punët e brendshme të vendit tonë, duke shkuar aq larg sa të bëjë thirrje për përmbysjen e udhëheqjes së Partisë e të shtetit shqiptar; se ka shpifur kundër udhëheqësve shqiptarë, duke i quajtur ata agjentë të imperializmit etj., etj.

Kjo kërkesë e popullit dhe e Partisë sonë është e ligjshme, marksiste dhe parimore. Veprimet e sipërme të qeverisë sovjetike kundër Republikës Popullore të Shqipërisë nuk janë gabime «teknike», ato kanë bazën e tyre ideologjike e politike.

Ndoshta udhëheqësit e sotëm sovjetikë do të dëshironin dhe mendojnë që, megjithëkëtë, ne, shqiptarët, duhet të shkojmë në Moskë dhe të përulemi përpara tyre, sepse ne jemi vend i vogël, kurse ata përfaqësojnë një vend të madh. Ose ndoshta mendojnë se tani që u shkarkua N. Hrushovi, ata e kanë ndërgjegjen të qetë ndaj Partisë e popullit shqiptar. Është e qartë se në të dy rastet ata gabojnë rëndë. Marksizëm-leninizmi nuk njih të madh e të vogël, por njih vetëm të barabartë midis të barabartëve, prandaj kush është fajtor, duhet të njohë fajet. Për sa i përket çështjes tjetër, dihet se ato çka u thanë e u bënë kundër Partisë së Punës të Shqipërisë e popullit shqiptar, nuk ishin vetëm veprim-

me personale të N. Hrushovit, por, siç kanë qejf të përsëritin vetë udhëheqësit sovjetikë, ishin vendime kolegjiale. Bile ato jo vetëm janë vendosur nga Presidiumi i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por u aprovuan edhe nga plenumi i Komitetit Qendror dhe iu shtruan edhe Kongresit të 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Dihet gjithashtu se, që të aprovoheshin nga kongresi dhe më vonë që qëndrimet e udhëheqësve sovjetikë ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë të bëheshin «vijë e përgjithshme e lëvizjes komuniste», në sulmet shpifëse kundër Partisë e vendit tonë morën pjesë aktive Mikoiani, Kosigini, Brezhnjevi, Suslovi etj. Prandaj fakti që në krye të qeverisë sovjetike nuk është më Hrushovi nuk e prek aspak thelbin e problemit. Përgjegjësia për të gjitha veprimet antishqiptare rëndon mbi udhëheqjen e Bashkimit Sovjetik dhe asaj i përket t'i korrigjojë ato me guxim. Vetëm kështu mund të krijohen konditat e barazisë, të nevojshme për bisedime dypalëshe dhe për rivendosjen e unitetit të kampit socialist.

Një krim serioz e me pasoja të rrezikshme i vijës hrushoviane është rehabilitimi i klikës së Titos. Gjatë shumë vjetëve dhe me fakte konkrete, jo vetëm teorikisht, por edhe praktikisht, është provuar se klika titiste është agjentura më agresive dhe më e rrezikshme e imperializmit amerikan, e specializuar në luftë kundër lëvizjes komuniste dhe vendeve socialiste, si dhe për sabotimin e lëvizjes antiimperialiste të popujve të ndryshëm. Partia jonë ka luftuar dhe lufton me këtë klikë tradhtarë pothuajse gjatë gjithë ekzistencës së vet

23-vjeçare. Mbi kurrizin e tyre Partia dhe populli ynë e kanë provuar gjithë arsenalin e armëve të socializmit specifik jugosllav: intrigat, diversionin, komplotet, shpifjet, provokacionet në kufi etj., etj. Por përpara viggjilencës dhe vendosmërisë së popullit tonë të gjitha këto armë revizionisto-shoviniste kanë dështuar. Veprimet antishqiptare të klikës titiste nuk kanë mundur të cenojnë ndjenjat e miqësisë që lidhin popujt e Shqipërisë e të Jugosllavisë, të cilat u farkëtuan me gjak veçanërisht gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë. Me rastin e festës kombëtare të Jugosllavisë, populli ynë u dërgon popujve vëllezër të Jugosllavisë përshëndetjet e tij revolucionare dhe uron që idealet për të cilat ata luftuan të triumfojnë.

Grupi i Hrushovit është përpjekur shumë herë ta largonte Partinë tonë nga pozitat e saj parimore, ta detyronte atë që të hiqte dorë nga lufta kundër revizionizmit titist, nën pretekstet se gjoja këtë e kërkonte nevoja e luftës kundër imperializmit, meqë Jugosllavia paskësh 40 divizione me ushtarë, se në Jugosllavi po bëhej një kthesë dhe titistët po heqkan dorë nga shumë çështje të programit të tyre, se nuk duhej t'ua rritim vlerën para imperializmit duke folur për ta dhe se, në fund të fundit, për disa çështje parimore rreth të cilave ekzistojnë divergjencia, prapë do të vazhdohej polemika etj., etj. Por Partia jonë nuk ra në pozitat hrushoviane, ajo nuk u zmbraps nga rruga e saj, me gjithë kërcënimet dhe epitetet që na ngjiti Hrushovi, si «gjaknxehtë», «sektarë» etj. Jeta tregoi se kush kishte të drejtë. Hrushovi vajti në Beograd dhe iu përul Titos, hoqi

të ashtuquajturat mbishtresa, rehabilitoi hap pas hapi titizmin, u afrua dhe u puth me këtë armik të socializmit, ndërsa u hodh në luftë kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, që ndoqi me besnikëri mësimet e leninizmit dhe ka luftuar e lufton me konsekuencë për demaskimin e klikës titiste.

Grupi i Hrushovit, duke rehabilituar titizmin, i hapi rrugën dhe i krijoi kushtet e nevojshme kësaj agjente të imperializmit amerikan për të sabotuar kampin socialist dhe për t'i shtyrë vendet socialiste drejt degjenerimit dhe afrimit me imperializmin. Partia jonë, që e konsideron dobësimin e vigjilencës dhe pakësimin e luftës kundër titizmit si një rrezik serioz për fatet e socializmit, nuk do ta pushojë luftën e saj për demaskimin e klikës titiste. Ne jemi absolutisht të bindur se lëvizja komuniste dhe kampi socialist nuk mund të forcohen dhe të shkojnë përpara pa luftuar me guxim e vendosmëri agjunkturën më të shkathët e më të rrezikshme të imperializmit amerikan, pa vënë në jetë porositë e Deklaratës së Moskës të vitit 1960 mbi nevojën e luftës konsekuente kundër revizionizmit modern jugosllav.

Mendimi i Partisë sonë është se vetëm duke hedhur poshtë dhe duke korrigjuar me guxim bolshevik vijën revizioniste në këto çështje themelore, krijohen kushtet për të ecur me të vërtetë në rrugën e marksizëm-leninizmit. Lenini dhe Stalini mësojnë se serioziteti i një partie revolucionare shprehet në qëndrimin që mban ajo ndaj gabimeve të veta. Dhe për këtë duhen jo formula mashtruese, por fakte e veprime konkrete. Partia jonë do të përshëndetë çdo hap pozitiv që mund

të bëhet në këto drejtime. Ky është një qëndrim parimor, i cili përputhet me gjithë vijën marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Ne, shqiptarët, shpeshherë revizionistët na kanë akuzuar si «gjaknxehetë» dhe bile «kokëfortë», por ne jemi të bindur se nuk jemi të tillë, ne veprojmë si marksistë-leninistë. Në fakt ata që na akuzojnë kështu, siç duket, harruan se, nën drejtimin e N. Hrushovit, nuk u treguan aspak korrektë e gjakftohtë me Partinë e Punës të Shqipërisë, por u sollën padrejtësisht dhe me sulme e shpifje nga më të shtururat kundër saj. Ata, siç duket, harruan se, megjithëse kishte plotësisht të drejtë, Partia e Punës e Shqipërisë asnjëherë nuk iu përgjigj sulmeve dhe shpifjeve të tyre, por u përmbajt. Në rast se ata flasin për borxhe, duhet të dinë se ata janë borxhlinj ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe jo kjo ndaj tyre. Kështu është puna edhe me kokëfortësinë. Ne, po, jemi kokëfortë dhe nuk lëshojmë në parimet, nuk u besojmë frazave boshe e premtiveve demagogjike hrushoviane. Dhe këtë e quajmë një veprim të drejtë. Por megjithëkëtë, ne u bëjmë thirrje atyre që janë gabuar që të gjejnë forca dhe të vihen në rrugë të drejtë. Ata do të kenë gjithë përkrahjen tonë dhe do të shohin se ne nuk jemi aspak kokëfortë. Kthesa nuk mund të bëhet duke shpresuar se me rrëzimin e N. Hrushovit çdo gjë do të rregullohet. Kthesa përgatitet dhe fitohet me luftë revolucionare, duke dënuar e duke demaskuar hapur tradhtinë e Hrushovit e të grupit të tij, sepse nuk mund të korrigjohen gabimet duke e ruajtur Hrushovin, duke e mbajtur çështjen e tij të mbyllur brendapërbrenda partisë, siç po përpiqen

ta mbajnë gjithë revizionistët modernë. Kjo është një përpjekje për të mbrojtur tradhtinë, sepse vënia në dukje e tradhtisë së N. Hrushovit do të dëmtonte e do të demaskonte gjithë kursin revizionist, në të gjitha çështjet kardinale për të cilat folëm.

Partia e Punës e Shqipërisë, si gjithë marksistë-leninistët revolucionarë, do të luftojë me guxim për arritjen e fitoreve të reja mbi revizionizmin. Lufta jonë dhe polemika e hapët, parimore, do të vazhdojnë pa pushim, derisa të shqelmohen pozitat hrushoviane në gjithë vijën.

Periodha që po kalon lëvizja komuniste ndërkombëtare është një periudhë vështirësish e mosmarrëveshesh të thella. Çështja e unitetit të lëvizjes sonë preokupon sot me të drejtë gjithë komunistët e ndershëm në botë. Të gjithë revizionistët flasin për unitet, të gjithë revizionistët përpiqen ta rrëmbejnë flamurin e unitetit. Partia jonë mendon se parulla e luftës për unitet nuk është një parullë e thjeshtë, që mund të përdoret për qëllime taktike, por përbën një problem shumë serioz, parimor dhe kyç, si për të sotmen ashtu edhe për të ardhmen e komunizmit ndërkombëtar.

Disa kohë më parë grupi i Hrushovit, me parullën e unitetit, projektoi thirrjen e një mbledhjeje fraksioniste ndërkombëtare, e cila në të vërtetë do t'i shërbente përçarjes dhe aspak unitetit. Por ai dështoi. Kohët e fundit projekti hrushovian u nxor përsëri mbi tavolinë, i shoqëruar me një zhurmë të përgjithshme se tani qenka imperative mbledhja e komunizmit ndërkombëtar.

Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë dhe është për

thirrjen e mbledhjes ndërkombëtare të komunizmit, po për një mbledhje që efektivisht t'i shërbejë forcimit të unitetit të lëvizjes sonë. Sot në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare mungon uniteti, si rrjedhim i veprimtarisë përçarëse të revizionistëve modernë. Kjo është e keqja themelore. Prandaj rëndësia dhe detyra e mbledhjes së komunizmit ndërkombëtar qëndrojnë në zhdukjen e divergjencave, në vendosjen e unitetit të vërtetë marksist-leninist. Qëllimi i saj nuk mund të jetë përgatitja e një dokumenti të ri, të mbushur me formula kauçuku, dhe as të shpallë formalisht se u arrit njëfarë uniteti, i cili, pas disa muajsh, do të tronditet përsëri me siguri nga divergjenca të reja dhe nga ringjallja e polemikës publike.

Partia jonë mendon se, për të siguruar unitetin e vërtetë marksist-leninist dhe për të zhdukur divergjencat, më parë është e domosdoshme të merren masa serioze dhe të bëhet një punë e madhe, në mënyrë që të përgatiten të gjitha kushtet e domosdoshme për suksesin e mbledhjes ndërkombëtare.

Siç e shprehëm edhe më sipër, ne mendojmë se, për të siguruar unitetin e vërtetë në gjirin e lëvizjes komuniste, para së gjithash, duhet të rivendoset uniteti i kampit socialist, që përbën strumbullarin rreth të cilit mund të forcohet e të çelikoset uniteti i gjithë lëvizjes komuniste e revolucionare. Jeta ka treguar se divergjencat dhe përçarja në gjirin e kampit socialist kanë ushqyer divergjencat e përçarjen në gjirin e vetë lëvizjes komuniste. Pa u arritur uniteti i kampit socialist, asnjë mbledhje ndërkombëtare e komunizmit

nuk mund të sigurojë unitetin e vërtetë të lëvizjes komuniste.

Veç kësaj, për të arritur rezultate pozitive në mbledhjen ndërkombëtare, qysh më parë duhen zgjidhur, veç atyre që përmendëm më lart, edhe disa çështje me rëndësi parimore.

Revizionistët, me qëndrimet dhe me veprimet e tyre antimarksiste, kanë krijuar shumë koncepte të shtrembra mbi vetë kuptimin e unitetit dhe mbi rolin e detyrat e partive të ndryshme për ruajtjen dhe për forcimin e tij. Kështu, në praktikën e punëve ekzistenca e «dirigjentit», e «partisë mëmë», që është «e pagabueshme» dhe që mund të zgjidhë gjithçka, kurse të tjerat duhet të jenë bisht i saj dhe mund të gabojnë; ekzistenca e mendimit se vetëm një parti mund të interpretojë marksizmin, kurse të tjerat jo etj., etj., të gjitha këto janë bërë si rregulla «të shenjta», megjithëse askund të shkruara. Si reaksion i këtyre rregullave dhe i të ashtuquajturit liberalizëm që ka krijuar revizionizmi, janë forcuar e janë zhvilluar tendencat «autonome», jo nga dirigjenti, sepse me të janë lidhur kockë e këmbë udhëheqësit revizionistë, por nga marksizëm-leninizmi, nga internacionalizmi proletar.

Pa hedhur poshtë kategorikisht këto pikëpamje antimarksiste, revizioniste e shoviniste dhe pa vënë pikat mbi «i», mbi këto çështje, është krejt formale e pa asnjë rezultat çdo përpjekje për unitet të çeliktë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Marksizëm-leninizmi është busull veprimi për çdo parti revolucionare të proletariatit

Marksizëm-leninizmi është një e vërtetë e madhe, universale. Ai nuk është dogmë, por të vërtetat e marksizëm-leninizmit nuk mund të shpërdorohen sipas qejfit të njërit ose të tjetrit, duke u fshehur pas parullës së drejtë: «T'i zbatojmë ato sipas vendit dhe kohës». Marksizëm-leninizmi është busull veprimi për çdo parti. Çdo parti mundet dhe duhet ta zbatojë marksizëm-leninizmin në konditat dhe në rrethanat e vendit të saj, por busulla tregon pa u gabuar pikat kardinale. Dhe në rast se me zor do të përpiqesh që veriuin ajo të ta tregojë në jug dhe lindjen në perëndim, pavarësisht se mund të thërrasësh që ke një busull në dorë, ajo mund të jetë çdo gjë, por jo busull. Kështu është edhe me zbatimin korrekt të ligjeve universale të marksizmit.

Mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit nuk mund të jenë monopoli i disa partive. Ato janë thesari i njerëzimit, i mbarë komunistëve. Ka parti ose njerëz që përpiqen të spekulojnë për të nxjerrë përfitime antimarksiste nga ajo që Marksit dhe Engelsi ishin me kombësi gjermane, ose që Lenini e Stalini ishin anëtarë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Nga ky fakt, sipas këtyre partive e njerëzve, çdo gjë që thonë ata dhe udhëheqësit e tyre, pavarësisht se ata thonë gjepura revizioniste, qenkan ligj i së vërtetës dhe interpretim autentik i mendimeve të klasikëve. Kjo pikëpamje duhet të shqelmohej, sepse është antimarksiste.

Për të hedhur bazat për një unitet të çeliktë në lëvizjen komuniste, duhen flakur tej konceptet që kanë kultivuar revizionistët mbi nevojën e «dirigjentit», ose të ndjekjes qorrazi të vijës së një partie: Partia jonë mendon se dirigjent i komunistëve është vetëm marksizëm-leninizmi, ai i udhëheq ata, ai dhe parimet e internacionalizmit proletar i bashkojnë në luftën e tyre të madhe. Besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit dhe solidariteti ndaj partive motra, ndaj shokëve e miqve, që u përmbahen gjithashtu me besnikëri parimeve të marksizëm-leninizmit, çështjes së socializmit e të komunizmit, është një detyrë e shenjtë për çdo parti revolucionare. Partia jonë qëndron me këmbëngulje në këto parime. Në të njëjtën kohë, duke respektuar normat leniniste, çdo parti duhet të kritikojë me kurajë gabimet e fajet e një partie tjetër motër. Partia jonë e ka bërë dhe do ta bëjë këtë gjë, kurdoherë, shoqërisht e pa drujtje. Ajo ka kritikuar dhe do të kritikojë ato parti ose ata shokë që, sipas mendimit të saj, gabojnë dhe do të luftojë pa mëshirë e deri në fund kundër atyre që tradhtojnë. Me ato parti dhe ata njerëz që njohin gabimet, që i ndreqin dhe që japin prova për këtë, ne kurdoherë do të sillemi si leninistë.

Duke ia njohur këto të drejta Partisë sonë, njëkohësisht ne i njohim të drejtën çdo partie motër dhe çdo komunisti që edhe ata të veprojnë po në këtë mënyrë ndaj nesh, kur e gjykojnë se Partia jonë gabon. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen, gjyqtari më i mirë për të treguar se kush ka të drejtë është praktika, koha, por jo koha plot «qetësi», plot «heshtje», e «indiferencë», por koha plot polemikë të bazuar në fakte,

në dokumente, polemikë revolucionare e konstruktive e jo me shpifje e gënjeshtër.

Pa i kuptuar drejt, pa i pranuar dhe pa krijuar kushtet reale efektive për ushtrimin e këtyre të drejtave të partive komuniste, nuk mund të rivendoset uniteti i çeliktë. Në parim dhe me fjalë këto të drejta e detyra njihen edhe sot, por është fakt se kur Partia jonë i përdori në Mbledhjen e Bukureshtit, apo në atë të Moskës, mbi ne u lëshuan të gjitha rrufetë e grupit të Hrushovit e të pasuesve të tij.

Jeta ka treguar se çdo parti komuniste, e vogël apo e madhe qoftë, mund të gabojë. Prandaj ajo parti që gabon, qoftë e madhe ose e vogël, duhet të kritikohet, të njohë gabimet, që të ndreqet. Vetëm kjo rrugë është marksiste. Të mos kritikohet as njëra as tjetra, ky është oportunizëm dhe prish punë; të mos kritikohet e vogla është e padrejtë; të kritikohet e vogla dhe të harrohet e madhja, është servilizëm; të fshehësh gabimet e partisë së madhe e të mos e kritikosh atë, kjo i ka të gjitha të këqijat brenda, pasi një parti e madhe me një vijë të gabuar shkakton dëme kolosale.

Uniteti i vërtetë kërkon marrëdhënie krejt shoqërore midis partive, sepse çdo parti ka nevojë për përkrahjen dhe për eksperiencën e një partie tjetër. Eksperienca e çdo partie është një thesar i madh i të gjithëve dhe duhet të shfrytëzohet nga të gjithë. Por asnjë presion nuk mund dhe nuk duhet të ushtrohet nga një parti mbi parti të tjera për t'u imponuar këtë ose atë eksperiencë. Kjo në asnjë mënyrë nuk përjashton këshillat shoqërore dhe as kritikën karshi atij që shkel parimet.

Pa u përcaktuar qartë normat e marrëdhënieve midis partive, nuk mund të ketë asnjë siguri se mund të arrihet uniteti që dëshirojnë revolucionarët e marksistët e vërtetë. Është e qartë se ne marksistë-leninistët, kur flasim për unitet, kemi parasysh unitet mbi baza leniniste, parimore, e jo mbi baza revizioniste e kompromisesh. Ne duam, jemi dhe luftojmë për një unitet të atillë ku të mos ketë vend as për revizionizmin, as për dogmatizmin.

Uniteti i vërtetë mund të arrihet e të forcohet vetëm nën flamurin e marksizëm-leninizmit dhe me përpjekjet e përbashkëta të të gjitha partive motra. Ai nuk mund të arrihet as me takime e bisedime vetëm midis dy partish, as edhe me bisedime midis udhëheqësish, që nuk shprehin mendimet dhe vullnetin e vërtetë të masës së komunistëve. Unitet efektiv është vetëm ai që vendoset midis popujsh, midis partish që njohin hollësisht ndjenjat, mendimet dhe aspiratat e njëri-tjetrit.

Revizionistët hrushovianë kanë bërë shumë për t'i shkëputur popujt e komunistët nga njëri-tjetri, për t'i mbajtur në errësirë e në injorancë të plotë mbi kontradiktat, mbi mendimet e shokëve e vëllezërve të tyre përtej barrikadës. Prandaj Partia jonë kurdoherë ka qenë dhe është e mendimit se masa e parë që duhet marrë para se të mblidhen udhëheqësit, është të informohen plotësisht partitë e komunistët mbi mosmarrëveshjet ideologjike, jo sipas dëshirës së «agjitorëve» të parapërgatitur, por mbi bazën e materiale kryesore të partive motra, të caktuara prej vetë këtyre, që duhet t'u shpërndahen gjithë komunistëve. Vetëm kështu mund të gjykojë vetë partia, mund të

vendosë ajo dhe t'i diktojë udhëheqjes së saj çfarë duhet të bëjë. Tanimë nuk duhen betime mbi zbatimin e normave leniniste, por të vihen ato në jetë.

Partia jonë mendon se një rrugë e tillë krijon kushtet e favorshme për zgjidhjen e divergjencave, ndihmon rivendosjen e unitetit dhe përgatit terrenin për suksesin e një mbledhjeje të komunizmit ndërko-mbëtar. Për një mbledhje të tillë dhe për një unitet luftarak, marksist-leninist, Partia jonë do të luftojë me konsekuencë edhe në të ardhmen.

Uniteti i vërtetë i lëvizjes komuniste do të arrihet nëpërmjet luftës së vendosur parimore të marksistë-leninistëve. Fitorja që arritën këta me likuidimin e N. Hrushovit do të pasohet, pa dyshim, me fitore të tjera të mëdha. Forcat e marksizëm-leninizmit po rriten me shpejtësi. Partia jonë përshëndet me gjithë zemër krijimin e partive komuniste marksiste-leniniste të Australisë, të Brazilit, të Cejlonit etj. Ne përshëndetim gjithë komunistët revolucionarë që janë bashkuar në grupe antirevizioniste, si ato të Italisë, Francës, Austrisë, Anglisë, Holandës, revolucionarët spanjollë, portugezë, të Kilit, të Kolumbisë e të vendeve të tjera. Partia jonë përshëndet të gjithë ata komunistë që, brenda radhëve të partive komuniste e punëtore ku në udhëheqje janë revizionistët, luftojnë për triumfin e marksizëm-leninizmit. Veprimtaria revolucionare e partive dhe e grupeve të krijuara ka tronditur seriozisht radhët e revizionistëve modernë. Perspektiva e luftës dhe e fitores së komunistëve revolucionarë është shumë e mirë. E ardhmja u përket atyre, kurse revizionistët janë të destinuar të falimentojnë.

Partia e Punës e Shqipërisë do të forcojë unitetin marksist-leninist me partitë e tjera motra që qëndrojnë me besnikëri në pozitë revolucionare të marksizëm-leninizmit, unitetin luftarak për mbrojtjen e pastërtisë dhe të parimeve të ideve të mëdha të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Partia jonë e konsideron si detyrën e vet internacionaliste që të forcojë bashkëpunimin e solidaritetin e saj me të gjithë revolucionarët antirevizionistë. Ajo do të përkrahë me të gjitha forcat e saj shokët, vëllezërit dhe bashkëluftëtarët e çështjes sonë të madhe.

Partia jonë, në këtë fazë të re në të cilën ka hyrë lufta me revizionizmin, është më e bindur se kurrë në drejtësinë e rrugës së saj marksiste-leniniste dhe e mbushur plot me besim për fitoren e pashmangshme mbi armikun më të egër të njerëzimit, imperializmin amerikan dhe mbi renegatët e marksizëm-leninizmit, mbi revizionistët hrushovianë, titistë dhe të çdo kallëpi tjetër.

Populli dhe Partia jonë e shohin të ardhmen më me optimizëm se kurrë

Të dashur shokë,

Rezultatet që ka arritur populli ynë gjatë këtyre njëzet vjetëve, sukseset e mëdha në zbatimin e vendimeve të Kongresit të 4-t të Partisë, plotësimi i mirë i detyrave të këtyre katër vjetëve të pesëvjeçarit të tretë dhe eksperiencia kolosale e fituar në luftën kundër pen-

gesave, vështirësive e armiqve të çfarëdoshëm, si dhe zhvillimi i situatës ndërkombëtare në përgjithësi, i bëjnë popullin dhe Partinë ta shohin të ardhmen më me optimizëm se kurrë. Këto rezultate janë një bazë e shëndoshë për të arritur suksese të reja, akoma më të mëdha, në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Së shpejti ne do të fillojmë nga puna për realizimin e planit të vitit të fundit të pesëvjeçarit të tretë. Ky vit do të jetë ai i zhvillimit të punimeve në shkallë të gjerë për vazhdimin e ndërtimit të një vargu veprash të mëdha industriale.

Partia dhe Qeveria po punojnë për hartimin e projektplanit të pesëvjeçarit të katërt. Ai do të shënojë një etapë të rëndësishme në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës popullore dhe në forcimin e mbrojtjes së vendit tonë. Gjatë këtij pesëvjeçari populli ynë, duke u mbështetur kryesisht në forcat e veta, do të zhvillojë më me hov ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit, në rrugën e kthimit të vendit tonë nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar. Kjo do të arrihet duke zhvilluar me hov prodhimin bujqësor nëpërmjet intensifikimit të shpejtë dhe kompleks të bujqësisë, që është baza e ekonomisë popullore dhe duke i dhënë një hov të mëtejshëm zhvillimit të industrisë, që është forca drejtuese e ekonomisë popullore, kryesisht nëpërmjet përdorimit maksimal e racional të kapaciteteve të reja, mbi bazën e lëndëve të para që sigurohen në vend. Të gjitha këto do të bëjnë të mundur të arrihet një rritje e mëtejshme e mirëqenies materiale dhe e nivelit kulturor të masave punonjëse.

Kështu, në një të ardhme jo shumë të largët, Shqipëria jonë do të bëhet një vend akoma më i bukur dhe gjithmonë më i lulëzuar, një vend ku akoma më me vrull do të ziejë puna krijuese e njerëzve tanë të mrekullueshëm. Me duart tona do të ngrihen njëra pas tjetrës vepra të reja që do të sigurojnë përpunimin në kompleks dhe me metoda moderne të naftës, zgjerimin e bazës energjetike, pasurimin e mineraleve të dobishme, shkrirjen e hekur-nikelit, shtimin e materialeve të ndërtimit, zhvillimin e mëtejshëm të industrisë kimike e mekanike, shtimin dhe zgjerimin e konsiderueshëm të prodhimit të mallrave të përdorimit të gjerë prej industrisë së lehtë e ushqimore. Në të katër anët e atdheut do të zgjerohen industria nxjerrëse, kërkimet gjeologjike për zbulimin dhe për rritjen e rezervave të mineraleve të dobishme etj.

Në të ardhmen, në kuadrin e përpjekjeve për të siguruar bukën në vend, ne do të prodhojmë shumë më tepër drithëra buke se më 1965; do të rriten gjithashtu edhe prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale, për të përmirësuar furnizimin e popullit, për të plotësuar nevojat e industrisë me lëndë të parë dhe për të rritur eksportin e tyre; do të zhvillohet në mënyrë të veçantë bujqësia në zonat malore; do të përfundohen objektet e bonifikimit dhe të ujitjes që janë në vazhdim dhe do të fillohen objekte të tilla të reja. Krahas këtyre, kodra të tjera do të shndërrohen në plantacione pemësh frutore, ulliri e agrumesh, do të përmirësohet ekonomia pyjore, do t'i kushtohet kujdes blegtorisë, për rritjen e përmirësimin e saj si në numër dhe në cilësi etj. Në të njëjtën kohë, zgjerime e përmirësime do të

bëhen në fushën e transportit automobilistik, hekurudhor e detar, në fushën e ekonomisë komunale me anë të mirëmbajtjes e ndërtimit më të shpejtë e më të shumtë të banesave, në atë të elektrifikimit të mëtejshëm të fshatrave, në fushën e arsimit, të kulturës, të shkencës dhe të shërbimit shëndetësor.

Parashikimet që bën Partia dhe perspektivat që ajo i hap popullit, nuk bazohen në gjykime subjektive dhe ireale, por në gjykime plotësisht objektive e reale, pasi ato nisen nga ligjet objektive të zhvillimit të socializmit, nga mësimet e marksizëm-leninizmit, nga eksperiencia jonë e pasur, nga gjendja dhe mundësitë konkrete të vendit tonë, nga gjendja e faktorët realë të jashtëm dhe interesat e socializmit në përgjithësi, nga aftësitë krijuese, vullneti i patundur dhe aspiratat e popullit tonë, të cilat kanë gjetur dhe do të gjejnë kurdoherë mishërimin e tyre në vijën e përgjithshme të drejtë të Partisë sonë, busulla jonë e pagabuar, që na prin në luftëra dhe fitore.

Po për t'i bërë realitet këto perspektiva, natyrisht, nuk është një punë e lehtë. Populli ynë është plotësisht i ndërgjegjshëm se, për t'i arritur ato, duhet një punë e madhe, duhet derdhur shumë djersë. Dhe ai, si kurdoherë, është i gatshëm për ta bërë këtë.

Që ndërtimi i socializmit të vazhdojë pa u ndalur dhe me sukses, duhet një mobilizim total i të gjitha masave punonjëse të vendit në çdo sektor dhe front pune: secili të kryejë në mënyrë shembullore detyrat e tij.

Partia dhe Qeveria u bëjnë thirrje klasës heroike punëtore, fshatarësisë së lavdishme kooperativiste, in-

teligjencies popullore, rinisë trime, grave patriote, ushtrisë sonë syptatrembur, të gjithë qytetarëve të Republikës sonë Popullore, që të mobilizohen e të punojnë me zjarr dhe shpirt krijues, me zgjuarsi dhe vendosmëri, të prodhojnë më shumë, më mirë dhe më lirë, të zotërojnë shkencën e teknikën dhe t'i vënë ato në shërbim të ndërtimit socialist, ta bëjnë sa më të bukur e të gëzueshme jetën e popullit dhe ta garantojnë atë nga çdo pikëpamje. Të forcohen më tej ndërgjegjja socialiste, patriotizmi popullor, besimi në forcat tona dhe fryma klasore revolucionare.

Ne e ndërtojmë socializmin në kushtet e rrethimit armiqësor imperialist e revizionist. Me gjithë disfatat që kanë pësuar deri më sot, armiqtë vazhdojnë të ëndërrojnë të prekin pavarësinë tonë, të përmbysin pushtetin popullor dhe të na rrëmbejnë fitoret e arritura me kaq gjak e djersë. Prandaj, ashtu si kurdoherë, detyrë e shenjtë për çdo shqiptar të ndershëm është të rritë vazhdimisht vigjilencën kundrejt armiqve imperialistë e revizionistë, të çelikosë çdo ditë e më shumë fuqinë mbrojtëse të atdheut dhe të mos harrojmë për asnjë minutë parullën e Partisë: «Të ndërtojmë socializmin duke mbajtur në një dorë kazmën e në tjetrën pushkën». Çdo punonjës, kudo që punon e jeton, ta konsiderojë veten ushtar të popullit, mbrojtës të vendosur të lirisë, të pavarësisë e të fitoreve socialiste të atdheut.

Por, ashtu si deri më sot, kyçi i të gjitha fitoreve tona ka qenë dhe mbetet uniteti i çeliktë i popullit me Partinë. Për ta shpënë çështjen e socializmit kurdoherë përpara, detyra numër një e të gjithëve është ta ruaj-

më si sytë e ballit dhe ta çelikosim vazhdimisht unitetin monolit midis Partisë dhe popullit. Tek uniteti Parti-popull qëndron forca jonë; këtu mbështeten shpresat dhe e ardhmja e ndritur e Shqipërisë së re.

Në të njëjtën kohë, populli ynë është i bindur se në luftën për realizimin e perspektivave dhe të ardhmes së tij të ndritur, ashtu si deri tani, do të ketë kurdoherë përkrah miq e shokë të panumërt, të cilët do ta ndihmojnë në mënyrë vëllazërore, internacionaliste.

Të dashur shokë,

Rruga e lavdishme që ka bërë populli ynë nën udhëheqjen e Partisë, e bën atë me të drejtë të jetë krenar. Por fitoret atë s'e kanë dehur kurrë dhe, aq më tepër sot, kur mbetet akoma kaq shumë për të bërë, ai s'fle mbi dafina. Vitet e luftës dhe të punës ndërtimore të këtyre 20 vjetëve e kanë pajisur popullin tonë me një eksperiencë kolosale dhe e kanë çelikosur së tepërmi. Ai kurrë s'ka pasur iluzione se ndërtimi i socializmit është një punë e lehtë dhe se mund të pritet si dhuratë. Ai s'u ka kthyer kurrë kurrizin armiqve, pengesave, vështirësive dhe rreziqeve kur ka qenë puna për këtë çështje të drejtë e të madhe, por është angazhuar në luftë me to dhe i ka mposhtur. Kështu do të ndodhë edhe në të ardhmen. Populli ynë është i paepur, ai ka energji krijuese të pashtershme dhe një shpirt të madh revolucionar, nuk ka dhe nuk do të ketë as sot as nesër forcë, pengesë e vështirësi që mund ta ndalë atë të ecë kurdoherë fitimtar në rrugën drejt komunizmit. Në këtë 20-vjetor të lavdishëm

ai rigrupon forcat për startin e ri drejt betejave të reja, drejt fitoreve të reja të pashmangshme gjithnjë më madhështore. Me të tillë popull revolucionar, të udhëhequr nga Partia e Punës, Shqipëria e re jo vetëm jetoi, luftoi e fitoi në këta 20 vjet, por do të rrojë, do të luftojë, do të fitojë e do të lulëzojë në shekuj.

Rroftë populli ynë trim, punëtor e liridashës!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, udhëheqësja dhe organizatorja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 286 (5068), 29 nëntor 1964

Botohet me ndonjë shkurtim sipas broshurës: «20 vjet Shqipëri e re socialiste» Tiranë, 1964

REVIZIONISTËT MODERNE JANË SABOTATORË TË LUFTËRAVE ÇLIRIMTARE TË POPUJVE

*Nga biseda me delegacionin e Frontit Kombëtar
të Çlirimit të Vietnamit të Jugut*

2 dhjetor 1964

Pasi miqtë nga Vietnami i Jugut zunë vend, shoku Enver Hoxha u interesua për gjendjen dhe shëndetin e tyre pas një rruge aq të gjatë prej Vietnamit gjer në Shqipëri. Mysafiri që kryeson delegacionin vietnamezojugor u përgjigj se ata janë mësuar me lodhje, e përballojnë lehtë atë, se janë mësuar të ngjiten nëpër malet e larta. Pastaj e mori përsëri fjalën

SHOKU ENVER HOXHA: Ne jemi shumë të gëzuar për ardhjen tuaj në Shqipëri. Kurdoherë që na vijnë shokë nga Vietnami i Jugut në vendin tonë, jo vetëm ndiejmë një kënaqësi të veçantë, por na duket sikur marrim forca të reja. Ne jetojmë këtu, në Shqipëri, në këtë skaj të largët të Ballkanit, por zemrën dhe mendjen i kemi edhe te ju, të dashur vëllezër vietnamezë. Çdo ditë ne rrojmë me ju, me luftën dhe me përpjekjet tuaja heroike. Lajmet e përditshme për luf-

tën tuaj legjendare na entuziazmojnë shumë, na i shtojnë edhe më tepër dashurinë dhe simpatinë që kemi për popullin e Vietnamit.

Ju, shokë vietnamezë, bëni një luftë nacionalçlirimtare, e cila nga karakteri i saj njëkohësisht ndihmon edhe popujt e vendeve socialiste dhe të gjithë popujt e tjerë në botë që luftojnë për çlirimin e tyre, sepse fitorja juaj është fitore për të gjithë ne. Dhimbjet tuaja janë edhe dhimbjet tona, sepse, kur vriten shokët tuaj në Vietnam, na duket sikur na vriten shokët tanë këtu në vendin tonë.

Luftën e popullit tuaj ne e konsiderojmë jashtëzakonisht të madhe edhe në kuptimin e eksperiencës së pasur që ajo po u jep popujve, të cilën ne e çmojmë shumë. Rëndësia e saj nuk gjykohet vetëm nga madhësia e popullit që e bën këtë luftë, por nga momentet kur bëhet, nga raporti i forcave ndërluftuese, nga taktikat dhe nga mjetet që përdoren.

Natyrisht, edhe armiqtë imperialistë amerikanë kanë eksperiencë të madhe në luftë. Juve, sigurisht, ju kujtohet se në kohën e luftës në Kore Stalini ka thënë që nuk duhet t'i nënvleftësojmë gjeneralët amerikanë. Me këtë dua të them se armiku nuk duhet nënvleftësuar, aq më tepër tani, kur imperialistët amerikanë në Vietnamin e Jugut po përdorin të gjithë zotësinë e tyre ushtarake dhe të gjitha mjetet e metodat e shfarosjes. Por, megjithëse po i përdorin këto, ata po thyhen vazhdimisht, kurse shokët dhe luftëtarët vietnamezë po fitojnë.

Lufta juaj çlirimtare, që së shpejti do të kurorëzo-

het me fitore, do të na armatosë të gjithë ne me eksperiencën tuaj të madhe, gjë që do ta forcojë akoma më tepër mbrojtjen tonë. Lufta juaj është një luftë me të vërtetë e lavdishme dhe heroike dhe tregon sa të lidhur jeni ju me popullin, ç'vullnet të fortë keni ju, shokët komunistë dhe partizanët vietnamezojugorë, që përballoni me kaq sukses armiqtë imperialistë, që po i bëni ata të dridhen dhe në Uashington. Ky është fakt. Sot preokupacioni më i madh, numër një, në Uashington, është lufta në Vietnam. Kenedi, Xhonsoni, Maknamara, Rasku, Ajzenhaueri e kanë thikën në grykë. Kur themi, pra, se lufta juaj është heroike, e lavdishme, këtë e bazojmë në fakte dhe jo në fjalë. Ne, shqiptarët, që kemi luftuar vazhdimisht, i vlerësojmë shumë dhe kemi respekt të madh për trimat dhe për luftëtarët. Jemi njerëz që duam paqen, po kur të tjerët përpiqen të na sundojnë, të na vrasin, atëherë ne s'pyesim më, por ngrihemi dhe nuk lëmë kusur kundër armiqve.

Është për këtë arsye që, kur na vini ju, shokë vietnamezë, në Shqipëri, ne sikur afrohemi edhe më shumë me Vietnamin e Jugut, me partizanët dhe me popullin tuaj luftëtar dhe të pamposhtur. Vietnami i Veriut dhe i Jugut përbëjnë një vend dhe një popull të vetëm, po ju jeni të detyruar të rrini përkohësisht të ndarë. Dhe që të bashkoheni me Veriun, ju vetë po luftoni duke qenë njëkohësisht të përkrahur edhe nga popujt e tjerë. Prandaj dita që do të bashkoheni do të vijë patjetër.

Ne e dimë se Vietnami i Veriut është angazhuar në një luftë të përbashkët me vëllezërit e Vietnamit të

Jugut kundër imperialistëve amerikanë. S'ka asnjë diskutim se pa e bërë shkrap, imperializmi nuk të lëshon asgjë.

Te Shqipëria e vogël, ju, shokë, keni miq dhe vëllezër, që ju duan me gjithë shpirt, keni shokë që janë të lidhur me ju me ndjenja të thella internacionaliste. Deri tani ne kemi bërë për ju sa kemi mundur, por në të ardhmen do të bëjmë edhe më shumë, se është në interesin tonë të përbashkët të njohim dhe të ndihmojmë edhe më tepër luftën tuaj.

Ju do të na gëzonit po të na tregonit vetë mbi gjendjen aktuale në Vietnamin e Jugut, por nga sa dimë ne, ju keni çliruar tani pjesën më të madhe të vendit, keni vendosur pushtetin në zonat e çliruara, kurse armiqtë janë strukur nëpër fortina. Është për këtë arsye që amerikanët bëjnë mbledhje dy herë në ditë për çështjen e Vietnamit të Jugut.

Pasi shprehu gëzimin për ardhjen në Shqipëri me rastin e festës së Çlirimit të vendit tonë, kryetari i delegacionit, midis të tjerash, tha:

Fjalët tuaja, shoku Sekretar i Parë, që shprehët për luftën heroike të popullit të Vietnamit të Jugut na emocionojnë pa masë dhe ju premtojmë se ato do t'ua transmetojmë të gjithë luftëtarëve dhe popullit të Vietnamit të Jugut.

Ju jeni mirë në dijeni mbi gjendjen e vendit tonë. Ne e dimë dhe e kuptojmë ndihmën që na keni dhënë ju, ajo përbën një përkrahje shumë të madhe për popullin tonë. Për ndihmën dhe përkrahjen tuaj ne ishim të sigurt përpara se të vinim në Shqipëri, por tani që

vizituar vendin tuaj, gjatë bisedave që patëm me udhëheqës të ndryshëm shqiptarë të Partisë dhe të pushtetit, në qendër dhe në rrethe, me komunistë dhe masat e popullit, me të rinj dhe studentë, kuptuam edhe më mirë përkrahjen dhe simpatinë tuaj për popullin e Vietnamit të Jugut. Kudo vumë re se përkrahja, shpirti, ndjenjat tuaja për luftën tonë dhe në përgjithësi për popullin vietnamez janë shumë të mëdha. Ne ju kemi konsideruar kurdoherë si vëllezërit tanë më të afërt.

Partia jonë, Fronti Kombëtar i Çlirimit të Vietnamit të Jugut, kanë porositur popullin tonë që gjithnjë të luftojë dhe të punojë duke pasur parasysh kurdoherë eksperiencën dhe traditat e mëdha luftarake të popullit shqiptar. Ju keni luftuar dhe keni çliruar atdheun dhe, më vonë, në kushtet shumë të vështira të rrethimit imperialist dhe revizionist, keni ndërtuar e po ndërtoni edhe socializmin. Në këto kushte të rënda ju keni ditur si t'i kaloni vështirësitë.

Si vëllezër, si shokë shumë të ngushtë që jemi, ju lutem, dua t'ju pyes, mund të më lejoni, po të keni kohë, se e di që jeni shumë të zënë me punë, t'ju flas pak për luftën që po zhvillohet tani në Vietnam?

SHOKU ENVER HOXHA: Posi, të na flisni, kemi kohë, me gjithë qejf do t'ju dëgjojmë.

KRYETARI I DELEGACIONIT: Revolucioni në Vietnamin e Jugut po bëhet në saje të udhëheqjes së Partisë së Punonjësve të Vietnamit. Po përse nuk flasim ne për partinë në Vietnamin e Jugut, por vetëm për Frontin Kombëtar të Çlirimit? Pikërisht sepse në

Komitetin e Frontit Kombëtar të Çlirimit nuk janë vetëm komunistët. Përveç nesh, në Front ka edhe nga ata që vishen me rroben e budistit, ka edhe nga ata që vishen me rrobat e priftërinjve katolikë dhe të feve të ndryshme. Gjithashtu, në arenën ndërkombëtare ne nuk bëjmë luftë direkte kundër revizionizmit modern. Këtë luftë e bëjmë sipas formave tona, për shkak se gjendja në Vietnamin e Jugut është pak e ndërlikuar.

Gjendjen e tanishme në Vietnamin e Jugut ne e konsiderojmë afër fitores. Tani kontrollojmë tri të katërtat e territorit të Vietnamit të Jugut me një popullsi prej 8 milionë banorësh, kurse armiqtë tanë kanë vetëm një të katërtën e territorit me gjithsej 10 milionë banorë. Forcat tona veprojnë gjer 10 kilometra në afërsi të kryeqytetit. Tani në duart e armiqve kanë mbetur vetëm qytetet e mëdha dhe rrjeti hekurudhor e automobilistik.

SHOKU ENVER HOXHA: Një agjenci lajmesh njoftonte ditët e fundit se forcat partizane të Vietnamit të Jugut kishin goditur një qytet 10 kilometra në afërsi të Sajgonit, ku kishin vrarë shumë ushtarë dhe oficerë amerikanë dhe kishin zënë shumë material luftarak, duke u vënë zjarrin të gjitha atyre që nuk i merrnin dot me vete.

KRYETARI I DELEGACIONIT: Tani ne jemi në gjendje të sulmojmë edhe kryeqendrat e qytetet kryesore, por këtë nuk duam ta bëjmë akoma, sepse duam të rigrupojmë mirë forcat që, kur ta godasim armikun, ta godasim gjer në palcë me forca më të mëdha. Duke grumbulluar këto forca, ne jemi duke përgatitur pak nga pak grushtin e fundit për armikun.

Vetë amerikanët po e konstatojnë superioritetin që kemi ne mbi ta. Ata e njohin gjendjen dhe tani po bëjnë të gjitha përpjekjet që të sulmojnë me të gjitha forcat. Por ne mendojmë se ata nuk janë në gjendje të dërgojnë në vendin tonë më shumë forca nga sa kanë dërguar gjer tani, megjithëse edhe këto nuk janë të pakta. Ata kanë pasur shumë humbje në Vietnamin e Jugut dhe, po të dërgojnë më shumë forca, humbjet e tyre do të shtohen, do të jenë edhe më të mëdha.

SHOKU ENVER HOXHA: Unë ju falënderoj për informacionin shumë të dobishëm që na dhatë. Ne do të përdorim të gjitha mjetet që kemi në dispozicion për të qenë gjithnjë afër jush. Kemi përgatitur dokumente për mbrojtjen e çështjes suaj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe ministri ynë i Punëve të Jashtme, që u nis dje për në OKB, do ta bëjë atje një mbrojtje të tillë. Unë e porosita atë, në mënyrë të veçantë, që të jetë në kontakt me përfaqësuesit e të gjithë popujve që luftojnë kundër imperializmit dhe në mbledhjen e Asamblesë së OKB-së të flasë në mënyrë të veçantë për luftën çlirimtare në Vietnamin e Jugut dhe kundër imperialistëve amerikanë.

Lufta që zhvillonit ju, me një rëndësi kaq të madhe dhe shkatërrimtare për imperializmin, nuk mund të bëhet pa pasur në udhëheqje një parti të fortë, të shëndoshë, marksiste-leniniste. Vetëm një parti e fortë, marksiste-leniniste mund të bëjë gjithçka për shkatërrimin gjer në fund të armiqve dhe për t'u dhënë atyre një grusht dërrmues. Janë bërë shumë luftëra të tjera të mëdha në kohën tonë, por lufta që po bëni ju

është jashtëzakonisht e madhe. Ju po bëni të dështojë strategjia e kreut të imperializmit botëror, imperializmit amerikan. Strategjia dhe taktika juaj në luftë dhe në arenën ndërkombëtare janë të rralla. Strategjinë dhe taktikën duhet t'i ndërtojë partia juaj, se ajo i njeh kushtet e vendit, fuqinë e Frontit Kombëtar të Çlirimit, mënyrat se si duhet bërë diferencimi midis klasave, shtresave, individëve, ajo di konkretisht si duhen përçarë armiqtë. Të gjitha këto ajo i di më mirë se kushdo tjetër, sepse mbështetet te populli dhe, të kesh popullin me vete, do të thotë të kesh të sigurt fitoren mbi armiqtë.

Partia jonë që në kohën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e kishte dhe e ka kurdoherë popullin me vete. Më lejoni t'ju them një episod të vogël. Një fshatari, në luftë, i ishte vrarë i biri, i cili qe partizan. Pas Çlirimit këtë fshatar e ngarkuan një herë të bënte propagandë në fshat në favor të Frontit Nacionalçlirimtar, por ai druhej dhe thoshte se nuk dinte të bënte propagandë, nuk dinte të fliste shumë. Më së fundi mori përsipër të fliste. Në mbledhje ai u tha dëgjuesve: «Shikoni, ka vetëm një parti që na çliroi. Jeni ju për këtë që ka bërë dhe thotë Partia? Po, iu përgjigjën dëgjuesit. Atëherë shumë mirë, me kaq konferenca mbaroi».

Kjo tregon që populli i kupton gjërat, di ku të kapet. Populli nuk lufton kot, ai di përse lufton, për lirinë e tij.

Edhe ne, sikurse ju, qeverinë popullore nuk e formuam qysh në fillim, por vetëm në pragun e Çlirimit, kur e pamë se e kishim të sigurt fitoren dhe mbasi demaskuam e likuiduam të gjitha orvatjet e imperialistë-

ve amerikanë dhe anglezë. Nën maskën e aleatëve ndodheshin në vendin tonë oficerë amerikanë dhe anglezë, të cilët bënë çdo gjë për të na penguar në luftën tonë. Vetëm pasi krijuam këto kushte, formuam Qeverinë tonë. Ne e dimë se në Vietnamin e Jugut, në zonat akoma të paçliruara, bëhet luftë kundër pushtesve dhe reaksionit të vendit nga shtresa të ndryshme të popullsisë. Por ne e kemi gjithashtu të qartë se në krye të kësaj luftime politike që bëhet atje është partia juaj, e cila bën gjithë këtë presion të madh kundër kukullave të Sajgonit.

Ju keni shumë të drejtë që zemëroheni kundër manovrave të revizionistëve modernë. Ne jemi të bindur se qysh ditën e parë që ju do të çlirohemi nga zgjedha e Imperialistëve amerikanë, revizionistët modernë do të përpiqen të gjejnë të çara për të ndërhyrë në çështjet tuaja, por ju keni një eksperiencë të gjatë në luftën kundër armiqve dhe do t'u tregoni vendin atyre.

E kush nuk e kuptonte se përpjekjet e N. Hrushovit për të mbrojtur gjoja luftën në Vietnamin e Jugut ishin një demagogji? Revizionistët modernë bëjnë një reklamë të madhe gjoja se ndihmojnë popujt që luftojnë për lirinë dhe për pavarësinë e tyre. Por ne e dimë mirë çfarë ndihme japin ata. Ne ata na kanë sabotuar, nuk na dhënë armatimet që kishim kontraktuar me marrëveshje të rregullta dhe synonin që, me heqjen e disa nëndetësve nga baza ushtarako-detare e Vlorës, t'i hapnin portat e Shqipërisë imperializmit amerikan në Mesdhe. Ata donin t'i merrnin të gjitha, por ne nuk i lamë. Kur ata e bënë një gjë të tillë kundër nesh, këtë mund ta bëjnë edhe me ju. Ata e dinë se lufta që bëni ju është një disfatë e madhe për imperializmin, prandaj, jo ve-

tëm që nuk do t'ju japin armë të luftoni miqtë e tyre, por do të përpiqen ta dobësojnë luftën tuaj. Edhe në momentet e fundit të luftës për çlirimin tuaj ata do të përpiqen të fusin hundët në Vietnamin e Jugut, të krijojnë situata për ta futur çështjen tuaj në diskutime ndër-kombëtare, me qëllim që ajo të hyjë në një rrugë pa krye dhe në këtë mënyrë të dështojë lufta juaj. Por, si në fushën diplomatike, ashtu edhe në fushën e luftës së nxehtë jemi të bindur se ata do të pësojnë kurdoherë disfatë.

Imperializmi amerikan, kur të shohë se çdo gjë në Vietnamin e Jugut ka marrë fund për të, ka mundësi që të përdorë edhe raprezalje të mëdha. Por ne jemi të bindur për fitoren tuaj dhe të jeni të sigurt se te populli dhe Partia jonë keni vëllezër dhe miq që do të jenë me ju gjer në fitoren përfundimtare.

Në emër të të gjithë shokëve të Komitetit Qendror të Partisë sonë ne ju shprehim edhe një herë admirimin e madh që kemi për gjithë popullin e Vietnamit dhe me të gjitha mundësitë që ne disponojmë do t'i vijmë në ndihmë popullit tuaj, duke bërë çdo gjë sikur të ishte çështja për luftën tonë.

Shqipërinë ta konsideroni si vendin tuaj. Do të ishte kënaqësi e madhe për ne t'ju kishim këtu për një kohë më të gjatë. Ne ju lutemi të keni parasysh që shokët tuaj, sa herë u takon rasti të vijnë në Evropë, të mos lënë pa ardhur edhe në Shqipëri.

KRYETARI I DELEGACIONIT: Para se të ndahe-mi, më lejoni t'ju japim një dhuratë modeste. Është një pushkë që quhet «Ponamamb» që Presidenti i Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut më ka

ngarkuar t'jua jap juve. Këtë e kanë bërë vetë partizanët. Është «topi» i parë i grave luftëtare vietnameze.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falënderojmë shumë për gjithçka dhe për dhuratën. Ky do të jetë një kujtim shumë i çmueshëm për ne. Ju urojmë me gjithë zemër të realizoni sa më parë fitoren e madhe mbi të gjithë armiqtë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

REVIZIONISTËVE HIRUSHOVIANË LITARI PO U MBLIDHET NË FYT DHE PO I SHTRËNGON

*Bisedë me një delegacion të Partisë Komuniste
dhe të Qeverisë së RP të Kinës*

10 dhjetor 1964

Pas këmbimit të përshëndetjeve dhe pasi miqtë dhe të gjithë të pranishmit zënë vend, e mori fjalën kryetari i delegacionit, Li Hsien Nien, i cili, ndërmjet të tjerash, tha:

Dua t'ju them, shoku Enver Hoxha, se delegacioni yrë ju është shumë mirënjohës për pritjen kaq të ngrohtë që na u bë kudo që shkuam. . .

Të gjithë shokët e delegacionit tonë kanë përshtypjen se me një parti aq të mirë si Partia juaj, me një vijë e q të drejtë dhe me masa punonjëse aq të mira, ju i keni patjetër të gjitha mundësitë për të arritur suksese dhe fitore akoma më të mëdha. Te ju Partia është e lidhur, e bashkuar shumë ngushtë me popullin. Për këtë arsye ajo është kaq e guximshme në luftën kundër imperializmit e revizionizmit modern dhe e vendosur gjer në fund për të korrur fitore. Neve na është krijuar

një përshtypje shumë e thellë dhe kemi mbetur shumë të kënaqur nga vizitat që bëmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falënderojmë shumë për fjalët që thatë në adresë të Partisë dhe të popullit tonë si dhe për ardhjen tuaj në vendin tonë me rastin e festës sonë të 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Ne kemi ndjekur me interes manifestimet e përziermërta që u bënë në Kinë me rastin e festës së 20-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, sidomos mitingjet e mëdha që u bënë në Pekin, ku morën pjesë më shumë se 20 mijë veta. Mitingje nuk u bënë vetëm në Pekin, por edhe në të gjitha qytetet kryesore të Kinës. Manifestime të zjarrrta, vëllazërore, shoqërore, të sinqerta për popullin shqiptar dhe për Partinë e Punës të Shqipërisë u bënë gjithashtu në shumë fabrika e institucione dhe në komune popullore. Të njëjtat ndjenja ushqejnë populli, Partia dhe udhëheqja e Partisë dhe e shtetit tonë për ju.

Sikurse e kemi theksuar kurdoherë, partitë marksiste-leniniste që qëndrojnë në pozita revolucionare janë një forcë kolosale në botë. Këto kanë krijuar një situatë jashtëzakonisht të favorshme për lëvizjen revolucionare, për popujt e marksistët revolucionarë dhe të disfavorshme për imperializmin dhe për revizionizmin modern. Kjo i detyrohet forcës së madhe të marksizëm-leninizmit.

Lufta kundër imperializmit po shkon duke u forcuar drejt suksesesh të reja për popujt dhe drejt disfatave për të. Lufta kundër revizionizmit modern gjithashtu po shënon fitore për ne dhe humbje për revizionistët. Ata tashmë janë demaskuar. Koka e tyre, N. Hrushovi, u eliminua.

Ne morëm komunikimin që na bëri ambasadori në lidhje me vajtjen e shokut Çu En Lai në Moskë. Por ne e shohim fare mirë ç'janë ata që po qëndrojnë tani pas Hrushovit. Këta janë po aq tradhtarë sa ai dhe po e vazhdojnë rrugën e Hrushovit pa Hrushovin. Ata janë revizionistë të pandreqshëm, që do të vazhdojnë të ecin në rrugën e tradhtisë të kongreseve të 20-të, të 21-të dhe të 22-të. Ne do t'ua zbulojmë shpejt maskat e reja që do të mundohen të vënë dhe taktikat që po orvaten të përdorin, një nga të cilat është edhe letra që kemi marrë pardje nga KQ i PK të Bashkimit Sovjetik lidhur me mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste që duan të zhvillojnë. Kjo orvatje e tyre është një kurth i vjetër, është e njëjta taktikë e N. Hrushovit. Me rënien e këtij, udhëheqësit e rinj revizionistë sovjetikë e futën një këmbë në varr, kurse tani, me dëshirën që manifestojnë për të bërë mbledhjen, janë të angazhuar të fusin edhe tjetrën, sepse, kur të vijë marsi, do të gjenden në të njëjtat pozita si Hrushovi kur ishte në fuqi. Pra, ata, ose do të bëjnë mbledhjen e tyre fraktioniste, separatiste, revizioniste, ose nuk do ta bëjnë dot dhe kështu do të diskreditohen keqas. Por, meqenëse është hera e dytë që do të dështojnë, në këtë rast ata do të futen më thellë në varr.

Besoj që e keni vënë re se në letrën e fundit të revizionistëve sovjetikë ka një nuancë, kësaj radhe ata kanë kërkuar që në mbledhje të marrin pjesë edhe disa parti që nuk janë parashikuar në komision. Këto janë parti revizioniste, pasuese të tyre. Mendojmë se kjo letër ka dy kuptime:

E para, ata heqin dorë nga bisedimet dypalëshe

qoftë me partinë tuaj, qoftë me Partinë e Punës të Shqipërisë etj., sepse ballafaqimi dypalësh i dërrmon dhe nuk mund të ketë asnjë rezultat pozitiv për ta. Prandaj përpiqen që takimet dypalëshe t'i zëvendësojnë me mbledhje ku të kenë shumicën me vete, të kenë numrin në favor të tyre.

E dyta, mendojmë se kërkesën e tyre për të ardhur në mbledhje edhe parti të tjera e bëjnë me qëllim që gradualisht të kalojnë në mënyrë të papërcaktuar nga një mbledhje komisioni në një mbledhje pothuaj të përgjithshme. Herën e parë, propozojnë që në komision të venë edhe tri parti të tjera. Pastaj, meqenëse mbledhjet e komisionit, sipas tyre, mund të vazhdojnë tri-katër herë, do të propozojnë që në të dytën të tërheqin edhe disa parti të tjera e kështu me radhë, gjersa të përfshijnë në këto mbledhje të komisionit të gjitha partitë, punë kjo që mund të vazhdojë me vite.

Me një fjalë, hrushovianët duan një mbledhje-asamble, siç bëjnë kapitalistët, ku të diskutojnë, të kritikojnë dhe të kritikohen, por ama atje brenda, jo jashtë. Kjo do të thotë që ne t'i mbyllim gjërat në qyp dhe revizionistët modernë të vazhdojnë punën e tyre. Por marksistë-leninistët revolucionarë në botë nuk do të gënjejnë nga taktikat e tyre. Revizionistët modernë do të diskreditohen dhe do të demaskohen përfundimisht.

Ata do të bëjnë me siguri plot manovra të tilla taktike. Ja, siç njoftohemi nga Kuba, ka të ngjarë të jetë bërë një mbledhje e sekretarëve të parë të partive komuniste të vendeve të Amerikës Latine. Atje qenkan marrë gjoja disa vendime, një nga të cilat është të

dërgohet pranë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe atij të PK të Bashkimit Sovjetik një delegacion i këtyre partive për të bërë përpjekje që të pushojë polemika. Zaten këtu e kanë gjithë hallin revizionistët, te polemika. Ne e kemi thënë dhe po e përsëritim se Partia jonë nuk do ta pushojë polemikën me revizionistët deri në likuidimin e tyre.

Ne mendojmë se revizionistët hrushovianë e kanë pisk punën, litari po u mblidhet në fyt dhe po i shtrëngon. Tani ka filluar të krijohet një situatë shumë e vështirë për ta dhe për të gjithë revizionistët e tjerë. Për shembull, në ambasadën tonë në Paris, me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, ambasadori shqiptar kishte ftuar edhe shumë anëtarë të Partisë Komuniste të Francës. Një pjesë e madhe e tyre, që i kishin marrë ftesat, kishin shkuar. Midis tyre kishte edhe personalitete të njohura në Francë. Komunistët francezë kishin dy-tre vjet që nuk shkonin në ambasadën tonë me rastin e festave të Shqipërisë, sepse ua kishte ndaluar udhëheqja, kurse tani shkuan me shumicë për të gëzuar së bashku me personelin e ambasadës festën tonë dhe i thanë ambasadorit: «Tani ndryshuan kohërat». Ndërsa në Shqipëri erdhën për të marrë pjesë në festën tonë përfaqësues të grupeve revolucionare të Francës. Me këtë dua të them se kontaktet me të tillë elementë janë të nevojshme dhe të vlefshme, sepse sqarohen njerëzit. Pra, nga njëra anë polemika të vazhdojë, nga ana tjetër të vazhdojë dhe sqarimi i njerëzve nga ana jonë. Të dyja këto veprime të zhvillohen së bashku.

Neve, të dashur miq, na vjen keq që nuk do të

rrini më tepër që të mundnit të shikonit më mirë vendin tonë. E vërteta është se kemi suksese. Kudo te ne, në popull dhe në Parti ka një hov revolucionar dhe bëhen përpjekje për realizimin e detyrave. Natyrisht, kemi edhe vështirësi e të meta, por ne po bëjmë të gjitha përpjekjet që të eliminojmë gjithçka negative në punën tonë dhe t'i realizojmë të gjitha detyrat që ka shtruar Partia.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

**SIDO QË TË ZHVILLOHEN SITUATAT,
E ARDHMJA DHE FITORJA
DO TË JENË ME MARKSIZËM-LENINIZMIN**

*Bisedë me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë
Komuniste Peruane, Saturnino Paredes Macedo*

15 dhjetor 1964

Menjëherë pasi u takuan, shoku Enver Hoxha u interesua për shëndetin e mysafirit dhe të shokëve të tjerë udhëheqës të Partisë në Peru, pastaj e pyeti Paredesin se si e kaloi në Shqipëri. Duke iu përgjigjur pyetjeve, mysafiri, midis të tjerash, tha:

Nga takimet që kam pasur me disa prej udhëheqësve të Partisë suaj, me punëtorë dhe me drejtues partie në rrethet që vizitova, të gjithë më kanë lënë shumë përshtypje dhe kam vënë re se masat e popullit dhe komunistët janë shumë të lidhur me udhëheqjen e Partisë. Kjo është një nga cilësitë më të rëndësishme të një partie komuniste, veçanërisht në këto momente, kur ne duhet të bëjmë një luftë të ashpër dhe të vendosur kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Fatkeqësisht, shumë nga aspektet e luftës dhe të

veprimtarisë së popullit dhe të Partisë suaj gjer tani ne nuk i kemi njohur. Revizionistët modernë na kishin bërë, si të thuash, njëfarë bllokade, duke mos lejuar futjen e literaturës së nevojshme në vendin tonë nga partitë motra, sidomos nga Shqipëria. Ky ka qenë një dizavantazh i madh për luftën tonë, sepse, po të kishim pasur mundësi që të na kishin ardhur më parë botimet tuaja, siç na erdhën kohët e fundit, ne do t'ua kishim bërë të njohur gjithë komunistëve të Perusë veprimtarinë e Partisë suaj dhe jemi të sigurt se lufta marksiste-leniniste në vendin tonë do të kishte marrë përpjesëtime më të mëdha. Megjithatë në Peru tani ekzistojnë kushte të mira për luftën tonë.

Ne, komunistët peruanë, ju jemi shumë mirënjohës për ndihmën dhe kujdesin e madh që keni treguar ndaj nesh. Kjo tregon me të vërtetë se ju jo vetëm flitni, por luftoni dhe zbatoni drejt në praktikë parimet e internacionalizmit proletar.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit shumë shoku Saturnino Paredes për fjalët e mira që thoni në adresë të Partisë sonë.

E ndiejmë veten shumë të gëzuar për ardhjen tuaj midis nesh dhe, me këtë rast, duam t'ju themi atë që kemi në zemër. Jemi shumë të gëzuar që Partinë Komuniste Peruane e kanë marrë në dorë marksistë-leninistët, të cilët po e pastrojnë atë vazhdimisht nga elementët oportunistë, revizionistë, antimarksistë. Ashtu si e gjykojmë ne, si e gjykon e gjithë Partia e Punës e Shqipërisë, kjo është një fitore për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, është një shembull inkurajimi, sepse ka të bëjë me vazhdimësinë e luftës së një partie dhe

tregon sidomos se në shumicën dërrmuese të partisë suaj dominojnë idetë e marksizëm-leninizmit. Kurse në shumë parti të tjera, ku dominojnë revizionistët, elementët marksistë-leninistë kanë qenë të detyruar të krijojnë parti të reja, të cilat, natyrisht, do të rriten dhe do të zmadhohen gjatë luftës së tyre. Kështu ka ndodhur, për shembull, edhe me Partinë Komuniste të Brazilit, në udhëheqje të së cilës është revizionisti Prestes. Lufta e marksistë-leninistëve brazilianë do të bëjë që ajo të humbasë autoritetin e vet dhe të shkojë, në qoftë se nuk ka shkuar akoma hapur, në pozitat e socialdemokracisë, të bashkëpunimit me borgjezinë, në rrugën ideologjike dhe politike të imperializmit. Kjo do të arrihet me luftën revolucionare të Partisë së re Komuniste marksiste-leniniste të Brazilit.

Është fakt që tani partia e Prestesit po vepron në mënyrë pak a shumë të fuqishme për të mashtruar proletariatin, për ta futur në qorrsovak lëvizjen nacionalçlirimtare, për të penguar luftën e popullit brazilian kundër imperializmit etj., kurse në Peru ka ngjarë e kundërta.

Lufta e revizionistëve modernë, sikurse po e shohim, ka për qëllim të mbështetë sa të jetë e mundur kudo elementët revizionistë dhe tradhtarë në udhëheqjet e partive komuniste, që ata të marrin fuqinë në dorë atje ku nuk e kanë dhe të pastrojnë partitë nga elementët e shëndoshë marksistë-leninistë. Në partinë tuaj, revizionistët nuk e arritën dot një gjë të tillë dhe kjo ka arsytet e veta të shëndosha objektive. Kjo ndodhi, mendojmë ne, për arsye se partia juaj, në shumicën e saj dërrmuese ka qenë në pozita të drejta dhe se pjesa

më e madhe e udhëheqjes së saj, me ju në krye, ka qenë në pozita revolucionare marksiste-leniniste.

Eksperienca jonë është e thjeshtë, për arsye se ne jemi përfaqësuesit e një partie dhe të një populli të vogël. Por për të gjithë ne, marksistët, eksperienca e cilëso parti, qoftë ajo e madhe ose e vogël, është shumë e vlefshme, sepse grumbullimi i saj përbën shumimin e eksperiencës së marksizëm-leninizmit në përgjithësi.

Partia jonë gjendet në disa pozita të veçanta. Ne ndodhemi në Evropë, ku lëvizja komuniste dhe kampi i socializmit kanë ngrënë një grusht mjaft të rëndë, në radhë të parë në Bashkimin Sovjetik, ku drejtimin e partisë dhe të shtetit sovjetik pas vdekjes së Stalinit e mori në dorë grupi tradhtar i Hrushovit; në Jugosllavi, ku revizionistët e kishin marrë me kohë fuqinë në dorë, si dhe në të gjitha vendet socialiste të Evropës, ku, me përjashtim të Shqipërisë, erdhën në fuqi revizionistët, të cilët filluan një luftë graduale, të vazhdueshme dhe të paprincipitë kundër marksizëm-leninizmit.

Partia e Punës e Shqipërisë që e vetmja parti në Evropë që jo vetëm u rezistoi luftës së revizionistëve, të gjitha presioneve të tyre, por pa u përkulur për asnjë çast mbrojti me vendosmëri nga gjithë kjo rrymë e madhe regresive dhe tradhtare parimet e marksizëm-leninizmit. Në këto kushte çështja për ne shtrohej kështu: ose të luftonim me këmbëngulje kundër revizionizmit modern, ose të gjenim disa rrugë oportuniste, njëfarë *modus vivendi* dhe të ruanim disa interesa të përkohshme materiale për pushëtin tonë, ta shikonim çështjen vetëm nga interesi i ngushtë i Republikës

Popullore të Shqipërisë, në një kohë kur revizionizmi modern ndërmori dhe intensifikoi luftën e tij kundër marksizëm-leninizmit, kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste botërore. Pra, Partia jonë nuk e pa këtë çështje në prizmin e ngushtë të interesit imediat të vendit tonë. Po ta shihte kështu, ne do të bënim një gabim kolosal në dëm të marksizëm-leninizmit në përgjithësi dhe njëkohësisht do të sakrifikonim edhe fitoret e popullit shqiptar, duke filluar që nga çështja shumë e rëndësishme e pavarësisë kombëtare dhe gjer te ndërtimi i socializmit. Partia jonë gjykoj drejt se të gjitha këto ishin në rrezik të madh. Prandaj ajo zgjodhi rrugën e luftës dhëmb për dhëmb me revizionizmin, ndryshe nuk do të ishim marksistë-leninistë.

Po përse Partia jonë doli në këtë rrugë të drejtë? Sepse Partia jonë kurdoherë u ka qëndruar dhe u qëndron me besnikëri parimeve të marksizëm-leninizmit dhe ka besim të patundur në fitoren e revolucionit dhe të çështjes së madhe të komunizmit, pavarësisht se pas vdekjes së Stalinit doli kundër socializmit rryma e egër antimarksiste e revizionizmit modern. Partia jonë e dinte se marksizëm-leninizmi dhe forcat revolucionare që janë shumë më të mëdha se ato të revizionizmit dhe që vijnë kurdoherë duke u zgjeruar, do ta dërrmonin këtë rrymë regresive dhe tradhtare.

Në këto situata të vështira që u ndodh gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare dhe veçanërisht vendi ynë, Partia e Punës e Shqipërisë nuk u lëkund dhe asnjëherë nuk e humbi busullën. Është fakt se Partia jonë i kapërceu me sukses rreziqet imediate dhe të veçanta që i kanoseshin vendit tonë. Por këtë fitore ne

nuk e shikojmë vetëm si rezultat i gjendjes së brendshme të shëndoshë në vendin tonë. Ne jemi të ndërgjegjshëm se përveç forcës së Partisë dhe të popullit tonë në ruajtjen e fitoreve të arritura kemi pasur e kemi ndihmën dhe mbështetjen e fuqishme të një numri të madh partish që qëndrojnë në pozita të forta marksiste-leniniste. Prandaj, duke u bazuar në eksperiencën tonë, ne mund të themi se në çdo situatë të vështirë që mund të gjendet lëvizja komuniste ndërkombëtare ose ndonjë parti e veçuar, apo grup marksist-leninist, për marksizëm-leninizmin gjendja nuk ka për të qenë dhe nuk do të jetë asnjëherë e dëshpëruar. E ardhmja dhe fitorja, sido që të zhvillohen situatat, do të jenë me marksizëm-leninizmin.

Të mos flasim për borgjezinë, për imperialistët apo për revizionistët, por edhe shumë nga miqtë tanë bëjnë pyetje: si është e mundur të rezistojë një parti dhe një vend i vogël që ndodhet i rrethuar nga revizionistët dhe imperialistët, sikundër është Shqipëria në kontinentin Evropian? Dhe fjala është jo në një rrethim çfarëdo, por në një rrethim aktiv me shtete të interesuara shumë që të likuidohet socializmi në Shqipëri. Përse ka ngjarë një gjë e tillë? Ata që e bëjnë pyetjen nuk shohin një gjë, që këtu nuk është fjala vetëm për çështjen e një Shqipërie të vogël, por për çështjen e madhe të revolucionit në përgjithësi, për çështjen e madhe të ideve të marksizëm-leninizmit e për luftërat nacionalçlirimtare kundër imperializmit, që po zhvillohen me forca gjithnjë në rritje në të gjitha kontinentet. Prandaj Partia jonë po zhvillon e do të zhvillojë me një forcë akoma më të madhe luftën kundër imperializmit e revizioniz-

mit, sepse imperialistët dhe revizionistët janë dy armiqtë tanë më të egër e më të rrezikshëm, që luftojnë me të gjitha mjetet që kanë në dispozicion për shuarjen e revolucionit, për shtypjen e popujve.

Luftën kundër revizionizmit modern ne e bazojmë në teorinë e marksizëm-leninizmit dhe në eksperiencën tonë të përditshme. Kjo luftë e Partisë sonë ka kaluar në faza të ndryshme, sepse në faza të ndryshme e ka zhvilluar luftën e vet kundër marksizëm-leninizmit edhe revizionizmi modern. Në fillim revizionistët modernë nuk kanë dalë hapur, por kanë vepruar në mënyrë të maskuar, bile në një ilegalitet të rëndë. Kështu kanë vepruar edhe revizionistët sovjetikë, kështu edhe ata jugosllavë.

Megjithatë, ne, në marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Jugosllavisë, qysh në fillim konstatuam veprime jomarksiste, josocialiste ndaj vendit dhe Partisë sonë, e cila, sado e re që ishte atëherë, gjithë luftën dhe veprimtarinë e vet e bazonte në parimet e marksizëm-leninizmit.

Po kështu edhe për sa i përket revizionizmit hrushovian. Partia jonë e gjykon se në disa momente të caktuara, qysh kur ishte gjallë Stalini, Hrushovi dhe banda e tij kanë qenë në pozita tradhtare antimarksiste, revizioniste. Faktet e mëvonshme të bindin plotësisht se ata kanë qenë në këto pozita, por kanë ditur të punojnë në mënyrë shumë të maskuar. Por kur grupi i Hrushovit filloi të manifestonte qoftë edhe në mënyrë latente veprimtarinë e vet armiqësore revizioniste, Partia jonë e ndjeu sadopak këtë. Me të ardhur në pushtet, grupi i Hrushovit mendoi për një moment se e

kishte stabilizuar situatën, se e kishte marrë plotësisht drejtimin, se veprimet e tij të para kishin hedhur rrënjë të thella në Bashkimin Sovjetik, prandaj iu duk se erdhi koha që të manifestonte si me thënë megalomanië e «shtetit të madh», «të partisë së madhe» dhe precipitoi veprimet. N. Hrushovi erdhi në konkluzionin se kishte ardhur koha të bëheshin ndryshime rrënjësore në fushën e ideologjisë, të politikës, në çështjet organizative, ekonomike etj. Banda e Hrushovit i formuloi këto pikëpamje dhe kujtonte se do t'i zbatonte pa asnjë pengesë dhe kundërshtim nga të gjitha partitë komuniste, nga e gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare.

Në ato etapa që kaloi veprimtaria e udhëheqjes revizioniste sovjetike u zhvillua dhe lufta e Partisë sonë. Në fillim ajo ka nisur në rrugën e kritikave e të këshillave shoqërore, e objeksioneve, e vërejtjeve kritike të dyanshme, gjersa erdhi momenti që çështjet të ngriheshin në konferencat ndërkombëtare të partive komuniste. Këto nuk i themi ne duke u nisur nga pozita subjektive kundër udhëheqjes sovjetike, por i kemi të faktuara. Për të gjitha këto ekzistojnë dokumente në Partinë tonë. Në këto forma vazhdoi lufta kundër Hrushovit dhe pasuesve të tij gjersa ata vendosën platformën e revizionizmit modern në kongreset e 20-të, të 21-të dhe të 22-të.

Por, kur Hrushovi dhe grupi i tij, jo vetëm në Bashkimin Sovjetik, por edhe gjetkë, u përpoqën që këtë platformë t'ia impononin lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe vepruan intensivisht për këtë, atëherë Partia jonë gjykoj se tashmë duhej vendosur kufiri me

këta armiq dhe e kuptoi se që nga kjo kohë nuk kishim të bënim më me komunistë që kishin gabuar, por me armiq të betuar të marksizëm-leninizmit, që tashmë e kishin hequr maskën. Kështu, pra, me revizionistët sovjetikë ne vendosëm vijën e demarkacionit, ashtu sikurse u bë nga partitë komuniste më 1948 me revizionistët jugosllavë. Natyrisht, për mjaft kohë ne u treguam shumë të durueshëm me udhëheqësit revizionistë sovjetikë dhe bëmë të gjitha përpjekjet në rrugë marksiste-leniniste për të rregulluar mosmarrëveshjet, por grupi i Hrushovit kishte shumë besim në vijën e tij. Ai kujtonte se e kishte fituar davanë, prandaj në Kongresin e 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik na sulmoi haptazi, duke bërë një hap që nuk njihej gjer atëherë në marrëdhëniet midis partive komuniste. Atëherë Partia jonë mendoi se kundër revizionistëve modernë, veçanërisht kundër krerëve të tyre, hrushovianëve e titistëve, duhej bërë një luftë e paprerë, e hapët dhe gjer në fund.

Ky grupim i madh revizionistësh ka punuar në të gjitha drejtimet për të bashkëpunuar me imperialistët, për të qenë në koordinim të plotë ideologjik dhe politik me ta, me qëllim që ta degjenerojnë marksizëm-leninizmin, ta zëvendësojnë atë me revizionizmin modern, të shtypin revolucionet dhe luftërat nacionalçlirimtare kudo në botë. Në të tilla situata, Partia jonë mendon të mos u bëhet asnjë lëshim këtyre armiqve. Një qëndrim i tillë luftarak kundër revizionizmit modern është plotësisht i drejtë, kurse, po të bënim të kundërtën, ne do të bënim me ndërgjegje një tradhti të madhe.

Aktualisht lëvizja marksiste-leniniste kudo në botë

po ngrihet dhe po forcohet pa ndërprerje. Por, në kushtet kur përballë nesh kemi armiq të tillë të tërbuar, siç janë imperializmi, me atë amerikan në krye, dhe revizionizmi modern që është në fuqi në Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende të tjera ish-socialiste, dhe kur në udhëheqjen e shumë partive komuniste dhe punëtore në Amerikën Latine, në Evropë e gjetkë janë gjithashtu elementë revizionistë, duhet koordinuar me kujdes lufta e partive marksiste-leniniste dhe e të gjitha forcave revolucionare në botë.

Sipas pikëpamjes së Partisë sonë kjo luftë do të koordinohet jo duke pasur Komintern, i cili, për kushtet e sotme, nuk na duket i nevojshëm. Të gjithë e dimë se Kominterni, në gjithë veprimtarinë e vet, ka bërë një punë shumë pozitive. Megjithëse në kushte jashtëzakonisht të vështira, kur sundonte imperializmi dhe kapitalizmi, kur në shumë vende ishte vendosur diktatura fashiste, Kominterni ndihmoi avangardën e proletariatit dhe bëri një punë kolosale që në një shumicë vendesh të krijoheshin partitë komuniste dhe të vihej kufiri në mes të socialdemokracisë tradhtare dhe marksistë-leninistëve.

Partitë që qëndrojnë në pozita marksiste-leniniste, duke analizuar veprimtarinë e madhe të Kominternit, që ndihmoi dhe konsolidoi partitë komuniste kudo në botë, e vlerësojnë lart këtë veprimtari, pavarësisht se mund të jenë bërë dhe gabime. Por këto nuk kanë qenë gabime parimore. A mund të ekskludohen gabimet gjatë veprimtarisë së një organizate? Jo, nuk është e mundur, jo vetëm në kohën e Kominternit, por edhe në kohën e tanishme.

Më vonë erdhi koha kur Stalini dhe udhëheqja e Kominternit e gjetën të arsyeshme ta shpërndanin atë. Dikush mund të bëjë pyetjen: përse u mor një masë e tillë? Të gjithë e dimë se pikërisht në atë kohë partitë komuniste kishin arritur një nivel të lartë pjekurie, ato prej kohësh ishin futur në luftë për interesat e proletariatit, kishin korrur një varg fitoresh duke zgjeruar influencën e tyre, jo vetëm në radhët e proletariatit, por dhe në masat e tjera të gjera të punonjësve dhe ishin pasuruar me një eksperiencë kolosale në veprimtarinë e tyre praktike. Ato ishin bërë kështu një forcë e madhe e pavarur.

Përse i them këto? I them sepse revizionistët modernë, me Hrushovin në krye, ndërmorën një sërë aktesh dhe veprimesh për ta demaskuar, ose, si me thënë, për ta njollosur Kominternin. Kjo u bë nga ana e tyre për dy arsye:

Së pari, për të njollosur Leninin, sido që kursi i tij përdoret nga revizionistët modernë si një perde për të mbuluar tradhtinë e tyre dhe për të gënjyer masat e komunistëve. Duke qenë revizionistë, ata janë pasardhësit, djemtë e tradhtarëve Bernshtajn dhe Kautski, prandaj nuk mund të bënin tjetër veçse të ndiqnin rrugën e tradhtisë të paraardhësve të tyre. Ata kapen pas Leninit, me qëllim që me këtë maskë të luftojnë dhe të njollosin edhe Stalinin, nxënësin besnik të Leninit, dhe veprën e tij.

Së dyti, revizionistët nuk janë budallenj. Ata e dinë se Kominterni në momentet më të përshtatshme dhe të vështira për proletariatin ndërkombëtar ka ditur të ngjallte, të konsolidonte forcat dhe organizimin e

proletariatit dhe të avangardës së tij, ta kaliste këtë me një disiplinë të vetëdijshme marksiste-leniniste, ta pajiste me një ideologji të vërtetë marksiste-leniniste në luftë të ashpër dhe të pamëshirshme kundër imperializmit, kundër borgjezisë, kundër fashizmit dhe të kristalizonte njëkohësisht me këtë luftë solidaritetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Por revizionistët, të cilët shikojnë njëkohësisht me kujdes dhe alarm të ardhmen e tyre, po punojnë që ta njollosin dhe ta injorojnë Internacionalen Komuniste, po shtrembërojnë parimet e drejta marksiste-leniniste etj., organizimin dhe unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të cilin kurdoherë e kanë pasur dhe e kanë frikë, prandaj dhe synojnë që ta përçajnë atë. Për ta është jetikë dhe e domosdoshme t'u na shpartallojnë ne, marksistë-leninistët kudo që jemi në botë, të shpartallojnë partitë marksiste-leniniste që qëndrojnë në pozita të forta parimore, të shpartallojnë grupet e reja marksiste-leniniste që po krijohen, po konsolidojnë forcat e tyre dhe po ecin drejt formimit të partive të tipit të partisë së Lenin-Stalinit. Për t'i shpartalluar këto, ata kanë zhvilluar, po zhvillojnë dhe vazhdojnë të zhvillojnë një veprimtari intensive antimarksiste, antisocialiste.

Është për këtë arsye që Partia jonë mendon se ne, në radhë të parë, duhet të konsolidojmë forcat tona në rrugën e konsultimeve e të kontakteve të shpeshta midis partive marksiste-leniniste. Ne jemi të mendimit se tani nuk është koha për të krijuar ndonjë organizatë ndërkombëtare si Kominterni ose Byroja Informativë, krijimi i të cilave në atë kohë ishte plotësisht i drejtë.

Partia bolshevike dhe Stalini i gjykuan drejt momentet kur e krijuan Byronë Informative. Ishte koha pikërisht pas Luftës së Dytë Botërore, kur ishte krijuar një situatë e re për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, kur në botë ishin krijuar një sërë vendesh socialiste, kur ishin krijuar parti të reja komuniste në shumë vende të botës, kur shumë parti komuniste në vendet kapitaliste kishin rritur influencën dhe autoritetin e tyre në masat punonjëse dhe kishin fituar pozita të shëndosha në fushën politike. Byroja Informative nuk kishte formën e Kominternit, ajo ishte një formë organizative shumë më e ndryshme nga ai dhe plotësisht e përshtatshme për situatat e kohës kur u krijua.

Si konkretizohej ajo? Është e njohur nga të gjithë që ajo konkretizohej nëpërmjet konsultimeve. Të gjitha mbledhjet që u bënë nga Byroja Informative gjatë ekzistencës së saj prej disa vjetësh kanë pasur vetëm karakter konsultimi dhe aspak imponimi. Megjithatë në atë kohë nuk kishte asnjë parti marksiste-leniniste që të mos kishte një konsideratë të veçantë, një dashuri të thellë dhe një respekt të madh për partinë e Leninit dhe të Stalinit. Do të ishte gabim i madh po të mos e kishin atëherë marksistët një konsideratë, dashuri dhe respekt të tillë dhe të mos përfitonin nga rruga e drejtë, nga eksperiencia, nga këshillat dhe ndihma marksiste-leniniste e Bashkimit Sovjetik dhe e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Revizionistët modernë u përpoqën ta diskreditojnë dhe ta njollosin Byronë Informative për shkak të veprimtarisë së saj të drejtë, për këshillat marksiste dhe

paralajmërimet objektive e konkluzionet që bëri ajo për revizionistët jugosllavë.

Kur Hrushovi vendosi të likuidohej Byroja Informative, ne ndodheshim në Kremlin. Atje mësuam se N. Hrushovi e kritikonte Byronë Informative. Në mes të tjerash, ai na tha, se në një bisedim që paskësh pasur me Xhavaharlal Nehrunë, ky i fundit i kishte thënë se duhej prishur Byroja Informative, pasi ajo u shtinte frikën borgjezisë dhe popujve. Kështu na e ka thënë këtë çështje Hrushovi në Kremlin, në një kohë kur ishte në ekstazë.

Partia jonë mendon që, pa qenë nevoja të krijohet tani një Byro Informative e re, ato parti, që janë në fuqi dhe mbështeten fort në parimet e marksizëm-leninizmit, duhet të ndihmojnë në mënyrë të organizuar me të gjitha forcat dhe mjetet që kanë në dispozicion të gjitha partitë komuniste dhe grupet marksiste revolucionare, me qëllim që këto të konsolidohen sa më shpejt e sa më shumë, duke pasur kurdoherë mirë parasysh që gjatë këtij bashkëpunimi ne t'i ruajmë parimet, që gjatë bashkëpunimit ndërmjet partive komuniste të mos ketë çështje të tilla si «parti e madhe» ose «e vogël», por çdo gjë të kuptohet dhe të zgjidhet në rrugë të drejtë marksiste-leniniste.

Partitë marksiste-leniniste janë parti të pavarura. Por duhet kuptuar drejt se pavarësia jonë nuk është jashtë marksizëm-leninizmit. Ky i bashkon të gjitha partitë komuniste. Dhe kur them na lidh marksizëm-leninizmi, me këtë kuptojmë se na lidhin qëllime të mëdha, na lidh një vijë politike e njëllojtë dhe reale në të gjitha drejtimet. Kjo bën që uniteti ynë të jetë i

çeliktë. Në një unitet të tillë, çdo shfaqje mikroborgjeze e «partisë mëmë», e «partisë së madhe», e «shtetit të madh», çdo urdhër i dhënë një partie nga një parti tjetër etj. zhduken.

Që të zhduken këto ne mendojmë se duhet të intensifikohen takimet ndërmjet partive marksiste-leniniste, me qëllim që të shkëmbejmë midis nesh eksperiencën, t'i shfaqim mendimet tona njëri-tjetrit, të bëjmë kritika të drejta dhe nga këto takime të dalim kurdoherë me rezultate, me konkluzione dhe me veprime të përbashkëta. Kështu do të arrijmë që të forcojmë pozitat e fituara gjer tani në secilën parti dhe në secilin vend, si dhe të fitojmë pozita të tjera, duke u kujdesur edhe për pozitat e reja që duhet të fitojnë partitë dhe popujt e tjerë. Kjo kërkon që të bëjmë një luftë të organizuar, me qëllim që të mos lëmë vende të hapëta dhe të ndihmojmë si duhet dhe ku duhet lëvizjet revolucionare kudo në botë.

Komiteti Qendror i Partisë sonë ka mendimin se çështja e kontakteve të rregullta, e gjetjes së mundësive për të bërë mbledhje më të shpeshta midis partive komuniste dhe grupeve marksiste revolucionare për koordinimin e veprimeve, të propagandës dhe të luftës së tyre, është një ndër faktorët kryesorë të luftës sonë. Ne e shikojmë mirë dhe e kemi të qartë çfarë bëjnë revizionistët modernë duke pasur nën kthetrat e tyre forcën e madhe të Bashkimit Sovjetik. Ata po bëjnë në të katër anët e botës një propagandë të fuqishme, demagogjike, po veprojnë gjithashtu në mënyrë intensive edhe me mjete ekonomike e financiare kundër forcave marksiste-leniniste në rritje. Ata propagandojnë

nga të katër anët për koordinimin e veprimeve për të na përçarë duke përdorur kundër nesh, në radhë të parë, teoritë e tyre antimarksiste të maskuara. Ata flasin për propozimet e tyre gjoja për mbledhje, për diskutime, për marrëveshje, për të shuar polemikën, ose të paktën për ta shuar për njëfarë periudhe etj., etj. Ne i kuptojmë mirë këto manovra të tyre, ato janë manovrat e revizionistëve modernë kundër marksizëm-leninizmit.

Në këto kushte, Partia jonë mendon se është e nevojshme që të shtohen lidhjet dhe konsultimet midis partive marksiste-leniniste, me qëllim që lufta jonë të zgjerohet e të zhvillohet kudo, si edhe për të forcuar pozitën tona atje ku këto janë dobësuar, si për shembull, këtu në Evropë. Mirëpo revolucioni zien kudo, ai zien të ju në Amerikën Latine, në Azi e në Afrikë. Këto revolucione medoemos duhen ndihmuar me të gjitha forcat, por pa neglizhuar Evropën, që përbën një rrezik të madh për lëvizjen komuniste dhe revolucionare në botë, sepse Evropa ushqen kundërrevolucionin, që ka shpërthyer dhe që po zhvillohet edhe në Amerikën Latine, në Azi dhe në Afrikë.

Partia jonë është e ndërgjegjshme se neve, marksistë-leninistëve në të gjithë botën na bie detyra që armikun ta godasim atje ku është, në strogën e tij. Kjo do të thotë që ne t'u bëjmë një luftë të rreptë dhe të pandërprerë revizionistëve modernë, hrushovianëve, titistëve dhe të tjerëve brenda në follenë e tyre. Njëkohësisht, atje ku ziejnë revolucionet duhet të përqendrohet i gjithë zjarri dhe goditja e marksistë-leninistëve, sepse ne jemi të bindur se kur fiton lëvizja nacional-

çlirimtare në Azi, në Afrikë dhe në vendet e Amerikës Latine, lehtësohet veprimtaria dhe lufta e partive marksiste-leniniste, se fitorja e revolucionarëve në këto kontinente do të shpejtojë njëkohësisht edhe fitoren e marksizëm-leninizmit kundër revizionizmit modern.

Në qoftë se revizionizmi modern e ka follenë këtu në Evropë, koka e imperializmit është në kontinentin tuaj në Amerikën e Veriut dhe i ka hedhur rrënjët e helmatisura dhe thonjtë e tij të përgjakur edhe në Amerikën e Jugut. Lufta në Amerikën Latine është shumë e vështirë. Komunistët që veprojnë atje luftojnë në kushte shumë të vështira. Partia jonë dhe partitë e tjera që qëndrojnë në pozita të forta marksiste-leniniste e kuptojnë mirë gjendjen tuaj. Ato e kanë të qartë se shokët komunistë në vendet e Amerikës Latine duhet të ndihmohen në luftën e tyre të drejtë e të lavdishme me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kemi ne dhe të ndihmohen sidomos ato parti dhe ato grupe marksiste revolucionare që qëndrojnë në pozita të forta parimore, siç janë partia juaj, Partia Komuniste e Brazilit, si edhe grupet marksiste-leniniste në vendet e tjera. Themi se duhen ndihmuar në radhë të parë ato parti sikurse është partia juaj, sepse ajo ka një vazhdimësi në luftën e saj dhe i ka pastruar e po i pastron vazhdimisht radhët e veta nga armiqtë antimarksistë, oportunistët e çdo ngjyre. Kjo çështje ka një rëndësi të madhe jetike për zhvillimin me sukses dhe kompaktësinë e partisë marksiste-leniniste. Të gjitha partitë marksiste-leniniste duhet ta kuptojnë çështjen e ndihmës si një nevojë të domosdoshme dhe ta shohin si detyrën numër një të tyre.

Në marrëdhëniet midis partive marksiste-leniniste duhen flakur tej pikëpamjet e huaja të revizionistëve lidhur me ndihmat. Marksizmi na mëson se si partia që e jep ndihmën, ashtu edhe ajo që e merr, duhet ta kuptojnë që kjo është një ndihmë vëllazërore, internacionaliste, pa kushte e detyrime dhe u shërben kauzës së përbashkët, luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, fitores së marksizëm-leninizmit.

Ne jemi një vend i vogël. Edhe Partia jonë është një parti e vogël, por ajo, aq sa do të mundë dhe sa do t'ia lejojnë forcat, do të jetë kurdoherë në gatishmëri t'u japë një ndihmë vëllazërore internacionaliste shokëve dhe vëllezërve të Partisë Komuniste Peruane.

Siç na ka mësuar marksizëm-leninizmi, në marrëdhëniet me partitë e tjera ne nuk praktikojmë diplomaci. Kur kemi ndonjë vërejtje ose kritikë për t'ua thënë shokëve tanë komunistë të partive të tjera kur janë mundësitë, ne ua themi ato haptazi, në rrugë vëllazërore, marksiste-leniniste, të sinqertë, jo prapa kraheve, por midis nesh, prandaj edhe shokët tanë, në goftë se kanë vërejtje për ne, dëshirojmë që të na i bëjnë ato mbi këto baza.

Tani në lëvizjen komuniste ndërkombëtare ka disa çështje që aktualisht janë në rënd të ditës. Revizionistët modernë kanë deklaruar se do të bëjnë një «mbledhje të komunizmit ndërkombëtar», por në lidhje me këtë çështje ata janë në pozita shumë të vështira dhe mbledhja për të cilën bëjnë fjalë është vdekje për ta. Ne nuk do të vemi në këtë mbledhje, ashtu si nuk do të shkojnë dhe mjaft parti të tjera komuniste.

Ne mendojmë se ata mund ta bëjnë mbledhjen që kanë njoftuar edhe pa ne. Por ne, sigurisht, nuk do të heshtim, këtë do ta demaskojmë. Duke bërë mbledhjen pa ne ata mund të mos vendosin dot gjë, por në mënyrë kolektive mund të mendojnë për të gjetur disa rrugë dhe mënyra se si të bien në kontakt me partitë tona, që nuk do të marrin pjesë në mbledhje, gjoja «për të biseduar», «për të këmbyer mendime».

Qëllimi i revizionistëve është i qartë për ne. Ata përpiqen për të krijuar në lëvizjen komuniste ndërkombëtare një gjendje hutimi dhe pritjeje për të lënë përshtypjen te masa e komunistëve dhe e popujve të tyre se gjoja po përpiqen «të merren vesh» me ne dhe se situatat «po sqarohen». Për të njëjtat arsye, edhe në Peru, revizionistët peruanë, duke ndjekur të njëjtën taktikë, do të bëjnë presion mbi partinë tuaj duke u thënë komunistëve peruanë se Partia e Punës e Shqipërisë etj. tani është duke u marrë vesh me sovjetikët e të tjerët, prandaj përse të mos merremi vesh ne që jemi «vëllezër»; ne jemi «komunistë», sekretari i përgjithshëm i partisë është «sektar», ai nuk e kupton politikën marksiste etj., etj.

Udhëheqja revizioniste e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ka zhvilluar ndaj Partisë sonë një veprimtari armiqësore. Në këto kushte, kemi të drejtë t'u themi që në qoftë se duan të bisedojnë me ne, më parë duhet të njohin publikisht gabimet që kanë bërë kundër Partisë dhe vendit tonë.

Përse insistojmë ne për këtë? Sepse ata i bënë këto veprime armiqësore, antimarksiste ndaj nesh ngaqë janë armiq. Si të tillë ne duhet t'i demaskojmë dhe do t'i

demaskojmë ata gjer në fund që t'i njohin popujt çfarë janë dhe që të tilla gabime të bëhen mësim për të tjerët.

Edhe shokët e bashkëpunëtorët e ngushtë të Nikita Hrushovit, që erdhën në fuqi pas rënies së tij, gjer më sot nuk kanë bërë as hapin më të vogël që të tregojnë se kanë ndër mend të njohin gabimet që kanë bërë ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Ata asgjë nuk kanë ndryshuar, as vijën, as qëllimet e tyre, as objektivat e largët, as ata të afërt. Por tani ne shikojmë se ata akoma nuk e kanë marrë dot veten pas grushtit që hëngrën me largimin nga skena politike të N. Hrushovit. Ata janë trullësuar nga kjo dhe përpiqen t'i hedhin çapat me shumë prurëncë, përpiqen të tatonë pulset, me qëllim që të lidhin ato nyje që u janë prerë me rrëzimin e Hrushovit, por duke vepruar jo në mënyrë të bujshme, siç bënte Hrushovi, i cili vepronte në çdo rast si një sharlatan dhe palaço. Kjo metodë që ndiqte N. Hrushovi u diskreditua dhe nuk po përdoret prej atyre që erdhën pas rrokullisjes së tij, sepse kjo do t'i shkaktonte humbje akoma më të madhe dhe të mëtejshme prestigjit të tyre. Duke u përpjekur të stabilizojnë pozitën e tyre tradhtarë, ata dëshirojnë të krijojnë një situatë të tillë të favorshme për veprimtarinë e tyre që synon të evitohet polemika me marksistë-leninistët.

Por Partia jonë i ka mirë parasysh këto kurthe dhe taktika të tyre dhe i llogarit mirë goditjet e veta kundër udhëheqjes së re sovjetike, ashtu sikundër i llogariti edhe kundër Hrushovit. Ajo do ta ndjekë me kujdes procesin e gjithë veprimtarisë së revizionistëve so-

vjetikë dhe do të përdorë forma të tilla polemike dhe lufte që ajo vetë dhe opinioni publik shqiptar të mos vihet në gjumë nga taktikat e grupit revizionist sovjetik. Prandaj ne themi që më parë se të shkohet në këto mbledhje që duan të bëjnë revizionistët dhe në qoftë se atyre u dhemb me të vërtetë uniteti, ashtu siç pretendojnë, revizionistët hrushovianë duhet të thonë bërërisht se i njohin gabimet. Leninizmi na mëson se marksistët që bëjnë gabime duhet t'i njohin ato, kurse revizionistët nuk kanë njohur asgjë. Tek ata asgjë nuk ka ndryshuar dhe ne jemi të bindur se asgjë nuk do të ndryshojë. Atëherë del qartë se mbledhjet që përpiqen të bëjnë ata, ndjekin qëllime të tjera dhe aspak për të forcuar unitetin.

Ne marksistët nuk e kuptojmë ashtu si ata unitetin. Unitetin në radhët e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, si ju, ashtu edhe ne, e kuptojmë në pasqyrën e unitetit brenda radhëve të partisë, si unitet mendimi dhe unitet veprimi. Kur brenda në parti shfaqen fraksione trockistësh, si mund të pajtohemi ne me to? Si mund të krijoni ju, për shembull, unitet me elementët revizionistë në vendin tuaj, që japin shokët komunistë në polici, që bashkëpunojnë me reaksionin etj.? Ata bërtasin për unitetin, por ata duan një lloj uniteti që t'i shërbejë vetëm shkatërrimit të Partisë Komuniste Peruane. Të njëjtën gjë duan revizionistët modernë edhe në shkallë ndërkombëtare. Ata kërkojnë atë unitet që u shërben dobësimit dhe shkatërrimit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, sepse e shikojnë që uniteti ynë po kalitet çdo ditë e më shumë në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, të cilët do të

shpartallohen, sepse nuk do t'u qëndrojnë dot radhëve tona të bashkuara, që rriten çdo ditë e më shumë.

Revizionistët modernë kanë përdorur kundër nesh taktika dhe presione nga më të ndryshmet, por kanë dështuar. Vetëm brenda këtij pesëvjeçari ata na kanë bërë dëme të mëdha në fushën ekonomike, që llogariten me miliarda. Megjithatë Shqipërinë e vogël ata nuk e mbytin dot. Ekonomia jonë ka ecur vazhdimisht me sukses përpara, aftësia mbrojtëse është forcuar dhe më shumë, populli është ngritur i tëri në këmbë për të mposhtur e për të shpartalluar bllokadën e egër të revizionistëve modernë.

Atëherë ç'armë tjetër u ka mbetur atyre për të na luftuar? Atyre tani u ka mbetur demagogjia, propaganda, me të gjitha mjetet e saj, për të na penguar, për të dobësuar unitetin tonë marksist-leninist, për të krijuar konfuzion në radhët e komunistëve të lëkundshëm, për të penguar luftën nacionalçlirimtare të popujve të shtypur. Edhe kundër kësaj veprimtarie ne po luftojmë e do të luftojmë edhe në të ardhmen.

Partia jonë mendon se ndaj atyre njerëzve dhe komunistëve për të cilët shpresohet se mund të ndreqen dhe që nuk janë faktori kryesor i kësaj veprimtarie tradhtare, pa humbur vigjilencën, pa humbur metodën e drejtë të kritikës dhe të luftës, duhet të punohet për t'i tërhequr në rrugë të drejtë dhe ta përqendrojë luftën e vet në drejtim të rrezikut kryesor. Në këtë mënyrë ka vepruar Partia jonë ndaj gjithë këtyre grupimeve revizioniste.

Përse e them këtë? E them se marksizëm-leninizmi na mëson, dhe kjo është një eksperiencë e fi-

tuar me gjakun e klasës punëtore dhe të popujve, që përpara një rryme të tillë armiqësore regresive, përpara taktikave të saj të ndërtuara në momente shumë të rënda, nuk duhet të gënjehemi. Në këtë çështje ne duhet të jemi shumë, shumë të kujdesshëm.

Rënia e Hrushovit ishte një fitore e madhe për marksizëm-leninizmin, por ne nuk menduam asnjëherë se Brezhnjevi, Kosigini etj., etj. u korrigjuan, sepse nuk kemi parë asnjë fakt apo provë nga ana e tyre për këtë, as u nxituam të thoshim se «këta janë njerëz të mirë, se tek ata ka diçka pozitive» etj. Po ta bënim një gjë të tillë, do të gabonim dhe mund të themi se një gabim, qoftë edhe i vogël në këtë drejtim nga ana e partive tona do të ishte një armë e fortë në favor të revizionistëve modernë, të cilët, të dëshpëruar, do të përpiqeshin të merrnin në dorë dhe të shfrytëzonin çfarëdo hapi të pamatur të partive tona për demagogjinë e tyre, për të lehtësuar gjendjen e tyre të vështirë.

Ne e dimë se ata që kanë ardhur tani në fuqi në Bashkimin Sovjetik nuk janë njerëz të tillë që mund t'i pranojnë botërisht gabimet dhe krimet e tyre, që të vihen seriozisht për t'i ndrequr dhe të bëjnë kështu një kthesë, qoftë edhe graduale. Ky është i njëjti grup revizionist që ishte edhe përpara, kur ishte në fuqi Hrushovi. Ky grup e lëshoi Hrushovin, sigurisht për shumë arsye. Ata u detyruan ta bënin një gjë të tillë, por, me këtë që bënë, pozitat e tyre, qoftë në arenën ndërkombëtare, qoftë brenda në Bashkimin Sovjetik, në vend që të forcoheshin, u dobësuan shumë. Ne nuk pretendojmë se e kishim parashikuar që Hrushovi do

të përmysej pikërisht më 14 tetor 1964, por ama e dinim se një ditë ai do të rrëzohej nga fuqia. Lufta revolucionare e të gjithë marksistë-leninistëve në botë ishte e efektshme, mjaft e fortë dhe i kaloi parashikimet tona. Ajo ka kontribuar fuqimisht për rrëzimin e Hrushovit, por nuk duhet harruar se në këtë drejtim ka kontribuar me siguri dhe kryesisht edhe pakënaqësia e madhe brenda në Bashkimin Sovjetik. Për këtë, ne, konkretisht, nuk kemi të dhëna, por jemi të bindur dhe logjika marksiste të bën të mendosh se në Bashkimin Sovjetik ka dhe duhet të ketë rezistencë kundër këtij grupi, që ndofta zhvillohet në një konspiracion të thellë.

Këto vështirësi të sovjetikëve i ka shkaktuar gjithashtu edhe politika revizioniste e «shtetit të madh» në gjirin e vendeve të demokracisë popullore. Ne mendojmë se tani po zhvillohet një proces i tërë që karakterizohet nga mosmarrëveshje të shumta në marrëdhëniet e Bashkimit Sovjetik me këto vende, që duken sidomos në fushën e marrëdhënieve ekonomike dhe pastaj edhe në fushën politike. Sa që Hrushovi në krye të këtij grupi tradhtar revizionist, shumë nga këto kontradikta u acaruan mjaft deri në atë shkallë sa që gradualisht nxorën veshët lidhjet politike dhe ekonomike të këtyre vendeve me imperializmin amerikan.

Ky proces, sigurisht do të zhvillohet më tej. Kjo ndodh për arsye të rrugës revizioniste që kanë marrë këto grupime, që i shtyn ato drejt një rruge «independente» partie, ekonomike dhe politike, drejt një transformimi gradual të shteteve të tyre në shtete me ideologji socialdemokrate borgjeze, në aleancë, në mos ush-

tarake, por patjetër politike, ideologjike dhe ekonomike me borgjezinë ndërkombëtare dhe me imperia-listët amerikanë, anglezë, francezë. Këto lidhje do të vazhdojnë të avancohen në të gjitha format në të ardhmen.

Thellimin e këtij procesi e lejon gjithashtu edhe dobësimi i Bashkimit Sovjetik, si në fushën ekonomike, ashtu edhe në lëmin ndërkombëtar, gjë që duket në uljen e prestigjit politik dhe ideologjik të shtetit sovjetik. Tani Bashkimi Sovjetik, nga një shtet i fuqishëm socialist që ndihmonte fuqimisht vendet e tjera socialiste, ka arritur në atë gjendje sa të kërkojë ndihma nga imperialistët, të kontraktojë marrëveshje me ta për ndërtimin e një sërë ndërmarrjesh industriale me kredi. Kjo do të thotë se sot Bashkimi Sovjetik, jo vetëm nuk i ndihmon dot ekonomikisht siç ndihmonte dikur vendet e demokracisë popullore, por gjendja në të cilën e kanë katandisur atë revizionistët, i nxit këto vende të ndjekin të njëjtën rrugë, t'u drejtohen edhe ato për «ndihma» e kredi shteteve imperialiste. Në këtë mënyrë po zhvillohet një proces dizintegrimi i këtyre vendeve ku sundojnë revizionistët dhe po zhvillohet një-kohësisht integrimi i ekonomisë së tyre me vendet kapitaliste. Natyrisht, ky proces ecën jo vetëm në fushën ekonomike, por është e logjikshme që, si pasojë, ai do të ecë gjithashtu dhe në fushën politike e ideologjike, pra edhe në strukturë, edhe në superstrukturë.

Ç'tregon e gjithë kjo? Në sytë e popujve të këtyre vendeve dhe të marksistë-leninistëve kjo tregon kalbëzimin e revizionistëve, tradhtinë e tyre. Një situatë e tillë është e pamundur dhe e paevitueshme që të mos

i nxitë të ngrihen forcat revolucionare në këto parti dhe në këta popuj, ku drejtimin e kanë në duar revizionistët modernë. Kush mendon se ato nuk mund të ngrihen, ai humbet perspektivën e revolucionit. Ne kemi besim se në këto vende, si në Bashkimin Sovjetik, në Poloni e gjetkë, ka forca të mëdha revolucionare, ka marksistë-leninistë, të cilët, është rasti dhe e drejta të thuhet, se revizionistët i kapën në befasi, i gënjyen dhe udhëheqjet e vjetra të këtyre partive, pas vdekjes së Stalinit, e humbën vigjilencën përpara demagogjisë së revizionistëve, gjë që ka luajtur një rol të madh në ardhjen e revizionistëve në fuqi. Por njerëzit nuk mund të gënjehen vazhdimisht dhe nuk mund të gënjehen të tërë. Pikërisht në këtë e mbështet Partia jonë besimin dhe shpresën e vet se forcat revolucionare në këto vende do të ngrihen e do ta marrin veten.

Lëvizjet revolucionare, duke u forcuar në vendet e Amerikës Latine, në Azi, në Afrikë e kudo gjetkë ku zien kazani, ndihmojnë që të goditet imperializmi, të dobësohen pozitat e tij. Njëkohësisht këto lëvizje ndihmojnë fuqimisht që të goditen dhe të dobësohen edhe pozitat e revizionizmit modern. Ne si marksistë-leninistë nuk mund ta quajmë të humbur luftën as në Bashkimin Sovjetik as në vendet e tjera ish-socialiste. Ne i kuptojmë kushtet shumë të vështira të luftës së marksistë-leninistëve kundër armiqve antimarksistë në këto vende, sepse revizionistët nuk e lëshojnë dhe nuk do ta lëshojnë lehtë pushtetin, ashtu si nuk e lëshojnë lehtë fuqinë, as imperialistët. Nga ana tjetër, ne jemi të sigurt se revizionistët modernë, kur ta shikojnë keq, do t'u kërkojnë ndihmë imperialistëve. Këtë e ka pro-

vuar lufta, e kanë provuar revolucionet. Por çfarëdo që të bëjnë armiqtë tanë, ne jemi të sigurt se marksizmi do të fitojë dhe revizionistët modernë do të humbasin.

Lufta e marksistë-leninistëve, revolucionet që po zhvillohen në botë, luftërat nacionalçlirimtare, luftërat kundër imperializmit nuk do t'i lënë revizionistët të zbatojnë taktikat e planet e tyre dhe të zhvillojnë në qetësi dhe në fshehtësi aleancat e tyre me imperialistët amerikanë. Lufta që bëjnë marksistë-leninistët në unitet të plotë dhe në një bashkëveprim frontal e të pjesshëm, do të jetë në dobinë e përgjithshme të revolucionit, por njëkohësisht do të jetë edhe në interes të vendeve të veçanta. Parullën e «kushteve specifike» të secilit vend revizionistët e kanë në majë të gjuhës, me qëllim spekulimi, ndërsa në kushtet e veçanta të çdo vendi i mbajmë parasysh në veprimtarinë tonë praktike pa harruar ligjet e përgjithshme të marksizëm-leninizmit. Ne marksistët e kemi të qartë se ashtu si janë zhvilluar ngjarjet në Shqipëri, nuk mund të zhvillohen edhe në Peru, se nuk mund të ngjasë në Peru ashtu sikurse ka ngjarë në ndonjë vend tjetër. Por ama, si te ne, ashtu edhe te ju, apo në çdo vend tjetër të botës, është e domosdoshme që, për ta çuar revolucionin deri në fitoren e plotë të proletariatit dhe të masave të tjera të shfrytëzuara, ky revolucion të udhëhiqet nga partia komuniste, që të luftohet me të gjitha mjetet kundër armiqve të klasës, që të përgatitet revolucionin me armë, që kur të futemi në revolucion, sikurse ka thënë Lenini, ta çojmë atë gjer në fund, që të vendoset diktatura e proletariatit, të zhvillohet lufta e klasave etj., etj.

Këto që i përmenda i dimë të tërë se janë ligje të përgjithshme, të domosdoshme e duhet të kihen parasysh e të zbatohen nga të gjitha vendet dhe partitë. Fakti që te ju ka më shumë latifondistë dhe te ne ka pasur më pak, që te ju ka më shumë kapitalistë të mëdhenj dhe te ne ka pasur më pak nuk do të thotë që ne të mos e zbatonim në vendin tonë parimin e luftës së klasave dhe të vendosjes të diktaturës së proletariatit. Ne e zbatuam dhe e zbatuam mirë këtë, natyrisht sipas kushteve konkrete të vendit tonë. Edhe ju, gjatë zbatimit të këtij parimi, do të keni parasysh kushtet konkrete të vendit tuaj, të cilat ju i njihni më mirë se kushdo tjetër, ashtu sikurse i njohim ne kushtet e vendit tonë më shumë se të tjerët. Por në asnjë mënyrë nuk u lejohet marksistë-leninistëve të injorojnë këto ligje të përgjithshme të domosdoshme për të gjithë, duke u justifikuar me parullat e «kushteve specifike».

Në kemi për detyrë të këmbëjmë eksperiencën me njëri-tjetrin. Arma jonë ideologjike është e përbashkët. Megjithatë mund të ketë ndonjë çështje që ne nuk e shohim drejt, prandaj ju lutemi të na bëni vërejtje e të na jepni eksperiencën tuaj, ashtu siç bëjmë ne, që atë eksperiencë të paktë që kemi, shokëve dhe vëllezërve tanë ua japim pa hezitim. Sigurisht ka edhe parti të mëdha me një eksperiencë të pasur në luftë dhe në vjetërsi, por nuk ndodh kurdoherë që një parti e madhe të ketë edhe eksperiencën më të madhe. Partia juaj është akoma e vogël në Amerikën Latine, por eksperiencia e saj në luftë kundër kapitalit amerikan dhe të brendshëm, kundër latifondistëve peruanë dhe të tjerë,

është një eksperiencë interesante, e madhe dhe shumë e vlefshme, jo vetëm për ato parti që luftojnë për të marrë pushtetin, por edhe për partitë që janë në fuqi. Edhe Partia jonë, që e ka sjellë popullin në fuqi, ka nevojë për eksperiencën dhe ndihmën e partive të tjera, sepse ajo çdo ditë është në luftë me vështirësi të shumta, si në fushën ekonomike, ashtu edhe në fusha të tjera, të cilat i kapërcejmë me punën tonë të përditshme.

Duke marrë fjalën shoku Paredes foli mbi situatat e favorshme që janë krijuar për marksistë-leninistët në Peru, përgjithësisht në shumë vende të Amerikës Latine, si dhe për përpjekjet që bëjnë ata për të organizuar një mbledhje të përbashkët të përfaqësuesve të partive komuniste të këtyre vendeve. Pastaj përsëri e mori fjalën

SHOKU ENVER HOXHA: Është shumë interesante situata në vendet e Amerikës Latine. Ju faleminderit për ekspozenë mjaft të qartë që na bëtë mbi gjendjen në vendin tuaj veçanërisht. Ju na dhatë një ndihmë të madhe, sepse na sqaruat jo vetëm për gjendjen, për mënyrat dhe për metodën e punës e të luftës që bëni ju në Peru, por, të themi të drejtën, na hapët neve perspektiva dhe kjo na ndihmon për të qenë më mirë në dijeni dhe për t'i gjykuar drejt situatat në vendet e Amerikës Latine. Do të jetë një fitore e madhe për marksizëm-leninizmin sikur edhe në vendet e tjera të Amerikës Latine partitë komuniste dhe punëtoare të arrijnë ato suksese që keni arritur ju.

Është një gjë shumë e mirë mbledhja e përfaqësuesve të partive marksiste-leniniste për konsultime të

përbashkëta që keni ndër mend të bëni. Kjo ka një rëndësi kolosale për fitoren e marksizëm-leninizmit, për koordinimin e veprimeve midis partive, me qëllim që të arrihen sa më shumë suksese. Ja, këtë themi ne të bëhet midis partive. Unë mendoj, se ju, më vonë, pasi ta keni bërë këtë mbledhje, duhet të organizoni mbledhje edhe me partitë e kontinenteve të tjera, në të cilat mund të shtrohen dhe të zgjidhen bashkërisht çështje të ndryshme të vijës së organizimit të luftës kundër imperializmit e revizionizmit dhe të ndihmës reciproke.

Ne e konsiderojmë shumë të drejtë dhe shumë të mirë idenë që keni ju për ndihmën e efektshme që duhet t'i japin njëra-tjetrës partitë e vendeve të Amerikës Latine, për koordinimin e veprimtarisë e të luftës suaj. Një veprimtari e tillë do t'i lehtësojë shumë partitë komuniste dhe do ta forcojë lëvizjen revolucionare në këto vende.

Ne jemi të shqetësuar për shokët e Partisë Komuniste të Brazilit, sepse u bë një kohë e gjatë që kemi humbur krejtësisht kontaktet me ta. Në Brazil, pas grushtit të shtetit, ne kemi mësuar se ka pasur edhe goditje nga ana e reaksionit kundër forcave përparimtare të vendit.

SHOKU SATURNINO PAREDES: Para se të nise-sha nga Peruja, ne mundëm të merrnim një kontakt me shokët brazilianë, por pasi u largova, nuk kam marrë vesh ç'ka ndodhur më vonë në Brazil. Kur të kthehem në atdhe, pasi të marrim kontakt me shokët brazilianë, unë do të përpiqem t'ju informoj për t'ju vënë në dijeni mbi gjendjen e tyre.

Fjalët që na thatë, shoku Enver, janë me shumë

interes për ne, prandaj përmbajtjen e bisedimit të sotëm me ju unë do t'ia bëj të ditur Byrosë Politike të partisë sonë. Po kështu unë do ta informoj udhëheqjen e partisë edhe për fjalimin që mbajtët me rastin e festës së 20-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë. Janë shumë të vlefshme për ne tezat që shtrohen në atë fjalim, sidomos në drejtim të punës që duhet bërë për të krijuar dhe për të forcuar unitetin në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ju atje ngritët me të drejtë çështjen që udhëheqësit sovjetikë duhet t'i pranojnë gabimet që kanë bërë ndaj Shqipërisë, si dhe çështjet mbi Stalinin. Ato janë shumë të rëndësishme.

Ju jeni në kondita shumë më të mira nga ne, sepse duke u ndodhur pranë vendeve ku janë në fuqi klika revizioniste, keni pasur mundësi t'i njihni shumë kohë përpara, keni parashikuar taktikat dhe metodat e veprimtarisë që kanë zbatuar dhe do të zbatojnë revizionistët për të gënjyer marksistë-leninistët.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne i kemi hequr në kurriz pasojat e veprimtarisë armiqësore të revizionistëve. Kuptohet se në fillim ne nuk para i shikonim taktikat e punës së tyre, ashtu siç i shikojmë tani, sepse atëherë ata vepronin në mënyrë shumë të maskuar e të djallëzuar.

Tani ne duhet të mendojmë dhe të përpiqemi për të konkretizuar lidhjet tona dhe shkëmbimin e pikëpamjeve me shokët e Partisë suaj.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

DUKE U MBËSHTETUR NË FORCAT E POPULLIT TONË NE DO TË ECIM KURDOHERË PËRPARA

*Nga biseda me përfaqësues të kolonive shqiptare të
mërgimit të ardhur në vendin tonë me rastin
e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut*

16 dhjetor 1964

Pasi u takuan dhe zunë vend të gjithë, shoku Enver Hoxha u interesua se si e kaluan me vizitat nëpër Shqipëri vëllezërit e kolonive shqiptare dhe cilat vende vizituan. Disa prej tyre treguan se kishin kaluar shumë mirë kudo dhe se një natë më parë ishin kthyer nga Shkodra. Të gjithë kanë mbetur shumë të kënaqur nga realizimet e mëdha që janë bërë në vendin tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, pas Çlirimit janë bërë shumë gjëra të mira në vendin tonë.

JAKUP MAHMUTI: Sidomos ne, që jemi larg atdheut, çuditemi me të gjitha këto që janë bërë.

SHOKU ENVER HOXHA: Janë bërë vërtet mjaft gjëra dhe të tjera do të bëhen në të ardhmen. Natyrisht, këto realizime ne i matim me të kaluarën, sepse, kur bëjmë krahasime me ato që kemi pasur përpara Çliri-

mit, dalin shumë qartë përparimet e mëdha dhe gjithë këto punë të mira që ka bërë populli shqiptar, në vitet e pushtetit popullor, nën udhëheqjen e Partisë.

Ju keni emigruar prej kohësh nga Shqipëria, megjithatë ne jemi të bindur se ju e kuptoni sa i vështirë ka qenë krijimi i këtyre veprave; për t'i ndërtuar ato janë dashur përpjekje, lodhje, djersë dhe njëkohësisht vigjilencë, organizim, punë politike dhe fonde të mëdha financiare. Për të arritur këto suksese, natyrisht, janë dashur përpjekje të mëdha nga ana e popullit, por Partia jonë diti t'i mobilizojë mirë masat punonjëse, jo me urdhra dhe imponim, sikurse thonë armiqtë, po me bindje, duke i bërë ato të ndërgjegjshme. Në radhë të parë, Partia u hapi sytë njerëzve, i ngriti politikisht, i bëri të ndërgjegjshëm për forcën e tyre mendore dhe fizike, i lidhi ngushtë me interesat e përgjithshme të shtetit të tyre, i dha të kuptojë secilit se nuk mund të sigurohet e mira e shtëpisë dhe e familjes pa luftuar e pa siguruar njëkohësisht edhe të mirën e përgjithshme të të gjithë popullit. Këto interesa janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe të gjithë njerëzit tanë duhet të jenë të bashkuar, që ato të plotësohen sa më mirë, që të sigurohet mirëqenia për të gjithë. Për të realizuar këtë qëllim të lartë Partia dhe Qeveria e mobilizuan mirë popullin, e ngritën në këmbë atë edhe në periudhën e ndërtimit të jetës së re, ashtu si dje në luftën për çlirim. Me mijëra e mijëra kuadro dolën nga shkollat e mesme e të larta, që u hapën kudo në vendin tonë, dhe tani jemi në gjendje që, duke u mbështetur mbi bazën ekonomike të krijuar nga populli ynë nën udhëheqjen e Partisë, ve-

ndi ynë të ecë edhe më përpara në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Për këtë ne jemi mbështetur kryesisht në forcat tona, ndërsa ndihma që na kanë dhënë të tjerët ka qenë fare e vogël përpara punës së madhe që ka bërë populli shqiptar. Sado e madhe të jetë ndihma e tjetrit, ajo mbetet kurdoherë e vogël përpara forcës së madhe ekonomike të vendit. Është fakt, dhe këtë mund ta themi me krenari e pa na u rritur mendja, se Shqipëria është një vend socialist me stabilitet të lartë ekonomik e politik. Çdo gjë që bëhet në vendin tonë është rezultat i punës vetëmohuese, i dashurisë, i unitetit, i kompaktësisë së popullit tonë rreth Partisë dhe Qeverisë, i zhvillimit të njerëzve, i edukimit të tyre, i mprehjes së vigjilencës ndaj çdo rreziku që na rrethon. Janë gjithë këta faktorë që kanë ndikuar në krijimin e këtij stabiliteti në shoqërinë dhe në ekonominë tonë socialiste. Dhe kjo është me shumë rëndësi. Mund të flasësh sa të duash me parulla politike, por kryesorja është që propaganda të shoqërohet edhe me mirëqenien e kujdesin për njerëzit, me punë konkrete për plotësimin e nevojave materiale të tyre, pasi, edhe pse populli ynë është patriot, në qoftë se do të kishte mungesa të artikujve kryesorë në treg, do të krijohej pakënaqësi.

Partia i ka zhvilluar në mënyrë të harmonishme të gjithë sektorët e punës dhe të jetës, prandaj edhe ka një stabilitet më të lartë në vendin tonë në krahasim me vendet e tjera. Në Shqipëri nuk ka papunësi dhe uri siç ka në SHBA dhe në vendet e tjera kapitaliste, ku miliona njerëz vuajnë për bukë. Shqipëria nuk ka

qenë dhe nuk është kolonizatore si SHBA, Franca, Belgjika etj. që të ishte majmur me gjakun dhe me djersën e popujve të shtypur. Populli ynë nuk u ka rënë kurrë në qafë të tjerëve, përkundrazi kanë qenë të tjerët që na kanë rënë në qafë. Çdo gjë në vendin tonë është ngritur nga zeroja. Megjithëkëtë ekonomia jonë përparon çdo ditë dhe niveli i jetesës te ne rritet vazhdimisht. Dhe kjo ka rëndësi të madhe.

Le të shohim ç'ndodh në vendet ish-socialiste të Evropës. Bullgaria sot, për shembull, ndodhet në gjendje të vështirë. Këtu e 17 vjet më parë Bullgaria ecte në rrugë të sigurt në zhvillimin e ekonomisë, një-rëzit kishin më shumë të ardhura, fshati bullgar bënte përparime dhe kështu vazhdoi gjersa kishte në krye një udhëheqje marksiste-leniniste. Por më vonë erdhën në fuqi revizionistët modernë dhe gjendja ndryshoi menjëherë. Puna ka ardhur tani gjer atje saqë Bullgaria, nga një vend i zhvilluar bujqësor që ishte, tani nuk arrin të furnizojë tregun dhe të plotësojë nevojat e popullit me produkte ushqimore. Në tregun bullgar ka edhe mungesë mishi. Edhe vendet e tjera revizioniste do të kalojnë sivjet një dimër të rëndë. Ndërsa në vendin tonë Partia dhe Qeveria kanë marrë masa, në çdo drejtim, për të mos pasur vështirësi në furnizimin e popullit. Veç kësaj, ky vit që po kalojmë, ka qenë një vit i mirë bujqësor për ne, prandaj populli do të ketë çdo gjë, bile do të ketë nga çdo gjë më shumë se vjet.

Ju vizituar disa qytete, patët takime me njerëz të ndryshëm dhe patë se si ishte furnizimi te ne. Me gjithë bllokadën e fortë që na u bë nga tradhtari

Hrushov e shokët e tij si dhe vështirësitë që iu shkaktuan popullit shqiptar, ai u mobilizua si kurrë ndonjëherë dhe i kapërceu këto vështirësi pa kriza.

Ashtu si ne edhe ju gëzoheni për këto suksese që ka arritur populli ynë pas Çlirimit, se të gjithëve së bashku na ka bërë ky popull, për të cilin, jam i sigurt, se edhe ju, ashtu si ne, e ndieni veten kryelartë. Pikërisht te populli qëndron edhe forca e madhe e pathyeshme e Partisë sonë. Po të mos i vinte rëndësi Partia vlerës së madhe të popullit, ajo nuk do ta kishte këtë forcë që ka. Ajo nuk mendon dhe nuk vepron si kapitalistët që e shfrytëzojnë popullin dhe e përdorin si vegël për qëllimet e tyre. Shqipëria nuk do të dilte dot kurrë nga mjerimi, po të veprohej kështu. Partia mendon e punon vetëm për popullin dhe di se e gjithë forca dhe dituria janë në popull. Ato vlejné kur vihen në shërbim të tij për ta ngritur gjithë popullin në një nivel të lartë diturie dhe zotësie për të bërë gjëra të mëdha.

Kapitalistët i akuzojné partitë komuniste si të egra. Borgjezët bërtasin përse nuk ka shumë parti në vendet socialiste. Po përse të këtë shumë parti? Po të kishte shumë parti në vendin tonë, këtu do të ishte një rrëmujë e s'do të merrej vesh asgjë. Në vendet kapitaliste ka shumë parti, sepse atje ka edhe shumë lloj trustesh, ka klasa me interesa të kundërta nga ato të popullit, kurse te ne është populli në fuqi. Për këtë e bëri Partia luftën, që në fuqi të jetë populli.

Gjithë këto realizime dhe ndryshime të mëdha që ju i shikoni me sytë tuaj nuk mund të ndodhnin në Shqipëri, po të mos e donte populli Partinë. Respektin

dhe simpatinë e madhe që gëzon sot vendi ynë në botë nuk e ka pasur kurrë. Po kush e bëri këtë? Këtë e bëri vetë populli i udhëhequr nga Partia. Titoja, Din Rasku, Dë Goli, Hrushovi dhe të tjerë si këta, natyrisht nuk mund të kenë respekt për Shqipërinë dhe për Partinë tonë. Por ngritja, përparimi i Shqipërisë, qëndrimet e Partisë dhe të popullit tonë kundër armiqve depërtojnë në mendjen e masave të popujve të vendeve të tjera dhe duan apo nuk duan, gazetat borgjeze detyrohen të thonë nga një fjalë se diçka bëhet në Shqipëri. Shqipëria është e vogël, po zëri i saj për çështjet e drejta, që ajo ngre sot, po përhapet në të katër anët e botës dhe kjo ka shumë rëndësi. Pastaj Shqipëria ka edhe miq të shumtë në të gjithë botën. Puna që bëjnë këta miq, për njohjen e propagandimin e Shqipërisë ndikon te masat e popullit në këto vende. Të gjitha këto ndihmojnë që të rritet autoriteti i Shqipërisë. Këtë janë të detyruar ta pohojnë edhe armiqtë tanë. Diplomata të huaj, sidomos ata të borgjezisë, që nuk na e duan të mirën, u thonë diplomatëve tanë se janë në kundërshtim me ne, por megjithatë e respektojnë Republikën Popullore të Shqipërisë. Dhe s'ka si të ndodhë ndryshe, se Shqipëria socialiste qëndron e patundur në pikëpamjet e veta, të cilat jo vetëm janë të palëkundshme, po edhe të drejta.

Në kohën e Stalinit Bashkimi Sovjetik ndiqte një rrugë të drejtë. Mirëpo pas ardhjes së Hrushovit në fuqi, qëndrimet e tij u bënë të lëkundshme bile edhe të rrezikshme për popujt, për interesat e proletariatit. Këto qëndrime kanë bërë që në të gjitha vendet e ish-demokracisë popullore të krijohet një situatë e vësh-

tirë, për popujt. Por kjo situatë nuk do të kalojë siç mendojnë revizionistët modernë që janë në fuqi. Popujt kanë luftuar në këto vende, ata kanë punuar për ndërtimin e socializmit dhe ia dinë vlerën këtij. Prandaj jemi të bindur se në këto vende kjo gjendje do të jetë e përkohshme. Është fakt se revizionistët u tremben shumë popujve dhe shmangen nga vija e tyre, por, po u largove nga vija e popullit, e pëson si në atë fjalën e urtë që thotë populli ynë: «delen që largohet nga tufa e ha ujku».

E tillë, të dashur vëllezër, është situata e brendshme dhe e jashtme e Shqipërisë. Kush e dëgjonte Shqipërinë më parë? Ju këtë e dini mirë. Ja, për shembull, shqiptarët, që jetojnë në Amerikë e dinë një gjë të tillë. Shoqëria «Shqipëria e lirë» është me të vërtetë një shoqëri patriotike, demokratike, e lidhur ngushtë me popullin e vet, pro pushtetit tonë dhe e mbron me konsekuencë atë. Kjo shoqëri është gjithashtu kundër kërcënimeve që i bëhen Shqipërisë nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe nga reaksionarët e tradhtarët shqiptarë që janë atje. Shoqëria «Vatra» nuk është në pozita të tilla, përkundrazi ajo tani ka rënë në duart e tradhtarëve dhe të reaksionarëve. Mirëpo, puna që bën Partia në përgjithësi i frymëzon atdhetarët shqiptarë të shoqërive patriotike, si dhe miqtë e Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ta bëjnë sa më të njohur Shqipërinë. Zëri i Shqipërisë sot dëgjohet kudo.

Tani në OKB po zhvillohet një debat midis sovjetikëve dhe amerikanëve, të cilët kanë kontradikta midis tyre. Amerikanët u kërkojnë sovjetikëve që të pa-

guajnë edhe ata për mbajtjen e trupave që kanë ndërhyrë në Kongo, duke vënë në dukje se vendimin për të dërguar ushtritë e OKB-së në Kongo e ka aprovuar edhe Hrushovi. Imperialistët amerikanë nuk e kanë hallin për t'u marrë 200 milionë dollarë sovjetikëve, se ata kanë siguruar miliarda nga shfrytëzimi i egër që u bëjnë popujve kolonialë, por duan ta detyrojnë qeverinë sovjetike të dërgojë ushtarë dhe të pohojë përpara gjithë botës se edhe ajo po dërgon ushtarë në Kongo për të vrarë popullin kongolez. Me politikën kapitulluese të Hrushovit, Bashkimi Sovjetik është komprometuar përpara opinionit botëror dhe tani ruhet shumë që të mos komprometohet më tej.

Në OKB tani po punohet në mënyrë qesharake. Në vitet e kaluara gjer në këtë kohë ishin bërë zgjedhjet e të gjitha organeve, kurse tani puna arriti deri atje sa kryetari të zgjidhej fare pa votim. Pra u bë njëfarë kompromisi. Me një fjalë OKB-ja është kthyer në një panair, ku delegatët e vendeve të ndryshme mbajnë vetëm nga një «fjalim» pa asnjë rezultat. Nesër ose pasnesër atje do të flasë edhe delegati i Shqipërisë, i cili do të shprehë pikëpamjen e vendit tonë. Të gjithë gazetarët presin këtë moment, se e dinë që Shqipëria do të ngrëjë zërin edhe kundër imperializmit amerikan, edhe kundër revizionistëve hrushovianë, se ajo është vetëm me të drejtën, prandaj do të kërkojë zbatimin e Statutit. Pikërisht për këtë fakt armiqtë na e kanë frikën se ua përplasim të vërtetën në fytyrë.

Jashtë është krijuar një situatë e shëndoshë për Shqipërinë. Kjo është një fitore e madhe për ne. Sot nuk preket dot lehtë Shqipëria. Pas Çlirimit në kufi

janë bërë herë pas here provokacione. Tani të tilla provokacione ka më pak e nganjëherë s'ka fare, por ne vigjilencën nuk e humbasim. Gjatë 20 vjetëve qarqet reaksionare rreth kufijve tanë përdorën çdo gjë kundër Shqipërisë, por të gjitha sulmet e tyre u zmbarsën, morën përgjigjen e merituar. Ata panë se vendi ynë kaloi me sukses të gjitha situatat jashtëzakonisht të vështira, politike, ekonomike. Shqipëria përballoi bllokada dhe jo vetëm ato të monarko-fashistëve grekë, të revizionistëve titistë, të imperialistëve italianë, amerikanë etj., por edhe bllokadën e Hrushovit e të revizionistëve të tjerë. Ata i provuan mirë forcën dhe vendosmërinë tonë, lidhjet e Partisë me popullin, se ne e mbajmë barutin gjithmonë të thatë, se i qëndrojmë me guxim gjithë reaksionit dhe çdo provokacioni i përgjigjemi menjëherë.

Çfarë na bën ne të aftë e të guximshëm të mbajmë një qëndrim të tillë për mbrojtjen e atdheut? Këtë e bën vetëm forca e bashkuar e popullit tonë, udhëheqja e Partisë së Punës e askush tjetër. Dhe forcën e popullit tonë e shohim sot në mbarë botën. Armiqtë tanë bëjnë shumë propagandë kundër nesh. Natyrisht ata këtë punë kanë, kjo është e kuptueshme, por në fakt edhe ata e dinë se regjimi ynë i ka bazat në popull, ai është i lidhur ngushtë me të, prandaj ka arritur suksese të mëdha në ekonomi dhe në kulturë, në fushën politike dhe në lëmin ndërkombëtar.

Ju, vëllezër shqiptarë, që jetoni jashtë atdheut, të jeni të sigurt për vendlindjen tuaj, le të jenë të sigurt edhe të gjithë shqiptarët e tjerë që jetojnë në mërgim dhe që i ka marrë malli për Shqipërinë. Ne i ftojme

ata të vijnë në Shqipëri si në shtëpinë e tyre, të takohen me të afërmit, të vizitojnë vendin, pastaj, po të duan të qëndrojnë, po të duan le të kthehen prapë atje ku janë vendosur prej vitesh. Ne ju sigurojmë se, sido që të venë punët, Shqipëria do të qëndrojë e fortë, e patundur dhe kurdoherë do të përparojë, sepse Partia dhe Qeveria janë të lidhura me popullin. Këtë nuk e themi për t'i bërë qejfin vetes, por i tillë është realiteti.

Partia na mëson të jemi të thjeshtë me popullin, të lidhur me të. Kjo do të thotë që të mos qëndrosh mbi popullin, por t'i dëgjosh e t'i zgjidhësh drejt e në kohë hallet e tij. Kështu ngjet te ne. Popullit nuk i pëlqejnë njerëzit që shkëputen prej tij, prandaj ai i do komunistët, sepse këta janë njerëz të thjeshtë dhe të dashur me të, se ata bëjnë çdo gjë për lumturinë e tij.

Por në punë, krahas sukseseve ne kemi edhe të meta, të cilat nuk i fshehim. Kemi bërë mjaft përparime në lëmin e ekonomisë, por, sigurisht, jo çdo gjë ecën si në vaj. Ne jemi të ndërgjegjshëm se, po t'i kishim luftuar më mirë dobësitë, do të kishim arritur rezultate edhe më të mëdha. Por edhe vështirësi kemi, pasi niveli teknik i kuadrove tanë nuk ka arritur akoma në një shkallë të tillë që secili të zotërojë si duhet mjeshtrinë e tij. Ne nuk kemi njerëz me një eksperiencë të gjatë 20-25-vjeçare në punë, sepse shumica e punëtorëve dhe e teknikëve janë të rinj e nuk e kanë një vjetërsi të tillë. Duhet të keni parasysh, ju vëllezërit tanë, që fabrikat e para moderne në Shqipëri filluan të futen në prodhim aty nga vitet 1952-1953 dhe

pjesa më e madhe e tyre më vonë, sepse nga vitet 1949-1950 filluam ndërtimet për objektet e reja industriale. Sidoqoftë dalngadalë krijuam një numër kuadrosh, të cilët ndihmuan që rendimenti i punës të na të jetë çdo vit më i madh, cilësia e mallrave të jetë më e mirë, trajtimi i lëndëve të para ushqimore, industriale etj. të bëhet më me kujdes nga njerëzit.

Kjo ka ardhur në sajë të udhëheqjes së Partisë, e cila zhvillon një punë të gjerë politike për edukimin e njerëzve në luftë me mbeturinat e ndryshme, që ekzistojnë në ndërgjegjen e tyre. Këto të fundit janë të dëmshme si për vetë personin që i bart, por edhe për shoqërinë, prandaj Partia punon që ato të zhduken dhe njerëzit të edukohen, të bëhen të mirë, të ndërgjegjshëm, të disiplinuar, të pastër moralisht. Por gjersa të arrihet kjo në shkallë të përgjithshme duhet mjaft kohë, prandaj ne kemi akoma të meta, të cilat në njëfarë mase na pengojnë në punë.

Populli ynë është i mirë, trim, punëtor, por midis masës ka edhe disa njerëz të ligj që duan të përvehtësojnë, pa të drejtë, pasurinë socialiste. Këto shfaqje ne i dënojmë dhe, në radhë të parë, ato i lufton vetë populli, i cili është vënë në roje të pasurisë socialiste, prandaj vijnë duke u ulur vazhdimisht. Me ngritjen e vazhdueshme të nivelit ekonomik dhe kulturor të popullit çdo ditë e më shumë po pakësohen edhe shfaqje të tilla si grindjet, shkurorëzimet, paragjykimet, që cenojnë personalitetin e gruas shqiptare, e cila, sot, i ka të garantuara me ligj të drejtat e barabarta me burrin dhe nuk varet më ekonomikisht prej tij, si në qytet ashtu dhe në fshat. Gruaja shqiptare ka dalë nga

muret e shtëpisë dhe gjendet në të gjitha frontet e punës ndërtimore, gjë që është një fitore e madhe jo vetëm ekonomike, por edhe shoqërore e politike.

Sukseset që kemi arritur, ne i matim me shkallën e zhvillimit që ka ekzistuar në vendin tonë më parë, por asnjëherë nuk kënaqemi me ato që kemi realizuar. Duke shfrytëzuar mundësitë që kemi, ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet që niveli i jetesës, ai arsimor e kulturor i popullit tonë, të vijë kurdoherë në ngritje. Për këtë qëllim, në pesëvjeçarin e ardhshëm parashikojmë të bëjmë përparime më të mëdha, do t'i zgjerojmë më tej industrinë dhe minierat tona, do të përpiqemi të përpunojmë në vend lëndën e parë, gjë që do të na sigurojë më shumë të ardhura. Më përpara ne kishim vetëm një fabrikë për shkrirjen e bakrit. Tani ngritëm edhe një tjetër në Kukës, të cilën e projektuan dhe e ndërtuan nga e para njerëzit tanë, pa asnjë ndihmë nga jashtë. Tani në këtë fabrikë po ndërtohet edhe një furrë tjetër, e kështu me radhë.

Sot hekur-nikelin ia shesim Çekoslovakisë, por ajo na e ka marrë atë në baza krejt kapitaliste dhe jo mbi bazën e lidhjeve vëllazërore që duhet të ekzistojnë midis vendeve socialiste. Çekët kanë vepruar me djallëzi ndaj nesh, duke synuar që të nxirrnin sa më shumë fitime nga blerja e mineralit tonë, në kurriz të popullit shqiptar. Po të mos kishin qëllime të tilla të këqija, uzina për shkrirjen e hekurit shqiptar duhej të ishte ndërtuar në Shqipëri, ku është lënda e parë, dhe jo në Çekoslovakia. Këtë uzinë Çekoslovakia mund të na e ndërtonte me kredi dhe të mos vepronte kështu si ka vepruar, sepse Shqipëria nuk është koloni e Çekoslo-

vakisë. Ne i kuptuam djallëzitë e tyre, por duke pritur që ata të hiqnin dorë nga hileja e tyre, e lamë kështu përkohësisht, duke u mjaftuar hëpërhë me shitjen e hekurit tonë. Por ne do ta ngremë në vendin tonë uzinën për shkrirjen e hekurit dhe e dimë që Çekoslovakia do të ketë prapë nevojë për hekurin tonë. Atëherë ne do t'u themi atyre se do t'u japim, por pasi të paguajnë edhe borxhet e vjetra.

Ne kemi tani forca dhe mundësi më të shumta që ta zhvillojmë më tej ekonominë tonë në radhë të parë me forcat e vetë popullit. Ne kemi një klasë punëtore të mrekullueshme, kemi fshatarësinë patriote, kemi një rini të fortë, kemi kuadrot tanë. Me punën e bërë nga mbarë populli, vendi ynë ka përparuar shumë. Para Çlirimit, jo vetëm fshatrat, por edhe qytetet si Gjirokastra nuk kishin dritë elektrike. Bile 30 vjet më parë vetë njerëzit ishin shumë më të prapambetur. Kurse tani është krejt ndryshe. Jeta e popullit është përmirësuar mjaft si në qytet edhe në fshat. Sot fshatarin tonë nuk e dallon nga qytetari. Bazë për këtë është puna. Fshatarësia jonë punon pa u lodhur dhe merr rendimente të kënaqshme. Ka parcela, për shembull, në NBSH-në e Maliqit që kanë prodhuar 40-50 kv grurë për ha dhe gjer në 430 kv panxhar për ha. Këto nuk janë realizime të vogla. Si Republikë në grurë ne marrim rendiment relativisht të mirë dhe në kushtet që dihet, pa u hedhur drithërave pleh kimik. Por, kur të mbarojnë së ndërтуari uzinat e plehrave kimike, ne do të kemi plane të tjera, rendimente shumë më të larta.

Perspektivat e bujqësisë sonë janë shumë të mira dhe ato do t'i bëjmë realitet, sepse fshatarësia jonë ka përqaftuar kolektivizimin, i cili është i vetmi shpëtim për të. A mund të thaheshin gjithë këto fusha, të sistemoreshin e të kanalizoheshin ato, a mund të arriheshin këto rendimente përpara në Shqipëri? Jo. Mirëpo, edhe duke qenë arat të ndara copa-copa të vogla, nuk mund të bëhej mekanizimi i bujqësisë, siç është bërë sot dhe fshatari ynë nuk do t'i punonte dot me një pendë që këto sipërfaqe të mëdha që janë shtuar. Por, duke u bashkuar në kooperativa, jo vetëm që qetë janë shtuar, por veç atyre shteti ka sjellë me mijëra traktorë, sepse e dimë që vetëm me që bujqësia nuk mund të përparojë. Vetëm në fushën e Vrinës punojnë sot me dhjetëra traktorë. A e mbani mend si ishte atëherë fusha e Dropullit? Ta shihni si është tani. Por në të ardhmen do të bëhet edhe më e begatshme. Ç'të thuash pastaj për fushën e Myzeqesë dhe për fushat e tjera, që përpara ishin krejt kënetat e moçale dhe ka kohë që janë kthyer në toka buke e japin prodhime të bollshme?! Në të ardhmen do të përfundojmë të gjitha bonifikimet, kurse që tani kemi filluar që, për nevojat e bujqësisë, të ngremë dy uzina për prodhimin e plehrave kimike, një në Fier dhe tjetrën në Laç. Këto do të ndihmojnë për shtimin e prodhimit bujqësor, kështu ne do të mund të plotësojmë edhe më mirë nevojat e popullit tonë. Këto kohët e fundit në Gjirokastrë uzina metalike ka filluar të prodhojë artikuj të përdorimit të gjerë. Në perspektivë ne do ta zgjerojmë më tej atë, pasi nevojat e popullit për këta artikuj janë të mëdha. Ju i patë lugët dhe pirunët që prodhon kjo

uzinë, ata janë të mirë dhe s'kanë ndonjë ndryshim nga ata që prodhohen jashtë.

Në kohën e Stalinit, kur kishim marrëdhënie normale, Bashkimi Sovjetik na ndihmonte në mënyrë internacionaliste. Krejt ndryshe na ka ndodhur me çekët dhe me gjermanët, të cilët u treguan ndaj nesh hileqarë të mëdhenj. Makineritë e tyre të vjetra i lyenin me bojë dhe na i dërgonin si të reja, pastaj bënin një propagandë të madhe se gjoja i kishin dhënë ndihmë e kredi Shqipërisë. Ju vizituat Kombinatin e Konservimit të Peshkut në Vlorë. Në fillim, kur e ngritëm, ai ishte një fabrikë e vogël me makineri të vjetra të dërguara nga Gjermania Lindore. Kjo gjë na detyroi t'i dyfishonim shpenzimet për ta sjellë në gjendjen që është sot. Revizionistët gjermanë, kur na sulmojnë, mburren duke thënë se e kanë ndihmuar Shqipërinë, kurse po të hyjmë në llogari, del se ata na kanë grabitur.

Edhe bullgarët, megjithëse nuk kanë ndonjë kapacitet për të ndihmuar të tjerët, na u zotuan të na ndërtonin nja dy fabrika. Por ne u detyruam të harxhonim shumë para kot, se fabrikat e tyre ishin primitive. Kjo ndodhi edhe me fabrikat që na dërgoi Titoja para vitit 1948. Ju nuk i keni parë ato dhe ne kemi bërë gabim që nuk i kemi ruajtur, si për shembull, fabrikën për prodhimin e litarit në Rrogozhinë, që s'ishte veçse një haur me disa çikrikë, disa tela të vjetër e nja dy sendukë, ku përzihej kërpi dhe me të bëhej spangoja. Më mirë të thuash se këta mekanizma ishin të shekullit të 17-të! Kjo ishte fabrika e famshme e litarit që na dha Jugosllavia.

GLIGOR GALLANI: Duket do ta kishin trashëguar nga austriakët që nga Lufta e Parë Botërore.

SHOKU ENVER HOXHA: Mundet dhe thanë hajt t'ia japim Shqipërisë, pastaj bënin propagandë të madhe se Jugosllavia po e «ndihmonte» Shqipërinë me 2 miliardë dinarë kredi. Kurse e vërteta është se Jugosllavia na detyrohet neve disa miliardë dinarë borxh.

Prandaj themi se përparimet që janë arritur në vendin tonë populli ynë i ka arritur me forcat e veta, i ndihmuar nga Bashkimi Sovjetik, i cili, sa që gjallë Stalini, na jepte ndihmë internacionaliste. Por armiqtë tanë kanë thënë se gjoja Shqipëria është koloni e Bashkimit Sovjetik. Ata harrojnë se ne me Stalinin kishim marrëdhënie të shëndosha mbi bazën e internacionalizmit proletar. Për marksistë-leninistët kolonializmi është i huaj. Ndërsa Hrushovi me shokë kishin qëllim të na kolonizonin. Kjo nuk është marksiste. Hrushovianët donin ta kishin Shqipërinë të tyre në çdo drejtim, në drejtimin politik, ekonomik dhe ushtarak. Por Partia jonë, që është një parti marksiste, i zbuloi qëllimet e tyre dhe u dha dërmën, pa marrë parasysh kush janë dhe ç'fuqi të madhe kanë në dorë. Ne jo vetëm që nuk iu nënshtroam Hrushovit, por e gjithë bota po shikon se Shqipëria është më e fortë se përpara.

Hrushovi, si kundërshtar i marksizmit, duke vepëruar ashtu si bëri për ta shtypur popullin shqiptar, mendoi se brenda 2-3 ditëve do ta shtinte në dorë Shqipërinë. Ai u tregua shumë mendjeshkurtër, bile më mendjeshkurtër se imperialistët amerikanë, italianë, monarko-fashistët grekë dhe titistët jugosllavë, të cilët e dinë që Shqipëria nuk nënshtrohet lehtë, se, po të gu-

xojnë të na sulmojnë, populli ynë do t'i presë me luftë dhe, përveç dënimit nga ana e opinionit publik ndërkombëtar, ata këtu do të thyejnë kokën, pse lufta do të jetë e gjatë gjer në shkatërrimin e tyre.

Ç'i bëri Shqipëria Hrushovit? Shqipëria i tregoi botës se ai ishte shitur te borgjezia, se ishte një tradhtar me idetë e borgjezisë në zemër. Po të mos e kishim luftuar ashpër Hrushovin, ai do të ishte akoma në fuqi, por me demaskimin që iu bë përpara opinionit botëror politikës së tij tradhtarë, shokët e tij u detyruan ta largojnë nga udhëheqja dhe nga skena politike. Kjo erdhi jo vetëm nga lufta jonë, por sepse, në radhë të parë, ka luftë brenda në vetë Bashkimin Sovjetik, ku duket se do të ketë pasur medoemos ndonjë gjendje të vështirë. Ne jemi të sigurt se dhe këta që kanë ardhur në udhëheqje të Bashkimit Sovjetik ndjekin të njëjtën rrugë, atë të N. Hrushovit, veçse janë në situata më të vështira.

Natyrisht revizionistët nuk i kanë hedhur armët, por lufta e popujve, veprimtaria e marksistëve do t'i demaskojë ata vazhdimisht. Pastaj edhe imperialistët nuk do t'i lënë rehat revizionistët, ata tani u kanë zënë duart atyre dhe do të përpiqen t'u zënë edhe kokën. Rruga që kanë nisur revizionistët bashkë me imperialistët do t'i çojë në greminë. Duke ecur në këtë rrugë ata do të demaskohen më shumë, sepse popujt tani po i njohin gjithnjë e më tepër se cilët janë.

Kështu janë punët. Por ne do të luftojmë të ecim përpara. Çështja jonë është e drejtë. Nga ju, vëllezërit tanë, kërkojmë të na ndihmoni me sa të mundni që të propagandoni sukseset e përparimet e vendit tonë në ve-

ndet ku punoni dhe jetoni dhe ne do të jemi kurdoherë solidarë me punën dhe me veprimtarinë tuaj. Kini besim te ne se do të punojmë kurdoherë në rrugë të drejtë për të mirën e popullit, do të përpiqemi të forcojmë miqësinë e popullit shqiptar me popujt e vendeve ku ju jetoni. Me popujt ne kemi dhe duam të kemi gjithmonë marrëdhënie të mira. Ne dëshirojmë të kemi marrëdhënie edhe me qeveritë e këtyre vendeve. Këtë e doni edhe ju. Por që të kemi marrëdhënie të drejta, qeveritë e këtyre vendeve nuk duhet të kenë synime agresive ndaj Shqipërisë.

Ne e dimë dëshirën e shqiptarëve që jetojnë jashtë atdheut për të ardhur në Shqipëri për vizitë. Edhe ne duam që vëllezërit tanë, veçanërisht ata të Amerikës, të vijnë në Shqipëri, por me konditë që ata të mos i keqësojnë ndjenjat e dashurisë që kanë shqiptarët për atdheun e tyre duke shpifur e duke shtrembëruar realitetin shqiptar, siç bëjnë disa të ligj, që, kur kthehen në Amerikë, ato që shohin këtu i paraqesin krejt ndryshe dhe shqetësojnë kështu vëllezërit dhe motrat e tyre, të cilët nuk kanë mundësi ta vizitojnë vetë atdheun.

Ne nuk jemi kundër atyre që vijnë në Shqipëri me zemër të mirë, por që thonë edhe ndonjë kritikë për ne. Le të bëjnë vëllezërit tanë vërejtje dhe kritika. Por nuk na vjen mirë prej atyre që gënjejnë dhe shpifin kundër nesh. Njerëz të tillë ne nuk kemi përse t'i pranojmë ta vizitojnë Shqipërinë. Ne duam që në Shqipëri të vijnë të shikojnë vendin dhe njerëzit e tyre vetëm bashkatdhetarët e ndershëm. Ne do t'i presim ata kurdoherë me krahë hapur. Po të vesh gjटकë, as ta vë veshin njeri kush je, kurse këtu në Shqipëri njerëzit tanë

i presin shqiptarët e mërgimit si vëllezër. Populli ynë ushqen respekt dhe dashuri për të tërë shqiptarët kudo që janë, në Amerikë, në Francë, në Argjentinë, në Australi, në Rumania etj., ku kemi koloni shqiptare patriotike, të lidhura ngushtë me atdheun.

Shokët e ambasadës sonë në Paris na kanë njoftuar se shumë shqiptarë që jetojnë në Francë ishin mbledhur me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut në ambasadë dhe kishin kaluar një mbrëmje shumë të mirë.

JAKUP MAHMUTI: Po. Ne shqiptarët e Francës përpara ishim lidhur shumë ngushtë me Partinë Komuniste të Francës, por shkaktar i prishjes së lidhjeve tona me të u bënë revizionistët francezë. Përgjigjja që i dha Hrushovit Partia e Punës e Shqipërisë, me ju në krye, u gjet shumë e drejtë nga ne. Ky qëndrim shumë i lartë juaji ishte një frymëzim i madh për ne, shqiptarët e mërguar, sepse ka nderuar emrin e popullit tonë. Kjo është aq e vërtetë sa të huajt thonë me respekt se populli shqiptar, një popull kaq i vogël, ka një udhëheqje të mrekullueshme. Kur partia e Torezit filloi të sulmojë udhëheqjen e PPSH dhe personalisht shokun Enver Hoxha, ne iu përgjigjëm se, duke vepruar kështu, ajo vihet kundër gjithë popullit shqiptar, se luftën populli ynë e bëri dhe e fitoi me shokun Enver në krye dhe jo me Hrushovin, se në Shqipëri Partia është e lidhur shumë ngushtë me popullin dhe populli me Partinë dhe shokun Enver. Ne shqiptarët që jetojmë në Francë jemi të lumtur që atdheu ynë ka një udhëheqje të tillë.

KRISTO RËMBECI (KRISTESKU): Ne do të plo-

tësojmë me të gjitha forcat dëshirat e popullit shqiptar, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe tuajat dhe do të qëndrojmë edhe në të ardhmen, ashtu siç kemi qëndruar gjer tani, gjithnjë pranë popullit tonë, si në gëzime, ashtu edhe në kohë të vështira.

Ne u gëzuar shumë kur pamë me sytë tanë përparimet e popullit shqiptar, sepse, kur kemi mërguar, e lamë vendin të varfër, kurse tani e shohim atë me pallete, me fabrika, me shkolla, me spitale etj., gjë që na bëri përshtypje shumë të madhe. Këto përshtypje, të vërtetën që pamë në Shqipëri, ne do t'ua themi vëllezërve tanë atje ku do të vemi.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit. Fjalët tuaja tregojnë për patriotizmin tuaj. Edhe qëndrimi i shoqërisë «Shqipëria e lirë» është patriotik. Kjo shoqëri ka organin e vet të shtypit dhe ndjek një rrugë të drejtë, jo si ai i «Vatrës».

Anëtar i shoqërisë «Vatra», është edhe Fan Noli, por ai është nga shqiptarët që ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën e popullit tonë. Megjithatë ka një rrez që nuk e duan atë. Kjo ndodh sepse ai mbron çështjen e Shqipërisë. Në librin e tij «Album», të botuar kohë më parë, qysh në fillim ai thotë se atë ua dedikon kryetrimave të Shqipërisë. Ne kemi vlerësuar kurdoherë drejt veprimtarinë e Fan Nolit. Ai është patriot, prandaj Partia jonë ia njeh meritat, sidomos për veprimtarinë e tij patriotike, si dhe në lëmin e letërsisë. Ne e konsiderojmë si një nga shkrimtarët më të mirë të letërsisë shqipe. Në qoftë se ne kemi kundërshtuar sjelljen e eshtrave të Faik Konicës në Shqipëri, besoj se ju e kuptoni mirë përse e bëmë këtë, se e dini përfa-

qësuesi i kujt ka qenë ai. Ndërsa Fan Noli ka qenë kurdoherë i mirëpritur në Shqipëri si demokrat patriot. Tani ka njëvëz që janë hedhur edhe kundër Fan Nolit, kurse ju të shoqërisë «Shqipëria e lirë» keni dalë në mbrojtje të tij. Neve na duket se po veproni shumë mirë.

Nuk dua t'ju mbaj më shumë, se jeni edhe të lodhur. Të jeni të bindur se ne që jetojmë në atdhe kemi shumë mall për ju. Në raste gëzimi e festash si kjo e 20-vjetorit, kur takohemi me bashkatdhetarët tanë që vijnë nga jashtë, ne ndiejmë një gëzim të madh. Për ne, gjithashtu, është një kënaqësi e madhe kur vendosim të ftojmë vëllezërit tanë që kanë emigruar jashtë. Nga viti në vit ne do të kemi mundësi më të mëdha për të ftuar në raste festash më shumë bashkatdhetarë nga kolonitë shqiptare të mërgimit.

Në emër të të gjithë shokëve ju lutem që kur të ktheheni në vendet prej nga keni ardhur dhe të takoheni me bashkatdhetarët e atjeshëm, t'u transmetoni atyre dashurinë, respektin, mirënjohjen dhe të falat tona më të përzemërta dhe vëllazërore, si dhe përshëndetjet e gjithë popullit shqiptar. I siguroni të gjithë miqtë dhe dashamirësit e Shqipërisë që të kenë besim se Shqipëria do të ecë kurdoherë përpara, se popullit do t'i përmirësohet çdo ditë e më shumë jeta, se ai do të qëndrojë kurdoherë i patundur në rrugën e tij të drejtë, se do t'i ruajë me çdo kusht lirinë dhe pavarësinë. Populli dhe Qeveria Shqiptare e konsiderojnë kurdoherë të nevojshme ndihmën tuaj të vlefshme, pasi ajo ka qenë dhe është e madhe. Ju duhet të dini se në çështjen e madhe të Shqipërisë kontributi juaj është gj-

thashtu i madh. Këtë nuk ua themi për t'ju bërë qejfin. Ndihma e vëllezërve tanë jashtë atdheut është një ndihmë e madhe për Shqipërinë, e cila nuk rron e veçuar nga bota. Rrethi i gjerë i miqve e i mbrojtësve të flaktë të saj ka rëndësi shumë të madhe për pavarësinë dhe për mbarëvajtjen e Shqipërisë socialiste.

U tregoni dhe u provoni të gjithë popujve të vendeve ku jetoni, se shqiptarët janë njerëz besnikë dhe të ndershëm, se e duan popullin e vendin ku jetojnë dhe punojnë, ashtu si dhe popullin që i lindi. Ndershmëria në marrëdhëniet me të tjerët ka shumë rëndësi. Kur të sheh i huaji ty që je i drejtë, i dashur, i ndershëm, atëherë thotë se shqiptarët janë me të vërtetë njerëz të mirë, ata e duan popullin ku jetojnë ashtu si duan edhe popullin e tyre. Këto qëndrime të drejta të bashk-atdhetarëve tanë jashtë atdheut i japin nam të mirë Shqipërisë.

Edhe një herë ju uroj shëndet dhe sukses në veprimtarinë tuaj patriotike! Ju uroj gjithashtu të gëzoheni më së miri gjatë këtyre dy-tri javëve që do të shkoni të rrini në mes të njerëzve tuaj të dashur!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

MBETURINAT E VJETRA JANË SI PLAGA NË TRUP QË, PO NUK U MJEKUA, INFEKTON TËRË ORGANIZMIN

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

17 dhjetor 1964

Edukimi komunist i të gjithë popullit, në radhë të parë i anëtarëve të Partisë, nuk ka filluar me Plenumin e Komitetit Qendror, që u zhvillua në muajin korrik të këtij viti², po qysh kur u themelua Partia. Plenumi i Korrikut rishikoi edhe një herë rezultatet e mëdha, që janë arritur gjatë kësaj periudhe, të metat që ekzistojnë në fushën e edukimit ideologjik dhe dha orientime të shëndosha në bazë të një studimi të thellë të gjendjes ekzistuese. Natyrisht, këto rezultate janë të mira dhe përbëjnë një fitore të madhe për Partinë

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e komiteteve të Partisë të qytetit të Tiranës dhe të rrethit të Lushnjës për të vënë në jetë vendimet e Plenumit të KQ të Korrikut 1964.

2 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 27, f. 118.

tonë, po megjithatë, nuk mund të themi se në këtë Plenum u arrit gjithçka për edukimin e komunistëve dhe të masave. Asnjë nga ne nuk mund të ushqejë një iluzion të tillë. Edukimi komunist përbën një luftë të gjatë dhe të vazhdueshme. Lidhur me këtë doja të shtroja çështjen se si duhet ta kuptojmë e ta zbatojmë ne orientimin e Plenumit të fundit.

Mua më duket se ka akoma një koncept të ngushtë në kuptimin e edukimit ideologjik, ka burokratizëm në zgjidhjen e problemeve të mëdha shoqërore, ka disa herë edhe gjykime të optimizmit joreal e disa herë gjykime të tjera pesimiste.

Ka komunistë që tregohen shumë optimistë kur shohin se janë arritur suksese. Suksese arrijmë vërtet dhe optimistë duhet të jemi, por ky optimizëm të jetë real dhe jo të çojë në vetëkënaqësi e të na vërë në gjumë. Të mos harrojmë se të flesh mbi dafina është shumë e dëmshme. Edhe pse ne arrijmë shumë rezultate, duhet mbajtur parasysh se ndërtojmë socializmin në luftë me mbeturina të shumta, që janë si një plagë në trup, që, po s'u mjekua, infekton tërë organizmin. Prandaj duhet t'i zbulojmë e t'i shërojmë këto plagë në rruqën që na mëson Partia.

Ka disa njerëz të tjerë që nuk e vlerësojnë drejt zhvillimin tonë, por shikojnë vetëm anët e zeza të jetës. Këta janë në kontradiktë me realitetin dhe, duke parë vetëm anët negative të jetës, me paragjykimet e tyre, arrijnë në ndonjë rast në konkluzione pesimiste krejt të gabuara, e gjykojnë keq shoqërinë tonë socialiste. Kjo mbeturinë ekziston te disa intelektualë, por veçanërisht është më e theksuar në ata njerëz që

punojnë në organe të tilla të drejtësisë siç janë gjykatat dhe prokuroritë. Punonjësit e këtyre organeve janë njerëz me kulturë, njerëz të dalë nga gjiri i masave, por ka prej tyre që duke u marrë me elementë që shkelin normat e moralit komunist, ka raste që nxjerrin konkluzione të shtrembra, në kundërshtim me jetën, me realitetin tonë. Mirëpo këta shokë nuk duhet të kenë ndjenjën e superioritetit meqë kanë kryer universitetin dhe mbrojnë drejtësinë tonë. Prandaj duhet të njohin mirë realitetin e vendit tonë, sepse këtë realitet ata nuk e shohin gjithnjë në jetën e gjallë të vendit, por në sallat e gjyqit, në botën e tyre të ngushtë. Në gjykatat shkojnë për t'u gjykuar vetëm fundërrinat e shoqërisë sonë, nga të cilat do të ketë edhe pas shumë vjetësh, me ndryshimin se elementë të tillë do të vijnë vazhdimisht duke u pakësuar nga viti në vit. Këtë e shohim qartë kur u referohemi shifrave në lidhje me shkeljet e ligjeve të pushtetit popullor nga ana e elementëve të pandërgjegjshëm, shifra këto që vazhdimisht vijnë duke u ulur.

Ne, shokë, duhet të ruhem si nga optimizmi i tepëruar, ashtu dhe nga pesimizmi, nga një gjykim jo i drejtë i çështjeve, të nxitur nga egoja profesionale, nga papjekuria ose nga megalomania, e cila shfaqet edhe në mbivlerësimin e vetvetes. Kjo e keqe shfaqet gjithashtu edhe te disa punonjës të gjykatave. Prandaj Partia duhet t'i edukojë punonjësit e drejtësisë me frymën e saj të shëndoshë duke rrënjësuar në ta konceptin e drejtë mbi profesionin e juristit dhe njëkohësisht t'i bëjë të aftë për të nxjerrë konkluzione reale në punën e tyre, dhe jo konkluzione pesimiste.

Edhe te shokët e Ministrisë së Punëve të Brendshme duke qenë ditë e natë në luftë me armiqtë, ka shumë mundësi të ekzistojë prirja e vështimit të punëve në mënyrë pesimiste. Por megjithëkëtë, këta shokë e shohin drejt realitetin e vendit tonë. Kjo ndodh sepse Partia në këto organe ka punuar më mirë dhe punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme mbajnë lidhje më të ngushta me popullin, prandaj nuk bien në pesimizëm, që mund t'i shtyjë në situata të vështira në luftën e tyre kundër armiqve. Ata shohin edhe të mirat, edhe të këqijat, shohin si vërtitet dhe si punon armiku për të ngjitur sëmundjet në trupin e shëndoshë të shoqërisë sonë. Prandaj, thonë, me të drejtë, se trupi i Shqipërisë është i shëndoshë, kështu që armiqtë s'kanë se ç't'i bëjnë vendit tonë.

Partia, me vijën e saj të drejtë, me vendimet që merr, me eksperiencën e saj të dalë nga jeta, përpunon direktiva, edukon dhe brumos njerëzit. Ne duhet të bëjmë më shumë përpjekje që këto direktiva, kur punohen në bazë, të gëlltiten mirë, në radhë të parë nga anëtarët e Partisë, të mos reduktohen në gjëra të thata burokratike. Për t'ia arritur kësaj, me masat e popullit të përdoren forma të ndryshme. Format dhe metodat e punës, natyrisht, janë të rekomandueshme të shfrytëzohen, por nuk janë kurdoherë të domosdoshme të zbatohen pikërisht ashtu si janë dhënë. Komitetet e Partisë dhe sekretarët e organizatave-bazë duhet të kenë parasysh që format e punës t'i zbatojnë në bazë të kushteve të vendit, shtresave të njerëzve e problemeve. Ky

është një nga çelësat kryesorë të sukseseve. Pa një punë të gjerë edukuese në këtë fushë nuk mund të bëhet si duhet puna, ndryshe Partia mund të shkojë në një rrugë të rrezikshme administrative dhe shumë herë të bjerë në fërkime me masat e popullit. Kjo duhet të na shqetësojë, sepse masat punonjëse nuk janë inaktive në veprime ose, në gjykime përpara metodave dhe veprimeve të komunistëve, të një sekretari organizate-bazë ose të një anëtari byroje të komitetit të Partisë. Masat janë aktive ndaj veprimeve të komunistëve dhe i vlerësojnë ato sipas rastit, pozitivisht ose negativisht. Kur këto veprime i shtrohen popullit për gjykim, një gjë e tillë jo vetëm nuk e shqetëson Partinë, përkundrazi kjo dëshmon për lidhjen e Partisë me masat.

Në një mbledhje të Presidiumit të Kuvendit Popullor morëm në shqyrtim problemin e shkurorëzimeve dhe nëpërmjet shifrave vumë re që kemi një përparim të dukshëm. Jo vetëm kemi ulje në numrin e shkurorëzimeve, mbasi përqindja e tyre sot është më e vogël se disa vjet më parë, por përparimi në këtë fushë qëndron edhe në faktin se aq sa janë burra, aq janë pothuaj edhe gra që kërkojnë shkurorëzim. Kjo përbën një fitore të madhe politike, e cila ka ardhur si rezultat i punës së Partisë kundër paragjyqimeve të vjetra, kundër sundimit të burrit mbi gruan.

Rritja e ndërgjegjes socialiste nuk është vetëm rezultat i propagandës së Partisë, por edhe i ndryshimit gradual të gjendjes ekonomike në vendin tonë. Në të gjitha fushat e jetës sonë shoqërore ne kemi suksese të mëdha. Sot gruaja është futur në masë në punë. Ky

është një nga faktorët kryesorë të emancipimit të saj. Problemi i gruas është një nga problemet kyç të shoqërisë sonë. Gruaja sot në Shqipëri është e lirë. Këtë e pranojmë të gjithë. Sot te ne nuk ka pengesa që vajza të kryejë shkollën 8-vjeçare, kjo është e sanksionuar edhe me ligj. Puna që ka bërë Partia ka influencuar që gruaja të mos mbulohet më me perçe, por të marrë pjesë në punë të ndryshme si në fshat dhe në qytet. Pra në këto drejtime është arritur një sukses i madh. Kjo është një gjë shumë pozitive dhe na bën optimistë. Pra, sot të gjithë në vendin tonë pranojnë që gruaja të jetë e lirë të vejë në punë, në shkollë dhe të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore të vendit. Por kjo nuk do të thotë se janë zhdukur nga ndërgjegjja e njerëzve mbeturinat e së kaluarës për sa i përket lirisë së vërtetë të gruas dhe të vajzës. Të marrim, për shembull, çështjen e marrëdhënieve midis të rinjve dhe të rejave. Kjo është një çështje e rëndësishme partie. Marrëdhëniet midis djalit dhe vajzës duhet të rregullohen kurdoherë në rrugë të drejtë, ashtu sikurse na mëson marksizëm-leninizmi.

Secili nga ne dëshiron që djali ose vajza e tij të marrë një rrugë të drejtë në jetë. Në qoftë se nuk e bën këtë një prind komunist, ai nuk e bën punën e Partisë. Babait ose nënës nuk u lejohet të lënë pas dore të ardhmen e fëmijëve të tyre, ose t'i lënë ata të livadhisin si të duan. Një prind komunist sheh se në Shqipëri, krahas përparimeve kolosale, ka edhe të meta, se midis masës së rinisë ka edhe vajza e djem të infektuar nga ideologjia e huaj. Prandaj është e ligjshme që prindi të

interesohet për të ardhmen e fëmijëve të vet, që ata të mos marrin rrugë të keqe. Po nuk e mendojnë të gjithë në frymë të drejtë një gjë të tillë. Ka prindër konservatorë që edhe sot, të ndikuar nga mbeturinat e vjetra të së kaluarës, fejojnë vajzën ose djalin që në klasë të gjashtë edhe u bie kështu të martohen pas 7-8 vjetësh. Është e domosdoshme t'u futet në kokë prindërve të tillë se pas 7-8 vjetësh do të ndryshojë jeta, do të ndryshojnë gjer atëherë ndjenjat e të rinjve dhe të rejave, ndjenja që ata nuk mund t'i kenë në dorë për një kohë kaq të gjatë. Kush mendon ndryshe, ai është konservator. Djali në një moshë të tillë nuk ka mbaruar akoma shkollën e mesme, pastaj do të vejë ushtar, më vonë do të dërgohet të punojë, fjala vjen, në Shkodër dhe ja, atje mund të takohet me një vajzë tjetër, me të cilën do të miqësohet, do të pëlqehen, do të dashurohen e do të martohen. Kështu vajza me të cilën do ta kenë fejuar prindërit 7-8 vjet përpara do t'i mbetet babait në derë dhe pastaj fillojnë thashethemet, të cilat janë nga mbeturinat më të këqija.

Rininë duhet ta mbrojmë. Si te të gjithë edhe tek ajo mbeturinat e së kaluarës nuk mund të zhduken me dekret. Të tërë duam që vajza të vejë në shkollë, pastaj në punë etj. Kur shkojnë të rinjtë në shkollë, ndodh që një djalë të ketë afër një vajzë. Djemtë dhe vajzat që përbëjnë klasën janë si vëllezër e motra, me ndjenja të pastra ndaj njëri-tjetrit. Por edhe ndjenja e dashurisë së djalit për një vajzë është një ndjenjë e pastër. Një djalë mund të shoqërohet me një vajzë, sepse e ka shoqe të shkollës, të klasës. Vjen një kohë që për të ai mund të ndiejë edhe diçka që i zhvillohet gjer në da-

shuri dhe që përfundon me martesë. Kjo është normale. Mirëpo ka raste që kur kalojnë së bashku në rrugë një vajzë me një djalë fillojnë pëshpëritjet nga të katër anët dhe opinioni, vetëm pse i ka parë bashkë, i fejon! Njerëz të tillë as që mendojnë se kjo vajzë është një nxënëse ose punëtore e ndershme, e dashur, është shoqja e shkollës ose e punës së djalit, i cili e konsideron si motër të tijën dhe ka mësuar ose ka punuar bashkë me të. Lëre pastaj sikur një vajzë të shihet se po shkon në shtëpinë e një djali që të mësojnë së bashku, se të nesërmen mund të kenë provim. Atyre kushedi çfarë do t'u ngjitet nga të tillë njerëz që e kanë zakon të merren me thashetheme. Kjo nuk është e drejtë.

Në mënyrë individuale mund të zgjidhen këto probleme? Edhe kjo nuk përjashtohet, por kryesorja është që organizata e rinisë ta zgjidhë këtë problem në formë të ndryshme. Kështu, për shembull, në mbledhjet e rinisë mund të ngrihet një vajzë dhe të diskutojë se ka shëtitur një herë me një shok, një herë me një shok tjetër etj., po mos vallë për këtë na qenka vajzë e keqe? Shoqërimi i vajzës me njërin dhe tjetrin krijon te disa një opinion jo të mirë, që duhet luftuar. Më pas mund të ngrihet edhe një djalë e të thotë: «ne duhet të mbrohemi nga zakoni i keq i thashethemeve. Po si të mbrohemi? Vetëm ne, të rinjtë, duhet ta kuptojmë drejt moralin, pastaj të mbrojmë veten nga ata që pa vend flasin keq për ne, për vëllezërit dhe motrat tona që shoqërohen midis tyre». Pëshpëritjet janë një sëmundje shumë e dëmshme për rininë dhe duhen luftuar.

Po ju tregoj një rast. Më kanë thënë se një baba, që është dhe komunist, mori një ditë në telefon drejtorin e shkollës dhe i thotë: Ç'ndodh kështu në shkollën tuaj që na dërgon vajzat në piknik? Qëndrim i drejtë është ky i këtij shoku anëtar partie? Jo, aspak nuk është qëndrim i drejtë. Të rinjtë e të rejat do të venë edhe në piknik, kurse çdo prind e ka për detyrë ta edukojë vajzën në shtëpi dhe t'i thotë: vajzë, je e lirë, shko dhe në piknik, bëj dhe shëtitje, por ki kujdes të jesh e rregullt në marrëdhëniet me shoqet e shokët. Pra secili duhet të punojë që fëmijës së vet, si djalit edhe vajzës, t'i forcojë karakterin politikisht, ideologjikisht, moralisht dhe jo të marrë drejtorin e shkollës e t'i thotë pse shkojnë të rejat në piknik. Ky nuk është qëndrim komunist.

Duke luftuar kundër këtyre shfaqjeve të konservatorizmit, të kemi kujdes që të mos biem në liberalizëm. Komunisti nuk duhet të lejojë që të rinjtë tanë të shfaqin mënyra sjelljeje dhe veshjeje të pahijshme për shoqërinë tonë. Është e keqe kur shikon, për shembull, disa djem, vajza apo gra, që i kanë prindërit ose burrat komunistë, bile edhe me përgjegjësi, por që imitojnë modën e huaj. Ne nuk themi që të kthehemi te bruca e citjanët, po jo të vishemi në mënyrë të ekzagjeruar e të shthurur. Shoqëria socialiste ka disa norma të saj, të cilat i japin individit liri më të mëdha dhe janë më demokratike. Ato sjellin gëzim në shpirtin e njeriut dhe të familjes. Por në qoftë se kapërcehet kufiri, në qoftë se kalohet nga e djathta ose nga e majta, kjo është e rrezikshme.

Edhe në çështjet e edukimit të përgjithshëm kemi

për të bërë shumë. Ka njerëz që rrinë në kafene dhe përshtëpëritin, mbajnë në gojë të tjerët. Po pse vjen kjo? Kjo vjen se nuk zbatohen si duhet direktivat e Partisë. Këta njerëz shkojnë në kafene, sepse nuk gjejnë një vend ku të çlodhen ose nuk vihen në dispozicion për një punë të dobishme, për arsye se komiteti i Partisë, nuk e organizon si duhet kohën e dëfrimit dhe të zhvillimit të harmonishëm, që tjetri të mos mbetet kafeneve.

Puna është një nga mjetet më edukative për punonjësit, është baza e edukimit komunist të tyre. Pas pune njeriu ka nevojë për qetësi në shtëpi ose dëshiron të takohet me shokë, të bëjë një shëtitje ose të vejë në kafene. Por këtu ai nuk duhet të thotë, fjala vjen, që vajza e filanit dashuron këtë ose atë djalë. Që të mos ndodhë një gjë e tillë koha e lirë duhet të shfrytëzohet drejt. Kjo varet nga puna e Partisë, e cila duhet të jetë e organizuar, në mënyrë që pas pune secili të ketë mundësi të bëjë një bisedim të kulturuar, të arsyeshëm dhe kështu të mos ketë kohë të merret me gjëra që nuk i sjellin dobi. Po t'i krijohet njeriut një ambient i përshtatshëm, atëherë kudo që të jetë, në kafene, në klub ose në rrugë, jo vetëm do t'i forcohet gjykimi, por do të krijojë koncepte të reja për jetën dhe veçanërisht për marrëdhëniet midis të rinjve e të rejave. Këtej del se duhet të mendohet seriozisht për kohën e lirë të punonjësve.

Një punë e tillë nuk bëhet vetëm me direktiva. Direktivat e Partisë kanë për qëllim t'i edukojnë njerëzit, po jo në mënyrë formale. Natyrisht, direktivat e Partisë zbatohen me përpjekjet e njerëzve, por zbatimi i

tyre nuk bëhet nga të gjithë dhe kurdoherë si duhet në mënyrë komuniste. Prandaj në këtë drejtim ne duhet të bëjmë më shumë përpjekje. Për sa u përket njerëzve që i bëhen pengesë rinisë, Partia duhet të veprojë për edukimin e tyre, pa rënë as në qëndrime sektare, as në qëndrime liberale. Por duhet pasur parasysh që jo për çdo gjë ta thërresësh tjetrin në kryesinë e Frontit, për shembull, sepse ai nuk e lë vajzën të martohet me dashuri. Një gjë e tillë nuk është e lehtë për atë që ka mentalitet konservator. Thirrja në kryesinë e Frontit për këtë rast do të bëjë që ai ose nuk do të pranojë, ose do të pranojë pa dashje atë që do t'i thuash ti, por plotësisht nuk do të bindet, prandaj duhet kujdes dhe takt. Kur një konservator rrethohet në të gjithë ambientin nga një punë e gjithanshme dhe kur arrihet që edhe vetë vajza t'ia shpjegojë babait përse nuk e do atë që i jep ai për shok jete, atëherë plaku do të thyhet. Shembuj të tillë ka shumë. Por në saje të punës së Partisë tani mund të shikosh që edhe pleq të vjetër kanë ndryshuar mendimet, duke u larguar nga pozitat e dikurshme. Megjithëse jeta ecën përpara, ne përsëri do të kemi vështirësi, do të kemi shfaqje negative, po këto nuk duhet të na shqetësojnë e të na bëjnë pesimistë.

Kur shohim këto shfaqje të huaja ne, si komunistë, arrijmë në konkluzionin se me luftën kundër tyre nuk kemi mbaruar, pra do të vazhdojmë të ndeshemi për një kohë të gjatë me to. Edukimi i njerëzve nuk është i lehtë dhe nuk jep rezultate të shpejta.

Përparime kemi në punën tonë. Po ne duhet të ecim edhe më mirë, ta zgjerojmë dhe ta dendësojmë

punën për edukimin e njerëzve, të mobilizojmë në radhë të parë Partinë në këtë drejtim dhe të korrigjojmë gabimet në punën edukative.

Rol të rëndësishëm për edukimin e njerëzve luan në radhë të parë organizata-bazë. Nëse organizata-bazë nuk armatohet me frymën që kërkon Partia, është vësh-tirë të bëhet një punë kaq e gjerë për edukimin e nje-rëzve. Komunistët janë militantë të çështjes së Partisë, pra për punën dhe për detyrat e tij, çdo anëtar partie duhet të bluajë mirë në mendjen e vet format dhe me-todat e punës dhe t'i zbatojë ato në jetë me gjallëri, në mënyrë krijuese. Të mos ndodhë si në disa raste që dikush shikon, fjala vjen, diçka negative te një komu-nist ose te gruaja e tij dhe vete menjëherë t'ia rapor-tcjë sekretarit të komitetit të Partisë. Kjo nuk është e drejtë. Ti, si komunist, shok ose mik i atij që bën ga-bimin, shko më mirë në shtëpinë e tij ku është ai dhe gruaja dhe u thuaj vërejtjet që ke, për shembull, se grindjet që ngjasin në familjen e tyre po i merr vesh e tërë lagjja. Është më mirë të veprosh kështu sesa të vesh te sekretari i Partisë e të raportosh. Të tërë, si ko-munistë, kemi përgjegjësi për të luftuar kundër shfa-qjeve të huaja. Një anëtar partie, që arrin ta bindë dhe ta edukojë shokun dhe mikun e tij, të cilit i ka ngjarë diçka e papëlqyer në familje, ka bërë një punë komu-niste dhe në këtë mënyrë ia ka lehtësuar barrën edhe komitetit të Partisë.

Çështjet personale dhe familjare të njerëzve t'i ke-mi kurdoherë parasysh, po këto të mbeten atje ku bi-sedohen dhe jo të bëhen muhabete pazari. Në qoftë se një njeri vjen e të thotë diçka ty si komunist ose si se-

kretar, këtë e bën se ka besim të madh te Partia, e cila do t'ia zgjidhë ose do t'ia lehtësojë hallin që ka. Po kur ai vjen e ta thotë ty dhe pas dhjetë ditësh çështjen e marrin vesh edhe shumë të tjerë, atëherë një gjë e tillë e dëmton rëndë punën e Partisë. Ose, në qoftë se në një çështje janë ngatërruar dy-tri veta, atëherë ata duhen thirrur e duhen bindur dhe të marrë fund kjo punë, po jo të përhapet fjala nga goja në gojë dhe një ditë ta marrin vesh ngjarjen të gjithë.

Këto probleme kanë rëndësi të madhe sidomos për një vend të vogël si Shqipëria. Mos e harroni këtë. Në kushtet e vendit tonë Partia duhet të jetë shumë prudente. Njerëzit bëjnë edhe gabime, por kush e njëj gabimin dhe korrigohet, është detyrë shoqërore që ta mbrojmë. Është tjetër çështje kur njëri, për shembull, vjedh, në këtë rast Partia të tillë njerëz t'i demaskojë, që të bëhen shembull dhe mësim për të tjerët.

Partia duhet të punojë veçanërisht me rininë. Ajo të jetë për të si nëna, babai, motra apo vëllai. Nëse dikush erdhi e ta tha një gjë, për këtë ose atë të ri apo të re, detyra jote si punëtor partie është ta ndreqësh, që secili të ecë në rrugë të drejtë. Duke punuar kështu do të shtohet edhe më shumë dashuria për Partinë, do të zhduken mbeturinat që kanë njerëzit në ndërgjegje, një nga të cilat janë edhe thashethemet, marrja e të tjerëve nëpër gojë.

Natyrisht, këto detyra nuk zbatohen në një ditë, as në një apo në dhjetë vjet. Po Partia ka arritur suksese të mëdha në punën e vet edukative me masat. Le të punojmë kurdoherë e më mirë dhe të jemi të bindur se do të kemi suksese të reja edhe më të mëdha në luftë

kundër mbeturinave të vjetra e shfaqjeve të huaja, për edukimin e komunistëve e të punonjësve me politikën dhe me ideologjinë e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NË NDËRTIM KËRKOHET MË TEPËR PËRQENDRIM

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

17 dhjetor 1964

Është më e arsyeshme që korpusi kryesor i Kombinatit të Tekstileve në Berat të përfundojë sa më parë. Këtu të përqendrohen forcat kryesore. Prandaj, ju, shokë, që Partia ju ka ngarkuar me ndërtimin e kësaj vepre, keni mundësi për tërheqje material nga kantiere të tjera dhe mund të veproni që t'i përdorni ato për ndërtimin e këtij objekti të rëndësishëm, në mënyrë që vepra të përfundojë brenda afatit të parashikuar. Ta zëmë se ju keni caktuar një grafik prej tre muajsh. Mirëpo gjatë kësaj kohe ju punoni paralelisht edhe në sektorë të tjerë. Në këtë rast mundet që ta lini mënjanë përkohësisht grafikun për instalimin e maki-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e organizatës së Partisë në Kombinatin e Tekstileve në Berat për edukimin dhe për mobilizimin e punonjësve të ndërtimit, për plotësimin e detyrave të planit.

nerisë, se kjo është një gjë që pret, dhe të shpejtoni ndërtimin e këtij apo atij reparti.

Edhe Ministria e Ndërtimit duhet të përqendrohet në ndërtime, duke i dhënë herë pas here prioritet kësaj ose asaj vepre. Ta zëmë se janë në plan për t'u ndërtuar 10 fabrika. Në këtë rast ajo duhet të studiojë se cilës prej këtyre fabrikave ka interes t'i jepet prioritet dhe vendos, fjala vjen, që Kombinatin të Tekstileve në Berat t'i jepet prioritet. Prandaj, përveç 30 montatorëve që ka tani atje, mund të merren edhe 100 nga objektet e tjera dhe të bëhen 130, me qëllim që puna të përfundojë sa më parë dhe vepra të vihet sa më shpejt në shfrytëzim. Pas kësaj vepre puna përqendrohet në ndonjë vepër tjetër e kështu me radhë.

Kjo praktikë duhet zbatuar me qëllim që ndërmarrjet tona të ndërtimit të mos i zvarritin punët. Prandaj, meqenëse na ndodh të kemi shpesh mungesa të mëdha materialesh, atëherë kudo të ndërtojmë me prioritet, në shkallë objekti, në shkallë rrethi dhe në shkallë kombëtare. Në këtë mënyrë ne do të bëjmë që Kombinati i Tekstileve në Berat të hyjë sa më parë në prodhim. Në qoftë se ky objekt nuk na duhet shpejt, atëherë të vëmë të gjitha forcat për të përfunduar sa më parë një tjetër, për të cilin kemi më shumë nevojë, duke i dhënë këtij prioritetin. Por në qoftë se me këtë masë shikojmë se do të na vonohet ndërtimi apo vënia në shfrytëzim e një ose dy objekteve të tjera, këtë ta llogaritim mirë dhe t'i japim prioritet atij objekti për të cilin kemi leverdi të hyjë në prodhim sa më parë.

Kështu duhet të veprojmë edhe për ndërtimin e veprave të tjera. Grafikët ekzistojnë, po ata mund t'i

lëvizim sipas kushteve dhe interesit ekonomik. Grafikët e ndërtimit duhet, pra, të jenë të gjallë, të mos i shpërndajmë forcat në të gjitha objektet, pse kështu nuk ndërtojmë asnjë, na mbeten të tëra pa u ndërtuar për një kohë të gjatë ose përgjysmë, sikurse na ka ndodhur ndonjëherë, që kemi pasur në listë inaugurime fabrikash, por kësaj s'ia kemi arritur kurdoherë në kohë, sepse veprat s'kanë përfunduar të gjitha sipas grafikut. Prandaj do të kishte qenë më mirë që të caktonim më pak ndërtime objektesh, por këto t'i përfundonim me kohë, t'i inauguronim e t'i vinim në shfrytëzim.

Çështjen e ndërtimeve ne duhet ta shikojmë në dinamizmin e vet, të mos ecim si deri tani. Natyrisht masa të tilla detyroheni t'i marrim, sepse kemi vësh-tirësi. Për objektet që ndërtojmë duhet të kemi parasysh çështjen e kohës, gjë që për ne ka rëndësi të madhe. Ja, për shembull, Uzinën e Gjogjanit në Kukës e kishim parashikuar ta ndërtonim brenda 2 vjetëve, në fakt e mbaruam për 3 vjet. Por për leverdinë që ka ky objekt, i dhamë prioritet ndërtimit të furrës tjetër të tij. Ky prioritet ishte i domosdoshëm, sepse prodhimi i nxjerrë nga kjo uzinë është shumë i vlefshëm. Në gamën e madhe të ndërtimeve, na intereson të dërgojmë menjëherë në Kukës tulla shamot që janë të nevojshme me qëllim që furra e dytë të hyjë sa më parë në shfrytëzim dhe fabrika të punojë me rendiment të lartë. Kështu do të kemi më shumë bakër, që do të thotë më shumë valutë. Prandaj mund të vonohet edhe ca ndërtimi i ndonjë fabrike tjetër që nuk e ka rëndësinë e asaj të Kukësit.

Në këtë mënyrë duhet ta shikojmë çështjen e ndërtimeve, me prioritet dhe jo t'i ndërtojmë të gjitha objektet përnjëherësh, duke i vonuar ose duke i lënë përgjysmë dhe të mos jemi në gjendje të marrim prodhim prej asnjërit.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

REALIZMIT SOCIALIST I PËRKET E ARDHMJA

*Shënim në librin e përshtypjeve të Ekspozitës
Kombëtare të Arteve Figurative*

17 dhjetor 1964

Ekspozita Kombëtare e Arteve Figurative, e organizuar me rastin e 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, është një dhuratë me vlerë për popullin. Vlera e saj kryesore, më duket mua, është se ajo në tërësi bie erë «Shqipëri e re socialiste» e pasqyruar në art.

Më gëzon lidhja që mbajnë artistët tanë me jetën dhe me luftën heroike të popullit tonë. Të jenë të sigurt ata se, duke i forcuar akoma më shumë lidhjet me realitetin, do të gjejnë frymëzime të reja për vepra akoma më të realizuara në art. Më gëzon gjithashtu fakti që në këto vepra në përgjithësi dominojnë mendimi i ri socialist, optimizmi revolucionar i Partisë sonë. Duke e thelluar më tej këtë aspekt themelor, artistët tanë do të mund të realizojnë vepra edhe më të përkryera të realizmit socialist, të cilit i përket e ardhmja. Më së fundi, më gëzuan edhe sukseset në mjeshtrërinë artistike që kanë arritur piktorët, skulptorët, gra-

fistët etj. Por që të mund të meritojnë kurdoherë aprovimin dhe admirimin e masave, që janë njëkohësisht objekt i punës së tyre dhe gjykatësit më të drejtë të veprave të tyre, artistët tanë duhet të punojnë akoma më shumë edhe në të ardhmen për zotërimin e për perfeksionimin e mjeteve artistike, për krijimin e stileve të larmishme origjinale, për të dhënë secili diçka të tijën, të bukur dhe sa më të përsosur.

Puna e artistëve është mjaft fisnike dhe delikate; ata edukojnë dhe brumosin njerëzit e rinj me ndjenjën e së bukurës, me normat e moralit komunist etj. Është për këtë arsye që, si kurdoherë, ata do ta kenë pranë tyre Partinë, e cila mishëron dhe vë në jetë ëndrrat më të bukura të popullit tonë, e pra dhe të artistëve tanë.

Uroj nga zemra që punonjësit e arteve figurative të arrijnë suksese gjithnjë e më të mëdha!

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha «Mbi letërsinë dhe artin», f. 197.
Tiranë, 1977*

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TE MOS I FRYJME ORGANIKAT, TE LIDHEMI ME SHUME ME TERRENIN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

18 dhjetor 1964

Studimi që na është paraqitur për thjeshtimin e aparatit administrativ qendror, është i mirë, pavarësisht se mund të ketë akoma mundësi të tjera për shkurtime.

Jam dakord me atë që u tha këtu për vendet vakante. Edhe unë mendoja t'i fshinim nga organika këto vende, po del që kjo s'duhet bërë, sepse këto kanë mbetur vakante për mungesë kuadri dhe jo se janë vende për stoli. Megjithëse me kuadër hëpërhë mund të mos plotësohen, përsëri mund të mbeten në organikë në goftë se na duhen. Por llogaritë që kemi bërë nuk kanë qenë të sakta. Mund të hiqeshin ndoshta edhe më shumë, pra studimi për këtë çështje duhet të ishte bërë edhe më i thellë, sepse propozimet që na janë paraqitur nuk janë llogaritur mirë.

Nuk është e thënë që më vonë ne t'i shikojmë për-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi thjeshtimin e aparatit administrativ qendror dhe mbi forcimin e komiteteve ekzekutive të kp të rretheve.

sëri këto çështje, duke u nisur sidomos nga parimi se do të kemi edhe kuadro më shumë dhe se kuadrot do të rriten në punë e sipër, do të punojnë më mirë. Natyrisht, kuadrot do të fitojnë më shumë eksperiencë, gjë që do të thotë se rendimenti i tyre do të jetë më i lartë. Në këtë rast ne do të arrijmë në konkluzion që organikët të shkurtohen, por në atë shkallë, që parashikojmë ne, nuk kemi arritur akoma, për shkak të burokratizmit, javashllëkut, dembellëkut etj. Të gjitha këto nuk duhet t'i llogaritim vetëm teorikisht, por ta shohim problemin në praktikë, ndryshe mund të gabojmë. Kjo është një çështje shumë e komplikuar, megjithatë nuk duhet të na e errësojë perspektivën. Kur të na mbushen organikët me njerëz të aftë si i kërkon Partia, atëherë luftohet më mirë edhe burokratizmi. Në raste të tilla ne do të bëjmë edhe shkurtime.

Kryesorja për të cilën ne duhet të vendosim është lidhur me ndryshimet që duhet të bëjmë në strukturën e dikastereve. Kjo është çështje parimore. Prandaj, të diskutojmë jemi apo nuk jemi dakord për këtë dhe ata kuadro që i shkurtojmë në aparatet e qendrës mendoj se duhet t'ua shtojmë rretheve. Me këtë masë do t'i forcojmë rrethet. Një gjë e tillë na intereson dhe është e drejtë.

Mbi çështjen e shtimit të revizorëve shoku Haki ka për të bërë disa vërejtje, me të cilat edhe unë jam dakord. Por ne nuk duhet të mbështetemi vetëm në shtimin e numrit të revizorëve. Parimisht duhet të kemi revizorë, por nuk duhet ta flemë mendjen se janë vetëm ata që do ta bëjnë punën. Prandaj ta forcojmë kontrollin e gjithanshëm dhe të mos e mbështetim

gjithë punën te revizorët, se kështu do të gabojmë. Kontrollin në përgjithësi ne e forcojmë edhe në komitetet ekzekutive.

Kur lexojmë informacionet e Komisionit të Kontrollit të Shtetit, konstatojmë se ai nuk e lë pas dore kontrollin funksional. Megjithatë nuk duhet të largohet vëmendja e çdo ministrie nga kontrolli që duhet të ushtrojë mbi organet vartëse, duke menduar se kemi kontrollin e shtetit. Tani, duke shtuar kontrollorët financiarë në sektorët e ndryshëm në qendër e në bazë, është propozuar që organika e Komisionit të Kontrollit të Shtetit të mos pakësohet. Kjo më duket se nuk është e drejtë. Ne shtrojmë me forcë parimin e forcimit të regjimit të kursimit. Meqenëse ka raste që pasuria socialiste përvetësohet, prishet, harxhohet pa kriter, e gjejmë me vend të shtojmë revizorët. Gjersa ne lejojmë të shtohen këta revizorë, kjo do të sjellë, sigurisht, që të ketë më pak përvetësime, prishje, dëmtime etj., ndryshe do ta bënim kot shtesën. Pra, kjo shtesë do të thotë se puna e kontrollit të shtetit lehtësohet. Në këto kushte numrin e punonjësve në Komisionin e Kontrollit të Shtetit mund ta pakësojmë ca.

Por nuk është e drejtë të thuhet që mbasi të marrim të 200 revizorët pastaj ta shohim këtë çështje. Unë nuk jam dakord me një pikëpamje të tillë. Ne nuk duhet të nisemi nga pikëpamja pesimiste. Unë kam besim se shtimi i revizorëve do ta përmirësojë punën, veç të tjerave edhe në luftën kundër rutinës.

Bujqësisë duhet t'i vëmë rëndësi të madhe. Këtu u ngrit çështja që në komitetet ekzekutive të ngrihen tri seksione të veçanta për problemet e bujqësisë. Me-

ndoj që të mos ngremë seksione të veçanta, po të ruajmë strukturën ekzistuese. Seksion ka vetëm për drejtimin kryesor, pastaj të vendosim ndarje pune dhe njerëz të zotë. Ndarje pune në seksionin e bujqësisë ne mund të bëjmë në bazë sektorësh. Nuk ka asnjë rëndësi nëse i themi sektor apo seksion. Po ta quajmë seksion, duhet të kemi edhe shef seksioni. Në këtë seksion ne duhet të kemi njerëz të kualifikuar dhe mendoj se është mirë që në krye të tij të jetë një shef seksioni, i cili të jetë specialist për sektorin kryesor.

Edhe nënkryetarët e komiteteve ekzekutive si numër, mendoj, të jenë aq sa tani dhe ndarja e punës në kryesinë e komitetit ekzekutiv të qëndrojnë në fuqi siç është sot. Bujqësinë, sipas mundësive, mund ta marrë edhe vetë kryetari, por mund ta marrë edhe njëri nga nënkryetarët, i cili nuk është e domosdoshme të jetë specialist.

Jam gjithashtu dakord me numrin e ndërmarrjeve që vihen në vartësi të organeve lokale të pushtetit. Më vonë rretheve mund t'u japim edhe ndërmarrje të tjera dhe jam i bindur se ato do të shkojnë më mirë. Komitetet ekzekutive dhe ato të Partisë interesohen edhe tani për këto ndërmarrje, po, kur ta kenë direkt përgjegjësinë për to, do të interesohen edhe më shumë. Në këtë rast ato do ta ndiejnë përgjegjësinë e plotë direkte dhe do t'u vënë fre ministrive, do t'i vënë më shumë përpara përgjegjësisë sidomos në drejtim të furnizimit të materialeve etj. Veç kësaj, me këtë forcim kuadrosh që mendohet t'u bëjmë tani komiteteve ekzekutive, nuk ka arsye përse të mos u japim në vartësi edhe një pjesë të ndërmarrjeve. Kështu edhe vetë mi-

nistrive do t'ua lehtësojmë punën, gjë që do t'i ndihmojë ato për një punë më të mirë. Por edhe me kuadrrot që kemi në qendër ne duhet të bëjmë politikë më të drejtë partie. Nga këta ne duhet të çojmë më shumë në bazë.

Meqenëse shokët që merren me sektorin e tregtisë kanë frikë se do të na vështirësohet situata në lidhje me grumbullimet në zonat e thella dhe mund të dëmtochemi, të mos bëjmë ndryshime dhe ta përqendrojmë gjithë tregtinë e brendshme në një dikaster, prandaj le ta mbajmë organizimin ekzistues. Por në qoftë se kjo është njëfarë frike që vjen nga një ndryshim në punën e drejtimit, kjo frikë duhet zhdukur. Nuk duhet gjithashtu të harrojmë se kemi 15 vjet që ecim me një metodë pune, prandaj ndryshimi i metodës ose një organizim i ri, siç dihet, pranohet me vështirësi dhe zbatohet më ngadalë. Një gjë e tillë, natyrisht, ka edhe pasoja, këtë nuk duhet ta harrojnë edhe ata që drejtojnë sektorët e tregtisë, të cilët mundet që nuk e shohin si duhet këtë çështje. Ne nuk duhet t'i ekzagjerojmë ato që na thonë shokët e tregtisë dhe të qëndrojmë në vend me disa forma të vjetra pune, por të vendosim forma të tjera që janë më të mira.

Propozimi për shkrirjen e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit bëhet me qëllim që e gjithë tregtia e brendshme të përqendrohet në një dorë. Kjo nuk ka për qëllim vetëm të kursejë disa kuadro, sepse mundet që edhe të mos shkurtojmë asnjë në këta sektorë, po puna është që ata të vihen në një drejtim, të kontrollohet më mirë puna. Gjersa nuk prishet gjësendi, gjersa mbeten të gjithë kuadrrot pa u prekur

dhe siç janë, atëherë përse të ketë mendime se do të dëmtohet puna? Kjo për ne është e zorshme të kuptohet kështu. Po të bëheshin ndryshime në format organizative, puna do të ishte ndryshe. Unë nuk jam i bindur që në një vend të vogël si Shqipëria të kemi gjithë këto organe tregtie. Çështja e NSHFP-ve të studiohet. Po të ngushtohet aktiviteti i tyre, atëherë të shkurtohet organika e drejtorisë ekzistuese.

Për sa i përket naftës, çështjen e kam më shumë te Partia. Ajo duhet të lidhet mirë me terrenin. Mund të krijosh një kombinat të naftës duke lënë jashtë sektorin e kërkimeve, por pse të krijojmë ne një kombinat të tillë? Mendoj të mbajmë më mirë dy drejtori, siç janë, nuk ka kuptim ta bëjmë kombinat njërën prej tyre. Prandaj mendoj të qëndrojmë me dy drejtori, vetëm të forcojmë drejtimin në ministri për këtë sektor. Në ministri duhet të forcohet sidomos ana shkencore, në mënyrë që këto dy drejtori ta ndiejnë dorën e ministrisë dhe kjo të mos jetë një regjistruese e thjeshtë e veprimtarisë së tyre, por t'i drejtojë mirë dy drejtoritë, pse këto janë të mëdha dhe larg saj, në terren. Po të mos i drejtojë ministria, puna e tyre nuk do të ecë si duhet. Në përgjithësi ato varen nga ministria, por ne kritikojmë se ajo nuk është e lidhur sa duhet me bazën. Këtë vërejtje ne e kemi dhe luftojmë në këtë drejtim.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

LUFTA E PËRBASHKËT E PARTIVE MARKSISTE- -LENINISTE AFIRMON DHE FORCON UNITETIN MIDIS TYRE

*Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste
të Zelandës së Re*

21 dhjetor 1964

Pasi shoku Enver Hoxha u interesua për shëndetin e shokëve nga Zelanda e Re dhe i pyeti se çfarë panë në Shqipëri, a u takuan me komunistë dhe punonjës të vendit tonë, a u pëlqeu vendi ynë, fjalën e mori

KRYETARI I DELEGACIONIT: Ne vizituam mjaft rrethe dhe të themi të drejtën dëshirojmë të rrimë edhe më shumë në Shqipëri, se na pëlqeu mjaft, por na duhet të kthehemi shpejt në vendin tonë ku kemi shumë punë për të bërë. Na ka bërë përshtypje të madhe gjithçka që pamë në Shqipëri, por në mënyrë të veçantë fryma revolucionare marksiste-leniniste e popullit tuaj. Kudo që shkuam njerëzit tuaj na folën për vështirësitë që ju solli bllokada dhe veprimtaria tradhtarë e N. Hrushovit, por mësuam gjithashtu se si

të gjitha këto vështirësi populli dhe Partia juaj i kaluan me sukses.

SHOKU ENVER HOXHA: Na inkurajojnë shumë fjalët tuaja miqësore dhe të sigjerta. Natyrisht, ne kemi akoma shumë për të bërë. Jemi të bindur se do të vijë koha që edhe partia juaj do ta përgatitë revolucionin. Ajo është sot në krye të punës dhe të luftës kundër armiqve dhe mban në çdo rast qëndrim të vendosur dhe të qartë marksist-leninist. Kjo është garancia më e madhe për fitoret tuaja të ardhme. Partia Komuniste e Zelandës së Re është një parti me një peshë të madhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Shokët e partive motra, që qëndrojnë në pozita marksiste-leniniste, mburren me qëndrimin e drejtë të partisë suaj, ndërsa armiqtë revizionistë dhe imperialistë e konsiderojnë partinë tuaj si një kundërshtar të rreptë, pengesë të pakapërcyeshme dhe qëndrimin tuaj si shigjetë e helmatisur që i godet ata për vdekje. Kjo tregon se ky qëndrim ka një reperkusion të madh në botë. Prandaj ne e ndjekim me interes qëndrimin e drejtë të partisë suaj dhe jemi plotësisht dakord me të.

Partia juaj luan një rol të rëndësishëm edhe në drejtim të konsolidimit të radhëve të partive të reja marksiste-leniniste që po krijohen. Për këtë qëllim ju po koordinoni veprimtarinë tuaj me partitë komuniste të Australisë, të Indonezisë etj. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe. Partia juaj ka lëshuar një deklaratë ku thuhet: në rast se revizionistët modernë do të bëjnë mbledhje, edhe ne do të bëjmë mbledhje për të forcuar unitetin tonë. Kjo deklaratë ka rëndësi për çështjen tonë, sepse i tregon botës se partitë tona mark-

siste-leniniste qëndrojnë në pozita të forta dhe janë në një unitet të plotë mendimesh. Me të tilla qëndrime ne u tregojmë revizionistëve modernë forcën e partive tona dhe nuk i lëmë ata të ushqejnë iluzione ndaj nesh, nuk i lejojmë të na shkaktojnë çarje, ku ata të gjejnë mundësi të futen.

Është e qartë se revizionistët modernë i tmerron uniteti i partive marksiste-leniniste. Ata e dinë fare mirë se ç'është dhe ç'rëndësi ka ky unitet, sepse kanë kaluar nëpër rrugën e marksizëm-leninizmit, që tani e kanë tradhtuar, prandaj duan ta përçajjnë unitetin tonë dhe përdorin për këtë qëllim çdo lloj mjete. Tani ata po bëjnë orvatje të shumta për të arritur që të bëhet mbledhja e partive revizioniste dhe për të na tërhequr edhe ne të vemi atje. Por Partia jonë, partia juaj dhe disa parti të tjera motra nuk do të marrin pjesë në një mbledhje revizionistësh e përçarësish.

Këto orvatje ata i bëjnë me qëllim që të evitojnë mbledhjet dypalëshe, sepse në ato mbledhje që bëjnë me disa nga partitë komuniste, dështuan ngaqë nuk kishin argumente. Të gjitha argumentet ishin në favorin e marksistë-leninistëve. Prandaj në qoftë se revizionistët sovjetikë i vazhdojnë të tilla mbledhje, ata duhet të bëjnë mbledhje dypalëshe edhe me ne, sepse dihet që divergjencat që kanë sovjetikët me ne, nuk mund t'i zgjidhë ndonjë parti tjetër veçse Partia jonë. Kështu si me ne, ata kanë çështje për të zgjidhur edhe me partitë e tjera. Atëherë për t'i evituar takimet dypalëshe, po përpiqen që takimet e mbledhjeve të komisionit përgatitor të redaktimit t'i kthejnë në mbledhje ku të diskutohet pa fund,

me qëllim që në lëvizjen komuniste ndërkombëtare të krijohet përshtypja se gjoja po diskutohet, prandaj «të ndërpresim, të pushojmë polemikën». Ata bëjnë llogari që pas mbledhjes së parë të komisionit, të bëjnë të dytën, pastaj të tretën dhe në secilën mbledhje të sjellin edhe përfaqësues të kësaj apo të asaj partie tjetër, me qëllim që në një mëngjes të mirë, pa u kuptuar, ajo të transformohet në mbledhje të përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Por partitë tona nuk do të bien në një kurth të tillë të revizionistëve modernë.

Pikëpamja e Partisë sonë është që përfaqësuesit e partive tona të marrin herë pas here kontakt me njëri-tjetrin për shkëmbimin e mendimeve. Kjo ka shumë rëndësi, sepse midis nesh ka shumë probleme për të diskutuar, si ai për forcimin e luftës sonë të përgjithshme kundër revizionizmit modern, për mbledhjen ndërkombëtare të partive komuniste etj.

Më parë është bërë propozimi që edhe partitë tona të bëjnë mbledhje të përbashkëta. Për këtë kanë qenë dakord Partia jonë, juaja dhe parti të tjera motra, por situatat u zhvilluan në atë mënyrë që nuk pati mundësi të bëhej një gjë e tillë. Nga ana tjetër ne nuk e bëmë këtë, sepse nuk donim që t'u jepnim armë revizionistëve modernë për të thënë se po bënim një mbledhje të veçuar, megjithëse ata vetë po bëjnë vazhdimisht mbledhje, dy-tri ose edhe shumëpalëshe. Por në të ardhmen mbledhjet dy ose tripalëshe të partive tona duhet t'i praktikojmë, pasi ato kanë një rëndësi të madhe për forcimin e unitetit tonë, sidomos për organizimin e një lufte të fortë frontale kundër revizionistëve

modernë. Ne mendojmë se krahas tyre edhe kontaktet tona me partinë tuaj do të jenë shumë të dobishme, sepse ju keni një eksperiencë të madhe në lidhje me luftën kundër reformizmit të vjetër dhe të ri, në luftën kundër socialdemokracisë, në luftën greviste dhe veçanërisht në luftën kundër aktivitetit të kapitalizmit anglez në Zelandën e Re. Këtë eksperiencë ju e keni jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, sepse i keni vuajtur në kurriz kombinacionet e reformistëve, jo vetëm me kapitalizmin anglez, por dhe me atë amerikan dhe francez, me monopolet e vendeve të ndryshme, të cilat influencojnë mbi reformizmin në vendin tuaj. Eksperiencia juaj shërben si armë edhe për ne, këtu në Evropë. Socialdemokratët evropianë, të vjetër dhe të rinj, përpiqen të koordinojnë veprimet e tyre me ato të revizionistëve modernë, nën maskën e marksizëm-leninizmit. Prandaj eksperiencia juaj do të na shërbejë edhe neve që të mund të zhvillojmë një luftë më objektive, më konkrete dhe më të bazuar kundër reformistëve në Evropë.

Është fakt që edhe në vendet kapitaliste të Evropës, si në Itali, Francë, Angli etj., ka parti komuniste, në krye të të cilave janë revizionistët modernë. Por në shumë prej tyre tani janë krijuar grupe revolucionare marksiste-leniniste, me të cilat ne kemi lidhje dhe duhet t'i ndihmojmë. Për organizimin e kësaj ndihme shumë gjëra duhet t'i koordinojmë bashkërisht. Ne mendojmë se ndihma jonë do të ketë efekt më të madh në qoftë se do të bisedonim më parë dhe do të këmbënim mendimet me shokët e partisë suaj për këtë çështje, pasi ju keni një eksperiencë të madhe në luf-

tën kundër imperializmit anglez, e njihni më mirë atë, njihni hollësisht më mirë nga ne jetën dhe shpirtin e punonjësve anglezë, karakterin e tyre etj. Duke këmbyer eksperiencën, ne do të mundim që së bashku me shokët e partisë suaj të organizojmë sa më mirë punën për t'i ndihmuar grupet marksiste-leniniste të Anglisë. Kjo, sigurisht, do të ndikojë që lufta dhe lëvizja revolucionare në Angli të ngrihen e të forcohen më shumë, që të sheshohen mosmarrëveshjet që ekzistojnë ndërmjet grupeve marksiste. Kështu do t'i kundërvihet partisë revizioniste angleze një grupim i shëndoshë revolucionarësh marksistë-leninistë. Kështu do të veprojnë edhe marksistë-leninistët e vendeve të tjera. Materialet e ndryshme, artikujt teorikë, politikë, polemikë, që keni botuar në shtypin tuaj, janë jo vetëm një ndihmë e madhe për luftën kundër revizionizmit modern, reformizmit dhe socialdemokracisë në Zelandën e Re, por edhe për luftën e marksistë-leninistëve të vendeve kapitaliste të Evropës. Prandaj këta artikuj bashkë me materialet tona ne duhet t'i propagandojmë në mënyrë të organizuar, me qëllim që të frymëzohen nga eksperiencia dhe lufta e një partie që lufton në po ato kushte që ndodhen edhe ata. Kjo është e domosdoshme të bëhet, sepse, duke marrë parasysh se revizionistët modernë, socialdemokratët dhe borgjezia kapitaliste në Evropë kanë mjete të fuqishme propagandistike dhe materiale me të cilat përpiqen të trullosin dhe të hutojnë mendjen e njerëzve, duhet që edhe ne të marrim masa me mjetet tona të propagandës. Ne kemi vijën tonë të drejtë, por edhe mundësitë që kemi nuk janë të pakta. Prandaj t'i shfrytëzojmë në mënyrë

të organizuar mjetet tona të propagandës, sepse kështu do t'i ndihmojmë më shumë se gjer tani komunistët e Evropës Perëndimore.

Sot situata nuk është si në kohën e Marksit dhe të Engelsit, të cilët kanë hasur vështirësi të mëdha për konsolidimin e grupeve komuniste, grupeve të majta, grupeve socialdemokrate. Ata kanë bërë punë të veçantë me secilin grup, duke hasur e duke kapërcyer vështirësi të panumërta, sepse kishte nga ata që një herë paraqiteshin pro propozimeve të Marksit, një herë tjetër tërhiqeshin, herë ecnin përpara, herë numëronin në vend.

Tani ka një lëvizje komuniste ndërkombëtare të fuqishme. Është e vërtetë se revizionistët modernë i kanë shkaktuar dëm të madh kësaj lëvizjeje, por ekzistojnë partitë tona marksiste-leniniste dhe miliona marksistë të vendosur në vende të ndryshme të botës. Puna e përbashkët e këtyre partive duhet të ndihmojë grupet e reja të marksistëve revolucionarë që po krijohen gjer sa ato të konsolidohen dhe të bashkohen plotësisht. Kjo ndihmë është e domosdoshme, sepse këto grupe, për arsye subjektive dhe objektive, për paqartësi, herë janë dakord me njëri-tjetrin, herë largohen nga njëri-tjetri, pra herë bashkohen, herë ndahen. Kështu ndodh tani edhe me grupet marksiste angleze, të cilat kanë hyrë në luftë me njëri-tjetrin, gjë që e dëmton çështjen tonë, e ngadalëson procesin e rritjes së lëvizjes komuniste në këtë vend. Sigurisht kjo është një luftë rritjeje brenda radhëve të tyre. Në qoftë se ne dhe ju do t'u jepnim grupeve marksiste-leniniste të çdo vendi një ndihmë më efektive dhe më të organizuar që të kon-

solidonin radhët e tyre dhe të lidheshin fort me njëri-tjetrin gjersa të arrinin në krijimin e partive, ne do të fitonim kohë dhe do ta shpejtonim procesin e fuqizimit të frontit të bashkuar të partive marksiste-leniniste dhe të fitores mbi revizionizmin. Ky proces do të bëhet, kjo është dialektike, por një ndihmë jona më e organizuar do t'i jepte një hov më të madh luftës për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe për shpartallimin e revizionizmit modern.

Për të bërë një luftë të fortë kundër revizionistëve modernë, ne duhet të kemi, në radhë të parë, të forta partitë tona, të cilat duhet të punojnë që ta forcojnë gjithnjë e më shumë lëvizjen komuniste në të gjithë botën. Por rëndësi të madhe ka për ne çështja që revizionizmit modern t'i japim grushtin brenda në follenë e tij, këtu në Evropë. Kur ne ta demaskojmë mirë këtu dhe t'ia bëjmë jetën të pamundur në strofkën e tij, atëherë sukseset tona do të jenë më të shpejta. Ne kemi mundësi të shumta në këtë drejtim. Megjithëse revizionistët modernë i kanë zënë për gryke shumë parti, nga të dhënat që kemi ne, prapë ekzistojnë mundësi për një punë më të madhe në vendet kapitaliste të Evropës dhe në vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës. Bile edhe në vetë Bashkimin Sovjetik ka mundësi që lëvizja revolucionare të ngrihet e të zgjerohet.

Me një fjalë, Partia jonë e ndien nevojën e kontakteve të shpeshta me partitë motra. Ajo e ndien gjithashtu nevojën për shkëmbimin e mendimeve dhe të eksperiencës edhe me shokët e Partisë Komuniste të Zelandës së Re.

Kryetari i delegacionit, pasi foli për domosdoshmërinë e kontakteve midis dy partive dhe për luftën e Partisë Komuniste të Zelandës së Re kundër reformizmit dhe socialdemokracisë, tha:

Dëshiroj t'ju them se qëndrimi dhe fjalimi juaj i mbajtur më 28 Nëntor të këtij viti do të jenë një ndihmë shumë e madhe për partinë tonë. Rehabilitimi i Stalinit, çështje për të cilën ju u ndalët shumë në fjalimin tuaj, është një nga kushtet kryesore për të luftuar revizionizmin modern.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falënderojmë shumë për vlerësimin që i bëni Partisë sonë. Mua më gëzon fakti që thelbi i çështjes, për të cilën ne ngulim këmbë në drejtim të mbrojtjes së Stalinit dhe që lidhet ngushtë me mbrojtjen e parimeve të marksizëm-leninizmit, vlerësohet gjithashtu nga ju.

Dua të theksoj se kontaktet midis dy partive tona do të na hapin mjaft horizont dhe do të na ndihmojnë për të gjetur forma më të efektshme pune në luftën kundër revizionizmit modern, ku Partia jonë dhe partia juaj kanë grumbulluar një eksperiencë të pasur.

Lufta e përbashkët e partive marksiste-leniniste afirmon dhe forcon unitetin midis tyre. Por gjatë luftës së përditshme ka edhe shumë gjëra konkrete, që ne duhet t'i diskutojmë dhe t'i vëmë në zbatim në një front të gjerë, gjë që e bën edhe më të domosdoshme nevojën e kontakteve midis partive tona.

Sot agjencitë e ndryshme të lajmeve njoftuan se revizionistët sovjetikë kanë botuar një artikull të gjatë në gazetën «Pravda», me të cilin na atakojnë të gjithë ne, marksistë-leninistët, por, natyrisht, jo direkt. Në

këtë artikull ata afirmojnë të gjithë vijën politike dhe ideologjike që ndiqej që në kohën e Hrushovit. Siç duket ata nuk mundën të qëndronin dot në pozitat e lëkundshme që morën pas rënies së Hrushovit të detyruar nga presionet e mëdha që u bëheshin nga grupet e tjera udhëheqëse të revizionistëve modernë në partitë e ndryshme, që po i nxitin udhëheqësit sovjetikë të mbajnë qëndrim. Kjo është një gjë shumë e mirë dhe ne do ta ndjekim situatën.

KRYETARI I DELEGACIONIT: Një nga problemet e mëdha që na është krijuar neve në Zelandën e Re nga revizionistët modernë është puna që duhet të bëjmë për të edukuar klasën punëtore që ajo të kuptojë drejt ngjarjet, të kuptojë sukseset e vendeve socialiste dhe politikën tradhtare të revizionistëve modernë. N. Hrushovi me tradhtinë e tij, me pikëpamjet e tij për rrugën paqësore të kalimit në socializëm, të bashkekzistencës paqësore etj., të paraqitura në rrugë shumë të gabuar, revizioniste, i solli një dëm të madh kësaj pune të gjatë të partisë sonë. Këto pikëpamje të shtrembra u kanë dhënë një armë të madhe laburistëve dhe reformistëve të vendit tonë, sipas të cilëve ato që thoshte Hrushovi i kanë shprehur ata gjatë 25 vjetëve. Tani ne po punojmë që klasa jonë punëtore të kuptojë se shkaktar i kësaj gjendjeje është tradhtia e udhëheqjes aktuale sovjetike.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë drejt e keni kuptuar këtë çështje. Udhëheqësit revizionistë sovjetikë e kanë kaluar kufirin, ata tashmë nuk janë marksistë që kanë gabuar. Ata kanë kaluar në kampin e armiqve, pra-

ndaj qëndrimet tona për t'i demaskuar këta tradhtarë janë të drejta, reale, konsekuente, marksiste.

Edhe komunistët mund të gabojnë, edhe partitë mund të gabojnë. Në këto raste duhen bërë të gjitha përpjekjet që gabimet të ndreqen, të likuidohen. Mirëpo udhëheqësit revizionistë sovjetikë nuk janë më në fazën e gabimeve, ata janë transformuar në reformistë modernë shumë të egër, që nuk janë demaskuar plotësisht dhe që për arsye se janë në pushtet dhe kanë në duart e tyre një fuqi të madhe, njëkohësisht janë edhe shumë të rrezikshëm. Reformistët e vjetër, siç janë, për shembull, liderët e Partisë Socialiste të Francës, i shërbejnë borgjezisë në mënyrë direkte dhe indirekte. Ata, pavarësisht se disa herë janë në qeveri dhe disa herë nuk janë, marrin pjesë në shtypjen e punëtorëve. Të gjitha rrymat e ndryshme reformiste në vendet kapitaliste janë në favor të borgjezisë, por disa nga revizionistët modernë janë edhe më të rrezikshëm se ata, sepse janë në fuqi. Prandaj lufta për demaskimin e tyre është detyrë e dorës së parë për të gjithë marksistë-leninistët.

Lufta që bëni ju kundër reformizmit dhe përpjekjet tuaja, për ta bërë klasën punëtore të Zelandës së Re të kuptojë domosdoshmërinë e luftës revolucionare, sidomos brenda lëvizjes sindikale, janë me rëndësi. Kështu ju zbatoni një parim leninist. Lenini theksonte vazhdimisht se në vendet kapitaliste, partitë komuniste duhet t'i kenë sindikatat nën drejtimin e tyre dhe t'i bëjnë ato një forcë të madhe dhe të organizuar. Prandaj ajo që bën partia juaj është shumë e drejtë. Në sindikata militon klasa punëtore, atje e ka bazën e vet

partia. Prandaj formimi dhe edukimi i ndërgjegjes së klasës punëtore për rolin e saj vendimtar në luftën kundër kapitalizmit, është arma më e mprehtë e partisë në vendet kapitaliste, natyrisht pa lënë pas dore në asnjë mënyrë edhe çështjen e fshatarësisë, sidomos atje ku kjo ka peshën më të madhe.

Shokët revolucionarë të vendeve kapitaliste duhet të kuptojnë mirë rëndësinë e madhe të punës së partisë brenda në sindikata dhe të luftojnë aktivisht për të hedhur bazat e veta në to, për të grumbulluar rreth tyre një numër sa më të madh elementësh të shëndoshë, për të demaskuar veprimtarinë e revizionistëve dhe të reformistëve brenda në radhët e sindikatave. Natyrisht, tani për tani, pozitat e shokëve të këtyre grupeve revolucionare marksiste në sindikatat janë akoma shumë të dobëta, por ato do të vijnë duke u forcuar, për arsye se marksizëm-leninizmi vepron në të gjitha drejtimet në lëvizjen punëtore ndërkombëtare. Prandaj kemi besim se gradualisht do të ecet përpara.

Luftën kundër revizionizmit modern ne e bëjmë në rrugë të drejtë dhe jemi të ndërgjegjshëm që deri në demaskimin e në shpartallimin e plotë të tij na presin luftëra të reja. Por ne nuk trembemi dhe kemi besim të patundur se do të ecim kurdoherë përpara dhe do të fitojmë mbi revizionistët.

Shokët më thanë se ju do të ikni sot. Na vjen keq që do të ndahemi. Ju falënderojmë shumë për vlerësimin e lartë dhe për besimin që ju keni te Partia e Punës e Shqipërisë. Partia jonë, ashtu sikurse thatë ju, do ta mbajë kurdoherë lart flamurin e marksizëm-leninizmit. Ju uroj rrugë të mbarë dhe shëndet! Ju lutem

u transmetoni të gjithë shokëve të udhëheqjes së partisë suaj, të falat tona më të përzemërta revolucionare, ndjenjat tona më të mira të miqësisë dhe të unitetit të çeliktë të Partisë sonë me Partinë Komuniste të Zelandës së Re. I urojmë suksese kurdoherë më të mëdha partisë suaj, i urojmë fitore të reja klasës punëtore të Zelandës së Re, dhe juve, të dashur shokë, shëndet të plotë! E gëzofshi me suksese gjithnjë më të mëdha Vitin e Ri për të mirën e gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TAKTIKA E UDHËHEQJES SË RE REVIZIONISTE SOVJETIKE

T e z a

23 dhjetor 1964

Aktualisht, taktikë veprimi e heshtur, pa bujë e pa fjalime bombastike, «spektakulare». E kundërta e veprimeve të bujshme të Hrushovit. Dëshirojnë të fitojnë prestigjin e humbur nga veprimet «amerikandashëse» të Hrushovit dhe me këtë gjë të japin përshlytjen e dyfishtë që asgjë s'kanë ndërruar, por edhe veprojnë si «njerëz të pjekur» dhe jo si sharlatanë.

Në arenën ndërkombëtare, natyrisht ata kanë pësuar një fiasko.

Në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, taktika e tyre ka shumë synime. Në radhë të parë, të rivendosin besimin e humbur ose të tronditur në gjirin e miqve të tyre revizionistë. Ata i sigurojnë miqtë e vet se asgjë s'ka ndryshuar në vijën e tyre politike dhe ideologjike, por çështja qëndron në atë që revizionistët sovjetikë duhet të kërkojnë dhe të gjejnë rrugën mesatare demagogjike të një propagande, as të bujshme, shkatërruese si të Hrushovit, as edhe krejtësisht të zbehtë, pse në të dyja rastet është një humbje për ta, por

njëkohësisht edhe për revizionistët e tjerë, të cilët duan dhe kërkojnë një mbështetje propagandistike nga revizionistët sovjetikë. Revizionistët e tjerë, natyrisht, nuk mund të jenë plotësisht dakord me atë që revizionistët sovjetikë të mos flasin fare për të mirë për Hrushovin, pse ky për ta ka qenë ideologu, që udhëhoqi për një dekadë. Kurse sovjetikët janë të detyruar, veçanërisht për opinionin e brendshëm, të mos flasin për Hrushovin, të flasin disi në «mënyrë kritike», por indirekt dhe të mos ekspozohen më në arenën politike dhe ideologjike në mënyrën e bujshme të Hrushovit.

Këto momente dhe koniunktura janë një hendikep¹ i madh për udhëheqjen e re revizioniste sovjetike, pse ajo është akoma larg derisa të krijojë atë autoritet të duhur mbi aleatët e vet revizionistë, të cilët po forcojnë «independencën» dhe arrogancën e tyre. «Shkopi i dirigjentit», që me qenien e Hrushovit në krye, u thye dhe vazhdon e do të vazhdojë të mos ngjitet. Ky është një minus i madh për ta dhe një plus për ne. Ata do të luftojnë kundër nesh, por jo në mënyrë të organizuar dhe monolite si më parë.

Vazhdon dhe do të vazhdojë për një kohë, sipas mendimit tim, të mos manifestohet personaliteti i gjithë udhëheqjes sovjetike, ose i disa udhëheqësve kryesorë, për arsye se ata krijuan përpara partisë së tyre dhe opinionit të brendshëm, një situatë të ndërlikuar në lidhje me «personalitetet» e udhëheqjes. Qëndrimi i tyre antimarksist ndaj Stalinit, duke ngritur çështjen e të ashtuquajturit «kulti i indi-

1 Handicap (angl.) — pengesë.

vidit», nuk shërben më për të maskuar komplotin e tyre kundër principeve të marksizëm-leninizmit. I gjithë blöfi u demaskua me rrëzimin e Hrushovit, i cili gjoja u hoq dhe dënohet për «kult të individit». Pra ai që gjoja e dënoi «kultin e individit» të Stalinit, ngriti kultin e tij dhe ata që në mënyrë të fshehtë punonin në kohën e Stalinit, për ta fryrë kultin e Stalinit, për ta dënuar atë, për të deklaruar se «ky kult u kapërcye», lanë më në fund të zhvillohej kult i Hrushovit. Tani ata s'i beson njeri, por jo vetëm s'i beson, por hapi më i parë që ata do të bëjnë për ta vënë më në dukje personalitetin e një ose dy udhëheqësve, do t'i gjejë përpara kritikave se po ngrihet «kulti i individit» të një udhëheqësi të ri. Një koniunkturë e tillë, është një hendikep tjetër për udhëheqjen e re revizioniste sovjetike, pse jo vetëm që ajo përbëhet prej njerëzish të diskredituar e pa personalitet, por edhe po të duan dhe do të tentojnë ta pompojnë, ky personalitet do të jetë një om dë paj¹ siç thotë francezi. Në këto situata të vështira për ta, revizionistët sovjetikë, vijnë rrotull dhe përtypen me parullat e «udhëheqjes kolektive» e të vendimeve «kolegjiale». Por kjo s'do të qëndrojë për shumë kohë në këmbë, veçse «do të riparohet» me zor dhe në mënyrë të çalë e të vajtueshme. Në udhëheqjen e re revizioniste sovjetike do të shquhet një kalë, dhe kjo është një humbje për ata dhe një fitore për ne. Ne shohim se fjalimet e udhëheqjes aktuale sovjetike, duke notuar në këto situata të vështira, janë të pakta, të

1 Homme de paille (frëngj.) — njeri pa vlerë, vegël e një tjetri.

zbehta, të përgjithshme, të tronditshme. Ata përpiqen të evitojnë fërkime të hapëta me ne, pse nga një goditje me ne, ata do të detyrohen të vijnë në pozitë e para. Atëherë «ku ishe? — asgjëkundi». Me taktikën e tyre, revizionistët sovjetikë përpiqen që ta evitojnë këtë, kurse ne duhet t'ua shkatërrojmë këtë taktikë.

Përballë polemikës, qëndrimet e revizionistëve sovjetikë nuk para u pëlqejnë revizionistëve të tjerë, të cilët, sigurisht u bëjnë presion sovjetikëve, të forcojnë dozën në afirmimin e mbrojtjes së tezave tradhtarë hrushoviane, gjë që i çon të largohen nga goditja me ne. Këtë e tregon artikulli i botuar kohët e fundit në gazetën «Pravda»¹.

Revizionistët sovjetikë duhet të jenë në ujdi të plotë me imperialistët amerikanë për shumë çështje. Lidhjet e Hrushovit jo vetëm që u ruajtën, por po forcohen, nëpërmjet një bashkëpunimi më pak të bujshëm, por më efikas. Bashkimi Sovjetik vazhdon të bëjë lëshime (siç janë kuotat për OKB) dhe imperialistët amerikanë të përfitojnë dhe të tregohen të qetë ndaj politikës së revizionistëve sovjetikë, pse ajo ecën kurdoherë në favorin e tyre.

Imperializmi po futet më thellë në vendet e ish-demokracisë popullore në Evropë dhe në Bashkimin Sovjetik. Ai në këto vende po fiton pozita ekonomike, politike dhe ideologjike.

¹ Është fjala për artikullin e botuar në gazetën «Pravda» më 6 dhjetor 1964 me titull «Shteti i gjithë popullit», ku, midis të tjerave, flitet edhe për «kuptimin politik të polemikës», sigurisht sipas pikëpamjes revizioniste.

Hrushovianët, herë pas here, në mënyrë demagogjike po flasin për Azinë, Afrikën, Amerikën Latine. Ata do të vënë forca dhe do të kujdesen, për të ndihmuar imperializmin amerikan në ato zona ku ai ndodhet në vështirësi dhe në përleshje.

Ne shohim, që revizionistët me bujë po ndihmojnë partinë revizioniste të Danges në Indi. Ata do të punojnë gjerësisht me reaksionin indian. Revizionistët sovjetikë do të ndihmojnë fuqimisht revizionistët japonezë dhe të tjerë, për të fituar pozitën e humbura dhe për t'u krijuar telashe ideologjike, politike dhe ekonomike vendeve socialiste të atij pellgu, si dhe partive marksiste-leniniste të Lindjes së Lartë.

Nuk duhet në asnjë mënyrë të nënvleftësohen këto rreziqe. Ne duhet të demaskojmë fuqimisht veprimet armiqësore të revizionistëve modernë, të demaskojmë planet e tyre, t'i parashikojmë këto plane, të kemi edhe ne planet, taktikat tona dhe këto taktika jo vetëm të jenë të drejta, por të jenë të gjalla, revolucionare, të efektshme, të shumanshme dhe në shumë drejtime të koordinuara.

Plogështia, mykja janë armiqtë tanë, prandaj t'i luftojmë ato që të mos kenë vend, as në politikë, as në polemikë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MARKSIZEM-LENINIZMI REVOLUCIONAR DO TË TRIUMFOJË NË EVROPËN E MBARSUR ME REVIZIONIZËM

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

6 janar 1965

Evropa është djepi dhe një ndër qendrat kryesore të kapitalizmit. Por ajo është njëkohësisht edhe djepi i lëvizjes revolucionare të klasës punëtore. Evropa është vendi ku zhvilluan veprimtarinë e tyre revolucionare mësuesit e mëdhenj të proletariatit, Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Lëvizja punëtore e komuniste evropiane, si dhe lëvizja komuniste botërore në tërësi, ka kaluar një rrugë të lavdishme që nga Manifesti Komunist tek Internacionalja e Parë, nga Komuna e Parisit te revolucioni i parë rus e te Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit, nga Internacionalja e Tretë te fitorja e socializmit në Bashkimin Sovjetik e te lufta kundër fashizmit në Spanjë, nga fitorja historike e Bashkimit Sovjetik dhe e popujve të tjerë në Luftën e Dytë Botërore te triumfi i revolucionit dhe futja në rrugën e socializmit të një sërë vendesh të ndryshme.

Traditat revolucionare dhe fitoret e lëvizjes punëtore e komuniste evropiane janë të shkëlqyera. Me këto tradita e fitore dhe duke vepruar në qendrat kryesore e më jetike të sistemit kapitalist, të imperializmit botëror, në vetë zemrën e tij, ajo ka luajtur dhe luan një rol shumë të madh në lëvizjen revolucionare botërore, ka ushtruar një ndikim të fuqishëm mbi të gjitha proceset revolucionare të kontinenteve të tjera. Duke i dhënë goditje të drejtpërdrejta imperializmit në strofkën e tij, lëvizja revolucionare e Evropës ka lehtësuar luftën e popujve të vendeve të tjera për çlirimin kombëtar e shoqëror dhe ka shpejtuar fitoren e tyre mbi imperializmin dhe reaksionin.

Por kjo është vetëm njëra anë e lëvizjes komuniste e punëtore në Evropë. Historia dëshmon se si kështjella kryesore e kapitalizmit dhe e imperializmit botëror, Evropa, bashkë me Amerikën e Veriut, kanë qenë gjithashtu djepi i oportunizmit e i revizionizmit në lëvizjen punëtore ndërkombëtare. Në Evropë kanë lindur dhe nga Evropa janë përhapur rrymat më të ndryshme antimarksiste, që nga bakuninistët, prudonistët, lasalianët e fabianët, kundër të cilëve luftuan në kohën e tyre Marksi dhe Engelsi, te bernshtajnianët, kautskianët, «marksistët legalë», «ekonomistët», menshevikët, eserët, empiriokritikët e anarkosindikalistët, kundër të cilëve luftoi me një vendosmëri të rrallë Lenini, dhe deri te trockistët, buharinistët, titistët, kundër të cilëve një luftë të madhe bëri Stalini.

«Sëmundja pleqërore e djathtizmit» në lëvizjen e sotme komuniste e punëtore evropiane

Evropa ka qenë gjithnjë arena e një lufte të ashpër midis marksizëm-leninizmit revolucionar dhe oportunizmit e revizionizmit. Në shembullin e Evropës është vërtetuar më mirë se kudo se ligji themelor i zhvillimit të lëvizjes komuniste e punëtore është lufta e të kundërtave: atje ku ka revolucion ka edhe kundërrevolucion, atje ku ka marksizëm shfaqen edhe rryma, të hapëta ose të fshehta antimarksiste, atje ku ngre kokën oportunizmi dhe revizionizmi është e pashmangshme edhe lufta e marksistëve revolucionarë kundër tyre. Qysh nga lindja e marksizmit kjo luftë është zhvilluar me një forcë të veçantë në lëvizjen komuniste e punëtore të Evropës. Në këtë luftë të gjatë e të vështirë janë rritur e janë kalitur radhët e komunistëve evropianë dhe nga kjo luftë lëvizja komuniste e punëtore evropiane ka dalë gjithnjë më e fortë dhe ka shkuar gjithmonë përpara, duke arritur suksese e fitore të mëdha.

Por lufta midis marksizëm-leninizmit dhe oportunizmit e revizionizmit vazhdon. Kjo është bërë sot më e ashpër se kurrë. Vendin e rrymave të vjetra antimarksiste e ka zënë sot revizionizmi modern, në mënyrë të veçantë ai hrushovian. Si vazhdim i drejtpërdrejtë i të gjitha rrymave revizioniste e oportuniste të së kaluarës, revizionizmi hrushovian është bërë sot rreziku më i madh që ka njohur historia e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe që i ka sjellë e po i sjell asaj dëme

kolosale. Rrezikshmëria e madhe e këtij revizionizmi qëndron në faktin se ai është shfaqur në partinë më të vjetër e më me autoritet në botë, në Partinë Komuniste të themeluar nga Lenini, se ai ka prekur vendin e parë e më të fuqishëm socialist në botë, Bashkimin Sovjetik, dhe se, duke qenë revizionizëm në pushtet, për realizimin e qëllimeve të tij tradhtarë, ai përdor të gjitha mjetet e shtetit socialist.

Revizionizmi hrushovian, i ndihmuar fuqimisht edhe nga paraardhësi i tij, titizmi, ka marrë tani një përhapje të gjerë. Nga ky revizionizëm janë pushtuar në radhë të parë Evropa dhe Amerika e Veriut, ku udhëheqjet e shumë partive komuniste e punëtore, duke tradhtuar traditat revolucionare të lëvizjes komuniste e punëtore evropiane, kanë shkarë në pozitat e oportunitizmit, ndjekin një kurs fund e krye antimarksist, kanë bërë çështje të përbashkët me armiqtë e socializmit dhe janë hedhur në sulm kundër bazave të marksizëm-leninizmit dhe të gjitha atyre partive që i qëndrojnë atij besnike e luftojnë kundër revizionizmit modern.

Evropa filloi të mbarset me revizionizmin modern menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. E tronditur nga fitoret e socializmit, nga rritja e lëvizjes komuniste e punëtore në vendet kapitaliste dhe nga zhvillimi i luftës nacionalçlirimtare të popujve të shtypur, borgjezia ndërkombëtare, me atë të SHBA-së në krye, u hodh në një sulm të ashpër frontal për të mbrojtur e për të zgjeruar sundimin e saj në botë. Për këtë qëllim ajo përpunoi planin e saj të presionit të gjithanshëm politik, ideologjik, ekonomik e ushtarak mbi vendet socialiste,

mbi partitë komuniste e punëtore dhe mbi të gjithë popujt e botës.

Për realizimin e planit të tyre strategjik imperialistët, me ata të SHBA-së në krye, e vunë ekonominë e vendeve të tyre në rrugën e militarizimit, i dhanë një hov të paparë garës së armatimeve, ngritën blloqet agresive-ushtarake, ndërtuan një rrjet të gjerë bazash ushtarake detare, tokësore dhe ajrore në vende të ndryshme të botës, ndërmorën një varg aktesh agresive, si në Kore, Vietnam, Egjipt, Kongo, Algjeri e gjetkë, përdorën gjerësisht shantazhin atomik, duke shfrytëzuar për këtë monopolin dhe epërsinë atomike të përkohshme.

Në fushën ekonomike imperialistët amerikanë shpallën «Doktrinën Truman» e «Planin Marshall», qëllimi i të cilëve ishte që, nën maskën e së ashtuquajturës ndihmë amerikane, të skllavëronin ekonomikisht, e pastaj edhe politikisht, vendet evropiane, vendosën një bllokadë të egër ekonomike kundër vendeve socialiste, filluan të ndërhyjnë brutalisht dhe në forma të ndryshme në të gjitha vendet e botës për të zëvendësuar kudo kolonialistët e vjetër me neokolonializmin amerikan.

Në fushën ideologjike ata shpërthyen një fushatë të tërbuar sulmesh e shpifjesh kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve socialiste, kundër partive komuniste e të gjitha forcave demokratike, të shoqëruar me një demagogji të madhe mbi «epërsitë e kapitalizmit popullor, të organizuar e demokratik», mbi «shtetin e mirëqenies së përgjithshme» dhe me masa fashiste e diktatoriale, duke persekutuar komunistët dhe duke

ndaluar partitë komuniste, për të forcuar kështu prapavijat e tyre.

Pjellë e këtij presioni të gjithanshëm të borgjezisë ndërkombëtare është revizionizmi, si shfaqje e ideologjisë borgjeze në lëvizjen komuniste. Këtë produkt të vet imperializmi e përkrahu dhe e ndihmoi me të gjitha mjetet, për të minuar e për të shkatërruar lëvizjen revolucionare të klasës punëtore. Eksperienca ka treguar se sa më tepër fitore korr lëvizja revolucionare, socializmi, sa më shumë forcohen pozitat dhe rritet fuqia e tyre, aq më shumë borgjezia i mbështet shpresat e saj në metodën e minimi nga brenda të lëvizjes punëtore e komuniste, në mbështetjen dhe në përkrahjen e oportunitizmit. Për më tepër, sa më shumë fitore korr marksizmi mbi armiqtë e vet ideologjikë në gjirin e lëvizjes punëtore, aq më i stërholluar e i maskuar bëhet edhe oportunitizmi, gjithnjë më shumë merr ai trajtën e shtrembërimit të fshehur të marksizmit, trajtën e revizionizmit. Për të inkurajuar e për të përhapur oportunitizmin dhe revizionizmin, borgjezia e vendeve të zhvilluara kapitaliste në Evropë e në Amerikë ka ndjekur një taktikë të dyfishtë: atë të dhunës së hapët, të mohimit të çdo lëshimi, të çdo reforme dhe institucioni e të drejte demokratike dhe atë të liberalizimit, të disa të drejtave politike, të reformave e të lëshimeve për të krijuar iluzione reformiste e oportuniste. Lidhur me këtë Lenini ka theksuar:

«Shumë herë borgjezia e arrin qëllimin e vet për një kohë të caktuar me anë të politikës «liberale», e cila është, sipas vërejtjes së drejtë

të Pannekukut, politikë «më dinake». Një pjesë e punëtorëve, një pjesë e përfaqësuesve të tyre disa herë gënjehen nga këto lëshime, që janë lëshime vetëm në dukje. Revizionistët e shpallin «të vjetruar» teorinë mbi luftën e klasave ose fillojnë një politikë, e cila në realitet çon në mohimin e saj. Dredhat e taktikës borgjeze shkaktojnë forcimin e revizionizmit në lëvizjen punëtore dhe shumë herë bëjnë që mosmarrëveshjet në radhët e saj të arrijnë në një përçarje të drejtpërdrejtë»¹.

Për të ndjekur këtë taktikë, borgjezinë monopoliste të SHBA-së e të vendeve të mëdha evropiane e ndihmoi shumë koniunktura ekonomike e pasluftës. Për sa i përket Amerikës së Veriut, dihet se ajo nuk pati dëmtime nga lufta, përkundrazi, SHBA përfituan nga lufta dhe nga shkatërrimet e saj në Evropë për të zhvilluar prodhimin e për të nxjerrë fitime kolosale. Kurse vendet kapitaliste të Evropës, me gjithë varësinë nga SHBA, filluan ta marrin veten, të rimëkëmbin forcat prodhuese të shkatërruara nga lufta dhe të zhvillojnë ekonominë e tyre, duke shfrytëzuar për këtë qëllim faktorë të tillë, si militarizimin e ekonomisë dhe garën e armatimeve, ekspansionin e jashtëm ekonomik, përtëritjen e kapitalit themelor, përdorimin e teknikës së re, shtimin e shfrytëzimit të punonjësve, grabitjen e popujve të tjerë etj. Kjo koniunkturë e favorshme ekonomike, e mbështetur kryesisht në faktorë të përkoh-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 16, f. 408.

shëm, i dha mundësi borgjezisë në Evropë e në Amerikën e Veriut të bëjë një zhurmë të madhe rreth «lulëzimit të përjetshëm» të kapitalizmit dhe të krijojë në masat shumë iluzione reformiste mbi gjoja zhdukjen e krizave, të anarkisë e të papunësisë dhe të plagëve të tjera të kapitalizmit. Filluan të marrin një përhapje të gjerë idetë mbi gjoja planifikimin e ekonomisë kapitaliste dhe mbi shtetin kapitalist si një shtet mbiklasor që i shërben gjithë shoqërisë, mbi ngushtimin dhe likuidimin e dallimeve midis klasave dhe, si rrjedhim, mbi gjoja zhdukjen e luftës së klasave etj., etj.

Koniunktura e lartë ekonomike solli me vete edhe rritjen e klasës punëtore, plotësimin e saj në një masë të konsiderueshme me «rekrutë» nga radhët e fshatërisë, zanatçinjve e të shtresave të tjera mikroborgjeze të rrënuara nga shtypja dhe nga konkurrenca e kapitalit të madh. Siç ka deklaruar vetë udhëheqja e PK të Italisë në Kongresin e saj të 10-të, gati gjysma e klasës punëtore të Italisë është rritur në këto vitet e fundit me njerëz të ardhur nga shtresa të ndryshme mikroborgjeze. Edhe radhët e disa partive komuniste, sidomos në Itali e në Francë, u rritën shumë pas luftës. Në to filluan të hyjnë gjithfarë elementësh mikroborgjezë, karrieristë e oportunistë. Nga ana tjetër, si rezultat i koniunkturës ekonomike, i fitimeve të mëdha, borgjezia është përpjekur të blejë, «të aristokratizojë», «të borgjeztojë» një pjesë të klasës punëtore. Klasikët e marksizëm-leninizmit kanë pas vënë në dukje prej kohësh rrezikun e veçantë të përhapjes së oportunizmit e të revizionizmit në vendet e zhvilluara kapitaliste, ku

borgjezia, nga superfitimet e saj, korrupton dhe bën për vete një pjesë të klasës punëtore.

«...proletariati anglez, i shkruante Engelsi Marksit më 7 tetor 1858, në fakt po borgjezohet gjithnjë më tepër, kështu që kombi, më borgjez nga të gjitha kombet, do, me sa duket të arrijë, në fund të fundit, që të ketë një aristokraci borgjeze dhe një proletariat borgjez përbri borgjezisë»¹.

Lenini gjithashtu ka shkruar:

«...këto superfitime, që arrijnë në miliarda, janë baza ekonomike, që e mban gjallë oportunitizmin në lëvizjen punëtore. Në Amerikë, në Angli, në Francë ne shohim se krerët oportunistë, shtresa e lartë e klasës punëtore, aristokracia punëtore, janë shumë më kryeneçë; ata i bëjnë një rezistencë më të fortë lëvizjes komuniste. Dhe për këtë arsye ne duhet të kemi parasysh se partitë punëtore evropiane dhe amerikane do të shpëtojnë nga kjo sëmundje më me vështirësi sesa ndër ne. Ne e dimë se, që nga koha e themelimit të Internacionales së Tretë, në shërimin e kësaj sëmundjeje janë korrur suksese shumë të mëdha, por akoma nuk kemi arritur deri në likuidimin përfundimtar të

¹ K. Marks e F. Engels. Letra të zgjedhura, bot. rus. 1947, f. 295.

saj: spastrimi i partive punëtore, i partive revolucionare të proletariatit në të gjithë botën nga influenca borgjeze, nga oportunistët në radhët e tyre akoma nuk është përfunduar»¹.

Një mbështetje shumë të fuqishme për përhapjen e revizionizmit në Evropë kanë qenë dhe janë partitë socialdemokrate, të cilat ekzistojnë pothuajse në të gjitha vendet kapitaliste të zhvilluara dhe kanë pozita të forta, bile në disa vende ato janë në krye të qeverive borgjeze. Partitë socialdemokrate janë pasardhëset e drejtpërdrejta të partive të Internacionales së Dytë tradhtare; ato janë, siç ka thënë Lenini, «parti borgjeze të klasës punëtore, agjente të vërteta të borgjezisë në lëvizjen punëtore», «çirakë të klasës kapitaliste nga radhët e punëtorëve», «mbështetja ideologjike e kapitalizmit» etj.

«Praktikisht është provuar, ka shkruar Lenini, se militantët në gjirin e lëvizjes punëtore që bëjnë pjesë në rrymën oportuniste, janë mbrojtësit më të mirë të borgjezisë sesa vetë borgjezët. Po të mos udhëhiqeshin punëtorët nga këta njerëz, borgjezia nuk do të mund të mbahej më këmbë»².

Revizionizmi i sotëm gjeti një mbështetje të fortë dhe një burim ushqimi shpirtëror te socialdemokracia, sepse që të dy janë shfaqje të ideologjisë borgjeze: so-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 254.

2 Po aty.

cialdemokracia në lëvizjen punëtore, kurse revizionizmi në lëvizjen komuniste.

Pas shpërthimeve revolucionare që ndodhën në Evropë gjatë dhe menjëherë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, gjithë periudha e gjatë e pasluftës për Evropën ka qenë në përgjithësi periudha e një qetësie relative, e një zhvillimi pak a shumë paqësor.

«... kalimi nga një periudhë ngritjeje në një periudhë qetësie, ka thënë Stalini, nga vetë natyra e tij, i shton mundësitë e rrezikut të së djathtës. Në qoftë se periudha e ngritjes pjell iluzione revolucionare, duke krijuar rrezikun e majtë si rrezikun kryesor, periudha e qetësisë, përkundrazi, pjell iluzione reformiste socialdemokrate, duke krijuar rrezikun e djathtë si rrezikun kryesor. Në vitin 1920, kur lëvizja punëtore ishte në ngjitje, Lenini shkroi broshurën mbi «Sëmundjen foshnjore të «majtizmit»». Pse Lenini shkroi pikërisht këtë broshurë? Sepse rreziku i majtë aso kohe ishte rreziku më serioz. Unë mendoj se, po të kishte qenë gjallë Lenini, tani ai do të kishte shkruar një broshurë të re mbi «Sëmundjen pleqërore të djathtëzimit», sepse tani, në periudhën e qetësisë, kur iluzionet e kompromisit duhet të shtohen, rreziku i djathtë është rreziku më serioz»¹.

Këto fjalë të Stalinit i përshtaten plotësisht edhe

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 61.

periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Po të ishte gjallë Lenini me siguri do të kishte shkruar edhe sot një libër mbi «Sëmundjen pleqërore të djathtëzimit» në lëvizjen komuniste e punëtore evropiane!

Procesi i përhapjes së revizionizmit në partitë komuniste e punëtore të Evropës e të Amerikës së Veriut u intensivua dhe u bë një fakt i gjallë sidomos pas vdekjes së J. V. Stalinit, atëherë kur doli në skenë grupi tradhtar i N. Hrushovit dhe shpalosi në Kongresin e 20-të të PK të BS flamurin e tij revizionist. Kongresin e 20-të të PK të BS revizionistët e kanë cilësuar me bujë të madhe si «kongresin që hapi një epokë të re në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare». Po, me të vërtetë Kongresi i 20-të i PK të BS do të mbetet në histori si kongresi që hapi një epokë të re, por kjo «epokë e re» s'është gjë tjetër veçse epoka e përhapjes së oportunizmit e të revizionizmit në lëvizjen e sotme komuniste e punëtore ndërkombëtare, sidomos në zonën e Evropës e të Amerikës së Veriut, ku ai gjeti terrenin më të përshtatshëm, qoftë nga pikëpamja historike, qoftë nga pikëpamja aktuale. Grupi i Hrushovit, duke shfrytëzuar autoritetin e PK të BS e të vetë Bashkimit Sovjetik dhe duke përdorur metodat e mjetet më të ulëta, mundi t'ua imponojë kursin e tij revizionist udhëheqjeve të shumë partive komuniste e punëtore. Për t'ia arritur këtij qëllimi, për të ndryshuar përbërjen e udhëheqjes së shumë partive dhe për të sjellë në fuqi njerëzit besnikë të vijës së tij tradhtarë, ai nuk u ndal as përpara kompleteve më të ndyra. I ashtuquajturit «kult i individit» dhe «lufta kundër pasojave të tij» u bënë kudo ajo armë demagogjike dhe ai gogol që grupi i Hru-

shovit përdorën për të kërcënuar, për të trembur e për të nënshtruar të gjithë ata që nuk i bindehin shkopit të tij. Si pasojë e të gjitha këtyre, u larguan nga udhëheqja e shumë partive kuadrot e vjetër revolucionarë, që kishin dhënë prova të besnikërisë ndaj marksizem-leninizmit dhe vija revizioniste e N. Hrushovit u shpall nga udhëheqësit revizionistë si vija e përgjithshme e shumë partive në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Burimi i të gjitha të këqijave është kursi revizionist

Revizionistët modernë përdorin të gjitha mjetet e manovrat për të mashtruar njerëzit e për t'i bërë ata të besojnë se Evropa është gjoja «kështjella e marksizem-leninizmit të vërtetë», «bartëse e zhvillimit dhe e zbatimit krijues të doktrinës marksiste», «qendra e zjarrit e revolucionit» dhe «fronti më i përparuar i lëvizjes revolucionare botërore». Ata përpiqen «të provojnë» se kudo gjetkë marksizem-leninizmi është degjeneruar, është zëvendësuar me dogmatizmin, sektarizmin, nacionalizmin, racizmin, neotrockizmin etj., etj., prandaj duhet përhapur kudo «drita shpëtimtare e Evropës». Duke spekuluar me traditat revolucionare të Evropës, revizionistët përpiqen ta shesin sapunin për djathë, ta shesin revizionizmin e sotëm evropian si marksizem-leninizëm të pastër e të kulluar, t'ia nënshtrajnë influencës helmuese të revizionizmit modern, me qendër në Evropë, gjithë lëvizjen revolucionare e çlirimtare botë-

rore, të mbytin hovin revolucionar të popujve të kontinenteve të tjera dhe të nanurisin e të vënë në gjumë komunistët revolucionarë evropianë, për të kryer kështu në qetësi veprën e tyre kriminale.

Por revizionistët nuk do të mund të mashtrojnë dot për një kohë të gjatë dhe t'ua arrijnë qëllimeve të tyre. Ata janë demaskuar e po demaskohen vazhdimisht. Vija e tyre tradhtare ka ndeshur në një rezistencë të fortë nga ana e marksistë-leninistëve të vërtetë, ajo ka hasur në vështirësi të mëdha dhe po pëson fiasko në çdo ballafaqim me realitetin. Se ç'është kjo vijë, tanimë është bërë fare e qartë për të gjithë. Ajo është vija e tradhtisë ndaj parimeve themelore të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, vija e heqjes dorë nga lufta kundër armikut të klasës dhe nga revolucioni, vija e afrimit dhe e bashkimit me imperializmin dhe me të gjitha forcat reaksionare, vija e degjenerimit të socializmit dhe e shkrirjes me socialdemokracinë. Është e hidhur, por është fakt se Evropa e sotme është bërë kështjella kryesore e revizionizmit më të tërbuar.

Sido që të përpiqen revizionistët ta zbukurojnë gjendjen e lëvizjes punëtore e demokratike në Evropë, është fakt i pamohueshëm se, si rezultat i kursit të tyre fund e krye oportunist e tradhtar, kjo lëvizje ka pësuar rënie, është dobësuar fryma e saj revolucionare dhe fuqia e aksionit. Me gjithë peshën e saj të madhe në gjithë jetën e vendit, klasa punëtore evropiane nuk po luan sa duhet dhe si duhet rolin e rëndësishëm që i takon, nuk po jep kontributin që duhet të japë në luftën për paqe, demokraci, pavarësi kombëtare dhe socializëm. Në Evropë sot ka shumë fjalë, iluzione e deklarata-

ta boshe dhe shumë pak vepra e aksione konkrete. Ku është ai hov i madh që mori lëvizja punëtore e demokratike në Evropë në vitet e para të pasluftës dhe që me të drejtë ngjalli admirimin e gjithë revolucionarëve të botës? Ku është heroizmi i Rajmonda Djenit dhe i do-kerëve francezë kundër luftës së ndyrë të kolonialistëve francezë në Vietnam? Ku janë grevat dhe demonstratat energjike shumëmilionëshe të punëtorëve dhe të argatëve italianë kundër reaksionit e fashizmit? Ku janë ajo përkrahje e vendosur dhe ai shpirt i lartë solidariteti që u treguan ndaj popullit korean, ndaj luftës së tij patriotike kundër agresorëve amerikanë? Ku është ajo lëvizje masive dhe luftarake e paqes që shpërtheu nëpër të gjithë Evropën në kohën e Thirrjes së Stokholmit etj.?

Revizionistët nuk i kanë mbështetur shpresat e tyre të klasa punëtore e masat punonjëse dhe tek aksioni e lufta e tyre revolucionare, por të kombinacionet politike e diplomatike, tek «arsyeja» dhe «urtësia» e krerëve të imperializmit, të vija revizioniste e «bashkekzistencës paqësore», «garës paqësore» dhe «rrugës paqësore», të kushtetutat dhe parlamentet borgjeze, të «reformat e strukturës» dhe tek aleancat me forcat konservatore e reaksionare. Me të gjitha këto revizionistët përpiqen të paralizojnë shpirtin luftarak të klasës punëtore evropiane, ta largojnë atë nga rruga e luftës revolucionare e ta hedhin në pasivitet, duke mbjellë në të gjithfarë iluzionesh pacifiste e reformiste.

Me kursin e tyre tradhtar revizionistët po orvaten t'i shndërrojnë partitë komuniste e punëtore të shumë vendeve të Evropës, me tradita të lavdishme, nga parti.

të revolucionit social në parti të reformave sociale, nga pararoja revolucionare, luftarake, të organizuara e të disiplinuar të klasës punëtore në organizata amorge, pa kufi të qartë, pa disiplinë të shëndoshë partie, ku mund të hyjnë e të dalin sipas qejfit gjithfarë elementësh borgjezë, karrieristë e oportunistë. Ata janë futur në rrugën e rishikimit të «karakterit, funksioneve dhe strukturës organizative» të partive komuniste, mohojnë rolin udhëheqës të partisë në luftën për fitoren e revolucionit dhe ndërtimin e socializmit. Nën pretekstin e krijimit të unitetit të klasës punëtore, revizionistët jo vetëm që kanë hequr dorë nga demaskimi i krerëve të djathtë socialdemokratë, që janë përçarësit kryesorë të klasës punëtore, por po afrohen e shkrihen gradualisht me partitë socialdemokrate, po bëjnë çmos të hyjnë në aleancë me borgjezinë liberale, me demokristianët e me gjithë reaksionarët e tjerë.

Revizionistët evropianë, ndërsa kanë bërë çeshtje të përbashkët me imperializmin e borgjezinë monopoliste, me klikën e Titos, me krerët socialistë, demokristianë, katolikë dhe me të gjitha forcat reaksionare, në të njëjtën kohë janë hedhur në një sulm të tërbuar kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, gjithë partive marksiste-leniniste dhe forcave të shëndosha të komunistëve revolucionarë në partitë dhe në vendet e tyre. Ata kanë përkrahur pa rezerva gjithë veprimtarinë tradhtarë, antimarksiste, antisocialiste e përçarëse të Hrushovit e të grupit të tij dhe kanë ndërmarrë vetë shumë aksione që kanë minuar unitetin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Revizionistët evropianë kanë marrë sot

në dorë flamurin e turpshëm të luftës kundër marksizëm-leninizmit. Si revizionistë të tërbuar, përpara demaskimit dhe disfatës së tyre të pashmangshme, ata bile janë të vendosur ta çojnë këtë luftë deri në fund, ata kërkojnë, siç bëri P. Toliati në «testamentin» e tij, që të intensifikohet edhe më shumë lufta kundër marksizëm-leninizmit dhe të gjitha atyre partive e forcave që i qëndrojnë atij besnike, duke përdorur për këtë qëllim metoda më të rafinuara, më dinake e, sipas tyre, më efektive.

Me vijën dhe me veprimet e tyre oportuniste, tradhtare e përçarëse, revizionistët evropianë mbajnë gjithë përgjegjësinë për gjendjen e rëndë që është krijuar në lëvizjen komuniste botërore dhe sidomos për të këqijat e dëmet e mëdha që i kanë shkaktuar lëvizjes punëtore e komuniste evropiane. Përpara realitetit të hidhur, ata vetë janë të detyruar të pranojnë dështimin e tyre. Në Tezat për Kongresin e 10-të të PK të Italisë thuhet hapur:

«Në kompleks duhet, sidoqoftë, të pranojmë se klasa punëtore dhe masat punonjëse të Evropës Perëndimore dhe organizatat e tyre nuk kanë dhënë në vitet e fundit kontributin që do të kishte qenë i nevojshëm në luftën për demokraci, socializëm dhe paqe... Mbetet, sidoqoftë, si një fakt i përgjithshëm, pavarësisht nga mendimet për vende të veçanta, që klasa punëtore nuk ka ushtruar atë funksion politik drejtues që i përket, qoftë për peshën që i jep pozita e saj në fushën e zhvillimit të prodhimit, qoftë për rëndësinë e problemeve që kanë të bëjnë si me ekzistencën e saj imediate,

ashtu edhe me zhvillimin e demokracisë dhe ecjen drejt socializmit».

Këtë ide Toliati e shprehu dhe një herë në «testamentin» e tij. Ai thotë:

«Ne kemi qenë kurdoherë të mendimit se nuk është e drejtë ta paraqesim në mënyrë kryesisht optimiste lëvizjen punëtore e komuniste të vendeve perëndimore. Në këtë anë të botës, edhe në qoftë se aty-këtu janë bërë përparime, zhvillimi ynë dhe forcat tona janë edhe sot e kësaj dite të papërshtatshme për detyrat që na paraqiten».

Kjo gjendje e lëvizjes punëtore e komuniste evropiane nuk mund të shpjegohet në asnjë mënyrë me kushtet e rrethanat objektive «të papërshtatshme» të Evropës. Përveç faktorëve negativë, ka pasur e ka edhe shumë faktorë të tjerë, pozitivë, për zhvillimin me sukses të lëvizjes revolucionare në Evropë. Të tillë janë forcimi i mëtejshëm i vendeve socialiste dhe sukseset e tyre në të gjitha fushat, dobësimi i vazhdueshëm i sistemit imperialist, hovi i madh i lëvizjes nacionalçlirimtare dhe shthurja e sistemit kolonial, ashpërsimi i mëtejshëm i kontradiktave të jashtme e të brendshme, klasore e kombëtare në vendet kapitaliste etj. Prandaj shkaku i vërtetë i kësaj gjendjeje, që janë të detyruar ta njohin edhe revizionistët, nuk duhet kërkuar në kushtet objektive, por në radhë të parë e kryesisht në gjendjen e faktorit subjektiv, në faktin që udhëheqjet e shumë partive komuniste e punëtore të Evropës kanë shkarë në pozitat e oportunitizmit e të revizionizmit, janë larguar nga parimet e marksizëm-leninizmit, nga vija

revolucionare dhe janë futur në rrugën e socialdemokratizmit.

Por ç'masa e ç'hapa propozojnë revizionistët të ndërmarrin për ta nxjerrë lëvizjen punëtore e komuniste evropiane nga qorrrokaku ku ata vetë e kanë futur? Asnjë masë e hap pozitiv. Përkundrazi, ata kërkojnë dhe ngulin këmbë që të ndiqet më me vendosmëri ajo politikë që u formulua nga pozitat e Kongresit të 20-të të PK të BS, pozita të cilat bile, sipas tyre, u dashkan thelluar e zhvilluar më tej. E keqja, arsyetojnë ata, nuk e ka burimin te vija e Kongresit të 20-të, por te fakti që kjo vijë nuk po zbatohet akoma si duhet, nuk po vihet në jetë me tërë forcën dhe nga të gjitha partitë! Revizionistët italianë, si revizionistët më të avancuar, si flamurtarët e revizionizmit në Evropën Perëndimore, kërkojnë nga të gjithë që, për të dalë nga situata e vështirë, të ndiqet me konsekuencë «vija italiane» drejt socializmit që, siç e kemi treguar edhe herë të tjera, është vija e largimit flagrant nga mësimet e marksizëm-leninizmit mbi luftën e klasave, mbi revolucionin dhe mbi diktaturën e proletariatit, vijë e ngjashme si dy pika uji me vijën e predikuar dhe të ndjekur nga Bernstajni, Kautski, Titoja, socialdemokratët e djathtë dhe gjithë renegatët e tjerë të klasës punëtore. Revizionistët e shohin rrugën e daljes nga kriza, ku e kanë futur lëvizjen punëtore e komuniste perëndimore, në përpjekjet për të hyrë në aleanca me çdo kusht e me çdo çmim me borgjezinë liberale, intelektualët borgjezë, demokristianët, socialdemokratët e socialistët e djathtë, me qëllim që të krijohet ai bashkim i gjerë, ai «bllok i ri politik, që do t'u sigurojë atyre «fitoren në

zgjedhjet», «zgjerimin e kufijve të lirisë e të demokracisë», «ndryshimin e natyrës klasore të shtetit borgjez» dhe «kalimin paqësor në socializëm»!

Jo vetëm kaq. Po për të dalë nga gjendja e vështirë, për triumfin e vijës së tyre dhe për hir të aleancave me borgjezinë, me krerët socialdemokratë, demokristianë etj., revizionistët e Perëndimit kërkojnë nga kolegët e tyre në Lindje, dhe veçanërisht nga udhëheqësit sovjetikë, që t'u vijnë më shumë në ndihmë. Ata janë plotësisht dakord dhe i përshëndetin hapat që janë ndërmarrë në Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende të tjera socialiste për degjenerimin e rendit socialist nën maskën e «destalinizimit», të «demokratizimit» e të «liberalizimit». Por ata, ashtu siç deklaroi Toliati në «testamentin» e tij, janë të pakënaqur nga fakti që ky proces në këto vende po zhvillohet me ngadalë, me zigzage e me frenime. Prandaj revizionistët e Evropës Perëndimore kërkojnë nga revizionistët e vendeve ish-socialiste që ata të ecin me ritme më të shpejta në rrugën e degjenerimit kapitalist të socializmit e të afrimit me imperializmin, me qëllim që të japin shembullin e likuidimit të plotë «të anomalisë staliniane» dhe të krijojnë një socializmi «demokratik» e «liberal», i cili t'i heqë çdo frikë borgjezisë dhe të jetë i pranueshëm për të gjithë pseudodemokratët e botës. Revizionistët modernë, për të çuar deri në fund veprën e tyre tradhtarë, nuk ngurrojnë, pra, të sakrifikojnë vetë BRSS dhe vendet e tjera socialiste, të likuidojnë fitoret historike të socializmit në këto vende, që janë arritur me kaq luftë, përpjekje e sakrifica të mëdha.

Revizionistët evropianë, që ishin lidhur pas qerres:

së N. Hrushovit, e pritën me shqetësim të madh fundin e palavdishëm të kryetarit të tyre. Ata të gjithë, si në kor, shprehën keqardhjen dhe disaprovimin e tyre për rrëzimin e N. Hrushovit, kritikuan «metodat antidemokratike» që u përdorën për përjashtimin e tij nga organet udhëheqëse të partisë e të shtetit, kërkuan me këmbëngulje sqarime dhe bënë presion mbi udhëheqësit e sotëm sovjetikë që të ndjekin patjetër vijën e N. Hrushovit, të formuluar në kongreset e 20-të, të 21-të dhe të 22-të të PK të BS. Ata bile i kërcënuan hapur udhëheqësit sovjetikë se, po të largohen nga kjo vijë, nuk do të kenë mbështetjen e tyre. Konkluzioni që nxorën revizionistët evropianë nga dëbimi i N. Hrushovit është ai që e formuluan qartë revizionistët italianë se «në Bashkimin Sovjetik nuk janë likuiduar akoma deri në fund mbeturinat e kultit të individit», se «liria dhe demokracia janë akoma të kufizuara» dhe se prandaj duhet ecur përpara pa lëkundje e ngurrime në rrugën e demokratizmit liberalo-borgjez të rendit socialist. Dhe udhëheqësit e sotëm sovjetikë, bashkëpunëtorë të vjetër të N. Hrushovit, nxituan të qetësojnë revizionistët e të gjitha kallëpeve, nga janë e nga s'janë, se ata do të ndjekin pa u lëkundur dhe me besnikëri kursin e trashëguar nga shefi i tyre N. Hrushov.

I tillë është, në vija të përgjithshme, kursi politik, të tilla janë qëndrimet e veprimet, rrugët e perspektivat e revizionistëve evropianë. Të gjitha këto janë një dëshmi e gjallë e faktit të pamohueshëm se Evropa e sotme është mbarsur me revizionizëm.

Revizionistët — armiq të lëvizjes çlirimtare antiimperialiste të popujve

Revizionistët evropianë i akuzojnë partitë që mbrojnë me guxim parimet marksiste-leniniste se gjoja ato nënvleftësojnë dhe bile mohojnë rolin dhe rëndësinë e lëvizjes revolucionare në Evropë, se gjoja i kundërvënë asaj lëvizjen nacionalçlirimtare si të vetmen forcë revolucionare në kohën e sotme, se gjoja përpiqen ta izolojnë dhe ta shkëputin lëvizjen revolucionare e nacionalçlirimtare të Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine nga kampi socialist dhe lëvizja punëtore e vendeve të zhvilluara kapitaliste etj. Të gjitha këto u duhen revizionistëve për të vërtetuar se gjoja qendra e revolucionit botëror është Evropa dhe se të gjitha lëvizjet revolucionare e çlirimtare të vendeve të tjera duhet t'i nënshtrohen dhe të udhëhiqen nga Evropa revizioniste. Me të gjitha këto shpifje revizionistët përpiqen të ulin autoritetin, rolin dhe ndikimin gjithnjë më të madh të forcave marksiste-leniniste në vendet e Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine, të mbytin edhe në këto rajone frymën revolucionare, të shuajnë shpirtin luftarak, të largojnë popujt nga lufta dhe t'i lidhin pas qerres së imperializmit.

Është fakt i pamohueshëm se sot pikërisht në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine revolucionit po ecën përpara me hapa viganë. Këto rajone të botës janë sot hallkat më të dobëta të sistemit imperialist, këtu janë pleksur e janë acaruar të gjitha llojet e kontradiktave shoqërore, në këto vende po rritet nga dita në ditë hovi

i lëvizjes revolucionare, këtu i jepet sot goditja më e fortë dhe e drejtpërdrejtë imperializmit. Për këtë realitet dëshmojnë fakte e ngjarje të shumta: lufta heroike e popullit të Vietnamit të Jugut, të Kalimantanit Verior e të Laosit kundër agresorëve amerikanë e forcave reaksionare të brendshme dhe lëvizja e fuqishme antiimperialiste në Indonezi e Japoni, në vendet arabe e gjetkë në Azi; lufta në Algjeri, vala e luftës çlirimtare në Kongo, Angolë, Guinenë Perëndimore e në zona të tjera të Afrikës; në Kubë, Venezuela, Panama etj., në Amerikën Latine.

Revizionistët evropianë, që janë vënë në shërbim të borgjezisë monopoliste të vendeve të tyre dhe të imperializmit amerikan, janë shumë të shqetësuar nga hovi i luftës së popujve të Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine. Për të maskuar fytyrën e tyre të vërtetë dhe për të shtrirë ndikimin e tyre në këto vende, revizionistët nuk mungojnë që, ngandonjëherë, të bëjnë edhe ndonjë deklaratë apo të ndërmarrin ndonjë hap që, në pamjen e jashtme, duket se është në përkrahje të luftës së popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine. Por, po të studiohen politika dhe veprimtaria e tyre e përgjithshme, esenca e qëndrimit të tyre ndaj lëvizjes nacionalçlirimtare, del sheshit se revizionistët evropianë mbajnë ndaj saj një qëndrim krejt antimarksist, përhapin gjithfarë iluzionesh të dëmshme dhe kryejnë veprime të tilla që pengojnë e sabotojnë luftën e drejtë të popujve kundër imperializmit. Revizionistët deklarojnë se «regjimi kolonial është shembur gati plotësisht», se «vetëm rreth 50 milionë njerëz gjenden akoma nën sundimin kolonial», se «nuk ekzistojnë më në botë sfera

influence të imperializmit». Ata thonë se detyra kryesore e lëvizjes nacionalçlirimtare sot nuk është zhvillimi i mëtejshëm i luftës kundër imperializmit, kolonializmit të vjetër e të ri dhe shërbëtorëve të tyre, por «sigurimi dhe forcimi i pavarësisë ekonomike». Sipas tyre, shpëtimi i popujve të këtyre zonave nga të gjitha të këqijat do të vijë «nga bashkekzistenca paqësore e gara paqësore», «nga çarmatimi i plotë e i përgjithshëm», «nga ndihma jo vetëm e vendeve socialiste por edhe e vendeve të zhvilluara kapitaliste», «nga Organizata e Kombeve të Bashkuara» etj., etj. Përhapja e këtyre iluzioneve dëmton rëndë çështjen e çlirimit të popujve.

Revizionistët modernë kanë shkuar edhe më tej: ata jo vetëm përhapin iluzione në popujt për kolonizatorët imperialistë, por kanë ndërmarrë edhe veprime të drejtpërdrejta tradhtare ndaj luftës çlirimtare të popujve të shtypur. Tanimë dihen shumë mirë qëndrimet e revizionistëve hrushovianë ndaj luftës së drejtë të popullit algjerian, të cilën e shihnin si një çështje të brendshme të Francës, ndaj Kongos, kur votuan për dërgimin e trupave të OKB-së, ndaj Kubës në kohën e krizës së Karaibeve, kur u përpoqën t'i impononin asaj inspektimin «ndërkombëtar» të SHBA-së, ndaj lëvizjes revolucionare në Irak, kur, me këshillat e tyre e çuan atë në disfatë, ndaj agresionit të imperializmit amerikan kundër RD të Vietnamit, kur me gjysmë zëri shprehën «keqardhjen» e tyre etj., etj.

Pra, ndërsa marksistë-leninistët marrin në mënyrë të vendosur anën e lëvizjes nacionalçlirimtare, anën e kombeve dhe të popujve të shtypur dhe u japin atyre një përkrahje aktive e të gjithanshme, revizionistët ev-

ropianë marrin në fakt anën e imperialistëve e të kolonialistëve, kundërshtojnë lëvizjen nacionalçlirimtare të popujve, e pengojnë dhe e frenojnë atë. Por sido që të përpiqen revizionistët të ngrenë në qiell rolin e Evropës, sido që ta nënvleftësojnë e ta mohojnë rolin dhe rëndësinë e madhe të luftës së popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine, sado që ta pengojnë e ta sabotojnë këtë luftë dhe sido që të shpifin kundër saj, ata nuk do të mund ta ndryshojnë dot realitetin dhe lëvizja revolucionare e nacionalçlirimtare e këtyre rajoneve më të mëdha të botës do të marshojë përpara, duke sjellë fitore të reja për popujt dhe disfata të reja për imperialistët dhe për revizionistët. Qëndrimi i revizionistëve modernë ndaj luftës revolucionare të popujve të këtyre kontinenteve dëshmon qartë për tradhtinë e tyre ndaj gështjes së revolucionit botëror, për shovinizmin e tyre, për ndihmën që ata u japin imperialistëve dhe forcave reaksionare që të mbytin luftën e drejtë të popujve.

Lëvizja revolucionare nacionalçlirimtare e popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine është një lëvizje me rëndësi të madhe historike jo vetëm për fatet e popujve të këtyre kontinenteve, por edhe për fatet e të ardhmen e popujve të Evropës, për gjithë zhvillimin progresiv të njerëzimit. Duke i dhënë goditje të rënda imperializmit në prapavijat e tij, duke minuar forcën e tij dhe duke ngushtuar sferën e sundimit të tij, kjo lëvizje acaroi kontradiktat në vetë vendet e zhvilluara kapitaliste, shpejton zhvillimin e lëvizjes revolucionare në to dhe lehtëson luftën e klasës punëtore për përmbysjen e kapitalit. Nga zhvillimi me sukses i luftës së popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine,

që përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë së botës, varet në një shkallë vendimtare çështja e zhvillimit dhe e fitores së revolucionit në metropolet.

«Në fillim Marksii, shkruan Lenini, kishte menduar se Irlanda nuk do të çlirohej nga lëvizja kombëtare e kombit të shtypur, por nga lëvizja punëtore në gjirin e kombit shtypës...»

Por rrethanat e kanë bërë klasën punëtore angleze të bjerë për një kohë mjaft të gjatë nën influencën e liberalëve, të hiqet pas qerres së tyre dhe të trulloset nga politika punëtore liberale. Lëvizja çlirimtare borgjeze në Irlandë forcohet dhe merr forma revolucionare. Marksii e rishikon pikëpamjen e tij dhe e ndreq atë. «Është fatkeqësi për një popull robërimi i një populli tjetër». Klasa punëtore e Anglisë nuk do të çlirohet, derisa të mos jetë çliruar Irlanda nga zgjedha angleze. Robërimi i Irlandës e forcon dhe e ushqen reaksionin në Angli...»¹.

Duke parafrazuar fjalët e Leninit, mund të thuhet me plot gojën se edhe Evropa, që është mbarsur me revizionizëm, nuk do të mund të çlirohet nga zgjedha e kapitalit pa i shkaktuar disfatë të plotë revizionizmit modern dhe pa i bashkuar forcat e veta revolucionare me luftën çlirimtare antiimperialiste të popujve të shtypur të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine, pa fitoren e tyre vendimtare në këtë luftë.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 20, f. 504-505.

«Nga tërheqja në jetën politike e masave punonjëse të Lindjes, theksonte Lenini, varet tani në një shkallë shumë të madhe fati i tërë qytetërimi të perëndimor».

«... është krejt e qartë, ka shkruar gjithashtu Lenini, se në betejat e ardhshme vendimtare të revolucionit botëror, lëvizja e shumicës së popullsisë së lëmshit tokësor, e cila në fillim ka si qëllim çlirimin kombëtar, do të kthehet kundër kapitalizmit dhe imperializmit dhe, ndoshta, do të luajë një rol revolucionar shumë më të madh nga sa mendojmë ne»¹.

Edhe Stalini ka vënë në dukje se

«Vendet koloniale janë prapavijat kryesore të imperializmit. Revolucionarizimi i këtyre prapavijave nuk mund të mos e minojë imperializmin jo vetëm në kuptimin që imperializmi do të lihet pa prapavija, por edhe në kuptimin që revolucionarizimi i Lindjes duhet t'i japë një nxitje vendimtare acarimit të krizës revolucionare në Perëndim»².

Prandaj kush nuk mbështetet dhe nuk përkrah me të gjitha forcat e mjetet lëvizjen nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve të shtypur, ai nuk mbështet e nuk përkrah as lëvizjen revolucionare në vendin e vet.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 579-580.

2 J. V. Stalini. Veprat, vëll. 7, f. 232.

Janë fund e krye trillime e shpifje akuzat e revizionistëve hrushovianë se partitë marksiste-leniniste dhe gjithë komunistët revolucionarë mohojnë gjoja nevojën e lidhjes e të bashkimit të lëvizjes nacionalçlirimtare të popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine me luftën e vendeve socialiste dhe të klasës punëtore të vendeve të zhvilluara kapitaliste, se gjoja ato përpiqen ta shkëputin këtë lëvizje nga kampi socialist dhe nga klasa punëtore e vendeve kapitaliste. Marksistë-leninistët kanë qenë dhe janë të ndërgjegjshëm për nevojën e domosdoshme të bashkimit të të gjitha rrymave revolucionare në luftën kundër imperializmit, dhe sidomos për bashkimin e dy lëvizjeve më të mëdha të kohës sonë: lëvizjes socialiste dhe lëvizjes nacionalçlirimtare. Ashtu si vendet socialiste e klasa punëtore e vendeve kapitaliste kanë nevojë për ndihmën e përkrahjen e lëvizjes nacionalçlirimtare, ashtu edhe lufta e popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine ka nevojë për ndihmën e përkrahjen e vendeve socialiste e të klasës punëtore të vendeve kapitaliste. Ndihma dhe përkrahja nga ana e vendeve socialiste dhe e klasës punëtore të vendeve të zhvilluara kapitaliste është një faktor me shumë rëndësi për zhvillimin me sukses të lëvizjes nacionalçlirimtare, për thellimin e mëtejshëm të revolucionit në vendet koloniale e të varura, si dhe për futjen e këtyre vendeve në rrugën e socializmit.

Por popujt e vendeve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine kanë nevojë për ndihmë e përkrahje të vërtetë revolucionare. Kurse revizionistët hrushovianë dhe revizionistët e tjerë modernë jo vetëm nuk

i japin ndihmë e përkrahje efektive luftës çlirimtare e antiimperialiste të këtyre popujve, por përkundrazi, përpiqen me çdo mjet ta mbytin e ta frenojnë atë në favor të imperialistëve. Vija e revizionistëve evropianë është vija e nënshtrimit dhe e kapitullimit pa kushte ndaj imperializmit, vija e heqjes dorë nga idealet e lirisë, pavarësisë dhe revolucionit në emër gjoja të «paqes», «bashkekzistencës paqësore», «garës paqësore», «çarmatimit të plotë e të përgjithshëm». Ç'të mira mund t'u japë kjo vijë tradhtarë popujve që luftojnë për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror? Prandaj revizionizmi është bërë sot një rrezik i madh jo vetëm për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, por edhe për lëvizjen nacionalçlirimtare të popujve të botës. Pa luftuar kundër revizionizmit, kësaj pjelle dhe aleati të imperializmit, jo vetëm lëvizja revolucionare e klasës punëtore, por as lëvizja nacionalçlirimtare e popujve nuk mund të zhvillohet me sukses dhe të kurojëzohet me fitore.

Nuk janë marksistë-leninistët ata që ia kundërvënë lëvizjen nacionalçlirimtare lëvizjes së klasës punëtore të vendeve të zhvilluara kapitaliste, por janë pikërisht revizionistët hrushovianë ata që lëvizjen punëtore ia kundërvënë lëvizjes revolucionare nacionalçlirimtare të popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine, duke e konsideruar këtë të fundit një formë «më të ulët» e «jo krejt të kulluar» të lëvizjes revolucionare, janë ata që e paraqesin çështjen se lëvizja revolucionare në zonat e tjera «joproletare», ku «predominon popullsia mikroborgjeze», duhet të ndodhet nën «patronazhin» dhe «udhëheqjen» e lëvizjes punëtore evropia-

ne «me të vërtetë proletare» etj. Këtu kemi të bëjmë me një formë të re, të stërholluar e të maskuar me një frazeologji gjoja «proletare» e «marksiste», të shovinizmit të vjetër imperialist evropian, me një shfaqje të theksuar të ideologjisë imperialiste të «kombeve të larta», të cilat prej dhjetëra e dhjetëra vjetësh kanë sunduar mbi shumicën dërrmuese të popullsisë së botës, të zbritur në «kategorinë e ulët» të popujve «të egër» e «të pazhvilluar», «të paaftë për një veprimtari historike krijuese të pavarur». Pra, janë pikërisht revizionistët ata që i ndajnë popujt në «të lartë» e në «të ulët», në «të aftë» e në «të paaftë», në «udhëheqës» e në «të udhëhequr», që i ndajnë ata sipas ngjyrës së lëkurës e racave, duke shkarë kështu kokë e këmbë në pozitë e shovinizmit imperialist dhe të racizmit.

Ka ardhur koha që komunistët revolucionarë të ngrenë krye kundër tradhtisë, të mposhtin revizionizmin modern

Asnjë marksist-leninist serioz nuk e mohon dhe nuk mund ta mohojë rolin dhe rëndësinë e lëvizjes punëtore evropiane, meritat, traditat dhe eksperiencën e shquar revolucionare të saj, nga të cilat kanë mësuar e duhet të mësojnë patjetër të gjithë revolucionarët e botës. Por më kot mburren revizionistët evropianë me traditat revolucionare të Evropës. Ata i kanë tradhtuar këto tradita. Revizionistët e sotëm janë vazhduesit e drejtpërdrejtë të traditave më të këqija të lëvizjes punëtore e komuniste të Evropës, të traditave të Bern-

shtajnit e Kautskit, të Trockit e Buharinit, të Leon Blymit e Saragatit, të Brauderit e Titos. Bartës dhe vazhdues të traditave të mëdha revolucionare të Evropës janë marksistë-leninistët, komunistët revolucionarë që po ngrihen kudo në Evropë kundër oportunizmit dhe revizionizmit, kësaj plage të rëndë e sëmundjeje të vjetër për lëvizjen komuniste e punëtore evropiane.

Revizionizmi, me të cilin është mbarsur sot Evropa, nuk është i përjetshëm. Edhe në të kaluarën ka pasur periudha kur oportunizmi e revizionizmi janë bërë rryma sunduese në lëvizjen punëtore evropiane. Kjo ishte periudha e Internacionales së Dytë. Edhe atëherë borgjezia imperialiste evropiane fërkonte duart dhe propagandonte me të madhe se u varros marksizëm-leninizmi dhe mbaroi revolucioni në Evropë. Por nuk kaloi shumë kohë dhe gëzimi i borgjezisë shpejt u shndërrua në një hidhërim të madh për të. Në vend të partive oportuniste e reformiste, lindën parti të reja revolucionare të klasës punëtore, në vend të Internacionales të Dytë tradhtare u krijua Internacionalja e Tretë komuniste, në vend të oportunizmit e revizionizmit triumfoi marksizëm-leninizmi, në vend të zbaticës së revolucionit erdhi periudha e shpërthimeve të mëdha revolucionare, që filloi me Revolucionin Socialist të Tetorit.

Edhe gjendja e sotme e zbaticës së revolucionit në Evropë do të ndryshojë patjetër. Hovi i ri revolucionar është i pashmangshëm. Atë nuk mund ta ndalin as i ashtuquajturi lulëzim i përkohshëm i kapitalizmit evropian, as diktaturat borgjeze të tipit fashist, as demagogjia dhe veprimet tradhtare të revizionistëve hrushovianë, titistë e të tjerë. Duke analizuar shkaqet e

zbaticës, të «qetësisë» relative që u vu re në Evropë pas fitores së Revolucionit Socialist të Tetorit në Rusi dhe pas disfatës së revolucionit në disa vende të tjera, J. V. Stalini ka thënë:

«Ç'është zbatika e revolucionit, qetësia? A mos është vallë fillimi i mbarimit të revolucionit botëror, fillimi i likuidimit të revolucionit proletar botëror? Lenini ka thënë se, pas fitores së proletariatit në vendin tonë, filloi një epokë e re, epoka e revolucionit botëror, epokë e mbushur plot konflikte dhe luftëra, sulme e tërheqje, fitore e disfata, epokë që shpie në fitoren e proletariatit në vendet kryesore të kapitalizmit. Në qoftë se filloi zbatika e revolucionit në Evropë, a do të thotë kjo vallë se teza e Leninit mbi epokën e re, mbi epokën e revolucionit botëror e humbet, si rrjedhim, fuqinë e vet? A do të thotë kjo vallë se, si rrjedhim, u la mënjanë revolucioni proletar në Perëndim?»

Jo, nuk do të thotë.

Epoka e revolucionit botëror është një etapë e re e revolucionit, është një periudhë e tërë strategjike, që përfshin një sërë të tërë vjetësh, dhe ndoshta dhjetëra vjetësh. Gjatë kësaj periudhe mund të ketë dhe duhet të ketë zbatika dhe batica të revolucionit»¹.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 91-92.

Dhe pasi e vërteton këtë me eksperiencën e revolucionit rus deri në fitoren e Revolucionit të Tetorit e pas tij, Stalini vazhdon:

«Ç'tregojnë këto lëkundje? A tregojnë ato se teza e Leninit mbi epokën e re të revolucionit botëror e ka humbur apo mund ta humbë rëndësinë e saj? Sigurisht, jo! Ato tregojnë vetëm se revolucioni, zakonisht, nuk zhvillohet në vijë të drejtë e përpjetë, duke u ngjitur dhe rritur vazhdimisht, por nëpërmjet zigzageve, nëpërmjet sulmeve e tërheqjeve, nëpërmjet baticave dhe zbaticave, të cilat, gjatë zhvillimit farkëtojnë forcat e revolucionit dhe përgatitin fitoren e tij përfundimtare.

Ky është kuptimi historik i fazës së zbatimit të revolucionit, që ka filluar tani, ky është kuptimi historik i qetësisë që po kalojmë sot»¹.

Por eksperiencia historike ka treguar dhe tregon se novi i lëvizjes revolucionare të klasës punëtore nuk vjen vetvetiu. Për këtë duhet luftuar e duhet punuar çdo ditë. Pengesa kryesore në rrugën e revolucionit sot në Evropë është revizionizmi hrushovian i cili ka mbytur hovin revolucionar, ka paralizuar vullnetin dhe shpirtin luftarak të klasës punëtore dhe të gjithë punonjësve evropianë, i ka larguar partitë komuniste të Evropës nga rruga revolucionare. Prandaj, pa një luftë të vendosur e parimore kundër oportunitizmit dhe revizioniz-

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 94.

mit të sotëm hrushovian në të gjitha format e shfaqjet e tij, nuk mund të çlirohet lëvizja punëtore evropiane dhe pararoja e saj, partitë komuniste, nga influenca e tij, nuk mund të krijohet një lëvizje punëtore me të vërtetë revolucionare dhe nuk mund të çohet në fitore çështja e madhe e klasës punëtore.

Komunistët evropianë kanë në këtë drejtim një eksperiencë të pasur historike. Klasikët e marksizëm-leninizmit, gjatë gjithë jetës së tyre revolucionare, kanë bërë një luftë të papajtueshme me të gjitha rrymat antimarksiste, kanë kërkuar kurdoherë ndarjen e prerë me oportunistët, kanë luftuar për një unitet të vërtetë parimor të lëvizjes komuniste e punëtore. Në letrën drejtuar punëtorëve gjermanë e francezë më 24 shtator 1920, Lenini shkruante:

«Oportunizmi përfaqësohet nga elementët e aristokracisë punëtore», e burokracisë së vjetër të bashkimeve profesionale, të kooperativave etj., nga shtresat e intelektualëve mikroborgjezë etj. Pa e flakur jashtë këtë rrymë, e cila në të vërtetë, me lëkundjet e saj, me «menshevizmin» e saj... çon influencën e borgjezisë te proletariati nga brenda lëvizjes punëtore, nga brenda partive socialiste, pa e flakur jashtë këtë rrymë, pa u përçarë me të, pa i përjashtuar të gjithë përfaqësuesit e saj të shquar, është i pamundur bashkimi i proletariatit revolucionar...

Ka ardhur koha të flaken përfundimisht të gjitha këto iluzione shumë të dëmshme mbi mundësinë e «unitetit» ose të «pages» me Dit-

manët dhe Krispinët, me krahun e djathtë të «Partisë Socialdemokrate të Pavarur» të Gjermanisë, të «Partisë Punëtore të Pavarur» të Anglisë, të «Partisë Socialiste të Francës» etj. Ka ardhur koha që gjithë punëtorët revolucionarë t'i spastrojnë partitë e tyre nga këta elementë dhe të formojnë partitë komuniste me të vërtetë të bashkuara të proletariatit»¹.

Luftën kundër oportunizmit dhe reformizmit, ndaj rjen e qartë e të prerë prej tyre, Lenini e konsideronte si kusht të domosdoshëm për pjesëmarrjen në Internacionalen Komuniste dhe për vetë ekzistencën e saj.

«Partitë që dëshirojnë të bëjnë pjesë në Internacionalen Komuniste, thuhet në kushtet e pranimit në Komintern të hartuara nga Lenini, kanë për detyrë të pranojnë nevojën e domosdoshme të prerjes së plotë dhe absolute të marrëdhënieve me reformizmin dhe me politikën e «qendrës» dhe ta propagandojnë këtë gjë në rrethet më të gjera të anëtarëve të partisë. Po nuk u bë kjo, është e pamundur të zbatohet politika komuniste konsekuente»².

Në kushtet thuhet gjithashtu:

«Secila organizatë, që dëshiron të bëjë pjesë në Komintern, ka për detyrë të largojë rregullisht dhe sistematikisht nga postet pak a shumë me

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 312-313.

2 Po aty, f. 227.

përgjegjësi në lëvizjen punëtore (organizata e partisë, redaksia, bashkimet profesionale, fraksioni parlamentar, kooperativa, bashkia etj.) reformistët dhe partizanët e «qendrës» dhe të caktojë në vend të tyre komunistë besnikë — duke mos u trembur se nganjëherë do të jetë nevoja në fillim të zëvendësohen udhëheqës «me eksperiencë» me punëtorë të thjeshtë»¹.

Duke folur për luftën parimore e të vendosur të Leninit kundër oportunitizmit të ngjyrave të ndryshme, Stalini ka thënë:

«Çdo bolshevik, në qoftë se është me të vërtetë bolshevik, e di se Lenini shumë kohë përpara luftës, afërsisht që prej 1903-1904, kur u formua në Rusi grupi i bolshevikëve dhe kur u dukën për herë të parë të majtët në socialdemokracinë gjermane, ndiqte vijën e ndarjes, e prishjes me oportunistët edhe ndër ne, në Partinë Socialdemokrate të Rusisë, edhe atje në Internacionalen e Dytë, sidomos në socialdemokracinë gjermane.

Çdo bolshevik e di se pikërisht për këtë arsye bolshevikët qysh atëherë (1903-1905) fituan në radhët e oportunistëve të Internacionales së Dytë famën e lavdishme si «përçarës» dhe «çorganizues»².

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 226.

2 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 83.

Duke u qëndruar besnikë këtyre traditave revolucionare dhe duke u frymëzuar nga to, marksistë-leninistët e Evropës janë ngritur e po ngrihen gjithnjë më shumë në një luftë të madhe historike për ta çliaruar Evropën nga kthetrat helmuese të revizionizmit hrushovian.

Këtë luftë të vendosur kundër tradhtisë së madhe të revizionistëve modernë e lypin e sotmja dhe e ardhmja e socializmit dhe komunizmit, e lypin interesat jetike të klasës punëtore e të popujve të mbarë botës, e lypin nderi dhe dinjiteti revolucionar i proletariatis evropian. Sot më tepër se kurrë është vënë me forcë të madhe në rendin e ditës lufta për mbrojtjen e bazave të marksizëm-leninizmit, të partive revolucionare komuniste, të vetë ekzistencës së socializmit në një varg vendesh evropiane.

Imperialistët dhe revizionistët hrushovianë po përpiqen të shuajnë krejtësisht frymën revolucionare në Evropë dhe ta bëjnë Evropën, bashkë me Amerikën e Veriut, kështjellë të reaksionit politik e ideologjik për mbytjen e lëvizjes revolucionare e të mendimit revolucionar në mbarë botën. Por ata nuk do t'ia arrijnë kurrë qëllimit të tyre. Evropa e Marksit, Engelsit, Leninit dhe e Stalinit, Evropa e Internacionales Komuniste, Evropa e Komunës heroike të Parisit dhe e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, e luftës së Spanjës dhe e Rezistencës Antifashiste ka forca dhe energji revolucionare të pashtershme, të cilat nuk kanë vdekur e nuk kanë për të vdekur kurrë. Në lëvizjen komuniste e punëtore në Evropë gjenden forca kolosale marksistë-leniniste. Ato janë kurdoherë të gjalla, ato luftojnë çdo

ditë më të vendosura, më me fuqi. Në shumë vende, si në Itali, Francë, Angli, Austri, Spanjë, Portugali, Zvicër, Holandë, SHBA e gjetkë, ato janë organizuar tani më në parti e grupe marksiste-leniniste, ato ekzistojnë, rezistojnë e luftojnë kudo, bile edhe brenda në ato parti komuniste e punëtoje evropiane në krye të të cilave qëndrojnë sot pasuesit e grupit të Hrushovit.

Në situatën e sotme të vështirë, kur Evropa është bërë kështjella e revizionizmit modern, marksistë-leninistët në Evropë e në Amerikën e Veriut nuk e shohin gjendjen me pesimizëm dhe nuk e ndiejnë veten të izoluar. Në lëvizjen komuniste ndërkombëtare ekziston sot një unitet i pathyeshëm i marksistë-leninistëve të të gjithë botës. Marksistë-leninistët evropianë janë të bashkuar si një trup i vetëm me partitë marksiste-leniniste dhe me marksistë-leninistët revolucionarë në gjithë botën, sepse nuk mund të shkëputet Evropa nga kontinentet e tjera, sepse lëvizja revolucionare e komuniste në Evropë është pjesë e pandarë, e rëndësishme dhe e denjë e lëvizjes revolucionare e komuniste botërore. Lufta e marksistëve revolucionarë të Evropës e të Amerikës së Veriut, si pjesë përbërëse e luftës së të gjithë komunistëve të botës, ka sot një rëndësi të veçantë ndërkombëtare, sepse ata militojnë brenda në kështjellën e revizionizmit modern dhe kjo kështjellë duhet minuar e duhet hedhur në erë, duhet bërë hi e pluhur.

Revizionistët lëshojnë kundër forcave të shëndosha marksiste-leniniste në Evropë gjithfarë trillimesh e epitetesh, përpiqen me gjithfarë mjetesh të paralizojnë veprimtarinë e tyre revolucionare dhe të mbytin zërin

e tyre, sepse në rritjen e këtyre forcave revizionistët shohin me tmerr disfatën dhe fundin e tyre të pashmangshëm. Nuk duhen lejuar revizionistët t'ua arrijnë këtyre qëllimeve antimarksiste e regresive. Përballë forcës propagandistike dhe organizimit të revizionistëve, të cilat ata i gjetën të gatshme në partitë komuniste e punëtore dhe i shfrytëzuan për qëllimet e veta tradhtarë, marksistë-leninistët në Evropë vënë forcën e tyre të organizuar, legale dhe ilegale, punën e tyre brenda dhe jashtë partisë, duke ngritur e duke forcuar grupe e parti të reja marksiste-leniniste, duke luftuar brenda në partitë për ruajtjen e parimeve që po shkelen nga revizionistët, kundër taktikave revizioniste, për të ngushtuar sferën e veprimtarisë së revizionistëve, për të demaskuar vijën dhe qëllimet e tyre, për t'i izoluar ata nga masa e komunistëve dhe për t'i shpartalluar përfundimisht.

Në mënyrë të veçantë marksistë-leninistët duhet të jenë vigjilentë përballë «qetësisë», «heshtjes» që po përpiqen të ruajnë revizionistët hrushovianë që janë në fuqi në Bashkimin Sovjetik. Udhëheqja e sotme revizioniste sovjetike gjendet në pozita shumë të vështira, për arsye të telasheve që i ka krijuar rrëzimi i Hrushovit. Vështirësitë ekonomike, të shkaktuara nga politika dhe metodat antimarksiste hrushoviane, likuidimi i qindra mijë kuadrove të shëndoshë revolucionarë në parti e në shtet, shpifjet e ndyra kundër jetës dhe veprës së Stalinit, kundër rendit socialist, diktaturës së proletariatit, politika e kapitullimit dhe e nënshtrimit të turpshëm para imperializmit, që ka diskredituar autoritetin e prestigjin e Bashkimit Sovjetik, afrimi e ale-

ancat me imperializmin amerikan dhe forcat e ndryshme reaksionare në dëm të interesave të vetë Bashkimit Sovjetik, të kampit socialist e të popujve, vija shoviniste e përçarëse e grupit hrushovian ndaj lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare, sulmet e egra dhe qëndrimet armiqësore ndaj Shqipërisë, gjithë kurssi revizionist e tradhtar i N. Hrushovit, të cilin po e ndjek me këmbëngulje udhëheqja e sotme sovjetike, ka ngjallur pakënaqësinë e thellë të komunistëve e të popujve sovjetikë, u hapi sytë miliona njerëzve që u hutuan në fillim dhe i bëri të ndërgegjeshëm në luftën kundër revizionizmit, shkaktoi kundërshtimin e vendosur dhe luftën parimore të marksistë-leninistëve në të gjitha vendet. Marksistë-leninistët revolucionarë të Bashkimit Sovjetik po zgjohen dhe po bëjnë një luftë aktive e vendimtare në të gjitha frontet kundër udhëheqjes revizioniste hrushoviane. Nga ana tjetër, me politikën e tij të diktatit, të nënshtrimit ndaj «shkopit të dirigjentit», N. Hrushovi shkaktoi në aleatët e vet, në grupimet revizioniste, të çara serioze, prirje për t'u shkëputur nga Bashkimi Sovjetik, tendenca për të qenë sa më të pavarur dhe për t'u afruar më lirisht me imperializmin e borgjezinë, gjë që ka dëmtuar rëndë jo vetëm autoritetin e prestigjin e udhëheqjes revizioniste sovjetike, por edhe i ka shkaktuar vështirësi të reja ekonomike Bashkimit Sovjetik. Tani udhëheqja e sotme sovjetike po kalon një fazë tranzitore për të gjetur një rrugëdalje, për të përcaktuar një taktikë të re, me qëllim që të evitojë luftën dhe goditjet nga ana e marksistë-leninistëve, të afirmojë vijën e vet revizioniste të pandryshueshme dhe të ruajë miqtë e vet, në

mos nën drejtimin e drejtpërdrejtë si më parë, të paktën të mos lejojë që ata të zhvillojnë një politikë të pavarur nga udhëheqja sovjetike, pa e pyetur fare këtë të fundit.

Pikërisht kjo pozitë e vështirë, kontradiktore, ka përcaktuar situatën e «heshtjes» apo të «qetësisë» që përpiqen të ruajnë udhëheqësit e sotëm sovjetikë. Ata, në dukje, përpiqen ta paraqesin veten si më të moderuar se shefi i tyre N. Hrushov, duke lënë përshtypjen iluzore se mund edhe të ndreqen, ndërsa në realitet vazhdojnë me këmbëngulje vijën e mëparshme hrushoviane.

Një periudhë e tillë «qetësie» dhe «heshtjeje» u intereson imperialistëve e revizionistëve dhe dëmton lëvizjen komuniste, çështjen e marksizëm-leninizmit e të socializmit, për arsye se revizionistët në këtë periudhë përpiqen të forcojnë pozitën e tyre për të goditur më me ashpërsi marksizëm-leninizmin. Nga ana tjetër, në këtë situatë «qetësie» imperializmi, sidomos ai amerikan, vazhdon të jetë shumë aktiv në marrëdhëniet e tij me revizionistët dhe ushtron ndaj tyre një presion të gjithanshëm, për t'i detyruar të bëjnë lëshime të reja e të afrohen me imperializmin, kurse udhëheqësit sovjetikë, duke përfituar nga situata e «heshtjes», po rivendosin të gjitha lidhjet e marrëveshjet që kishte Hrushovi me imperialistët, nga të cilat ata asgjë s'kanë prishur dhe asnjëherë nuk kanë hequr dorë. Prandaj marksistë-leninistët, komunistët revolucionarë nuk duhet të gënjejnë nga manovrat dhe taktikat e reja të revizionistëve hrushovianë, nuk duhet të bien në grackën e «heshtjes» që kanë ngritur ata,

nuk duhet të kenë asnjë iluzion ndaj udhëheqjes së sotme revizioniste sovjetike dhe as ta konfundojnë këtë me Bashkimin Sovjetik, me popujt revolucionarë sovjetikë, por të vazhdojnë në mënyrë konsekuente e pa lëkundje luftën parimore për demaskimin e revizionizmit modern.

Lufta kundër revizionizmit të sotëm në djepin e tij, në Evropë, nuk është një luftë e lehtë, ajo lyp për-pjekje të mëdha e sakrifica. Por asnjëherë komunistët dhe revolucionarët e vërtetë nuk i kanë kursyer ato për çështjen e madhe, asnjëherë ata nuk janë trembur e zbrapsur para armikut edhe në kohët e reaksionit më të zi, të barbarisë fashiste. Ka ardhur koha që komunistët revolucionarë të ngrenë krye kundër tradhtisë, të mposhtin revizionizmin modern, të krijojnë unitetin e mëparshëm marksist-leninist-stalinian të të gjithë komunistëve të botës, që i solli kaq fitore proletariatit, që forcoi pozitën e socializmit e të komunizmit në botë dhe u dha goditje vdekjeprurëse imperializmit e reaksionit në gjithë botën. Dikur Lenini i madh shkruante se

«... nga pikëpamja e zhvillimit të revolucionit ndërkombëtar kalimi nga çartizmi të Hendersonët, që sillen si servilë përpara borgjezisë, ose nga Varleni të Renodeli, ose nga Vilhelm Libknehti dhe Bebeli të Zydekumi, Shejdemani e Noske (dmth nga revolucionarët të oportunistët e tradhtarët — red.) s'është gjë tjetër veçse diçka që i përngjet «kalimit» të një automobili nga një rrugë e lëmuar dhe e rraf-

shtë prej qindra verstash në një pellg të ndyrë, të qelbur po në këtë rrugë, në një pellg prej disa kutësh»¹.

Nuk ka as dyshimin më të vogël se edhe në kohën e sotme kalimi nga periudha revolucionare e Stalinit te renegati Hrushov dhe trashëgimtarët e pasuesit e tij është gjithashtu një gropë e tillë prej disa kutësh plot baltë të ndyrë në bulevardin e madh e të ndritur të revolucionit proletar, që do të shpjerë në mënyrë të pashmangshme në fitoren e plotë e përfundimtare të socializmit e të komunizmit në mbarë botën. Revizionizmi hrushovian është një plagë e shëmtuar në trupin e shëndoshë të lëvizjes revolucionare e komuniste evropiane e ndërkombëtare, e cila duhet qëruar dhe do të qërohet me një operacion të guximshëm nga komunistët revolucionarë. Revizionizmi modern do të falimentojë me turp në mënyrë të pashmangshme, ashtu siç kanë falimentuar edhe paraardhësit e tij në të kaluarën.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 4 (5100), 6 janar 1965

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 102. Tiranë, 1965

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 389.

**DREJTUES DHE UDHËHEQËS I ÇDO PARTIE ËSHTË
MARKSIZEM-LENINIZMI DHE JO SHKOPI
I DIRIGJENTIT TË HRUSHOVIT**

*Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste
të Malajës*

20 janar 1965

Pasi shkëmbyen përshëndetjet e rastit dhe mysafirët zunë vend, fjalën e merr shoku Enver Hoxha:

Partia jonë ka një konsideratë të lartë për partinë tuaj, sepse është një parti marksiste-leniniste revolucionare. Solidariteti internacionalist i saj ka qenë një ndihmë e madhe për ne, sidomos pas Mbledhjes së Moskës më 1960. Partia Komuniste e Malajës ka luftuar dhe lufton në kushte të vështira kundër imperializmit japonez, anglez, kundër reaksionit malez, si edhe kundër revizionizmit modern. Ne kemi bërë, po bëjmë dhe do të na duhet të bëjmë akoma përpjekje të mëdha kundër të gjithë armiqve dhe partitë tona, të udhëhequra nga marksizëm-leninizmi, do t'i mundin ata dhe me luftë e me përpjekje do t'i kapërcejnë të gjitha vështirësitë.

Revizionizmi modern krijoi vështirësi shumë se-

riozë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe përgjithësisht në zhvillimin e ngjarjeve në botë, për arsye se ai u zhvillua në vendin e parë socialist në botë, në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik si dhe në partitë komuniste e punëtore të Evropës. Vetëm në Partinë e Punës të Shqipërisë dhe në Shqipëri nuk zuri vend dhe kurrë nuk do të zërë vend revizionizmi.

Brenda një kohe dhjetëvjeçare, gjer në njëfarë shkalle, revizionistët modernë mundën të orientonin politikën e këtyre shteteve drejt vartësisë nga imperia-lizmi amerikan, të zhvillonin një fushatë të egër anti-marksiste kundër Shqipërisë socialiste dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, si dhe kundër të gjitha partive të tjera marksiste-leniniste. Por në këtë luftë që bënë, ata nuk arritën dot suksesin që shpresonin. Përkundrazi gjatë kësaj periudhe të shkurtër ata u luftuan seriozisht nga Partia jonë, nga partitë e tjera marksiste-leniniste dhe nga të gjithë revolucionarët e botës. Tani ne mund të themi se revizionizmi modern hrushovian dhe ai titist janë demaskuar, po nuk e kanë humbur akoma fuqinë dhe influencën e tyre. Megjithatë demaskimi që i është bërë revizionizmit ka krijuar për të një situatë të vështirë dhe ai ka marrë tatëpjetën. Në radhët e revizionistëve modernë janë krijuar të çara dhe nuk ekziston më ai unitet mendimesh siç ndodhte në fillim, kur ata nisën haptazi luftën kundër marksizëm-leninizmit.

Revizionistët modernë nuk kishin dhe nuk mund të kishin një bazë politike të drejtë, qoftë të brendshme, qoftë ndërkombëtare, sepse parimet mbi të cilat ata kanë zhvilluar dhe zhvillojnë politikën e tyre janë an-

timarksiste. Politika që ndjekin ata ka qenë dhe është kapitulluese, e shoqëruar me një demagogji të madhe. N. Hrushovi, me demagogjinë e tij synonte të krijonte përshtypjen se Bashkimi Sovjetik dhe kampi socialist kishin arritur një zhvillim dhe forcë kolosale të tillë sa vetëm me fjalë mund t'i bëhej ballë veprimtarisë armiqësore të imperialistëve. Kjo demagogji bëhej me qëllim që të mbulohej tradhtia dhe veprimtaria armiqësore e Hrushovit me shokë. Por revizionistët modernë i bënin llogaritë dhe planet e tyre pa pasur parasysh kundërgoditjen e marksistë-leninistëve. Prandaj, kur filloi kundërgoditja nga Partia jonë dhe nga partitë e tjera marksiste-leniniste, e gjithë kjo «kështjellë», e ndërtuar prej revizionistëve mbi demagogjinë dhe aleancën e shenjtë me imperializmin në të gjitha çështjet, u trondit.

Është fakt se rënia e Hrushovit nga fuqia është pasojë e luftës së marksistë-leninistëve. Kjo e ka futur revizionizmin modern në një situatë të vështirë dhe e detyron të bëjë përpjekje për të gjetur një rrugëdalje. Një nga metodat e luftës aktuale të revizionistëve kundër nesh konsiston në pushimin e polemikës dhe të luftës. Ata dëshirojnë dhe synojnë të pushohet polemika, sepse e panë që lufta e partive tona është mbi baza të shëndosha, i ka demaskuar keq dhe nuk i ka lënë rehat të veprojnë dhe të realizojnë planet e tyre. Si rrjedhim i kësaj lufte, kudo ku kanë vepruar, revizionistët modernë kanë zbuluar fytyrën e tyre të vërtetë antimarksiste e kundërrevolucionare në sytë e komunistëve dhe të popujve të të gjithë botës. Prandaj të gjitha përpjekjet e tyre tani janë drejtuar që ne ta pushojmë pole-

mikën dhe të mos i godasim më pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre tradhtarë.

Të gjithë revizionistët modernë duhet ta kenë të qartë se që ne të arrijmë të mendojmë për pushimin ose jo të polemikës, paraprakisht duhet që të pranojnë e të thonë haptazi se kanë gabuar në gjithë vijën e tyre. Një gjë të tillë ata nuk e bëjnë dhe as do ta bëjnë. Prandaj lufta kundër tyre, lufta në mes të marksistë-leninistëve dhe tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, revizionistëve modernë, vazhdon dhe do të vazhdojë pa ndërprerje, në favor të marksizëm-leninizmit.

Revizionistëve modernë u ka mbetur në mendje të bëjnë një mbledhje ndërkombëtare. Këtë ata e kërkojnë posaçërisht me qëllim që të gënjejnë dhe të vënë në gjumë opinionin e komunizmit ndërkombëtar, për t'u thënë komunistëve kudo se gjoja jemi duke biseduar, me qëllim që të arrihet njëfarë heshtjeje për ta vazhduar më lehtë punën e tyre tradhtarë. Ne e dimë që ata janë tradhtarë dhe, sikurse na mëson Lenini, me tradhtarët duhet t'i kemi të ndara hesapet. Lenini në kohën e tij i ndau mirë kufijtë me oportunistët e me revizionistët, gjë që solli si pasojë forcimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare në botë. Prandaj edhe ne, duke ndjekur vijën e drejtë marksiste-leniniste, duhet t'i lajmë mirë hesapet me revizionistët modernë, gjë që do t'i sjellë një forcim të mëtejshëm lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ky është ligj. Revizionistët modernë duan ta bëjnë mbledhjen në muajin mars, por Partia jonë, ashtu si shumë parti të tjera, nuk pranon të vejë atje me kushtet që kërkojnë ata. Mbledhja e vërtetë, sikurse e kuptojmë ne, ka një qëllim — të for-

cohet uniteti marksist-leninist i lëvizjes komuniste ndërkombëtare, kurse mbledhja që kërkojnë të bëjnë revizionistët, është mbledhje tradhtarësh dhe përçarësish të këtij uniteti, prandaj në refuzojmë të vemi. Kjo do të thotë që ne të ecim kurdoherë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste në të gjitha çështjet, kombëtare dhe ndërkombëtare, të lëvizjes komuniste dhe të problemeve botërore. Duke ndjekur këtë rrugë ne as kemi rënë dhe as nuk biem kurrë në ujdi me revizionistët modernë, me këta tradhtarë, që janë lidhur në kauzë të përbashkët me imperializmin amerikan dhe me gjithë kapitalizmin botëror.

Në situatat e dëshpëruara që po kalon, imperializmi amerikan, në aleancë të ngushtë me agjenturën e vet, revizionizmin modern, po bën të gjitha përpjekjet për të goditur luftërat çlirimtare të popujve, partitë tona dhe krejt lëvizjen marksiste-leniniste. A mundet të heshtim ne ndaj veprimeve e qëllimeve të këtyre armiqve të betuar?

Jo, Partia jonë mendon se nuk duhet ndalur lufta kundër revizionizmit modern, në radhë të parë kundër revizionistëve hrushovianë dhe titistë dhe nuk duhen pranuar propozimet e tyre për mbledhje. Ky është një qëndrim shumë i drejtë me të cilin ne demaskojmë dhe pengojmë realizimin e qëllimeve të tyre. Mosvajtja jonë në mbledhjen që duan të bëjnë revizionistët në muajin mars është pjesë e luftës që ne i bëjmë revizionizmit modern.

Lufta e vazhdueshme ideologjike dhe politike që ne u bëjmë revizionistëve modernë për shkatërrimin e planeve të tyre (se ata kanë edhe plane të tjera, të ci-

lat ne do t'i shohim gjatë përpjekjeve të tyre për t'i vënë në jetë), do t'u shkaktojnë atyre disfata. Kjo është e natyrshme. Por çfarë disfatash? Ja, për shembull, si ajo që pësuan ata me heqjen e Hrushovit, gjë që është një humbje e madhe për revizionizmin. Partia jonë duke u bazuar në situatat ndërkombëtare që po zhvilloheshin, në grushtet e disfatat që hanin hrushovianët dhe në dobësimin e pozitave të Hrushovit, 10 ditë para se të rrëzohej Hrushovi, botoi një Letër të Hapur drejtuar anëtarëve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Me këtë letër i njoftonim ata se ne nuk kishim të bënim me klikën hrushoviane dhe u bënim thirrje komunistëve dhe popullit sovjetik të shihnin ç'ishte ky renegat. Rrëzimi i tij ishte një disfatë për revizionizmin modern, kurse për marksistë-leninistët ishte më i mirë nga vdekja e tij se, po të kishte vdekur, revizionistët do ta bënin hero.

Ne kemi shpresë dhe bindje se të tilla disfata atyre do t'u ndodhin edhe në të ardhmen që do të duken jo vetëm në arenën ndërkombëtare, por edhe brenda partive dhe shteteve të tyre, duke i vënë klikat revizioniste në pozita të vështira. Ne shpresojmë se lufta e marksistë-leninistëve, që ka për qëllim të mposhtë kundërvolucionin e revizionistëve, do të ndihmojë që të krijohen kushte më të favorshme për këtë qëllim. Ne do t'i krijojmë dhe do t'i studiojmë gjithë ato kushte që përbëjnë një faktor me rëndësi për realizimin e qëllimeve tona. Baza e fitoreve tona për shkatërrimin e revizionizmit modern është vazhdimi në çdo rrethanë i luftës sonë ideologjike dhe politike me tradhtarët e marksizëm-leninizmit.

Në Deklaratën e Moskës të vitit 1960 thuhet se për mbledhjet ndërkombëtare të partive komuniste e punëtoresh duhen bërë konsultime dypalëshe, shumëpalëshe etj. Ne jemi pro kësaj pike të Deklaratës dhe e mbrojmë atë edhe në këto situata. Por dihet se për mbledhjen duhet një përgatitje e madhe. Të thuash vetëm që duhet përgatitur është një anë, por ana tjetër, dhe më e rëndësishmja, është që të thuhet edhe se ç'duhet bërë. Partia jonë e ka thënë qartë mendimin e saj se si duhet vepruar dhe ç'përgatitje duhen bërë. Ajo është e mendimit se çështja e përgatitjes së një mbledhjeje të tillë nuk mund të zgjidhet nga dy parti, se ajo nuk është diçka e thjeshtë, por një punë shumë e komplikuar. Ne mendojmë se ajo ka të bëjë edhe me centralizmin demokratik, me frymën organizative dhe ideologjike të partive. Unë, fjala vjen, që do të vete në Moskë, ose atje ku do të bëhet mbledhja, duhet të kem për këtë edhe aprovimin e masës së Partisë që përfaqësoj. Për këtë qëllim Partia duhet të jetë në dijeni të plotë të pikëpamjeve të secilës parti që merr pjesë në mbledhje. Prandaj ajo kërkon që masa e komunistëve në çdo parti të marrë në dorë dokumentet dhe materialet e partive të tjera për t'i studiuar, për të marrë vendim dhe për t'i dhënë mendime Komitetit Qendror të Partisë mbi qëndrimin që duhet të mbajë në mbledhje përfaqësuesi i partisë së vet. Partia jonë i ka vënë në dijeni anëtarët e saj mbi materialet dhe pikëpamjet e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të të gjitha partive të tjera ku sundojnë revizionistët, kurse këta ia kanë fshehur masës së partisë së tyre materialet bazë dhe pikëpamjet e Partisë sonë. Revizio-

nistët nuk e bëjnë këtë, sepse kanë frikë nga masa e partisë. Mirëpo, pa bërë një punë të tillë përgatitore, e cila kërkon vite të tëra përpjekjesh këmbëngulëse, nuk mund të shkohet në mbledhje, sepse edhe sikur të bëhet mbledhja, kjo do të ishte një punë e kotë dhe vetëm në interes të revizionistëve.

Kështu ka menduar Partia jonë për përgatitjen e mbledhjes. Po të bëhet një përgatitje e tillë, atëherë do të ketë dhe rezultate dhe nga ana tjetër, gjatë kohës që do të bëhen përgatitjet, lufta jonë do t'i ketë goditur keqas revizionistët modernë dhe do t'u ketë shkaktuar disfata të rënda. Ja si u rrëzua Hrushovi. Nesër mund të rrëzohen edhe të tjerë. Po kush do të vijë në vend të tyre? Mund të vijnë të tjerë që janë njëlloj si paraardhësit e tyre, por sidoqoftë pozitat e revizionistëve do të dobësohen.

Këto janë mendimet e Partisë sonë, të cilat ne i kemi shprehur edhe botërisht, ato ua kemi thënë edhe shokëve të partive të tjera, tani ua themi edhe juve. Mendoj se edhe ne duhet të bëjmë takime e mbledhje, jo të përgjithshme, por takime midis partish, si ky që zhvillojmë ne sot, me qëllim që të rrahim mendimet tona për çështjet më të ndryshme. Ja, për shembull, ne kemi një pikëpamje të ndryshme nga ajo e shokëve të ndonjë partie motër, të cilët na këshillojnë të lejojmë që për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mëdha që ekzistojnë, të vendosin Partia Komuniste e Kinës dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Ne nuk jemi dakord me këtë pikëpamje, sepse këto mosmarrëveshje nuk ekzistojnë midis dy ose katër-pesë partive, por në gjirin e tërë lëvizjes komuniste ndërkombëtare, sepse ato janë

midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit modern. Nga ana tjetër, është e qartë se përveç mosmarrëveshjeve me karakter të përgjithshëm që ekzistojnë në tërë lëvizjen komuniste ndërkombëtare midis partive të ndryshme ka edhe mosmarrëveshje të veçanta që rrjedhin nga mosmarrëveshjet e përgjithshme, siç janë, për shembull, ato në mes të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, në mes të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Malajës etj., etj. Si rrjedhim zgjidhja në rrugë të drejtë e këtyre mosmarrëveshjeve të mëdha nuk është çështje vetëm e dy partive, por e të gjitha partive komuniste që janë të vendosura të mbrojnë dhe të zbatojnë me konsekuencë marksizëm-leninizmin. Prandaj në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që të gjitha këto mosmarrëveshje që kanë partitë marksiste-leniniste me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të sheshohen në mënyrë oportuniste, por t'i zgjidhim ato plotësisht në rrugën marksiste-leniniste, sepse vetëm në këtë mënyrë ne do ta thyejmë revizionizmin hrushovian. Partia jonë e Punës mendon se partitë marksiste-leniniste nuk duhet të lëshojnë pe në kontradiktat që kanë me revizionistët modernë. Përkundrazi, ato duhet t'i sulmojnë revizionistët modernë nga të katër anët.

Cili është mendimi i Partisë sonë për sa u përket konkretisht mosmarrëveshjeve tona me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik? Me të Partia jonë ka shumë kontradikta. Kontradiktat tona kryesore, që i kemi ne dhe të gjitha partitë marksiste-leniniste me revizionistët, janë në fushën ideologjike. Në parim ne jemi për

t'i zgjidhur këto kontradikta nëpërmjet bashkëbisedimeve. Por ne nuk harrojmë se udhëheqësit e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik janë armiq, ata kanë zhvilluar dhe zhvillojnë ndaj Partisë dhe vendit tonë një veprimtari thellësisht antimarksiste dhe antishqiptare.

Për këto arsye Partia jonë përpara se të hyjë në bashkëbisedime me ta, do t'u vërë atyre disa kushte, do t'u thotë atyre:

Së pari, se ata kanë prerë marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë dhe këtë e kanë bërë botërisht. Prandaj, paraprakisht, ata duhet ta pranojnë e ta vënë në vend po botërisht këtë gabim që kanë bërë, duke bërë një deklaratë publike, përse i prenë marrëdhëniet. Në qoftë se e ndreqin kështu si e kërkojmë ne, kjo do të ishte një disfatë e rëndë e revizionistëve hrushovianë para lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe opinionit publik botëror.

Së dyti, ne do t'u themi se me Shqipërinë kanë prishur të gjitha marrëveshjet ekonomike, kulturore, ushtarake etj. dhe jo vetëm ato diplomatike. Të gjitha këto janë me fakte, prandaj, para se të bashkëbisedojmë, edhe këto shkelje të paskrupullta të tyre duhen vënë në vend, duhen ndrequr. Në qoftë se ata do t'i ndreqin, atëherë edhe kjo do të jetë përsëri një disfatë e rëndë për revizionistët hrushovianë dhe një fitore jo vetëm për Shqipërinë, po për të gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Së treti, ne do t'u përmendim atyre se nga tribuna e Kongresit të 22-të i kanë bërë thirrje popullit shqip-

tar për t'u ngritur në kundërrevolucion, për të rrëzuar udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit shqiptar. Prandaj ne do t'u themi: «Do ta njihni edhe këtë gabim?». Në goftë se do ta njohin, atëherë përsëri ne do t'i kemi dhënë një tjetër goditje revizionizmit modern dhe do t'i kemi sjellë një fitore tjetër çështjes sonë.

Si këto ka edhe kushte të tjera. Me një fjalë ne u themi përfaqësuesve të shtetit dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që para se të vemi në bashkëbisedime me ta, në radhë të parë t'u krijojmë shtetit dhe PPSH kushte të drejta, të barabarta për të biseduar, pastaj të flasim për çështjet ideologjike. Në goftë se Bashkimi Sovjetik nuk bën hapat e duhur në këtë drejtim, çfarë do të thotë kjo për ne dhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare? Kjo do të thotë se revizionistët sovjetikë qëndrojnë në pozita armiqësore kundër lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe se të gjitha përpjekjet e tyre për t'u marrë gjoja vesh me ne janë vetëm bluf, prandaj nuk mund të arrihet unitet me ta.

Unitetin ne nuk mund ta kuptojmë si disa oportunistë që na thonë të shkojmë të përqafohemi dhe të puthemi me armiqtë tanë revizionistë dhe kështu t'i konsiderojmë të mbyllura mosmarrëveshjet. Kjo nuk është marksiste.

Mbledhjet dy ose shumëpalëshe për ne kanë si qëllim të luftojnë dhe të shkatërrojnë revizionizmin modern. Në rast se në këto mbledhje arrijmë të fitojmë pozita të vërteta marksiste-leniniste, kjo do të thotë dobësim i pozitave të revizionistëve. Nga mbledhje të ti-

lla ne duhet të kalojmë pastaj në mbledhje më të gjera. Kështu mendojmë ne. Duke zbatuar parimin leninist për bisedime dhe për konsultime, ne nuk do të pushojmë asnjëherë luftën tonë, por do të vazhdojmë pandërprerë polemikën kundër revizionistëve modernë. Gjithë qëllimi është të luftojmë revizionistët modernë, të mos i lëmë mënjanë gjithë këto mosmarrëveshje që kemi me ta.

Revizionistët i bëjnë bisht punës përgatitore që kërkojmë ne, ata duan që ne ta pushojmë pa kushte polemikën, që kjo çështje të mos ngrihet më nga ne. Ata përpiqen të organizojnë krerët e revizionizmit modern në vendet e Amerikës Latine për të lënë përshtypjen sikur edhe në këtë kontinent forcat komuniste janë një bllok me ta. Në Evropë ata kanë me vete krerët e partive revizioniste. Me punën e tyre kundërrevolucionare ata kanë shkatërruar edhe partitë marksiste të Afrikës dhe me revizionistët e këtij kontinenti po bëjnë një grupim tjetër. Të gjitha këto grupime ia kundërvënë rrugës sonë marksiste-leniniste, për të nxjerrë «unite-tin» e tyre revizionist kundër veprimtarisë sonë të drejtë që synon në likuidimin e revizionizmit modern dhe në arritjen e një mbledhjeje ndërkombëtare marksiste-leniniste. Ndaj mbledhja ndërkombëtare me revizionistët modernë nuk ka asnjë kuptim, dhe, po të merrnim pjesë në një mbledhje të tillë, do të ishte një dëm i madh për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, do të ishte një kapitullim i saj.

Të supozojmë për një çast sikur të vemë në mbledhje kështu si jemi, si kundërshtarë të papajtueshëm. Çfarë mund të dalë nga një mbledhje e tillë? Asgjë,

mendojmë ne. Të gjithë do të ndahen në dy pjesë, një palë do të luftojë palën tjetër, asnjëra nuk do t'i lëshojë rrugë tjetrës, gjë që do të ishte në favor të revizionistëve modernë, qëllimi i të cilëve është të gënjejnë popujt dhe t'u krijojnë përshtypjen masave të komunistëve sikur po bëhet mbledhja, kurse në fakt nuk zgjidhet asgjë. Në qoftë se mendohet të vemi atje për të luftuar kundër revizionistëve, do të bënim vetëm një luftë në vazo të mbyllur, ndërsa do të linim pas dore luftën e hapët kundër revizionistëve modernë me të gjitha format e në të gjitha drejtimet.

Me përjashtim të partive që mbështeten fort në mësimet e marksizëm-leninizmit, në gjirin e çdo partie komuniste dhe punëtore është zhvilluar dhe po zhvillohet një luftë e ashpër kontradiktash të brendshme në mes të revizionistëve modernë dhe marksistë-leninistëve revolucionarë. Veç kësaj gjatë viteve të fundit janë krijuar edhe një sërë partish dhe grupesh marksiste-leniniste të reja, të cilat brenda në gjirin e partive të vjetra po bëjnë një luftë të ashpër parimore. Këto përpjekje nuk mund të injorohen, as në shkallën e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, as brendapërbrenda çdo partie të veçantë. Sot në fakt në mjaft vende të botës janë krijuar parti komuniste, ka gjithashtu edhe shumë grupe marksiste-leniniste revolucionare në vende të tjera. Revizionistët modernë thonë se partitë dhe grupet e reja marksiste-leniniste janë tradhtarë, kurse ne themi të kundërtën. Kjo është një kontradiktë e madhe në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Por si do të zgjidhet kjo kontradiktë? Duke u puthur me revizionistët dhe duke u thënë partive e gru-

peve marksiste-leniniste të tërhiqen, ta pushojnë luftën dhe të futen nën zgjedhën e partive revizioniste? Jo. Po ta bënim një gjë të tillë, kjo nuk do të ishte marksiste dhe gjersa nuk është marksiste, në nuk e bëjmë. Revizionistët hrushovianë, atje ku ka dy parti, ndihmojnë klikat revizioniste për të luftuar marksistë-leninistët, ndërsa partitë tona bëjnë të kundërtën, ndihmojnë marksistë-leninistët për të shkatërruar revizionistët modernë brenda në radhët e partive të tyre. Le të na thonë sa të duan të vemi të puthemi me revizionistët, kjo nuk do të ndodhë kurrë, sepse është luftë e thellë që nuk zhduket me të përçafuar. Prandaj në kushtet kur përbërja e lëvizjes komuniste ndërkombëtare nuk është më ajo që ka qenë në kohën kur u bë Mbledhja e Moskës më 1960, lufta për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zhvillohet si brenda radhëve të secilës prej këtyre partive, ashtu edhe në gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Nëpërmjet kësaj lufte forcohen edhe më shumë lidhjet dhe uniteti midis partive marksiste-leniniste, të cilat duhet të vendosen dhe të udhëhiqen vetëm në bazë të marksizëm-leninizmit. Kjo çështje ka rëndësi kolosale. Vetëm lidhjet e bazuara mbi marksizëm-leninizmin janë të shëndosha dhe përmbajnë në vetvete pavarësinë e sovranitetin e partive, të drejtën e fjalës dhe të konsultimeve, diskutimet e barabarta. Në të tilla kushte luftohet shovinizmi i shtetit ose i partisë së madhe, nuk ka «parti mëmë» e «parti bijë». Drejtues dhe udhëheqës i çdo partie është vetëm marksizëm-leninizmi, ai është strumbullari prej të cilit varen të gjitha. Marksizëm-leninizmi është baza e unitetit të të gjitha

partive, është truri i tyre dhe jo shkopi i dirigjentit, siç mendonte dhe vepronte N. Hrushovi.

Revizionistët modernë përveç përpjekjeve për mbledhjen e përgjithshme bëjnë edhe takime të tjera. Duke përfituar nga rasti, unë mund t'ju tregoj pak për mbledhjen e fundit të Traktatit të Varshavës. Sido që ky traktat përbën një rreth të mbyllur, pasi ka të bëjë vetëm me pjesëtarët e tij, çështjet e shtruara në këtë mbledhje janë të njohura prej kohësh. Në këtë mbledhje pjesëtarët e këtij traktati «u kujtuan» pas 4 vjetësh të na ftojnë edhe ne si anëtarë të tij. Në fakt ne ata na kanë përjashtuar nga Traktati i Varshavës, por tani situatat e vështira i detyrojnë të na thërresin. Mirëpo ftesën ata e kanë bërë në mënyrë krejt të paligjshme, duke shkelur për 4 vjet me radhë të gjitha normat e aprovuara dhe të vendosura bashkërisht në Traktatin e Varshavës, të cilat janë ligje për ne.

Si përgjigje të ftesës dhe brenda normave të vendosura bashkërisht për Traktatin e Varshavës, ne u kërkojmë atyre llogari duke u thënë:

E para, përse nuk na ftuat për 4 vjet me radhë, por na ftoni vetëm tani? Përse na keni përjashtuar *de facto* nga Traktati i Varshavës dhe kush ka propozuar të na përjashtonte?

E dyta, cilat janë vendimet që janë marrë gjatë kësaj periudhe në të gjitha mbledhjet e Traktatit të Varshavës, për të cilat ne s'kemi asnjë dijeni? Si anëtarë të Traktatit të Varshavës që jemi është e ligjshme që neve të na jepen edhe procesverbalet e mbledhjeve, në të cilat, jo për fajin tonë, nuk kemi marrë pjesë.

E treta, si mund të vijmë ne në një mbledhje të ti-

llë, kur një anëtar i këtij traktati, Bashkimi Sovjetik, ka prerë marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë që është gjithashtu anëtare e Traktatit të Varshavës?

E katërta, Bashkimi Sovjetik në kuadrin e Traktatit të Varshavës duhet të na furnizonte ne me armë dhe me mjete të tjera ushtarake. Por Bashkimi Sovjetik, në të kundërtën ia ka ndërprerë Shqipërisë furnizimet me armatime, i ka grabitur asaj nëndetëse, ka dobësuar fuqinë mbrojtëse të Shqipërisë dhe e ka detyruar atë të armatohet, duke rënduar së tepërmi buxhetin e shtetit shqiptar; ka prerë të gjitha marrëdhëniet ekonomike dhe të ndihmës etj., të cilat duhet t'i jepeshin vendit tonë në bazë të këtij traktati. Vetë Kosigini, kryeministri i tanishëm sovjetik, para disa vjetësh na ka pas bërë një letër, në të cilën na thoshte se Bashkimi Sovjetik priste të gjitha marrëdhëniet ekonomike, politike, ushtarake etj. me Shqipërinë, ndërsa disa nga pjesëtarët e tjerë të Traktatit të Varshavës kanë dëbuar ambasadorët shqiptarë nga vendet e tyre dhe kanë tërhequr ambasadorët e tyre të akredituar në Shqipëri. A mundet, pra, të vijmë ne në mbledhjen e Traktatit të Varshavës pa u ndrequr nga ana juaj të gjitha këto veprime armiqësore antishqiptare?

E pesta, bashkërisht në Traktatin e Varshavës kemi marrë vendime, një nga të cilat është edhe nënshkrimi i traktatit të paqes me Gjermaninë. Ne pyesim: përse nuk është zbatuar dhe kush ka penguar të zbatohet ky vendim i përbashkët?

Ne kemi pastaj mendime edhe për sa i përket rendit të ditës të mbledhjes së Traktatit të Varshavës. Në rendin e ditës, për shembull, është vënë diskutimi i

çështjes së armëve bërthamore që do t'i jepen Gjermanisë revanshiste nga imperialistët amerikanë.

Qeveria Shqiptare insiston të nënshkruhet traktati i paqes me Gjermaninë dhe, po të mos realizohet kjo për të gjithë Gjermaninë, të nënshkruhet vetëm me Republikën Demokratike Gjermane, ashtu siç kemi vendosur; të denoncohet traktati tripalësh i Moskës «për ndalimin e pjesshëm të provave të armëve bërthamore»; të hidhet poshtë politika tradhtarë që i ka imponuar N. Hrushovi Traktatit të Varshavës; të ndalohej menjëherë furnizimi me armë që u bën qeveria sovjetike reaksionarëve indianë. Ne akuzojmë gjithashtu qeverinë sovjetike për bashkëpunimin në komplotin që kishin kurdisur titistët, monarko-fashistët grekë dhe Flota e 6-të Amerikane me synim rrëzimin e pushtetit popullor në Shqipëri. Për këtë ne disponojmë dokumente. Kështu u kemi kërkuar atyre llogari edhe për një sërë çështjesh të tjera.

Ne i njoftuam pjesëtarët e Traktatit të Varshavës se, pa na u plotësuar këto kushte, nuk do të shkojmë në mbledhje dhe i paralajmërojmë ata që deklarata jonë të lexohet në mbledhje, ndryshe do ta botojmë botërisht në mënyrë që popujt t'i shohin ç'janë dhe çfarë organizojnë pjesëtarët revizionistë të Traktatit të Varshavës.

Të gjitha këto që thashë janë të drejta të ligjshme të Republikës Popullore të Shqipërisë, të përcaktuara në Traktatin e Varshavës. Në këtë dokument ne nuk prekim fare mosmarrëveshjet tona ideologjike si çështjen e Stalinit etj., etj. Ato që kemi parashtruar ne janë kërkesa krejt të ligjshme dhe me karakter shtetëror.

Çështjet që u kemi parashtruar anëtarëve të Trak-

tatit të Varshavës, në pamjen e parë duken sikur kanë karakter kombëtar, por në të vërtetë ato janë probleme me karakter ndërkombëtar që i interesojnë gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ne u themi atyre se traktati tripalësh i Moskës është një traktat mashtrues, një nga qëllimet e të cilit është që armët atomike të mbeten monopol i SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik.

Në letrën që i dërguam mbledhjes së Traktatit të Varshavës kërkojmë shpjegime se ç'është vendosur atje në lidhje me traktatin e Moskës. Në dokumentet bazë të Traktatit të Varshavës, të aprovuara që me krijimin e tij, theksohet se asnjërit nga pjesëtarët e këtij traktati nuk i lejohet të nënshkruajë në mënyrë të njëanshme ndonjë traktat të veçantë me të tjerët, pa aprovimin e mbledhjes së Traktatit të Varshavës. Atëherë, duam të dimë: e ka aprovuar Traktati i Varshavës traktatin tripalësh të Moskës? Në qoftë se po, atëherë një vendim i tillë është i paligjshëm, gjersa Shqipëria në këtë aprovim nuk ka marrë pjesë. Këtë nuk e themi se kështu na pëlqen neve, por sepse vetë Traktati i Varshavës parashikon që për çdo vendim që do të merret duhet të ketë aprovim unanim të të gjithë pjesëtarëve të traktatit. Në të kundërtën, në qoftë se Bashkimi Sovjetik e ka nënshkruar traktatin tripalësh të Moskës, pa dijeni në e pjesëtarëve të tjerë të Traktatit të Varshavës, atëherë ky traktat është minuar nga vetë Bashkimi Sovjetik, prandaj duhet prishur si i jashtëligjshëm dhe arbitrar.

Ose të marrim problemin e armëve bërthamore. Ne e dimë që pjesëtarët e Traktatit të Varshavës po përpigjen të bëjnë kompromise me imperialistët amerikanë.

Ne u themi anëtarëve të Traktatit të Varshavës se duhet të nënshkruhet traktati i paqes me Gjermaninë Lindore dhe të likuidohet traktati i Moskës, të deklarojmë bashkërisht se, po t'i jepen armët bërthamore qeverisë së Bonit nga ana e SHBA-së, atëherë Bashkimi Sovjetik do t'i pajisë të gjitha vendet socialiste me armë bërthamore. Ne u themi gjithashtu atyre se argumenti, sipas të cilit, me nënshkrimin e traktatit tradhtar të Moskës gjoja pengohej armatosja e aleatëve të SHBA-së me armë bërthamore, siç e propagandonte me forcë të madhe propaganda e N. Hrushovit, nuk është veçse një bluf, sepse në fakt tani imperialistët amerikanë, pa çarë krye për traktatin e Moskës, po e armatosin Gjermaninë Perëndimore me armë bërthamore.

Pra ne, me të gjitha forcat e mundësitë tona, ndihmojmë në luftën kundër tradhtisë së revizionistëve modernë. Lufta jonë kundër tyre nuk ka mbaruar, ajo do të vazhdojë deri në fund. Për suksesin e kësaj lufte një rëndësi të madhe ka uniteti ynë marksist-leninist. Për këtë unitet janë të vendosura të gjitha partitë tona marksiste-leniniste. Ta kalitim kurdoherë këtë unitet nëpërmjet luftës parimore, sepse vetëm nëpërmjet luftës çimentohen uniteti, aleanca dhe qëndrimet tona të përbashkëta.

Ne jemi në dijeni se në Traktatin e Varshavës ka edhe kontradikta të mëdha në mes të pjesëtarëve. Këto kontradikta janë midis revizionistëve që udhëhiqen nga ideologjia borgjeze, e cila për vetë burimet që e ushqejnë, pëson variacione, në gjirin e saj ngjallen tendenca të ndryshme, që bien në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe frymëzohen nga kapitalizmi botëror, nga im-

perializmi për interesat e tij. Kjo bën që revizionistët modernë të përpiqen të gjejnë rrugë të ndryshme nga njëri-tjetri dhe të maskohen sipas nevojave dhe kushteve që ua imponon ai kapital ose ajo pjesë e imperialistëve me të cilët ata lidhen më shumë. Do të ketë dhe ka edhe nga ata të «vijës së mesit» domethënë që mbajnë një qëndrim të djathtë oportunist të maskuar. Këta hiqen sikur janë me ne, por në realitet veprojnë në të kundërtën, sepse të gjitha këto grupime dhe tendenca që krijohen janë të tëra revizioniste. Ne e kemi për detyrë që të gjitha këto nuanca t'i ndjekim me sy analitik, marksist-leninist, të mos gabohemi, por dhe të përfitojmë prej tyre në rrugë marksiste-leniniste. Qëllimi i revizionistëve është lufta kundër marksizëm-leninizmit. Mirëpo lufta jonë, lufta e marksistëve-leninistëve, i bën tani revizionistët që, pa humbur qëllimet e përbashkëta të luftës kundër nesh, të çahen dhe midis tyre. Kështu ngjau dhe në kohën e Leninit kur, si rezultat i luftës së marksistëve, u arrit shpartallimi ideologjik i social-demokracisë. Kështu ka ngjarë e do të ngjasë kurdoherë dhe me revizionizmin modern.

Ne do të fitojmë se jemi në rrugë të drejtë. Të gjitha përpjekjet dhe manovrat e revizionistëve modernë dhe të imperialistëve kundër marksizëm-leninizmit, ne do t'i thyejmë se jemi një forcë kolosale.

Duke marrë fjalën, kryetari i delegacionit e falënderoi shokun Enver Hoxha për bisedën shumë të rëndësishme që zhvilloi dhe i shprehu ndjenjat e respektit dhe të simpatisë së thellë të PK të Malajës ndaj PPSH, e cila ndjek kurdoherë një politikë të drejtë, të guximshme e parimore në mbrojtje të marksizëm-leninizmit.

nga sulmet tradhtare të revizionistëve modernë. Pasi foli mbi veprimtarinë e PK të Malajës në luftë kundër reaksionit dhe revizionizmit modern, ai shprehu mirënjohjen e thellë për ndihmën dhe për përkrahjen e madhe që u jep PPSH partive dhe forcave marksiste-leniniste kudo në botë; ai tha se gjatë qëndrimit në Shqipëri kishin vizituar Korçën, Vlorën, Durrësin dhe Qytetin Stalin nga ku kishin mbetur me përshtypje shumë të mira. Pastaj shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Siç e shihni emrin dhe veprën e Stalinit ne nuk i kemi zhdukur siç kanë bërë revizionistët modernë, por i kemi mbajtur dhe i mbajmë kurdoherë lart. Armiqtë na luftojnë për këtë, por emri i Stalinit nuk njolloset dot nga lufta e armiqve. Stalini është një nga marksistët e mëdhenj. Ata që u rezistojnë kohërave dhe furtunave, janë më të pamposhturit, ata nuk janë të përkohshëm, por qëndrojnë dhe do të qëndrojnë gjallë si monumentet e pavdekshme, të cilat furtunat e kohërave dhe fenomenet e tjera të natyrës, të shumtën e herës, edhe i kanë rrëzuar, bile i kanë mbuluar, por ato kanë dalë përsëri në dritë. Kështu edhe emri dhe vepra e Stalinit nuk errësohen dot nga shpifjet e revizionistëve modernë. Kohërat që kanë kaluar e kanë vënë në dukje veprën e tij të madhe.

Por përse e mbrojmë ne Stalinin? Siç dihet, revizionistët modernë e filluan fushatën e tyre kundër marksizëm-leninizmit, pikërisht me luftën e paprincipitë dhe me shpifjet kundër Stalinit, sepse Stalini ishte vazhduesi besnik i veprës së pavdekshme të Leninit. Revizionistët modernë janë jo vetëm kundër Stalinit, por dhe kundër vetë Leninit. «Proleninizmi» i tyre

është fals. Ashtu sikurse oportunistët e Internacionales së Dytë, të cilët, në sulmet e tyre për të shkurorëzuar marksizmin në pamundësi të dilnin hapur kundër Marksit dhe Engelsit dhe duke u mbështetur gjoja në teoritë e Marksit dhe të Engelsit, luftonin leninizmin, pra vetë marksizmin, ashtu edhe revizionistët modernë, hrushovianët, titistët etj., në pamundësi të sulmonin Leninin, sulmuan Stalinin, sepse me veprën e Stalinit ata godisnin njëkohësisht leninizmin në vijën e tij të përgjithshme, në vijën ndërkombëtare dhe në Bashkimin Sovjetik. Pra, qëllimi i revizionistëve modernë ishte të shkurorëzonin leninizmin dhe sulmin e parë e filluan kundër Stalinit.

Revizionistët modernë ngritën kundër Stalinit një varg shpifjesh fantastike pa asnjë bazë të shëndoshë, por të mbështetura në trillime, shtrembërime e falsifikime. Marksistët e marrin me mend se në punën kaq të madhe që ka bërë Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik, me Stalinin në krye, nuk mund të mos jenë bërë edhe disa gabime pune. Të tilla gabime janë të natyrshme dhe të mundshme të bëhen. E kush mund të pretendojë se nuk ka gabime në punë? Por revizionistët modernë nuk e kanë çështjen te këto gabime, prandaj Stalinit dhe marksizëm-leninizmit i vënë përsipër gjëra të paqena, të cilat i ngritën dhe i formuluan në një mënyrë të tillë tendencioze për të arritur të gënjejnë disa, sidomos njerëzit e paformuar mirë ideologjikisht, për të shkaktuar tek ata njëfarë dyshimi për Stalinin dhe veprën e tij. Revizionistët modernë nisen nga mendimi, «shpif, shpif, shpif, se diçka do të mbetet», por nga shpifjet e tyre për ne mbetet ve-

tëm ajo që armiq të marksizëm-leninizmit janë revizionistët modernë dhe jo Stalini.

Partia jonë udhëhiqet nga parimet e drejta marksiste-leniniste dhe nuk përzihet në punët e brendshme të partive të tjera. Por për udhëheqës të mëdhenj partie si Stalini, të cilët me cilësitë e tyre pozitive e kapërcejnë kuadrin e partisë së vet, se me punën e tyre kanë ushtruar një influencë kolosale në zhvillimin e marksizëm-leninizmit dhe në ngjarjet botërore, Partia jonë e ka thënë dhe do ta thotë fjalën e saj, pasi ata nuk mund të gjykohen vetëm brenda caqeve të partisë nga e cila kanë dalë.

Prandaj çështja, nëse Stalini ka bërë ose nuk ka bërë gabime, nuk është çështje vetëm e PK të Bashkimit Sovjetik, por e gjithë komunizmit ndërkombëtar, sepse nuk ka parti marksiste-leniniste që të mos ketë për të thënë fjalën e vet mbi veprën e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik dhe mbi veprën e Stalinit që ishte udhëheqësi i saj kryesor pas Leninit, pasi veprimtaria e tyre ka influencuar në gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Partia jonë mendon se veprimtaria e PK (b) të Bashkimit Sovjetik në kohën që udhëhiqej nga Stalini ka influencuar në mënyrë pozitive në zhvillimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, në zhvillimin e ngjarjeve ndërkombëtare në të gjithë botën. Por nga Hrushovi me kompani në këtë çështje nuk është kërkuar mendimi i lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Këtu nuk është fjala për një njeri të zakonshëm, por për udhëheqësin e një çështjeje të madhe. Lufta kundër Stalinit është kurdisur në mënyrë konspirative, komplotiste nga borgjezia ndërko-

mbëtare, nga revizionistët modernë hrushovianë. Revizionistët, duke u përpjekur të shfrytëzojnë influencën e madhe që ka pasur Partia Komuniste (bolshevikë) e Bashkimit Sovjetik janë munduar ta mbulojnë pikëpamjen marksiste në lëvizjen komuniste ndërkombëtare për Stalinin dhe për partinë që ka udhëhequr ai, si nxënës dhe vazhdues i veprës së Leninit.

Kush mund ta mohojë veprën e madhe të bolshevikëve, të Leninit, të Stalinin dhe të partisë të tyre? As revizionistët modernë dhe askush tjetër nuk janë në gjendje të mohojnë një gjë të tillë. Në fakt ata detyrohen të thonë se «në Bashkimin Sovjetik u ndër-tua socializmi me sukses etj. dhe kjo është vepër e Partisë Komuniste të BS». Por dihet se socializmin e ndërtojnë masat, të cilat duhet të organizohen për një qëllim të tillë të madh. Këtë organizim e realizon partia. Prandaj në qoftë se e mohon rolin udhëheqës të partisë marksiste-leniniste, në qoftë se thua se udhëheqja e Bashkimit Sovjetik dhe Stalini, të cilët hrushovianët i kanë diskredituar, kanë qenë në rrugë të gabuar, atëherë, si ishte e mundur të ndërtohej socializmi në Bashkimin Sovjetik? Në qoftë se udhëheqja tradhton, siç ndodhi me klikën titiste, atëherë si është e mundur të ndërtohet socializmi në Jugosllavi? Si është e mundur që Titoja, që është një tradhtar dhe antimarksist, të influencojë për ndërtimin e socializmit? Këto arsyetime të udhëheqjes hrushoviane nuk qëndrojnë dot në këmbë.

Si mund të errësohet politika aq tejpmënë e Stalinin në arenën ndërkombëtare kundër imperialistëve, borgjezisë monopoliste të vendeve të ndryshme dhe

kapitalizmit botëror në përgjithësi, të cilët ishin lidhur në aleancë të fortë midis njëri-tjetrit për shkatërrimin e Bashkimit Sovjetik! Në qoftë se për kapitalizmin botëror ka ekzistuar një armik i vendosur dhe i papërkulur gjer në fund në radhë të parë, ky ka qenë Stalini. Këtë nuk mund ta mohojë askush. Dihet se borgjezia dhe kapitalizmi botëror vazhdimisht i kanë pasë drejtuar të gjitha shigjetat kundër Bashkimit Sovjetik dhe personalisht kundër Stalinit kur ky ishte në udhëheqje të partisë dhe të shtetit sovjetik. Njerëz konsekuentë në bindjet dhe në ideologjinë e tyre reaksionare, bile edhe krerët e kapitalizmit botëror, si Rusvelti, Trumani, Çërçilli, Ideni, në shkrimet dhe në kujtimet e tyre, flasin me shumë respekt për armikun e tyre të madh, Stalinin, për zotësinë, mençurinë, vendosmërinë dhe luftën e tij konsekuente kundër kapitalizmit. Qëndrimi i vendosur i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe i udhëheqësit të saj, Stalinit, bëri që Bashkimi Sovjetik, vendi i parë socialist në botë, të dilte fitimtar nga lufta dhe të krijohej e të forcohej kampi socialist. Këtë realitet të madh nuk e solli politika tradhtare e Hrushovit, por politika e drejtë e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, e Stalinit. Në kohën e tij u forcua lëvizja komuniste ndërkombëtare, u forcuan partitë e ndryshme, u pajisën ato me një vijë të drejtë, u krijuan edhe shumë parti të reja. Le të përrallisë sa të dojë Hrushovi se Stalini gjoja nuk ishte i aftë. Jo, realiteti vërteton se Stalini ishte një marksist i madh, ai nuk e tradhtoi kurrë, si Hrushovi, çështjen e madhe të socializmit. Pa qëndrimin e vendosur marksist-leninist

të Stalinit, gjatë periudhës së forcimit të nazizmit dhe të fashizmit, lëvizja komuniste ndërkombëtare dhe partitë komuniste të vendeve të ndryshme do të ishin likuiduar.

Tani ne jetojmë në një kohë kur revizionistët modernë, me hrushovianët, titistët dhe shokët e tyre në krye, janë bërë vegla të imperializmit amerikan. Bashkekzistenca paqësore e tyre është një pikëpamje e predikuar nga imperializmi amerikan dhe e zbatuar nga N. Hrushovi. Kjo nuk ka asnjë pikë të ngjashme me bashkekzistencën paqësore leniniste, për të cilën luftojnë Partia e Punës e Shqipërisë, Partia Komuniste e Malajës dhe të gjitha partitë e vërteta komuniste të botës. Në bashkëpunimin revolucionar të marksistë-leninistëve forcohet lëvizja komuniste botërore dhe uniteti i tyre internacionalist. Kësaj i shërben edhe këmbimi i eksperiencës në mes të partive marksiste-leniniste.

Gjatë vizitave, që ju bëtë nëpër vendin tonë, patë sukseset që ka arritur populli ynë punëtor nën udhëheqjen e Partisë. Por ne ju themi se në vendin tonë nuk është çdo gjë e përsosur, kemi akoma të meta në punët tona. Të ndërgjegjshëm për këto Partia dhe populli kurdoherë bëjnë përpjekje për t'i korrigjuar dhe për t'i eliminuar ato duke synuar të bëjmë gjithnjë e më pak gabime. Gabime në punë e sipër bëhen, ato janë të paevitueshme. Sidoqoftë në qëndrimet tona marksiste-leniniste për problemet e mëdha që preokupojnë të gjitha partitë, pikëpamjet tona janë të njëjta.

Ne kemi respekt për partinë tuaj, e cila ka shumë vjet që lufton në kushte të vështira ilegaliteti. Ajo ka

krijuar njësitë partizane, të cilat veprojnë nën udhëheqjen e saj. Ajo është e lidhur me popullin dhe mban një qëndrim të drejtë marksist-leninist kundër imperia-
lizmit dhe kundër intrigave të reaksionarëve vendas. Kjo është një garanci e madhe për fitoren e çështjes sonë, është pjesë përbërëse e gjithë çështjes sonë të madhe. Ne ju urojmë nga zemra suksese në punën tuaj dhe ju lutemi t'u thoni të gjithë shokëve të Komitetit Qendror të Partisë suaj se te populli shqiptar dhe te Partia e Punës e Shqipërisë ju keni dhe do të keni kurdoherë një mik besnik dhe solidar përjetë në çështjen tonë të madhe të përbashkët.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

TE ZHVILLOHEN ME TEJ HOVI DHE INICIATIVA E ORGANIZATAVE-BAZË TË PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 janar 1965

Çështja e shtruarjes së problemeve në organizatat-bazë të Partisë dhe e hartimit të programit të punës është me rëndësi të madhe. Ju, shokë të komiteteve të Partisë, duhet t'u hapni perspektivë komunistëve për zgjidhjen e problemeve në sektorët që ata drejtojnë në të gjitha fushat, ekonomike, kulturore, arsimore etj.

Temat që diskutohen në organizatat-bazë kanë rëndësi të veçantë. Ato duhet të zgjidhen e të përgatiten mirë dhe organizatat-bazë të kenë ndihmën e plotë të komiteteve të Partisë e të sekretarëve të këtyre komiteteve, që janë shokë më të ngritur nga sekretarët e organizatave-bazë. Në këtë mënyrë, shokët e bazës edu-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa çështje që kanë të bëjnë me gjallërimin e jetës së brendshme të organizatës-bazë.

kohen, marrin një përkrahje efektive dhe ecin përpara. Gjithashtu kanë rëndësi diskutimet që zhvillohen rreth një teme të caktuar në organizatën-bazë, prandaj këto duhet të nxiten sa më shumë. Një problem që shtrohet dhe diskutohet mirë ndihmon edhe në edukimin e sho-këve, sidomos të atyre që kanë nivel të ulët.

Në organizatat-bazë ka edhe komunistë që nuk diskutojnë ose flasin pak, sigurisht mirë është që këta të diskutojnë, por mendoj se nuk është nevoja t'u rrimë mbi kokë e t'u themi: «hë, fol», kur këta janë nga të parët që zbatojnë drejt direktivat e Partisë dhe i kryejnë si duhet punët e ngarkuara. Ka disa të tjerë, që vetëm dinë të flasin, po punë nuk bëjnë sa duhet. Njerëz të tillë organizata-bazë duhet t'i ndihmojë e t'i bëjë të punojnë mirë. Në qoftë se komunisti që punon mirë nuk e kritikon dot sot atë që ka shumë llafe, sepse nuk e merr fjalën të diskutojë, do ta kritikojë me siguri nesër, sepse shikon që llafazani vetëm tund derën, kur-se ai për vete djersin në punë. Pra do të vijë shpejt dita që komunisti, i cili dje s'fliste, të marrë me siguri guximin dhe t'i thotë: «Shumë të bukura na i thua fjalët, po ama në arë me shatë ti nuk punon. Prandaj duhet punuar jo vetëm me gojë, po në radhë të parë me shatë».

Caktimi i temave dhe ndihma për zhvillimin e diskutimeve në organizatën-bazë nuk duhet t'i mbeten spontaneitetit. Komiteti i Partisë nuk duhet t'i marrë nën tutelë organizatat-bazë, duke u diktuar çështjet që do të diskutojnë, por të zhvillojë hovin dhe iniciativën e tyre. Në të vërtetë, organizatat-bazë kanë ne-

vojë për ndihmën e madhe të komitetit të Partisë. Këtë ju, shokë të komiteve të Partisë, duhet ta keni mirë të qartë. Komiteti i Partisë duhet të ndihmojë konkretisht derisa të shikoni që organizata-bazë, anëtarët e Partisë dhe sidomos sekretari i saj të bëhen njerëz të aftë e revolucionarë për të drejtuar si duhet në rrugë marksiste, pa hatëre dhe tarafe. Të gjitha rregullat që kemi vendosur të kuptohen në dinamizmin e tyre. Rregullat e Partisë, që nga demokracia e brendshme dhe gjer te kartotekat, të kuptohen si pikënisje veprimesh, të cilat ndihmojnë në gjallërimin dhe në revolucionarizimin e jetës së organizatave-bazë. Ndryshe puna do të jetë e mykur dhe shabllon.

Të marrim dy-tri organizata-bazë që veprojnë në sektorë të ndryshëm. U tha se në Kukur të rrethit të Gramshit ka 15 komunistë. Kjo është një forcë e madhe për këtë fshat. Natyrisht, problemet atje nuk janë të mëdha, siç janë ato të rrethit. Gjithë problemet që preokupojnë organizatën-bazë në Kukur gjatë vitit mund të përmblihen e të shqyrtohen në 5-6 ose e shumta në 7 mbledhje. Sikur edhe me detaje të merrren në shqyrtim këto probleme, atëherë atje mbeten edhe 5 mbledhje të lira për çështje të tjera. Ne mendojmë që për këto mbledhje duhet reflektuar çfarë çështjesh të tjera mundet dhe duhet të shtrojë kjo organizatë-bazë e këtij fshati dhe jo të lejojme që ajo t'u futet fije për fije vetëm problemeve ekonomike, duke mos lënë asnjë mbledhje për probleme të tilla të rëndësishme, siç janë ato të edukatës, të moralit komu-

nist, për çështjet ideologjike etj. Nuk duhet t'i lëmë organizatat-bazë të fshatit që mbledhjet e tyre t'i bëjnë për gjëra fare të vogla. Organizata-bazë është themeli i Partisë, po nuk e patëm atë të fortë, nuk mund ta kemi të fortë Partinë.

Por organizata-bazë e Kukrit nuk ka të njëjtat karakteristika me atë të ndonjë fshati ose krahine tjetër, nuk ka po ato situata, prandaj duhen mbajtur parasysh edhe veçoritë që ka kjo ose ajo organizatë. Ose të marrim një organizatë-bazë partie në SMT. Çfarë do të diskutojë kjo organizatë në 12 mbledhjet e saj gjatë vitit? Në njërën, për shembull, mund të marrë në shqyrtim problemin e gatishmërisë së SMT-së, një herë tjetër fushatën e mbjelljeve të pranverës, më vonë fushatën e korrjeve dhe të shirjeve, në një mbledhje tjetër mund të diskutohet për kontrollin e punës, më pas për meremetimin e makinerisë. Pra 5 mbledhje për problemet e SMT-së. Po në 7 mbledhjet e tjera çfarë do të bëjë kjo organizatë-bazë? Në një situatë të tillë mund të merret në shqyrtim çështja se si punojnë dhe si sillen komunistët e kësaj organizate, niveli politik dhe ideologjik i tyre, se çështja e edukimit ideologjik nuk bëhet me një ose dy leksione. Pastaj mund të shqyrtohet çështja e lidhjeve të SMT-së me fshatarësinë, pavarësisht se kjo çështje ka edhe anët teorike etj. Kështu mbledhjet e organizatës-bazë do të shfrytëzohen më mirë për të ngritur në shkallën që kërkohet punën e komunistëve e të punëtorëve të SMT-së. Kështu shtrohet çështja edhe për organizatat-bazë të sektorëve të tjerë në shkolla, në administratë etj.

Duhet të mendojmë më thellë për këto gjëra, ta

gjallërojmë më shumë bazën. Na thuhet se në disa fshatra malore punët venë mirë, njerëzit janë gati për çdo gjë, Partinë e duan. Mirëpo na ngrihen dy-tre kulakë nga një rreth dhe shkojnë në një rreth tjetër ku hapin fjalë se «Partia ka dhënë urdhër që kooperativat bujqësore të prishen!» Kjo propagandë çorienton edhe disa fshatarë, te të cilët nuk ka zënë rrënjë të thella puna e Partisë. Pse ndodhin gjëra të tilla? Sepse puna e disa organizatave-bazë të Partisë nuk është në lartësinë e duhur, se në to nuk bëhet si duhet një punë e gjallë dhe revolucionare, nuk ndihmohen dhe nuk kontrollohet puna e tyre nga komiteti i Partisë i rrethit. Këtë çështje ne duhet ta shohim me shumë kujdes, jo vetëm nga ana formale administrative, duke dënuar njërin dhe tjetrin me masa ndëshkimore. Natyrisht, edhe këto kanë rëndësinë e tyre edukative, por rëndësi kanë më parë kritika dhe autokritika. Kur jepet një vërejtje, ajo bën efekt, por kur pas saj jepet edhe një e dytë, efekti i saj edukativ dobësohet. Rëndësi më të madhe ka kritika që bëhet. Prandaj të zhvillohet kritika dhe jo të jepen masa, se po t'u jepen të tërëve vërejtje, sikur shkarkohet përgjegjësia. Ne edhe vërejtje do të japim, se edhe këto i vlejné njërit apo tjetrit, po masat ndëshkimore duhet të përdoren drejt.

Mendoni më mirë mbi këto probleme, shokë të komiteteve të Partisë, se kanë rëndësi të madhe. Studioni rendet e ditës të çdo organizate-bazë për një ose dy vjet, planet e tyre të punës, tematikat e çështjeve, shikoni karakteristikat e këtyre temave. Përpiquni t'i gruponi disa nga këto tema që kanë afërsi me njëra-tjetrën

dhe, kur të bëhet plani, sugjeroni tema të mira. Kur ju tepron koha, gjeni edhe probleme të tjera që u vlej- në organizatave-bazë, me qëllim që t'i ngremë ato në një nivel më të lartë e të bëjnë vetë tema të veçanta të çfarëdo natyre.

Në qoftë se ka tarafe në një organizatë-bazë e vlen që ajo të zhvillojë dy mbledhje vetëm për këtë problem. Duhet pasur parasysh se kur bëhen mbledhjet në organizatat-bazë të shkohet nga parimi që problemi i diskutuar, për shembull, në janar, ta udhëheqë organizatën për tërë vitin. Kur shtrohet një problem, atij duhet t'i futen thellë të gjithë anëtarët e Partisë, të jepet drejt orientimi se si do të punohet dhe të caktohen një ose dy anëtarë të organizatës, të cilët gjatë punës për zbatimin e vendimeve, të ndihmojnë shokët që ngarkohen me detyra për këtë problem dhe organizata të mos kthehet më mbi atë çështje gjatë gjithë vitit. Kur merret në shqyrtim shembulli personal i komunistëve jo vetëm në punë, por edhe në shoqëri, në familje etj. për këtë qëllim mbledhja e organizatës-bazë mund të diskutojë edhe tri orë, të rrihen mirë çështjet, të kritikohen ata që kanë shkelur normat dhe të flitet se si duhet të jetë e si duhet të sillet anëtari i Partisë. Një punë e tillë duhet të bëhet në atë nivel që të shërbejë për tërë vitin dhe jo të diskutojë gjithnjë të njëjtën çështje. Organizata-bazë në çdo mbledhje të merret me probleme të veçanta. Çdo gjë që ka lidhje me një problem të shtrohet me forcë kur duhet, të merret shembull edhe për mirë edhe për keq dhe jo të harrohen problemet kryesore. Prandaj duhet bërë shumë kujdes

pasi kjo është një punë që u takon organizatave-bazë. Partia jonë ka një eksperiencë të madhe në këtë drejtim që ne duhet ta shfrytëzojmë sa më mirë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
taritit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**FSHATIN E RI TA NDERTOJMË NË VEND
TË PERSHTATSHËM, EKZISTUESIN
TA ZBUKUROJMË**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

23 janar 1965

Duhet t'i theksojmë dhe t'i ritheksojmë Partisë që direktivat e Komitetit Qendror të kuptohen mirë, se kështu do të zbatohen drejt. Disa nga këto direktiva janë me perspektivë të gjatë dhe nuk duhet shpejtuar në zbatimin e tyre. E tillë është edhe direktiva për përqendrimin e ardhshëm të fshatit.

Kjo direktivë nuk duhet kuptuar që të realizohet brenda një dite, një muaji, një viti apo qoftë edhe brenda 10 vjetësh. Të përpiqesh ta realizosh këtë direktivë në të gjitha fshatrat e vendit tonë brenda një kohe të shkurtër, kjo do të ishte e pamundur. Po ta përqendro-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e komiteteve të Partisë të rretheve Skrapar, Gramsh, Mirditë dhe Pukë për përqendrimin e ardhshëm të fshatit.

nim ndërtimin e fshatit tonë menjëherë, kjo do të kërkonte një sasi kaq të madh materialesh saqë çdo familje mund të ngrinte shtëpi të re një herë në 5 vjet. Për ne ky do të ishte një luks i tepërt, lëre pastaj që askush nuk mund ta bëjë një gjë të tillë. Problemi i përqendrimin të ardhshëm të fshatit nuk zgjidhet në afate të shkurtra, ai ka të bëjë me perspektivën.

Kur flasim për përqendrimin e fshatit tonë, duhet të kuptojmë që fshatin ekzistues në asnjë mënyrë të mos e shkatërrojmë. Nëpër fshatra ne kemi edhe shtëpi që janë ndërtuar prej 80 vjetësh. Kjo nuk do të thotë që të tilla shtëpi t'i prishim, në asnjë mënyrë. Të mendosh dhe të veprosh kështu është e kundërta e asaj që ka vendosur Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë i Qershorit të vitit 1963.

Ne nuk duhet t'i nxitim fshatarët të bëjnë shtëpi të reja, kur ata e kanë shtëpinë. Në qoftë se fshatari ka shtëpi, qoftë edhe të vjetër, atëherë ta nxitim që ta meremetojë atë, t'i bëjë penxhere, tavan, oxhak, banjë, ta mobilojë gradualisht mirë e më mirë, me qëllim që në një shtëpi të tillë të rregulluar dhe të mobiluar të jetojë rehat. Në qoftë se ndonjë fshatar kërkon të bëjë shtëpi të re kur ai mund të banojë akoma edhe disa vjet në shtëpinë që ka, t'i themi se atje ku është e ka të mirë shtëpinë, prandaj le të qëndrojë edhe ca kohë dhe nga ana tjetër t'i jepet mundësia të shtojë ndonjë dhomë po të dojë. Pra, të bëjë shtëpi të re, ne nuk e lejojmë, por jo ama ta ndalojmë të ndreqë çatinë, një mur ose të shtojë një dhomë të re. Gjithashtu, një fshatari që e ka shtëpinë larg fshatit në mes të fushës, nuk mund t'i themi ta prishë shtëpinë atje ku e ka në fushë se

është i izoluar, se na ka zënë shumë tokë dhe të ndërtojë një të re në qendër të fshatit. Asnjë fshatar nuk duhet ta nxitim ta prishë shtëpinë, kur ajo është e fortë dhe mund të qëndrojë në këmbë edhe për disa vjet. Por, kur një fshatar banon në një kasolle, larg fshatit dhe dëshiron të ndërtojë shtëpi të re, të mos e lejojmë ta bëjë përsëri larg fshatit, atje ku kishte më parë kasollen. Natyrisht kjo do bërë kurdoherë jo me forcë, po me bindje. Çështje të këtilla duhet të shikohen me shumë kujdes dhe të mos shtrembërohen direktivat. Kurse ata që duan të bëjnë shtëpi të reja, se i kanë mundësitë financiare etj., t'i bindim që t'i ndërtojnë atje ku parashikohet të jetë fshati i ardhshëm.

Nuk mund të prishim me forcë një fshat prej 20-30 shtëpish dhe të ndërtojmë në vend të tyre shtëpi të reja në qendrën e caktuar. Po atëherë si do të bëjmë, kur fshatarët do të kërkojnë të bëjnë shtëpi të reja? Në vendin e caktuar për fshatin e ardhshëm të ndërtojmë, në radhë të parë, shkollën. Fshatarit, që do të bëjë shtëpi të re, t'i themi se, po të dojë, e mira e tij është që atë ta ndërtojë afër shkollës, pasi kështu edhe fëmija e tij do ta ketë shtëpinë pranë shkollës. Veç kësaj, fshatarëve t'u thuhet se afër shkollës do të ndërtohet klubi, vatra e kulturës, çezma, fusha sportive, infirmieria, furra e bukës etj., se aty do të jetë kabina elektrike, do të vijë edhe rruga që lidh fshatin me fshatrat e tjera ose me rrugën nacionale. Të tilla ndërtime do t'i bëjë kooperativa bujqësore ose ndërmarrja komunale. Rreth kësaj qendre të fshatit të ardhshëm, gradualisht dhe në forma të rregullta do të mbliidhen ba-

norët e fshatit. Ndërtime të tilla do t'i tërheqin fshatarët t'i bëjnë shtëpitë e tyre aty përreth.

Dihet se krizë banesash në fshatin tonë socialist nuk ka. Fshatarët kanë ndërtuar vetë shumë shtëpi, afër 100 000 dhe mendojmë se kanë bërë shumë mirë. Këto shtëpi u ndërtuan pa llogaritur ato që trashëguam, të cilat edhe janë riparuar. Tani jemi në një situatë që si krahët e punës, ashtu edhe materialet e ndërtimit etj., na nevojiten më shumë për ndërtimin e uzinave, fabrikave, hidrocentraleve, rrugëve, shkollave, spitaleve, si edhe për shtëpi në qytete. Prandaj, derisa sot në fshat nuk kemi krizë banesash dhe, duke pasur parasysh interesat e përgjithshme të Republikës, në asnjë mënyrë nuk duhet t'i nxitim fshatarët për të ndërtuar shtëpi të reja. Ne do të përpiqemi të krijojmë më shumë mundësi që fshatari të zbukurojë brenda banesën e tij dhe njëkohësisht të lehtësohemi nga kërkesat e shumta për çimento, gurë, tulla, tjegulla etj. Në kushtet që jemi, në qoftë se do t'u japim edhe fshatarëve çimento për të ndërtuar shtëpi, atëherë do të na mbeten pa u bërë ndërtimet tona kryesore. Edhe kontingjentet që janë parashikuar për materialet e objekteve kryesore, nuk kanë qenë të studiara mirë. Po edhe sikur të ishin parashikuar si duhet, përsëri fshatarët nuk kemi mundësi t'i furnizojmë me të gjitha ato materiale që kërkojnë. Partia këtë duhet ta kuptojë mirë.

Sikurse vunë në dukje shokët që diskutuan, edhe unë dua të theksoj gjithashtu se, për të ndërtuar me dhjetëra mijë shtëpi në Shqipëri, fshatarët nuk kanë pritur t'u shkonte çimentoja nga qyteti, ata shtëpitë i kanë ndërtuar vetë. Kurse disave tani u ka hipur një

mani e sëmurë, siç është ajo që shteti duhet të parashikojë gjer në gozhdën e fundit për çdo shtëpi që bën fshatari. Kjo nuk është e drejtë.

Ndonjë shok nga komitetet e Partisë na thotë: «Duam automobil për të siguruar transportimin e materialeve të ndërtimit për nevojat e fshatit». Po ku t'i gjejmë? Pse, me automobila i kanë bërë fshatarët shtëpitë përpara, apo me krahët dhe me kafshët e tyre? Atëherë, përse të mos i bëjnë shtëpitë edhe tani me krahë dhe me kafshë? Sigurisht, po të kesh automobila edhe për nevoja të kësaj natyre, kjo do të ishte gjë e mirë. Kërkesa në vetvete është përparimtare, por komunistët kërkesa të tilla duhet t'i gjykojnë brenda mundësive të planit të shtetit, që po bën ndërtime të shumta. Prandaj të mos vihen në gjumë iniciativat e mira të masave, mjeshtëria dhe zotësia e tyre tradicionale, përkundrazi, ato të nxiten. Kjo është një detyrë e madhe për komunistët, por këtë çështje më duket nuk e shikojmë si duhet. Partia ka punuar që populli të ngrihet politikisht, prandaj ka mundësi t'i bindë njerëzit edhe në këtë drejtim që të veprojnë duke shfrytëzuar të gjitha rezervat dhe të mos kërkojnë nga shteti jashtë mundësive të tij. Ne kemi në vend rezerva të mëdha që për ndërtimet në fshatra, sidomos për shtëpitë e reja, të mos i biem në qafë shtetit, duke kërkuar të na sigurojë gjithçka.

Ia thashë me të qeshur një shoku të Ministrisë së Ndërtimit nëse kanë bërë gjë në drejtim të fshatit; po ne e kemi të qartë se, në kushtet e sotme, nuk është e mundur të përgatitim për të gjitha fshatrat planimetritë, projektet e shtëpive etj., etj. Po mos vallë i kanë

ndërtuar keq gjyshërit tanë shtëpitë që kemi trashëguar? Sipas kohës, shtëpitë ata nuk i kanë ndërtuar keq, përkundrazi i kanë bërë të përshtatshme për të banuar. Sigurisht ato janë ndërtuar më shtrenjtë, nuk janë ndërtuar dhe me aq ekonomi. Në këtë drejtim mund të ndihmojë ca Ministria e Ndërtimit, po ajo nuk mund të bëjë çdo gjë. Por mund të ndihmojë shumë sidomos Partia, mund të ndihmojnë komunistët, me ndjenjat, me horizontin dhe me aftësitë e tyre. Për shembull, kur një fshatar ka ndër mend të ndërtojë një shtëpi të re në fshat, një gjë të tillë komunistët e marrin vesh. Atëherë, anëtar i Partisë që është afër këtij fshatari, duke e pasur më të qartë perspektivën e zhvillimit të jetës në vendin tonë në të ardhmen, të shkojë dhe të bisedojë me të, ta këshillojë këtë fshatar se ku e si ta ndërtojë më mirë shtëpinë. Komunisti, që ka një horizont më të gjerë, duhet patjetër ta bindë fshatarin si ta ndërtojë më mirë shtëpinë e tij të re. Kur sheh që po bën, ta zëmë 4 dhoma të mëdha, mund t'i thotë pse të mos ndërtojë 5 dhe më të vogla, që shtëpisë t'i bëjë edhe banjë, korridori të jetë njëçikë më i gjerë etj., etj.? Me një fjalë, komunisti të diskutojë me fshatarin, t'i hapë perspektivën, ta ndihmojë, se kjo nuk i kushton asgjë. Por kjo nuk bëhet si duhet, prandaj të gjithë kërkojnë arkitekt, planimetri, rilevim topografik, nga do t'i vijë rruga etj., etj. Shokët komunistë në fshat, pa qenë nevoja të kërkojnë t'u vejë njeri nga rrethi, mendoj se mund ta caktojnë vetë qendrën e fshatit në një kodër të bukur, të parashikojnë atje shtëpitë e ardhshme, rrugën, çezmën, shkollën, infermierinë, furrën, dyqanet, zyrat e administratës të kooperativës etj., në

mënyrë që, kur të vijë koha për t'i ndërtuar të gjitha këto, kjo qendër të duket si një çerdhe e bukur. Mirëpo nuk veprohet kështu, po ka tendencë që të tërë të zbresin në fushë, të mos qëndrojnë sipër në kodër apo në mal.

Direktivat e Partisë kërkojnë që fshatin ta përqendrojmë në një vend dhe për këtë qëllim duhet të gjendet vendi më i përshtatshëm, por duke pasur kurdoherë parasysh kriteret ekonomike që jo vetëm të mos na harxhohet pa vend toka e bukës, por të mos na prishen edhe shtëpitë ekzistuese. Në vendin e caktuar për fshatin e ri të përpiqemi t'i grumbullojmë të gjithë ata që duan të bëjnë shtëpi të reja, por kurdoherë me rrugën e bindjes.

Me këto vërejtje mendoj se nuk e pengojmë zbatimin e vendimit të Komitetit Qendror të qershorit 1963. Të mos merremi me punë, sa për t'u marrë me punë. Komitetet e Partisë ta kuptojnë drejt këtë çështje. Në përgjithësi në fshatrat e Jugut çështjen e planimetrisë nuk e kemi problem. Një problem i tillë, pra, nuk shtrohet as për Korçën as për Gjirokastrën, Përmetin apo për rrethet e tjera ku fshatrat janë përqendruar në një vend. Atje detyra vihet për zbukurimin e fshatit. Tjetër problem është për Mirditën. Atje duhet të jepet edhe ndihmë nga shteti se shtëpitë janë të tëra të shpërndara. Pikërisht në rrethe të tilla na duhet ta studiojmë vendin dhe të caktojmë qendrën e fshatit. Por edhe kjo nuk do të thotë që tani të vihemi e të prishim kullat e mirditorëve për të ndërtuar shtëpitë e tyre në qendrën e re. Kjo do të bëjë gradualisht. Në qoftë se ndonjërit i rrëzohet shtëpia, ta këshillojmë, ta bindim që

ta ndërtojë atje ku është parashikuar qendra e fshatit. Për këtë qëllim të punohet edhe politikisht me fshatarin, ai të ndihmohet edhe ekonomikisht, në mënyrë që të shkëputet më lehtë nga trualli ku e ka pasë ndërtuar gjyshti shtëpinë. Në qendrën e caktuar për ndërtimin e fshatit të ri, të ndërtohen në radhë të parë dhe gradualisht të gjitha ato ndërtesa që kanë karakter shtetëror dhe shoqëror. Për shtëpitë e fshatarëve të kihet durim, të pritët.

Në rrethet e tjera të mos krijojmë probleme ekonomike dhe politike, e kam fjalën sidomos për ato fshatra që nuk e kemi të ngutshëm problemin e strehimit. Ne duhet të përpiqemi që edhe planimetritë e fshatrave t'i bëjmë, por e përsëris jo të ngutemi që t'i bëjmë domosdo brenda 2 ose 7 muajsh, po gradualisht me radhë, në bazë të një plani. Ndërtimet shoqërore dhe shtetërore, në radhë të parë, t'i bëjmë me plan. Të caktohet qendra e fshatit, e cila të plotësohet dalngadalë me ndërtime sipas planit për çdo ndërtim. Ne nuk i kemi mundësitë që t'i çojmë të gjithë fshatarët brenda pak vjetëve atje ku është perspektiva të ndërtohet fshati i ri më i bukur.

Pra, të mos bëjmë gabime, shokë e të na krijohen vështirësi kot në lidhje me këtë çështje. Flasim për perspektivën e fshatit tonë, për përqendrimin e tij në të ardhmen.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PERÇARJE NË GJIRIN E REVIZIONISTËVE

*Shënime rreth mbledhjes së Komitetit Politik
të Traktatit të Varshavës*

25 janar 1965

Informatat e para që na vijnë mbi zhvillimin e mbledhjes së Komitetit Politik të Traktatit të Varshavës vërtetojnë parashikimet tona. Në këtë mbledhje pati grindje, kontradikta të thella dhe mosmarrëveshje gati në të gjitha çështjet kryesore që u shtruan, ose më mirë të themi që duhej të shtroheshin. Komunikata që u botua, ashtu si mendonim, nuk shprehte asgjë konkrete. Por më e keqja për ata, është ajo, që as problemit që ishte në rendin e ditës, dhe as atyre që mund t'i shtroheshin, nuk mund t'u shkohej deri në fund, ashtu si duhet të bëjë një forum i tillë siç është Komiteti Politik i Traktatit të Varshavës. Pra, rendi i ditës vetëm sa u prek, në disa formulime të përgjithshme që edhe mbi këto nuk kishte dhe nuk mund të kishte unanimitet.

Arsyeja kryesore e një mbledhjeje të tillë pa sukses është frika e përçarjes flagrante në mes revizionistëve, pse kontradiktat midis tyre janë të pakapërcyesh-

me. Kjo është shpata e Damokleut që u qëndron mbi krye. Në fakt, ata s'janë dakord me njëri-tjetrin, vepronë të veçuar dhe duke mbrojtur secili interesat e veta thjesht kombëtare, në dëm të interesave të unitetit të veprimit të përbashkët. Unitetit të vërtetë ata i kanë vënë minat. Problemeve që nxjerr koha e që kërkojnë zgjidhje urgjente me qëndrime të qarta e të vendosura, u shkohet përciptas, dhe dilet, sikundër dolën, me një komunikatë të atillë, që gjithë shtypi perëndimor e talli, e vuri në lojë; vetëm shtypi amerikan, për t'ia ngritur «prestigjin» kësaj komunikate leckë, kërkoi të gjente gjoja prapa frazave të saj njëfarë «kërcënimi të padukshëm dhe shumë të maskuar». Imperialistët amerikanë, si duket janë të skandalizuar dhe njëkohësisht të hidhëruar për këtë «inkapacitet flagrant të veprimit» të aleatëve të tyre revizionistëve sovjetikë.

Por është fakt, se mbledhja e Komitetit Politik të Traktatit të Varshavës u kërkua nga Ulbrihti, i cili nuk arriti, të paktën, të fitonte duke inkuadruar një frazë në komunikatë, ku të flitej për mbrojtjen e RDGJ dhe ndonjë kërcënim qoftë formal për fashistët e Bonit. Ulbrihti korri erë. Të paktën, Hrushovi lëshonte nga ndonjë «të bërtitur» sa për sy e faqe. Pjesëmarrësit e mbledhjes s'kanë qenë në një mendje në lidhje me disa formulime të komunikatës dhe kontradiktat kanë arritur gjer atje sa ndonjëri ka kërcënuar me largimin e tij, duke mos e nënshkruar atë.

Për letrën e Qeverisë sonë që i drejtuam Komitetit Politik të Traktatit të Varshavës s'kemi dijeni të plota se si u përdor, por, patjetër edhe në qoftë se nuk është lexuar, duhet të jetë shpërndarë dhe ajo ka dominuar

dhe ka dërrmuar komplotistët revizionistë në panik. Ata me siguri presin me ankth shpërthimin publikisht të bombës sonë që nuk do të mungojë dhe nuk do të vonojë të shpërthejë.

Sovjetikët, sigurisht, për të mos lënduar plagët e rënda që i kanë pllakosur, s'guxuan të shtronin edhe probleme të tjera shumë akute e veçanërisht probleme të tilla, si mbledhja e famshme e marsit 1965 që u ka mbetur në derë.

Revizionistët sovjetikë, që kanë ardhur në fuqi pas Hrushovit, s'i kanë dhe aq mirë punët me partitë revizioniste të Evropës Lindore. Ata kanë rënë nën kthetrat dhe nën mëshirën e agjentit të borgjezisë, revizionistit Gomulka. Bisedojnë me të kokë më kokë, qajnë hallet, qajnë në prehrin e Gomulkës dhe gjarpëri po i kafshon më tepër se ç'i ka kafshuar.

Klika «Mikojan-Brezhnjev» është suita shkatërrimtare e Bashkimit Sovjetik. Kjo periudhë është ajo e rrokullisjes në greminë të Bashkimit Sovjetik, proces ky i filluar nga Hrushovi dhe që vazhdon prej grupit të tij.

Është detyrë imediate e partive të vërteta marksiste-leniniste që të luftojnë pa pushim kundër revizionistëve hrushovianë, t'i demaskojnë ata deri në fund, se vetëm kështu do të inkurajojnë, do të sqarojnë dhe do të fuqizojnë forcat revolucionare për të shpëtuar Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera që kanë rënë nën kthetrat e revizionizmit modern e të kapitalizmit botëror.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 26-të

V—X

1964

- PARTIA KA NEVOJË PËR DITURINË DHE ZOTËSINË E ANËTARËVE TË SAJ — Fjala në shkollën e Partisë «V. I. Lenin» me rastin e 15-vjetorit të krijimit të saj (20 tetor 1964) 1—24
- MARRJA E PUSHTETIT ISHTE NJË NGA DETYRAT KRYESORE TË LUFTËS SONË ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE — Fjala në drekën e shtruar në Berat me rastin e festimit të 20-vjetorit të Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar (22 tetor 1964) 25—41
- POPUJT NUK DO TË NA FALIN, PO TË DOBËSOJMË VIGJILENCËN NDAJ ARMIQVE TË KLASËS — Nga biseda me një udhëheqës të Partisë Komuniste të Indonezisë (24 tetor 1964) 42—67
- PARTIA KËRKON QË POPULLI DHE USHTRIA TË JENË TË QARTË POLITIKISHT DHE TË PËRGATITUR USHTARAKISHT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (30 tetor 1964) 68—80
- TË ORGANIZOJMË DHE TË DREJTOJMË MË MIRË ARSIMIN E PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (30 tetor 1964) 81—85

- 1
TË ZHVILLOJMË NË MËNYRË TË ORGANIZUAR
INFORMACIONIN POLITIK NË PARTI DHE NË
MASAT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH (30 tetor 1964) 86—92
- ME RËNIEN E N. HRUSHOVIT NUK ËSHTË ZHDU-
KUR REVIZIONIZMI HRUSHOVIAN — Artikull i
botuar në gazetën «Zëri i popullit» (1 nëntor 1964) 93—102
- ATA U BËNË TË PAVDEKSHËM DHE SOT RROJNË
NË ZEMRAT TONA — Letër dërguar nënave dhe
familjeve të dëshmorëve të rrethit të Tepelenës
(8 nëntor 1964) 103—105
- KRYESORJA ËSHTË TË MBËSHTETEMI FUQI-
MISHT NË FORCAT TONA — Diskutim në mbledhjen
e Byrosë Politike të KQ të PPSH (9 nëntor 1964) 106—113
- «TESTAMENTI» I P. TOLIATIT, KRIZA E REVIZIO-
NIZMIT MODERN DHE LUFTA E MARKSISTË-LE-
NINISTËVE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i
popullit» (13 nëntor 1964) 114—156
- NË KËTO SITUATA TË PËRPIQEMI PËR TË
SITUAR REZERVAT — Diskutim në mbledhjen e
Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 nëntor 1964) 157—162
- FORCA E POPUJVE TË VEGJËL QËNDRON NË
UNITETIN E TYRE LUFTARAK PËR LIRI, PAVA-
RËSI DHE PËRPARIM SHOQËROR — Nga biseda
në takimin me zonjën Shirlei Graham Dy Bua, drejtore
e televizionit të Republikës së Ganës (27 nëntor 1964) 163—170
- 20 VJET SHQIPËRI SOCIALISTE — Fjala në mbledh-
jen solemne kushtuar 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut
(28 nëntor 1964) 171—238

- REVIZIONISTËT MODERNË JANË SABOTATORË
TË LUFTËRAVE ÇLIRIMTARE TË POPUJVE — Nga
biseda me delegacionin e Frontit Kombëtar të Çlirimit
të Vietnamit të Jugut (2 dhjetor 1964) 239—249
- REVIZIONISTËVE HRUSHOVIANË LITARI PO U
MBLIDHET NË FYT DHE PO I SHTRËNGON — Bi-
sedë me një delegacion të Partisë Komuniste dhe të
Qeverisë së RP të Kinës (10 dhjetor 1964) 250—255
- SIDO QË TË ZHVILLOHEN SITUATAT, E ARDHMJA
DHE FITORJA DO TË JENË ME MARKSIZËM-LENI-
NIZMIN — Bisedë me Sekretarin e Përgjithshëm të
Partisë Komuniste Peruanc, Saturnino Paredes Macedo
(15 dhjetor 1964) 256—286
- DUKE U MBËSHTETUR NË FORCAT E POPULLIT
TONË NE DO TË ECIM KURDOHERË PËRPARA
— Nga biseda me përfaqësues të kolonive shqiptare
të mërgimit të ardhur në vendin tonë me rastin e
20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut (16 dhjetor 1964) 287—303
- MBETURINAT E VJETRA JANË SI PLAGA NË
TRUP QË, PO NUK U MJEKUA, INFEKTON TËRË
ORGANIZMIN — Diskutim në mbledhjen e Sekreta-
riatit të KQ të PPSH (17 dhjetor 1964) 309—322
- NË NDËRTIM KËRKOHET MË TEPËR PËRQE-
NDRIM — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të
KQ të PPSH (17 dhjetor 1964) 323—326
- REALIZMIT SOCIALIST I PËRKET E ARDHMJA
— Shënim në librin e përshtypjeve të ekspozitës kom-
bëtare të arteve figurative (17 dhjetor 1964) 327—328
- TË MOS I FRYJMË ORGANIKAT, TË LIDHEMI MË
SHUMË ME TERRENIN — Diskutim në mbledhjen e
Byrosë Politike të KQ të PPSH (18 dhjetor 1964) 329—334

LUFTA E PËRBASHKËT E PARTIVE MARKSISTE-
-LENINISTE AFIRMON DHE FORCON UNITETIN
MIDIS TYRE — Nga biseda me një delegacion të
Partisë Komuniste të Zelandës së Re (21 dhjetor 1964) 335—347

TAKTIKA E UDHËHEQJES SË RE REVIZIONISTE
SOVJETIKE — Teza (23 dhjetor 1964) 348—352

1965

MARKSIZËM-LENINIZMI REVOLUCIONAR DO TË
TRIUMFOJË NË EVROPËN E MBARSUR ME RE-
VIZIONIZËM — Artikull i botuar në gazetën «Zëri
i popullit» (6 janar 1965) 353—395

DREJTUES DHE UDHËHEQËS I ÇDO PARTIE
ËSHTE MARKSIZËM-LENINIZMI DHE JO SHKOPI
I DIRIGJENTIT TË HRUSHOVIT — Nga biseda me
një delegacion të Partisë Komuniste të Malajës
(20 janar 1965) 396—422

TË ZHVILLOHEN MË TEJ HOVI DHE INICIATIVA
E ORGANIZATAVE-BAZË TË PARTISË — Diskutim
në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 ja-
nar 1965) 423—429

FSHATIN E RI TA NDËRTOJMË NË VEND TË PËR-
SHTATSHËM, EKZISTUESIN TA ZBUKUROJMË —
Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të
PPSH (23 janar 1965) 430—437

PËRÇARJE NË GJIRIN E REVIZIONISTËVE — Shë-
nime rreth mbledhjes së Komitetit Politik të Trak-
tatit të Varshavës (25 janar 1965) 438—440

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1978